



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice

JUSTICIA

**REVISTË JURIDIKE E GJYQTARËVE,
GJENERATA E VI DHE E PROKURORËVE TË SAPO
EMËRUAR, GJENERATA E VII
NË PROGRAMIN E TRAJNIMIT FILLESTAR**

JUSTICIA

Revistë juridike e gjyqtarëve, gjenerata e VI dhe e prokurorëve të sapo emëruar, gjenerata e VII në Programin e Trajnimit Fillestar

Viti VII, Nr. 7 /2020

Botues

Akademia e Drejtësisë

ANËTARËT E REDAKSISË

Agim Kurmehaj, Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Pejë

Abdulla Aliu, ish Profesor në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës

Hashim Çollaku, Gjyqtar në Gjykatën e Apelit

Rafet Haxhaj, Gjyqtar në Gjykatën e Apelit

Dizajni dhe radhitja kompjuterike:

Akademia e Drejtësisë

Publikuar nga Akademia e Drejtësisë

© Akademia e Drejtësisë 2020, Të gjitha të drejtat e rezervuara

Përmbajtja e këtij materiali nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcillet në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim të Akademisë së Drejtësisë

Pikëpamjet e autorëve nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Akademisë së Drejtësisë

Tabela e përmbajtjes

Dren Rogova Përgjegjësia civile e gjyqësorit për dëmet e shkaktuara nga gjykatat: Vështrim krahasues	5
Dardan Kadolli Aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve	29
Filloreta Lekiqi Liria e shprehjes – deri ku shtrihet	53
Hysni Ismajli Fitimi i pronës së paluajtshme në Kosovë, nga qytetarët e shteteve anëtare të Bashkimit Europian	69
Paulin Pashku Provat në Procedurën Penale: Parimet, Kategorizimi dhe Shqyrtimi i Provave	79
Rexhep Gashi Roli i të dëmtuarit në procedurën penale sipas kodit të procedurës penale të Kosovës	92
Rilind Sermaxhaj Ankesa kundër aktgjykimit sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës	105
Rrahman Beqiri Veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës	122
Veton Ademaj Masat edukative ndaj personave të mitur të parapara në Kodin e Drejtësisë për të Mitur	142

Fjala hyrëse

Të nderuar lexues,

Kam kënaqësinë e veçantë që para jush të paraqesë numrin e shtatë të revistës juridike “Justicia” e cila është eskuzivisht e dedikuar për publikim të punimeve hulumtuese nga gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar të cilët kane ndjekë Trajnimin Fillestar në Akademi të Drejtësisë në vitin 2018/2019

Akademia e Drejtësisë dhe anëtarët e Redaksisë së Akademisë në këtë revistë kanë përmbledhur disa nga punimet hulumtuese të gjyqtarëve në gjeneratën e VI-të, dhe prokurorëve në gjeneratën e VII –të, e që kanë ndjeke dhe përfunduar me sukses Trajnimin Fillestar në Akademinë e Drejtësisë. Redaksia e Akademisë konform prioriteteve dhe standardet e kërkuara për publikim, ka vlerësuar se mënyra e trajtimit dhe tematika e përzgjedhur nga autorët e punimeve prezantojnë vlerë të shtuar për revistën “Justicia”, dhe pas një pune të gjatë editoriale në bashkëpunim të ngushtë me autorët kanë vendosë që këto punime t’i publikoj në këtë numër të revistës.

Akademia e Drejtësisë ne vazhdimësi nëpërmes revistës “Justicia “ ju mundëson të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve të emëruar të publikojnë punimet autoriale të cilat zhvillohen si rezultat i ngritjes së shkathtësive hulumtuese dhe analitike nëpërmes kurikules trajnuese në kuadër të trajnimit fillestar. Andaj, edhe kësaj radhe mundësia për të publikuar punime hulumtuese në këtë revistë ka qenë e hapur për gjithë gjyqtarët dhe prokurorët emëruar në gjeneratat si të lartshënuara që kane përfunduar trajnimin fillestar.

Revista ofron këndvështrimin e autorëve të mbështetur në hulumtim dhe argumentim për çështje ligjore nga fusha civile, penale dhe nga aspekti i lirive dhe të drejtave të njeriut duke kontribuar kështu në mendimin kritik, shkëmbimin e përvojave si dhe në pasurimin e literaturës juridike.

Shpresojmë që ky numër i revistës do të inkurajoje dhe motivoje gjyqtarët dhe prokurorët e tjerë që janë apo edhe do të jenë pjesë e Programit të Trajnimit Fillestar, në zhvillimin dhe angazhimin e vazhdueshëm për hulumtime dhe për publikim me theks në avancimin e praktikës gjyqësore dhe zgjidhjes më të mirë dhe në kohe të rasteve duke ju përmbajte standardeve dhe praktikave më të mira të GJEDNJ-së.

Me këtë rast dua të shprehe mirënjohjen dhe falënderimet, si për anëtarët e Redaksisë në vlerësimin, redaktimin si dhe realizimin e suksesshëm të punës editoriale për publikim, autorët e nderuar, që kanë punuar me përkushtim në hartimin dhe elaborimin e gjerë të çështjeve të përfshira në punimet ashtu edhe për stafin edhe bashkëpunëtorët në Akademi të cilët kanë kontribuar në zhvillimin e procesit dhe nxjerrjes së kësaj reviste.

Me respekt,

Enver Fejzullahu, Drejtor Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë

Dren Rogova¹

Përgjegjësia civile e gjyqësorit për dëmet e shkaktuara nga gjykatat: Vështrim krahasues

Abstrakt

Ky artikull trajton aspektet e përgjegjësisë civile për dëmet e shkaktuar nga ana e gjykatave gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, format eventuale të shkaktimit të dëmit, kompensimin e tyre si dhe përgjegjësinë civile të gjyqtarëve. Këto tema do të trajtohen në dritë të interpretimit të normave juridike të legjislacionit në fuqi, praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) dhe Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GJED). Në veçanti do të analizohen: korniza ligjore në Kosovë që ka të bëjnë me imunitetin dhe përgjegjësinë e gjyqtarëve; aktet ndërkombëtare për përgjegjësinë dhe pavarësinë e gjyqësorit; si dhe praktikën ndërkombëtare për dëmet civile të gjyqësorit.

Fjalët kyçe: Përgjegjësia për dëmin, pavarësia e gjyqësorit, kompensimi i dëmit, imuniteti.

Hyrje

Artikulli jep një vështrim për konceptet e përgjegjësisë civile të gjyqësorit, për format e shkaktimit të dëmit palëve në procedurë si dhe mekanizmat për kompensimin e tyre. Do të trajtohet pavarësia dhe imuniteti i gjyqtarëve, si attribute kryesore të një sistemi gjyqësor të pavarur. Këto parime do të shqyrtohen nga aspekti i Kushtetutës dhe një sërë instrumentesh ndërkombëtare. Duke qenë se pavarësia e gjyqësorit nuk mund të mjaftohet vetëm me normat e përgjithshme kushtetuese, shtrohet nevoja e një kornize ligjore e cila synon rruajtjen e pozitës së gjyqtarëve, por edhe ngritjen e llogaridhënies. Andaj, temë bosht e këtij artikulli do të jetë aspekti krahasues i rregullimit të përgjegjësisë civile të gjyqtarëve.

Pjesa kyçe e këtij punimi vë në pah ndikimin e të drejtës evropiane që ka sjellë një qasje më të reduktuar ndaj imunitetit absolut të gjyqtarëve dhe rritje të

¹ Autori është gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Divizioni për çështje civile.

përgjegjësisë karshi ushtrimit të funksionit gjyqësor. Si rezultat i disa rasteve para GJEDNJ-së, shtetet anëtare obligohen t'i kompensojnë qytetarët të cilët pësojnë dëme në procedurat gjyqësore për shkak të lëshimeve nga gjykatat. Shembulli më i mirë në këtë drejtim është numri i madh i aktgjykimeve për shkeljen e të drejtës për një proces në afat të arsyeshëm kohor. Ky segment mjafton për të krijuar bindjen se parimi i përgjegjësisë së shtetit për dëmet e shkaktuara nga ana e gjyqësorit, zbatohet edhe për gabimet e gjyqësorit. Për këto arsye, në shtetet në zhvillim siç është Kosova, është i domosdoshëm ndërtimi i një kornize ligjore që rregullon çështjen e përgjegjësisë në raport me dëmet e shkaktuara nga ana e gjyqësorit.

1. Pavarësia – imuniteti si “gardian” i gjyqtarit!

Pavarësia e gjyqësorit është një prej parakushteve kryesore për sundimin e ligjit dhe garanci themelore për një gjykim të drejtë. Shtetet demokratike përmes këtij parimi iu garantojnë gjyqtarëve që gjatë ushtrimit të funksionit të tyre dhe marrjes së vendimeve të jenë të pavarur dhe të paanshëm.² Pavarësia e gjyqtarëve sigurohet dhe proklamohet edhe me instrumente të ndryshme ndërkombëtare,³ Këto instrumente synojnë ruajtjen e integritetit dhe pavarësinë e gjyqtarëve, në mënyrë që të punojnë të pavarur nga presionet dhe

² Shih Neni 4 par.5 dhe Neni 102 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës; Neni 3 Ligji Nr.03/L-199 për Gjykatat, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës: Viti V/ Nr.79/ 24 Gusht 2010).

³ Për më tepër shih: “Mount Scopus Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë Gjyqësore”, të Shoqatës Ndërkombëtare të Pavarësisë Gjyqësore dhe Paqes Botërore, <https://www.icj.org/wp-content/uploads/2016/02/Mt-Scopus-Standards.pdf>; Standardet Minimale të Nju Delhit të Asociacionit për Pavarësinë Gjyqësore të miratuar në vitin 1982;

Deklarata Universale e Montrealit mbi Pavarësinë e Drejtësisë e vitit 1983;

Parimet themelore të Pavarësisë Gjyqësore të OKB-së të vitit 1985 (UN Basic Principles on the Independence of the Judiciary endorsed by the General Assembly resolutions 40/32 of 29 November 1985 and 40/146 of 13 December 1985) e qasshme në:

<http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/IndependenceJudiciary.aspx>;

Deklaratat e Këshillit të Evropës për pavarësinë gjyqësore (veçanërisht Rekomandimi Nr.94(12) i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare - pavarësia, efikasiteti dhe roli i gjyqtarëve), <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1707137>;

Karta Evropiane mbi Statutin e Gjyqtarëve e Këshillit të Evropës, e qasshme në: http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/evaluations/round4/European-Charter-on-Statute-of-Judges_EN.pdf;

Parimet e Bangalorit mbi Etikën Gjyqësore të vitit 2002:

http://www.unodc.org/pdf/crime/corruption/judicial_group/Bangalore_principles.pdf, etj.

ndikimet. E tërë kjo ka për qëllim garantimin e një procesi të drejtë dhe të pavarur në dhënien e drejtësisë nga gjykatat.⁴

Për ta ruajtur pavarësinë e gjyqësorit – gjyqtarët gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile apo shkarkimi nga funksioni për vendimet e tyre. Imuniteti i gjyqtarëve, si parim fundamental i pushtetit gjyqësor, garanton pavarësinë në punën dhe vendimmarrjen e tyre.⁵ Pra, siç shihet, parimi i pavarësisë dhe imuniteti janë të lidhura me njëra tjetrën dhe kanë për qëllim që t'i sigurojnë gjyqtarët nga çfarëdo ndikimi apo ndërhyrje nga institucionet apo faktorët e jashtëm në proceset gjyqësore.⁶

Çështja e imunitetit gjyqësor për veprimet e ndërmarra në cilësinë profesionale të gjyqtarit është trajtuar edhe nga GJEDNJ në rastin *Sergej Zubarev kundër Rusisë*.⁷ Edhe pse në këtë rast GJEDNJ nuk gjeti shkelje të Nenit 6 §1 – Gjykata e argumentoi edhe çështjen e imunitetit të gjyqtarëve. Lidhur me këtë Gjykata gjeti se është në interes të publikut që “*gjyqtarët të jenë të lirë të ushtrorjnë funksionin e tyre të pavarur dhe pa frikë nga pasojat, përderisa palët ndërgjyqëse mund të mbrojnë veten nga gabimet gjyqësore duke ushtruar ankesat e tyre në gjykatën e apelit pa ngritur padi për përgjegjësi personale ...*”⁸

Megjithatë, kur flitet për pavarësinë e gjyqtarëve me të drejtë mund të thuhet se, “*të qenit i pavarur nuk i bën gjyqtarët të papërgjegjshëm*”.⁹ Në raport me pavarësinë dhe imunitetin e gjyqtarëve, përgjegjësia është kusht i domosdoshëm për ta balancuar pushtetin gjyqësor. Kjo baraspeshë ka të bëjë me rruajtjen e kredibilitetit dhe profesionalizimit në marrjen e vendimeve, në njërin anë dhe parandalimin e keqpërdorimit të pushtetit gjyqësor nga gjyqtarët, në anën tjetër. Kur flasim për përgjegjësinë e gjyqtarëve, me theks

⁴ United Nations Basic Principles on the Independence of the Judiciary, *supra* 3

⁵ Neni 107 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Shih po ashtu, Enver Hasani, Ivan Čukalović “*Komentar-Kushtetuta e Republikës së Kosovës*”, 2013 GIZ, Prishtinë

⁶ Pika I(2)a(i) e Rekomandimit Nr.94(12) të Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare mbi ‘Pavarësinë, Efikasitetin dhe Rolin e Gjyqtarëve.

⁷ Rasti *Sergej Zubarev kundër Rusisë*, nr. 5682/06, 5 shkurt 2015, ka të bëjë me padinë e z. Zubarev (avokat) për shpifje dhe kompensim dëmi, kundër një gjyqtare, e cila kishte iniciuar procedurë disiplinore në Odën e Avokatëve ndaj z. Zubarev (për sjelljen e tij në procedurën civile, respektivisht shkaktimin e vonesave në disa seanca gjyqësore). Gjykatat vendore kishin hedhur poshtë padinë e z. Zubarev për shkak të imunitetit gjyqësor të gjyqtarit në përgjegjësinë profesionale. <http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-150785>

⁸ Po aty, parag.32

⁹ Report of the European Network of Councils for Judiciary (ENCJ), Working Group on Liability 2007-2008:

<https://www.encj.eu/images/stories/pdf/workinggroups/reportenliability20072008.pdf>

në përgjegjësinë civile për dëmin e shkaktuar mendohet në përgjegjësinë e gjyqtarëve për veprimet apo mosveprimet, respektivisht gabimet e shkaktuara gjatë ushtrimit të funksionit të tyre apo shkeljes së detyrës zyrtare - me c' rast palëve në procedurat gjyqësore mund t'i shkaktohet dëm eventual. Në këtë drejtim shtrohet pyetja se kush përgjigjet për dëmet e shkaktuara nga gjykatat, nëse ato shkaktohen?

2. Përgjegjësia civile e gjyqtarëve apo përgjegjësia e gjyqësorit: Kush duhet të përgjigjet?

Shtetet e ndryshme, varësisht nga sistemi juridik, i garantojnë gjyqësorit pavarësi në ushtrimin e funksionit të saj.¹⁰ Për të garantuar vendimmarrje të drejtë dhe të paanshme shteti i jep gjyqësorit pavarësi në vendimmarrje, rrjedhimisht edhe gjyqtarëve. Përmes imunitetit funksional gjyqtarët janë të mbrojtur "*...nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra [...] brenda fushëveprimit [...] të tyre*".¹¹ Imuniteti e kufizon mundësinë që gjyqtari të mbahet përgjegjës për dëmet të cilat iu shkaktohen palëve në procedurat gjyqësore nga puna e gjyqtarit apo vendimi i tij/saj.

Në sistemin kushtetues të Kosovës, gjyqtarëve iu garantohet imunitet funksional, brenda autorizimeve që rrjedhin nga funksioni i tyre si gjyqtarë. Për dallim nga imuniteti funksional i disa vendeve të sistemit kontinental të së drejtës, SHBA-të njihen si një vend që i garantojnë gjyqtarëve imunitet absolutë. Me të ashtuquajturin "Civil Rights Act" të vitit 1871, në SHBA qytetarëve u garantohet e drejta që të padisin qeverinë (shtetin) për shkelje të

¹⁰ Disa sisteme juridike gjyqësorit i garantojnë imunitet absolut në fushën e përgjegjësisë civile për dëmet siç janë SHBA-të, në grupin tjetër bëjnë pjesë shtetet (i.e. Gjermania) me imunitet të kualifikuar, në të cilat përgjegjësia civile e gjyqtarëve kufizohet në pjesën më të madhe me përgjegjësisë penale në procedurë penale. Ndërsa grupin më të madh e përbëjnë shtetet të cilat përgjigjen për dëmin e shkaktuar nga gjyqtarët, me çka shteti ka të drejtën e regresit ndaj gjyqtarit nën kushte të caktuara. Për më tepër rreth imunitetit të gjyqtarëve shih: Prof.Dr.Sc. Vesna Rakic-Vodinelic, "Ogranicena Odgovornost Sudije za Stetu – Neophodna Privilegija koja Obezbedjuje Nezavisnost ili Ucvrscivanje Sudijske Neodgovornosti?", Zbornik Pravnog fakulteta u Zagrebu, Vol.63, br. 3-4 (2013), fq. 717-742, <https://hrcak.srce.hr/109727>;

Timothy M. Stengel, "Absolute Judicial Immunity Makes Absolute No Sense: An Argument for an Exception to Judicial Immunity", Temple Law Review, Volume 84, No.4, Summer 2012, www.templelawreview.org/lawreview/assets/uploads/2012/09/84.4_Stengel.pdf

¹¹ Neni 107 i Kushtetutës

të drejtave civile.¹² Me "seksionin § 1983" të "Civil Rights Act" të vitit 1871, i garantohet çdo personi të cilit i shkelet apo privohet nga ndonjë e drejtë, privilegj apo imunitet, të garantuara me Kushtetutë dhe ligje, që të padisë për dëmshpërblim këdo që i ka shkaktuar këtë dëm.¹³ Mirëpo, përjashtim nga kjo përgjegjësi kanë "zyrtarët gjyqësorë" – gjyqtarët, të cilët nuk përgjigjen për veprimet apo mosveprimet në cilësinë e tyre si gjyqtarë.

Ndonëse "Civil Rights Act" i vitit 1871, e parasheh përgjegjësinë civile për çdo person që i shkakton dëm tjetrit apo e privon nga ndonjë e drejtë civile, kjo nuk gjen zbatim kur bëhet fjalë për imunitetin gjyqësor. Ndonëse jo drejtpërdrejt, çështja e imunitetit civil të gjyqtarëve për herë të parë u trajtua në vitin 1945, në rastin *Picking v. Pennsylvania Railroad*. Në këtë rast paditësit Pickings, që ishin burrë dhe grua, pretenduan se ishin arrestuar ilegalisht në Pensilvani (dhe më pas ishin ekstraduar) në bazë të një urdhër arresti të një gjyqtari të Nju Jorkut, "të lëshuar në mënyrë të kundërligjshme". Padia e paditësve u hodh poshtë nga Gjykata pasi që konstatoi se nuk ekziston "baza e padisë", për shkak të dështimit të paditësve që të paraqesin shkakun (cause of action), ndërsa lidhur me përgjegjësinë e gjyqtarit u vendos që të njëjtit gëzojnë imunitet.¹⁴

Ndryshe nga SHBA-të, ku garantohet imuniteti absolut, një pjesë e shteteve e njohin imunitetin e kualifikuar, sipas të cilit përgjegjësia civile e gjyqtarëve kufizohet në vërtetimin e përgjegjësisë penale. Në Gjermani – ku garantohet imuniteti i kualifikuar gjyqësor, për dëmin e shkaktuar nga zyrtarët shtetëror përgjigjet shteti. Por, ekziston e drejta e regresit ndaj zyrtarit nëse i njëjti mbahet përgjegjës për dëmin e shkaktuar me qëllim apo nga pakujdesia e

¹² Civil Rights Act i vitit 1871 (An Act to enforce the Provisions of the Fourteenth Amendment to the Constitution of the United States and for other Purposes) apo sic njihet ndryshe si "The Enforcement Act of 1871" apo "Ku Klux Klan Act", është Akt i Kongresit të 42-të të SH.B.A-ve, i cili është aprovuar me kërkesë të Presidentit Grant, duke i dhënë autorizim Presidentit që të pezulloj 'habeas corpus'-in dhe të shtyp Ku Klux Klan (KKK), me qëllim që të luftojë sulmet ndaj të drejtave të afro-amerikanëve.

Shih më tepër në <https://legal-dictionary.thefreedictionary.com/Ku+Klux+Klan+Act>.

¹³ Shih lidhur me "Seksionin 1983" të Titullit 42 të "Civil Rights Act 1871": Frank J. Walz, The Civil Rights Act of 1871: Continuing Validity, Volume 40, Issue I, Notre Dame La w Review 70, <https://scholarship.law.nd.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=3223&content=ndlr>; J.Randolph Block, Stump v. Sparkman and the History of Judicial Immunity, 1980 *Duke Law Journal* 879-925 (1980)

<https://scholarship.law.duke.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=2753&content=dlj>;

¹⁴ J.Randolph Block, fq. 904; Vesna Rakic-Vodinelic, fq. 724

rëndë. Gjyqtari mund të përgjigjet sipas të drejtës së regresit ndaj shtetit vetëm nëse shkaktimi i dëmit është vërtetuar me aktgjykim për vepër penale.¹⁵ Pra, që një gjyqtarë të jetë përgjegjës për dëmin civil të shkaktuar brenda funksionit të tij duhet të jetë penalisht përgjegjës me aktgjykim të formës së prerë.

Edhe në Francë, si shtet me imunitet të kufizuar gjyqësorë, gjyqtari mund të jetë përgjegjës për dëmin e shkaktuar me kryerjen e kundërligjshme të funksionit gjyqësor. Këtu, gjyqtari mund të jetë i paditur (vetëm sipas kërkesës së shtetit për rimbursimin e dëmit) për dëmin e shkaktuar nën kushte të caktuara: nëse ai ka kryer shkelje gjatë zhvillimit të procedurës, përmes aktgjykimit, me qëllim, nga pakujdesia ose pakujdesia e rëndë, dhe nëse i ka mohuar të drejtën në gjykim palës. Për dëmin e shkaktuar nga gjyqtari, me anë të veprimeve (të kundërligjshme) të cilat janë vërtetuar në procedurë gjyqësore kundër tij, në aspektin e përgjegjësisë civile përgjigjet shteti. Shteti pastaj ka të drejtë të regresimit të dëmit kundër gjyqtarit.¹⁶

Çështjen e përgjegjësisë së shtetit për shkak të shkeljeve të të drejtës së BE-së nga gjykatat vendore e ka trajtuar edhe Gjykata Evropiane e Drejtësisë (GJED) në rastin *Köbler kundër Austrisë*.¹⁷ Rasti *Köbler* i vitit 2003, kishte të bënte me një profesor austriak të cilit iu refuzua aplikimi për zgjatje të shërbimit si profesor për shkak të mungesës së përvojës së punës, pasi që nuk i kishte 15 vite përvojë në universitetet e Austrisë. Ndërkaq, përvoja e punës si profesor në shtetet tjera anëtare të BE-së nuk iu morr parasysht. Z. Köbler pretendonte se ky refuzim përbënte diskriminim dhe shkelje të lirisë së lëvizjes së punëtorëve (tani Neni 45 i Traktatit të Lisbonës), por Gjykata Administrative e Austrisë e refuzoi kërkesën e tij. Z. Köbler më pas bëri padi për kompensimin e dëmit kundër Austrisë, me pretendimin se Gjykata Administrative e ka shkelur parimin e drejtpërdrejtë të të drejtës së BE-së. Me këtë rast, Gjykata Supreme e Austrisë vendosi të pezullojë procedurën dhe të kërkojë një vendim paraprak (*preliminary ruling*) mbi atë se a mund të konsiderohet një shtet anëtar përgjegjës për shkeljet e të drejtës së BE-së nga ana e gjyqësorit. GJED

¹⁵ Vesna Rakic Vodinelic, fq.726

¹⁶ Shih Vesna Rakic Vodinelic, fq 729, po ashtu, Douglas K. Barth, Immunity of Federal and State Judges from Civil Suit - Time for a Qualified Immunity, 27 *Case Western Reserve Law Review* 727 (1997): <http://scholarlycommons.law.case.edu/caselrev/vol27/iss3/7> fq.751

¹⁷ *Köbler v Austria* (2003) C-224/01., E.C.R. I-10239. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=CELEX%3A62001CJ0224>. Për më tepër shih poashtu: Cees Van Dam, *European Tort Law*, Second Edition, Oxford University Press (2013), fq.46;

është shprehur se Shtetet anëtare mund të konsideroheshin përgjegjëse edhe për shkeljet e të drejtës së BE-së nga ana e gjyqësorit.

Në aktgjykimin e rastit *Köbler*, GJED-ja vendosi që përgjegjësia e një Shteti anëtar për shkeljet e ligjit të BE-së të kryera nga gjykatat kombëtare (që gjykojnë në shkallë të fundit) ekziston në të njëjtat kushte si ato që përcaktojnë përgjegjësinë e një Shteti anëtar për shkelje të tjera të së drejtës së BE-së. Prandaj, që shteti të përgjigjet për dëmin e shkaktuar nga gjyqësori, duhet të plotësohen tre kushtet e mëposhtme: (1) që shkelja e një të drejte duhet t'i jetë cenuar një individ; (2) shkelja duhet të jetë "mjaftueshëm serioze" (3) duhet të ketë një lidhje shkakësore (kauzale) të drejtpërdrejtë midis shkeljes së një detyrimi të shtetit dhe dëmit të shkaktuar palës së dëmtuar.¹⁸ GJED kishte konstatuar se "*përgjegjësia e shtetit për shkelje të së drejtës së BE-së me anë të një vendimi të gjykatës kombëtare që gjykon në shkallë të fundit, mund të ekzistojë vetëm në raste të jashtëzakonshme kur gjykata ka shkelur në mënyrë të dukshme ligjin në fuqi*".¹⁹ Në fund, sa i përket përgjegjësisë individuale, GJED-ja bëri të ditur se ky parim nuk ka të bëjë me "*përgjegjësinë personale të gjyqtarit, por atë të shtetit*".²⁰

Obligimet që kishin dalë nga vendimet e GJED për shtetet anëtare, kishin pasur ndikim në reformimin e kuadrit ligjor për përgjegjësinë e shtetit në raport me dëmet e shkaktuar nga gjyqësori. Italia ishte njëra nga shtetet që përkundër faktit se e kishte një Ligj mbi Shpërblimin e Dëmeve të Shkaktuara nga Ushtrimi i Funkcioneve Gjyqësore, si pasojë e ndikimit të GJED-së ishte detyruar ta ndryshojë këtë ligj. GJED në rastin C-379/10 *Komisioni kundër Italisë*, kishte gjetur se Italia ishte përgjegjëse pasi që ligji në fuqi, përbënte shkelje të drejtës së BE-së. Sepse ligji përjashtonte shtetin italian nga çdo lloj përgjegjësie për dëmet e shkaktuara ndaj individëve për shkak të shkeljes të së drejtës së BE-së.²¹ Si rezultat i ndryshimeve të ligjit ishte pranuar koncepti se "*kërkesat për kompensim duhet të iniciohen kundër shtetit, ku përgjegjësia e 'shtetit si gjyqtarë' ekziston nësoj sikurse shteti përgjigjet për punëtorin*".²² Pra edhe me ligjin e ri, është ruajtur parimi i "përgjegjësisë indirekte" të

¹⁸https://www.coe.int/t/dghl/cooperation/lisbonnetwork/Themis/Civil/Paper3_en.asp#P174_24771

¹⁹ Köbler, parag. 35. (përkthim i autorit)

²⁰ Köbler, parag. 42. (përkthim i autorit)

²¹ Antonio Cilento, The Civil Responsibility of the Italian Judiciary: A Double Speed System, The Italian Law Journal, Volume 3, No. 1 (2017), fq 27

<http://theitalianlawjournal.it/data/uploads/3-italj-1-2017/pdf/cilento.pdf>

²² Po aty, fq 26

gjyqtarit, sipas të cilit parashihet që qytetari i cili ka pësuar dëm të kundërligjshëm si rezultat i veprimit ose mosveprimit të gjyqtarit do të duhet të veprojë vetëm kundër Shtetit. Ndërsa shteti do të kompensohet nga gjyqtari i gjetur përgjegjës, përveç rasteve të veprës penale, në të cilin veprimi i drejtpërdrejtë është i mundur ndaj gjyqtarit.

Nisur nga kjo që u tha më sipër, në shumicën e sistemeve juridike, por edhe nga qëndrimi i GJED-së në rastin *Köbler*, formohet koncepti i përgjegjësisë së shtetit në raport me palët e treta dhe jo përgjegjësia individuale e gjyqtarit për dëmin. Pra, pavarësisht rregullimit të brendshëm të çështjes së imunitetit të gjyqtarëve, qoftë imunitetit absolut, të kufizuar apo imunitetit të kualifikuar, përgjegjësinë civile për dëmin e shkaktuar nga gjykatat e bartë vet shteti – sistemi gjyqësor dhe jo gjyqtari individual. Arsyeja se përse shteti është përgjegjës për punën e gjyqtarëve, vjen si pasojë e konceptit të drejtësisë si një "shërbim publik" - i cili duhet të vlerësohet mbi bazën e cilësisë së shërbimeve të ofruara. Me pranimin e këtij koncepti, rrjedhimisht autoritetet shtetërore bëhen përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre gjyqësor.²³

Kjo përgjegjësi lidhet drejtpërdrejtë me organizimin dhe punën e veprimtarive shtetërore. Përderisa shteti është përgjegjës në administrimin e drejtësisë, është në përgjegjësinë e tij që të krijojë edhe mekanizmat adekuat për t'iu kompensuar dëmet e qytetarëve, nëse ato u shkaktohen. Në rast të shkeljeve ligjore nga ana e gjykatës, të cilat vijnë si pasojë e punës së gjyqtarit, vetëm shteti mund të vendosë për përgjegjësinë civile të gjyqtarit përmes procedurave gjyqësore. Respektivisht, nëse gjyqtari mbahet përgjegjës, për shkeljet e të cilit i krijohet dëm qytetarit, shteti obligohet të kompensojë atë për shkak të lëshimeve të gjyqësorit. Pastaj, secili shtet individualisht rregullon procedurat ligjore për regresin e dëmit nga gjyqtarët. Në disa shtete përgjegjësia për regresin e dëmit lind nga përgjegjësia për veprat penale, ndërsa në disa shtete të tjera kjo ndërlidhet qoftë me përgjegjësinë civile apo disiplinore të gjyqtarëve. Por, nuk ka shembuj në praktikë të kërkesave për rimbursim të ngritura nga shtetet. E përbashkëta te këto sisteme është se shtetet mund ta obligojnë gjyqtarin që të rimburojë dëmet e shkaktuara, vetëm pasi që me vendim gjyqësorë të formës së prerë të jetë vërtetuar se ka shkaktuar një nga shkeljet që sjellin përgjegjësinë për dëmin.

²³ Po aty, fq.20:

Lidhur me çështjen e rimbursimit të dëmit, edhe Rekomandimi CM/Rec (2010)12 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës siguron që përgjegjësia civile e gjyqtarit mund të ngritet vetëm si rezultat i kërkesës së shtetit në gjykatë. Regresi iniciohet vetëm pasi që shteti të ketë kompensuar personat të cilëve u është shkaktuar dëm si rezultat i veprimit apo mosveprimit të gjyqtarit, vetëm sipas situatave të parashikuara me ligj.²⁴ Nga kjo konstatohet se ndaj gjyqtarëve individual nuk mund të udhëhiqet procedurë nga palët në procedurë apo individët (qofshin këta persona fizikë apo juridikë) për kompensim të dëmit. Kërkesat kundër tyre mund të parashtrihen vetëm nga shteti pas një vendimi gjyqësorë të formës së prerë, me të cilin është vërtetuar përgjegjësia e drejtpërdrejtë e gjyqtarit për dëmin e shkaktuar.

Bazuar në konceptin e përgjegjësisë së drejtpërdrejtë të shtetit formohen edhe mekanizmat për kompensimin e dëmeve. Secili shtet përcakton procedurat dhe kushtet me qëllim që qytetarët të kompensohen për dëmet e pësuar si pasojë e procedurave gjyqësore, siç mund të jenë: heqja e lirisë apo dënimet pa arsye, mungesa e gjykimit në kohë të arsyeshme etj.²⁵ Në Kosovë, Kodi i Procedurës Penale ka paraparë procedurat për kompensimin e dëmit të personave të dënuar ose të arrestuar pa arsye.²⁶ Neni 527 i KPPK-së shprehimisht ka paraparë organin publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore, si subjekt përgjegjës në rastet eventuale të inicimit të procedurës për kompensimin e dëmit. Pra nëse sipas padisë për kompensimin e dëmit për ndonjë prej rrethanave të parashikuara me këtë Kod, personi i autorizuar ngrit padi në Gjykatën kompetente, subjekt me legjitimitet pasiv do të jetë Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK). KGJK jo vetëm si kategori kushtetuese, por edhe me Ligj gëzon subjektivitet juridik,²⁷ prandaj, edhe e bartë përgjegjësinë për dëmet.

²⁴ Kapitulli VII, Pika 67, Rekomandimi CM/Rec (2010)12 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës (17 Nëntor 2010) dhe memorandumit sqarues për pavarësinë e gjyqtarëve, efikasitetin dhe përgjegjësitë. <https://rm.coe.int/16807096c1>

²⁵ Raporti i Rrjetit Evropian të Këshillave Gjyqësor (EJTN): Grupi Punues mbi përgjegjësinë fq.2

²⁶ Kodi Nr.04/L-123 i Procedurës Penale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr.37 / 28 Dhjetor 2012, Prishtinë, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>. Për më tepër shih Udhëzimin Administrativ të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (04/2015) për zbatimin e procedurës për kompenzimin e dëmit për personat e dënuar ose të arrestuar pa arsye: <http://www.gjyqesori-rks.org/sq/legislation/list?id=0&type=3&year=2015>

²⁷ Me nenin 1 të Ligjit për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-223 Për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, parashihet: "Këshilli Gjyqësor i Kosovës gëzon subjektivitet juridik", (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 17/ 30 Qershor 2015).

Ky është indikacion i qartë se edhe legjislacioni i Kosovës e njuh sistemin e përgjegjesisë së shtetit për dëmin e shkaktuar nga ana e gjyqësorit. Megjithatë, këtu bëjmë fjalë vetëm për një segment të përgjegjesisë për dëmet e shkaktuara, respektivisht vetëm për rastet e shkeljes së të drejtave të individit për gjykim të padrejtë në çështjet penale. Por, a mund të shkaktohen dëme civile nga gjykatat gjatë ushtrimit të funksionit të tyre gjyqësor? A mund të shkaktohen dëme përmes vendimeve gjyqësore? Në çfarë forma mund të shkaktojnë dëm gjykatat? Më poshtë do ta trajtojmë çështjen e "dëmit të shkaktuar" nga ana e gjykatave në kuptimin civilo-juridik.

3. A mund të jetë sistemi gjyqësor shkaktar i dëmit? Cilat janë format e "shkaktimit të dëmit" nga gjyqësori?

Për të ekzistuar përgjegjësia e gjyqësorit ndaj qytetarëve apo palëve në procedurë duhet që të njëjtit të pësojnë dëm. Privimi i paarsyeshëm nga liria, gjykimi i padrejtë, shkelja e të drejtës për një gjykim të drejtë dhe në afat të arsyeshëm kohor etj., janë vetëm disa nga format e mundshme ku gjykatat me veprimet e veta (apo mosveprimet) u shkaktojnë dëm qytetarëve. Sipas Raportit të Rrjetit Evropian të Këshillave të Gjyqësorit (ENCJ), "*Çdo mangësi në funksionimin e drejtësisë që nuk është në gjendje të përmbushë misionin e saj në përgjithësi përbën një gabim*".²⁸ Ky definim sjell një standard të lartë të funksionimit të gjyqësorit, rrjedhimisht edhe të përgjegjesisë së gjyqësorit në dhënien e drejtësisë. Kjo është një tendencë për të definuar konceptin e gabimeve (*error*) apo lëshimeve të gjykatave. Prandaj, themi se instrumentet ndërkombëtare i përcaktojnë vetëm standardet minimale të përgjegjesisë, ndërsa secili shtet përmes akteve ligjore i rregullon shkaqet e ardhjes deri të përgjegjësia. Rrjedhimisht rregullohen edhe format e shkaktimit të dëmit. Në vijim synoj të jap një vështrim mbi format e dëmit të shkaktuar nga gjykatat nga disa legjislacione të ndryshme.

Duke qenë se në SHBA vlen imuniteti absolut i gjyqtarëve, nuk ka rregullativë juridike për përgjegjësinë e gjyqtarëve për dëmet. Deri në vitin 1967 në rastin *Pierson v Ray*, Gjykata Supreme e SHBA-ve ka "refuzuar" të lëshohet në shqyrtimin e rasteve në të cilat janë ushtruar paditë për kompensimin e dëmit

²⁸ Raporti i Rrjetit Evropian të Këshillave Gjyqësor (EJTN): Grupi Punues mbi përgjegjësinë, fq.2 (përkthim i autorit)

kundër gjyqtarëve, respektivisht zyrtarëve gjyqësorë.²⁹ Megjithatë, tek në vitin 1971 për herë të parë është ndryshuar qëndrimi lidhur me imunitetin absolut të gjyqtarëve në kontestet e kompensimit të dëmit. Në rastin *Stump v. Sparkman*, Gjykata e ka trajtuar përgjegjësinë e gjyqtarit Harold Stump për vendimin e tij në kuptim të 'keqdashjes'.³⁰ Në raport me gjyqtarin Stump, gjykata e shkallës së parë kishte vendosur që i njëjti gëzonte imunitet si gjyqtar. Gjykata e shkallës më të lartë (Court of Appeals for the Seventh Circuit), duke shqyrtuar çështjen e imunitetit, kishte gjetur se gjyqtari Stump pa bazë ligjore ka urdhëruar sterilizimin duke vepruar jashtë kompetencave të tij. Prandaj, sipas Gjykatës, gjyqtari Stump ka humbur imunitetin "për shkak të dështimit që të veprojë konform parimeve elementare të një procesi të rregullt". Në këtë mënyrë, sipas disa autorëve,³¹ Gjykata e ka ngatërruar nocionin e kompetencës apo autorizimit (jurisdiction) me atë të bazës së padisë (cause of action). Mirëpo, Gjykata Supreme e SHBA-ve, në rastin *Stump v. Sparkman*, me shumicë votash kishte vendosur që vendimi (akti gjyqësor) për sterilizim bie në kompetencë të gjyqtarit Stump. Prandaj ai nuk kishte vepruar në mungesë të kompetencave, duke e konfirmuar njëkohësisht edhe imunitetin e gjyqtarit Stump.³²

Pasi që rasti *Stump* kishte hasur në kritika të ashpra brenda dhe jashtë gjyqësorit,³³ Gjykata Supreme e SHBA-ve kishte bërë përpjekje në disa prej rasteve të tjera që të definojë nocionin e "aktit gjyqësorë" të gjyqtarit (judicial act). Me këtë jo vetëm se janë përcaktuar elementet esenciale të "aktit

²⁹ Vesna Rakic-Vodinelic, fq.724

³⁰ Gjyqtari Stump në një procedurë gjyqësore ka marrë vendim dhe ka aprovuar kërkesën e nënës së Linda Sparkman për sterilizimin e saj, me arsyetimin se vajza e saj Linda është me të meta, e me qëllim që të parandalohet shtatzënia e saj. Në kohën e zhvillimit të procedurës Linda Sparkman ka qenë e mitur (pesëmbëdhjetë vjeçe) dhe nuk është dëgjuar para gjykatës, ndërsa për sterilizimin ka kuptuar pasi që ishte martuar. Me këtë rast edhe kishte parashtruar padi për kompensim dëmi ndaj gjyqtarit Stump, nënës së saj, spitalit në të cilin ishte kryer sterilizimi (pa dijeninë e saj) dhe mjekut. Më shumë te: Timothy M. Stengel, fq. 1079, J.Randolph Block, fq. 910

³¹ Vesna Rakic-Vodinelic, fq.725, J.Randolph Block, fl.912

³² Po aty.

³³ Gjyqtarët në rastin *Stump* që e kishin ndarë mendimin, kishin kundërshtuar faktin se veprimi i gjyqtarit Stump me të cilën e ka aprovuar sterilizimin mund të konsiderohet "veprim gjyqësor" (pasi që sterilizimit është kryer pavarësisht të metave procedurale, siç janë: mungesa e përfaqësimit për të miturën, nuk është dëgjuar e mitura në cilësi të palës para gjykatës etj.), prandaj dhe gjyqtari në fjalë nuk do të duhej të gëzojë imunitet gjyqësor. Gjyqtarët Stewart, Marshall dhe Powell argumentuan se "ajo që kishte bërë Gjyqtari Stump ishte përtej asaj që në mënyrë të arsyeshme mund të quhej akt gjyqësor". Shih Timothy M. Stengel, fq. 1097.

gjyqësorë”, por janë definuar kufijtë e përgjegjësisë së gjyqtarit për dëmin si pasojë e tejkalimit të kompetencave. Andaj, sipas Gjykatës Supreme të SHBA-ve, për tu trajtuar një veprim i gjyqtarit si “akt gjyqësor” duhet të përmbushen këto katër kushte: i) akti për të cilën është ngritur padia hyn në ushtrimin e funksionit gjyqësor; ii) nëse akti është marrë në gjykatore (sallë të gjykimit) ose në hapësirat tjera të gjykatës; iii) nëse ka të bëjë me procedurën gjyqësore të cilën e udhëheqë gjyqtari iv) nëse akti është ndërmarrë në bazë të kërkesës së palës nga gjyqtari brenda kompetencave zyrtare.³⁴

Në qoftë se përmbushen kushtet e theksuara, gjyqtari nuk përgjigjet për dëmin e shkaktuar qoftë edhe nëse i ka tejkaluar autorizimet e tij, nëse ka vepruar me keqdashje, nëse veprimi i tij është i përfshirë me gabime të rënda procedurale.³⁵ Kjo ka vendosur standardet e përgjegjësisë së gjyqtarëve në raport me dëmet eventuale që mund të shkaktohen në procedurë apo gjatë ushtrimit të funksionit të tyre. Siç shihet, SHBA-të i kanë përcaktuar kornizat e përgjegjësisë së gjyqtarëve në praktikën gjyqësore duke i dhënë imunitet mjaft të gjerë gjyqtarëve në raport me përgjegjësinë e tyre civile. I vetmi përjashtim nga imuniteti si pasojë e përgjegjësisë civile ekziston atëherë kur gjyqtari “padyshim (qartë) ka vepruar jashtë autorizimeve gjyqësore”.³⁶

Në Gjermani, format e përgjegjësisë civile për dëmin e shkaktuar nga gjyqtarët rregullohen me dispozitat e Nenit § 839(2) të Kodit Civil Gjerman (KCGJ),³⁷ dhe parimit të pavarësisë së gjyqësorit sipas Nenit 97 të Ligjit Themelor për Republikën Federale të Gjermanisë.³⁸ Ndërlidhja e dispozitave të këtyre dy

³⁴ www.federalpracticemanual.org/chapter8/section2

³⁵ Po aty

³⁶ Vesna Rakic-Vodinelic, fq.726

³⁷ BÜRGERLICHES GESETZBUCH [BGB] [CIVIL CODE], Jan. 2, 2002, BUNDESGESETZBLATT [BGBl] I § 839 (Ger.), te Jörg Philipp Terhechte, Judicial Accountability and Public Liability—The German “Judges Privilege” Under the Influence of European and International Law, *German Law Journal*, Vol 13, Nr.03, fq.316. “(2) Nëse një zyrtar kryen shkelje të detyrës zyrtare në dhënien e vendimit në procedurën gjyqësore, ai është përgjegjës për dëmin që rrjedh prej tij [vendimit] vetëm nëse kjo shkelje e detyrës përbën vepër penale. Kjo dispozitë nuk zbatohet për refuzimin e ushtrimit të detyrave zyrtare ose vonesës në ushtrimin e tyre.”

³⁸ Po at, fq.317: GRUNDGESETZ FÜR DIE BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND [GRUNDGESETZ] [GG] [BASIC LAW] 23 May 1949, BGBl I at art. 34 (Ger.). “Nëse ndonjë person, gjatë ushtrimit të detyrës publike që i është besuar, shkel detyrën e tij zyrtare ndaj një pale të tretë, përgjegjësia bie mbi shtetin apo organin publik të cili është i punësuar. Në rast të shkeljes me dashje apo pakujdesisë (neglizhencës) së madhe, lind e drejta e regresit kundër zyrtarit.”

akteve rezulton pothuajse në përjashtimin e përgjegjësisë personale të gjyqtarit dhe bartjen e përgjegjësisë nga shteti. Mbi këtë bazë ligjore, përgjegjësia civile e gjyqtarit kufizohet në disa kushte të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative: i) dëmi duhet të jetë i shkaktuar me aktgjykim (jo përmes aktgjykimit me veprime indirekte, por me aktgjykim); ii) dëmi duhet të jetë i shkaktuar me anë të shkeljes së detyrës zyrtare të gjyqtarit; iii) nga shkelja e detyrës zyrtare duhet të shkaktohet dëmi; iv) shkelja e detyrës zyrtare duhet njëherit të përbëjë vepër penale; v) shkelja nuk mund të shkaktohet si rezultat i refuzimit apo shtyrjes në kryerjen e detyrës zyrtare.³⁹ Fakti se "shkelja e detyrës zyrtare" duhet njëkohësisht të përbëjë vepër penale na sjell në përfundim se shkelja duhet të jetë e natyrës së rëndë. Sipas kësaj, veprimet procedurale të udhëheqjes së procedurës, përfshirë nxjerrjen e provave, vendimin se cilat prova do të administrohen, përcaktimi i afateve, caktimi i seancës etj., pastaj zbatimi i të drejtës materiale, nuk mund të përbëjë shkelje të detyrës zyrtare me çka do të shkaktohej dëm.⁴⁰ Ekziston koncepti se gjyqtari vepron brenda autorizimeve të tij dhe ka pavarësi në udhëheqjen e procesit gjyqësorë, dhe se për shkelje të dispozitave ligjore ekzistojnë mjetet juridike ankimore. Pra, konsiderohet se në rast të shkeljeve të ligjit nga ana e gjyqtarit ekziston mundësia e përdorimit të mjeteve juridike që i garanton siguri juridike palëve në procedurë.

Viteve të fundit, si pasojë e qëndrimit të GJED në rastin *Kobler* dhe sidomos me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës,⁴¹ e cila ka imponuar procedura strikte për shkeljen e të drejtës së BE-së, disa shtete anëtare kanë aprovuar ligje të veçanta mbi përgjegjësinë civile të gjyqtarëve. Italia është një nga shtetet e BE-së e cila ka miratuar ligj të veçantë mbi përgjegjësinë civile të gjyqtarëve,⁴² në veçanti për shkak të detyrimit që aktgjykimi i GJED (*case C-*

³⁹ Vesna Rakic Vodinelic, fq.727

⁴⁰ Po aty

⁴¹ Pas hyrjes në fuqi të traktatit të Lisbonës, me nenin 260 parag.2 të janë rregulluar procedura strikte për shkeljen e Traktatit mbi Funkcionimin e Unionit Evropian (TFEU), sipas të cilës: nëse një shtet anëtar nuk vepron në përputhje me aktgjykimin e nxjerrë për shkak të dështimit të shtetit që të përmbush obligimin konform nenit 258 TFEU, Komisioni Evropian mund ta referojë në Gjykatën e Drejtësisë.

⁴² Ligji Nr. 18 i datës 27 Shkurt 2015 mbi përgjegjësinë civile të magjistratëve (GAZETTA UFFICIALE (G. U.) No. 52, NORMATTIVA.

<http://www.loc.gov/law/foreign-news/article/italy-civil-liability-of-judges/>

379/10 *Commission v Italy*) i kishte imponuar Italisë për harmonizimin e legjislacionit vendorë me të drejtën e BE-së.⁴³

Ligji Italian fillimisht ka definuar nocionin e "dëmit", sipas të cilit "kushdo që ka pësuar dëm të kundërligjshëm si rezultat i sjelljes, veprimit ose vendimit (urdhrit) të gjykatës të vendosur nga një gjyqtar mund të ndër marrë veprime kundër shtetit për kompensim të dëmit material (financiar) dhe jomaterial (jofinanciar)".⁴⁴ Ligji në fillim ka vendosur standard të qartë se kërkesa për shpërblimin e dëmit mund të ushtrohet vetëm ndaj shtetit si subjekt përgjegjës – përgjegjës direkt ndaj qytetarit. Parimi i përgjegjësisë indirekte ka për qëllim rruajtjen e pozitës së gjyqtarit sipas të cilës gjyqtari nuk mund të mbahet përgjegjës për veprimet apo mosveprimet e tij në ushtrimin e funksionit si gjyqtar, përveç në rastet e veprës penale.⁴⁵ Ky parim i përgjegjësisë indirekte të gjyqtarit, ku shteti përgjigjet për dëmin e shkaktuar nga gjykata si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të gjyqtarit nuk vlen në rast të veprës penale të kryer nga gjyqtari. Në rast të tillë gjyqtari mund të përgjigjet sipas kërkesës së drejtpërdrejtë ndaj tij, për dëmin e shkaktuar me vepër penale.

Ligji italian ka adoptuar të ashtuquajturën "klauzola mbrojtëse" (*safeguarding clause*), sipas të cilës ushtrimi i rregullt i funksioneve gjyqësore nga një gjyqtar, duke përfshirë interpretimin e normave ligjore dhe vlerësimin e fakteve dhe dëshmive, nuk mund të sjellë deri te përgjegjësia civile e gjyqtarit.⁴⁶ Ky parim rrjedh nga imuniteti funksional i gjyqtarëve dhe ka për qëllim rruajtjen e pavarësisë së gjyqtarit në ushtrimin e funksionit gjyqësor. Sipas kësaj gjyqtarët nuk mund të thirren në përgjegjësi për interpretimin e ligjit, apo për mënyrën e vlerësimit të fakteve dhe provave,⁴⁷ pasi që deri të ky vlerësim vjen në bazë të bindjes së lirë të gjyqtarit në bazë të zbatimit të

⁴³ Përkundër faktit se Italia kishte një Ligj mbi Shpërblimin e Dëmeve të Shkaktuara nga Ushtrimi i Funksioneve Gjyqësore dhe Përgjegjësisë Civile të Gjyqtarëve (Law No. 117 of April 13, 1988, Indemnification of Damages Caused in the Exercise of Judicial Functions and Civil Liability of Judges, G. U. No. 88, NORMATTIVA), GJED në rastin C-379/10 *Komisioni kundër Italisë*, kishte gjetur se Italia ishte përgjegjëse pasi që ligji që ishte në fuqi në Itali deri atëherë, përbënte shkelje të drejtës së BE-së sepse përjashton shtetin italian nga çdo lloj përgjegjësie për dëmet e shkaktuara ndaj individëve për shkak të shkeljes së drejtës së BE-së që mund t'i atribuohet një gjykate të instancës së fundit.

⁴⁴<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=0900001680595b26>

⁴⁵ Po aty.

⁴⁶ <http://www.loc.gov/law/foreign-news/article/italy-civil-liability-of-judges/>

⁴⁷ A.Cilento, *The Civil Responsibility*, fq.29

normave ligjore. Për çështjen e zbatimit të dispozitave të ligjit dhe vlerësimit të fakteve, llogaritet se mbrojtja juridike e palëve sigurohet përmes ushtrimit të mjeteve juridike – ankesës ndaj vendimit. Por, me ligjin e ri italian mbi përgjegjësinë civile të gjyqtarëve (18/2015)⁴⁸ koncepti i "klauzolës mbrojtëse" është reformuar duke e kufizuar mos përgjegjësinë e gjyqtarit për interpretimin e ligjit në rast të "shkeljes së qëllimshme" (*wilful misconduct*) dhe "pakujdesisë së rëndë" (*gross negligence*).⁴⁹

Në Itali, janë përcaktuar me ligj kushtet për kompensimin e dëmit. Sipas ligjit, që një qytetar të mund të kërkojë kompensim nga shteti, duhet që dëmi të shkaktohet si pasojë e sjelljes, veprimit apo vendimit (urdhrit) gjyqësor, i cili është marrë nga gjyqtari me "shkelje të qëllimshme" apo "pakujdesi e rëndë" në ushtrimin e funksionit të tij/saj apo që rezulton me "mohimin e drejtësisë" (*denial of justice*). Ligji ka trajtuar edhe nocionin e "pakujdesisë së rëndë", sipas të cilit, pakujdesia e rëndë ekziston në rastet në vijim: 1) shkelje të qartë të ligjit, si dhe të së drejtës së BE-së.⁵⁰ 2) Keqinterpretimi i fakteve dhe provave.⁵¹ 3) pohimi i një fakti, ekzistenca e të cilit padyshim duhet hedhur poshtë nga çështja ose anasjelltas, mohimi i një fakti nga lënda që padyshim ekziston. 4) lëshimi i një urdhri (apo mase të përkohshme) ndaj një personi ose pasurie përtej kushteve të parapara me ligj rasteve të lejuara me ligj ose pa dhënë arsye.⁵²

Tendenca e rregullimit të përgjegjësisë së gjyqtarëve për dëmin është reflektuar edhe në shtetet e rajonit. Në Serbi dhe në Kroaci, përgjegjësia civile e gjyqtarëve për dëmin rregullohet me Ligjin për gjyqtarët,⁵³ respektivisht me Ligjin për Gjykatat në Kroaci.⁵⁴ Të dy ligjet e përmendura kanë parashikuar përgjegjësinë e shtetit për dëmin të cilin gjyqtari e shkakton me veprim të

⁴⁸ Shih fusnota nr.42

⁴⁹<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=0900001680595b26>

⁵⁰ Ligji ka përcaktuar kriteret të cilat duhet të përdoren për të konstatuar se kur ekziston "shkelja e qartë e ligjit", gjë që është: shkalla e qartësisë dhe saktësisë së rregullave të shkelura, si dhe rëndësia e shkeljes, Cilento fq. 30

⁵¹ Çështja e keqinterpretimit ishte objekt i debatve të ashpra në Itali, që u pasua nga një interpretim kushtetues, sipas të cilit keqinterpretim nënkupton pranimin e një fakti ekzistimi i të cilit qartazi duhej mohuar apo mohimi i një fakti ekzistimi i të cilit është i padiskutueshëm. Sipas këtij definicioni, keqinterpretimi duhet të jetë i qartë dhe qon në interpretime jonormale të ligjit dhe shtrembërime të mëdha të fakteve që janë objekt shqyrtimi. Cilento fq.30

⁵² Po aty

⁵³ Zakon o Sudijama, https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_sudijama.html

⁵⁴ Zakon o Sudovima Hrvatske https://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2013_03_28_473.html

kundërligjshëm apo me punë jo të rregullt.⁵⁵ Po ashtu dy ligjet e kanë adoptuar përgjegjësinë e shtetit në raport me dëmin e shkaktuar nga gjykatat, respektivisht parimin e përgjegjësisë indirekte. Mirëpo, për dallim nga ligji i Serbisë, dispozita e ligjit të Kroacisë ka parashikuar që "Republika e Kroacisë përgjigjet për dëmin e shkaktuar nga gjyqtari në kryerjen e detyrës zyrtare...".⁵⁶ Mungesa e termit "... gjatë kryerjes së detyrës zyrtare" është parë si e metë në ligjin e Serbisë dhe ka hasur në kritikë në teorinë juridike.⁵⁷ Fakti se norma ligjore që rregullon çështjen e përgjegjësisë së gjyqtarit nuk përmend se gjyqtari mund të merret në përgjegjësi vetëm në lidhje me veprimet apo mosveprimet në kryerjen e detyrës zyrtare, lë hapësirë të gjerë për interpretim. Njëkohësisht, kjo e metë është kritikuar pasi që e tejkalon përgjegjësinë e gjyqtarit që i garantohet me imunitetin funksional.

Të dy ligjet e përmendura rregullojnë mundësinë e kërkesës për kompensim të dëmit, përmes regresit ndaj gjyqtarit. Në Serbi, për të ekzistuar e drejta e shtetit për regres ndaj gjyqtarit duhet që "*...me vendim të Gjykatës Kushtetuese, vendimit të plotfuqishëm gjyqësor, përkatësisht nëse para gjykatës apo organit tjetër kompetent është vërtetuar që dëmi është shkaktuar me qëllim apo nga pakujdesia e rëndë*".⁵⁸ Ndryshe nga kjo zgjidhje ligjore në Serbi, në ligjin kroat nuk përmendet ekzistimi i vendimit gjyqësorë si kusht për të drejtën e regresit por vetëm kërkohet që gjyqtari të ketë shkaktuar dëmin me qëllim apo nga pakujdesia e rëndë. Të dy këto ligje i kanë të metat e veta. I pari për shkak se nuk trajtohet fare çështja se cili vendim i gjykatës merret parasysh kur themi se "*me vendim të plotfuqishëm të gjykatës përkatësisht kur para gjykatës apo me vendim të organit kompetent është vërtetuar shkaktimi i dëmit*". Pra, e metë e ligjit të Serbisë është mungesa e sqarimeve se cili vendim merret parasysh si bazë për iniciimin e procedurës së regresit- vendimi i plotfuqishëm penal, vendimi civil kundër gjykatës (për kompensim dëmi), apo vendimi disiplinor.⁵⁹ Në rastin e ligjit kroat, si e metë shihet fakti se nuk përmendet se si kusht për iniciimin e procedurës së regresit duhet të jetë ekzistimi i vendimit

⁵⁵ Shih Neni 6 paragraf 1 i Ligjit të Serbisë dhe Neni 106 paragraf 1 të Ligjit për Gjykatat të Kroacisë

⁵⁶ Neni 106 paragraf 1 i Ligjit për Gjykatat të Kroacisë

⁵⁷ Shih Vesna Rakic – Vodinelic, fq. 732

⁵⁸ Neni 6 paragraf 1 i Ligjit të Serbisë.

⁵⁹ Vesna Rakic-Vodinelic, fq.734

gjyqësorë. Por dispozita ligjore kufizohet vetëm te ajo që gjyqtari duhet ta ketë shkaktuar dëmin me qëllim apo nga pakujdesia e rëndë.⁶⁰

Në përgjithësi mund të vlerësohet se si ligji i Serbisë ashtu edhe ai i Kroacisë kanë bërë një orvatje për rregullimin e përgjegjësisë së gjyqësorit në kompensimin e dëmit, përmes ligjeve të gjyqësorit. Përkundër të metave që u përmendën, vlen të theksohet se fakti që këto parime kanë gjetur vend në kornizën ligjore të këtyre shteteve tregon për një hap drejt rregullimit të çështjes së përgjegjësisë me ligj. Rregullimi ligjor i hedh standardet minimale të përgjegjësisë së gjyqtarëve, duke i vënë kornizat ligjore të veprimeve apo mosveprimeve të cilat çojnë në përgjegjësinë e gjyqtarit. Një gjë e tillë, sipas mendimit tim, përcakton kufijtë e përgjegjësisë gjatë ushtrimit të funksionit gjyqësorë. Një përparësi tjetër është fakti se gjyqtarët jo vetëm se i kanë të rregulluara me ligj kriteret për përgjegjësinë civile, por eliminojnë mundësinë që përgjegjësia e tyre të jetë objekt i procedurës penale.

Në Kosovë jo vetëm se nuk ekziston ligj i veçantë i cili rregullon format e përgjegjësisë civile të gjyqtarëve, kompenzimin eventual të dëmeve të shkaktuara nga gjykatat apo procedurat për përgjegjësinë, por edhe praktika gjyqësore është e mangët në këtë drejtim. Korniza ligjore për çështjet e kompensimit të dëmeve të shkaktuara nga ana e gjykatave gjatë ushtrimit të funksionit kufizohet kryesisht në kompensimin e dëmit të personave të privuar pa arsye apo gabimisht nga liria. Përveç këtyre formave të kompenzimit të cilat i ka rregulluar Kodi i Procedurës Penale, nuk ekziston një kornizë ligjore e cila përcakton forma të tjera të dëmeve të shkaktuara nga gjyqësori, siç është rasti me Italinë apo Serbinë.

Nisur nga dispozitat ligjore në fuqi, përgjegjësia e gjyqësorit për dëmin e shkaktuar nga gjykata, respektivisht nga gjyqtari, ndërlihet vetëm me përgjegjësinë penale të gjyqtarëve. Pra, si formë e vetme e shkaktimit të dëmit nga gjyqësori është rasti i përgjegjësisë penale të gjyqtarit. Kjo përgjegjësi lidhet me nxjerrjen e kundërligjshme të vendimeve gjyqësore, si vepër penale e posaçme e paraparë me Nenin 432 të Kodit Penal.⁶¹ Kjo dispozitë e Kodit Penal ka inkriminuar një vepër penale të veçantë, të cilën mund ta kryej vetëm

⁶⁰ Shih Nenin 106 të Ligjit të Kroacisë për Gjykatat

⁶¹ Neni 432 i Kodit Penal të Kosovës, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr.19 / 13 KORRIK 2012, PRISHTINË. "Gjyqtari i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër ose për t'i shkaktuar dëm personit tjetër, nxjerr vendim të kundërligjshëm, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet".

gjyqtari gjatë ushtrimit të funksionit gjyqësor. Është e qartë që mënyra e kryerjes ndërlidhet vetëm me ushtrimin e funksionit gjyqësorë, respektivisht me nxjerrjen e vendimit të kundërligjshëm. Konsiderojmë se për të ekzistuar kjo vepër penale duhet të plotësohen kushtet si në vijim: (i) dëmi duhet të jetë shkaktuar me "vendim gjyqësorë" të gjyqtarit; (ii) vendimi duhet të merret nga gjyqtari brenda ushtrimit të funksionit gjyqësor; (iii) përmes vendimit, gjyqtari duhet të ketë realizuar përfitim apo dobi të kundërligjshme për vete, për personin tjetër apo që t'i ketë shkaktuar dëm personit të tretë.

Te kjo dispozitë ligjore termi "kundërligjshmëri" lë hapësirë të madhe për (keq)interpretim. Vendimet gjyqësore të "kundërligjshme" në aspektin procedural apo për nga zbatimi i të drejtës materiale mund të atakohet me mjete juridike. Me rastin e vendosjes sipas mjeteve juridike, gjykatat e shkallës më të lartë shpeshherë mund të konstatojnë se një vendim i shkallës më të ultë është marrë me shkelje, qoftë procedurale apo materiale. Me këtë rast gjykatat e shkallës më të lartë në argumentimin e tyre në të shumtën e rasteve mund t'i referohen vendimit të gjykatës më të ultë si i kundërligjshëm. Siç theksohet edhe në Komentarin e Kodit Penal, "*çdo vendim që anulohet nga gjykata e një instance më të lartë, është vendim i kundërligjshëm, sepse, po të mos ishte i tillë, nuk do të anulohet*".⁶² Po të ishte kështu, do të kishim një situatë paradoksale ku secili vendim i një gjykate i cili anulohet nga gjykatat e shkallës më të lartë, mund të jetë bazë për procedurë penale ndaj gjyqtarit! Kjo paqartësi rreth interpretimit të nocionit të kundërligjshmërisë, për nevoja të veprës penale të marrjes së vendimit të kundërligjshëm, mund të sjellë deri te vërshimi i gjykatave me kallëzime penale kundër gjyqtarëve (të cilat nuk është se janë të panjohura në praktikë)! Ngjashëm është rasti në Serbi, ku për shkak të lëshimit që të definohet çështjen e përgjegjësisë së gjyqtarëve, ka bërë që gjykatat të ballafaqohen me një numër enorm të padive të ushtruara për kompensim të dëmit kundër gjyqtarëve.⁶³

Prandaj, shtrohet pyetja se kur në të vërtetë një vendim është i kundërligjshëm në kuptim të përmbushjes së kushtit të kjo vepër penale. Vet ndërtimi i kësaj dispozite lë shumë çështje të paqarta. Fillimisht, nuk definohet çështja se përmes cilave vendime mund të kryhet veprimi i kundërligjshëm i gjyqtarit. Pra, a hyjnë këtu edhe vendimet procedurale të cilat gjykata i ndërmerr me

⁶² Prof.Dr.Ismet Salihu, Mr.Sc.Hilmi Zhitija, Dr.Sc. Fejzullah Hasani, "Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës", Botimi 1, Mars 2014, fq. 1261

⁶³ Shih Vesna Rakic-Vodinelic, fq.732.

qëllim të drejtimit të procedurës gjyqësore (i.e. aktvendimet për nxjerrjen e provave, vendimin se cilat prova do të administrohen, përcaktimi i afateve, caktimi i seancës etj.; pastaj vendimet për masat e përkohshme, kthimin në gjendjen e mëparshme, aktvendimi për caktimin e paraburgimit etj.). Në rastin konkret, mungon një definim i termit "vendim", siç është rasti i SHBA-ve në rastin *Stump* ku është definuar nocioni "akt gjyqësor" apo rasti i Gjermanisë, ku është përcaktuar se dëmi duhet të jetë i shkaktuar vetëm me aktgjykim, jo përmes aktgjykimit me veprime indirekte, apo me vendime procedurale. Së dyti, nuk përcaktohet nëse për ekzistimin e kundërligjshmërisë, duhet të ekzistojë dashja apo forma të tjera siç janë shkelja e qëllimshme e ligjit apo pakujdesia e rëndë. Pra, ligjdhënësi nuk është marrë me mënyrën apo formën e veprimit apo mosveprimit të gjyqtarit, por më shumë është fokusuar te çështja e përfitimit, respektivisht dobisë së fituar me vendimin e kundërligjshëm. Një gjë e tillë mund të jetë me rrezik për dy arsye:

1. E para, për shkak se në çështjet civile në të shumtën e rasteve mund të konsiderohet se njëra palë përfiton dobi pasurore, ndërsa pala tjetër dëmtohet me anë të vendimit gjyqësorë.
2. Së dyti, përgjegjësia e interpretimit të "kundërligjshmërisë" edhe në çështjet civile i vhet në barrë prokurorisë – gjë që është paradoksale që prokuroria të vlerësojë nëse një vendim në çështje civile është i "kundërligjshëm" apo jo!

Pra, që të vërtetohet nëse një gjyqtarë ka kryer një veprim apo mosveprim të kundërligjshëm, duhet të vërtetohet në një procedurë gjyqësore penale. Së fundi, shtrohet pyetja se për të filluar procedura penale ndaj gjyqtarit për veprën penale të nxjerrjes së kundërligjshme të vendimit, a duhet të pritet shterja e mjeteve juridike në procesin gjyqësorë në të cilin pretendohet veprimi i kundërligjshëm (p.sh. në procedurën civile apo administrative ku pala mund të pretendojë se është nxjerrë vendim i kundërligjshëm). Të gjitha këto mangësi që bartë me vete kjo dispozitë ligjore sjellin pasiguri të madhe juridike për gjyqtarët, por edhe për sistemin gjyqësor, si përgjegjës të drejtpërdrejtë për dëmet e shkaktuara ndaj palëve.

Ndryshe nga rasti i kompenzimit të dëmit të personave të cilëve u është hequr liria pa të drejtë, ku KPPK qartë ka përcaktuar përgjegjësinë e KGJK-së, nuk ka përgjigje definitive se si duhet të veprohet te rastet kur një gjyqtar mund t'i shkaktojë dëm personave të tretë (apo palëve në procedurë) me veprën penale

të nxjerrjes së kundërligjshme të vendimit. Te përgjegjësia e gjyqtarit për nxjerrjen e vendimit të kundërligjshëm, ekziston dilema se a mund të ngritët padi direkte ndaj gjyqtarit, apo si e paditur do të duhej të ishte Këshilli Gjyqësorë i Kosovës. Kjo dilemë shtrohet pasi që nëse shpallet fajtorë një gjyqtarë, kemi të bëjmë me një person penalisht përgjegjës ndaj të cilit mund të ngritët padi direkte sipas rregullave të përgjegjësisë civile sipas fajit. Në anën tjetër, mund të vie në shprehje edhe përgjegjësia e punëdhënësit sipas dispozitave të Nenit 152 të LMD-së, ku punëdhënësi përgjigjet për dëmin e shkaktuar ndaj personit të tretë nga punonjësi gjatë punës apo në lidhje me punën. Por, mund të zbatohen edhe dispozitat e nenit 153 që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e personave juridik ndaj palëve të treta. Një qëndrim i tillë është në harmoni edhe me parimin e përgjegjësisë indirekte të gjyqtarëve, respektivisht të "klauzolës mbrojtëse". Nga ajo që u pa në pjesën e III të këtij artikulli, në të gjitha sistemet juridike (përpos SHBA-ve në rast të përgjegjësisë penale), përgjegjës direkt ndaj qytetarit për dëmin e shkaktuar në procedurën gjyqësore është shteti. Kjo nuk është vetëm pasojë e imunitetit funksional, por edhe një tendencë e sigurisë juridike ndaj pozitës së gjyqtarit.

Edhe pse korniza ligjore në Kosovë nuk e parasheh çështjen e subjektivitetit procedural të gjyqtarit në procedurat e kompenzimit të cilat rrjedhin si pasojë e dëmit të shkaktuar nga gjyqësori (qoftë me vepër penale të gjyqtarit për nxjerrjen e kundërligjshme të vendimit nga Neni 432 i KP-së, apo në forma tjera), konsideroj se Gjykata Kushtetuese e Kosovës me Aktgjykimin KI41/12⁶⁴ ka lënë të kuptohet se për dëmin e shkaktuar nga gjykata përgjegjësinë në kuptim të dëmit të shkaktuar e bartë gjyqësori dhe jo gjyqtari individual. Edhe pse në pjesën më të madhe aktgjykimi i referohet Gjykatës Komonale si autoritet përgjegjës, Gjykata Kushtetuese nuk është marrë më tej me trajtimin e subjektit përgjegjës. Sepse, siç u përmend më lartë, edhe në bazë të ligjit mbi Gjykatat, KGJK do të duhej të ishte bartës i përgjegjësisë direkte. Megjithatë, për qëllim të ekzistimit të përgjegjësisë civile të gjyqësorit, Gjykata Kushtetuese e Kosovës me Aktgjykimin e saj në Rastin KI41/12, tashmë ka krijuar një precedentë lidhur me përgjegjësinë e gjyqësorit për dështimin në ndërmarrjen e veprimeve të parashikuara me ligj. Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se "*Gjykata Komonale në Prishtinë ishte*

⁶⁴ Aktgjykimi në Rastin KI41/12 Parashtrues Gezim dhe Makfire Kastrati kunder Gjykatës Komonale ne Prishtine dhe Keshillit Gjyqesor te Kosoves

përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve të parashikuara me [Ligj], dhe se mosveprimi i saj paraqet shkelje të detyrimeve kushtetuese që rrjedhin nga neni 25 i Kushtetutes dhe nga neni 2 i KEDNJ-se".⁶⁵ Në rastin konkret, Gjykata Kushtetuese, ndonëse nuk e ka trajtuar në detaje çështjen e përgjegjësisë civile të gjyqësorit, por është mjaftuar me përgjegjësinë në raport me shkeljet kushtetuese, megjithatë ka vënë themelet për dy çështje: së pari, përgjegjësinë e gjyqësorit për dëmin e shkaktuar dhe mosveprimin si bazë për shkelje të detyrimeve kushtetuese. Sido që të jetë, vlerësoj se për të ekzistuar përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga gjykata, vendimi gjyqësor i marr në mënyrë të kundërligjshme nga gjyqtari me vepër penale nga Neni 432 i KP-së, duhet të vendoset me aktgjykim të formës së prerë. Vetëm atëherë pa la do të mundte të iniciohte procedurë civile për kompensimin e dëmit. Kjo pasi që vetëm aktgjykimi dënues është bazë për vërtetimin e përgjegjësisë sipas fajit.

Përfundim

Nga analiza e mësipërme mund të konkludohet se normat ekzistuese të cilat e rregullojnë përgjegjësinë civile të gjyqësorit në Kosovë janë të reduktuara në përgjegjësinë penale të gjyqtarit. Kjo alternativë ligjore është jo vetëm e pamjaftueshme dhe e padrejtë, por le zbrazëti ligjore sa i përket formave të tjera të përgjegjësisë civile të gjyqësorit. Këtij vakumi ligjor i paraprinë fakti se ligjdhënësi është mjaftuar me krijimin e një veprë të posaçme penale në Kodin penal e cila është e vetmja mundësi për të vërtetuar dëmin e shkaktuar. Kjo ka bërë që iniciativa e palëve të orientohet gabimisht dhe padrejtësisht drejt ngritjes së kallëzimeve penale ndaj gjyqtarëve me qëllim që t'i mbajë penalisht përgjegjës. Ky fenomen ka edhe pasoja në praktikën gjyqësore. Sepse jo çdo vendim i kundërligjshëm në kuptim të shkeljeve ligjore është i "kundërligjshëm" në kuptim të veprës penal. Po ashtu, jo çdo veprim apo mosveprim i gjykatës i përket përgjegjësisë penale të gjyqtarit. Prandaj, paraqitet nevoja e nxjerrjes së dispozitave ligjore mbi përgjegjësinë e gjyqësorit dhe rishikimi i veprës penale të nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve. Me konkretizimin e dispozitave qoftë në një ligj të veçantë apo në Ligjin për Gjykatat do të përcaktoheshin kufijtë e përgjegjësisë së gjyqësorit dhe format e shkaktimit të dëmit. Po ashtu, rregullimi ligjorë i përgjegjësisë

⁶⁵ Po aty, parag.63

penale do të reduktonte kallëzimet penale ndaj gjyqtarëve, respektivisht ndjekjet penale ndaj gjyqtarëve.

Mungesa e normativës ligjore dhe procedurave, siç shihet e ka keq orientuar qytetarin të kërkojë medoemos përgjegjësinë penale të gjyqtarit me qëllim që eventualisht të fitojë bazën juridike për dëmshpërblim. Kjo zbrazëti ligjore vetëm sa e atakon pozicionin e gjyqtarit, sepse e vë në qendër personalitetin e gjyqtarit, shpeshherë pa të drejtë. Sepse, me kallëzimet penale të cilat janë prezentë në praktikë, të cilat në masë të madhe iniciohen padrejtësisht, gjyqtari individual e merr një barrë të madhe për dështimet të cilat në masën të madhe nuk i përkasin atij/asaj. Një gjë e tillë e dobëson sigurinë dhe pavarësinë e gjyqtarëve, rrjedhimisht edhe të gjyqësorit.

Kosova duhet të ndjek trendët e vendeve të BE-së, me çka do të forcojë pozicionin dhe sigurinë e gjyqtarëve, por edhe pozitën e qytetarëve në raport me dëmet e pësuar. Rasti i Italisë, sado që i ka mangësitë e veta është shembull për tu ndjekur. Sepse me krijimin e kornizës ligjore të përgjegjësisë së gjyqësorit (shtetit) për dëmet e shkaktuara, do të definoheshin qartë format e përgjegjësisë. Kjo, besoj se do të ndikonte që gjyqtari të shkarkohet nga ndjenja e ndjekjes penale për "gjithçka", ndërsa do të rritej përgjegjësia dhe llogaridhënia për gabimet apo lëshimet gjatë ushtrimit të funksionit gjyqësor. Nevoja për konkretizimi të dispozitave ligjore që rregullojnë përgjegjësinë civile të gjyqësorit është e pashmangshme edhe për faktin se e bën dallimin mes formave të përgjegjësisë së gjyqtarit dhe atyre të cilat nuk hyjnë në domenin e tij/saj. Në anën tjetër, gjyqësori, si instrument shtetëror, do të rritë përgjegjësinë karshi kërkesave të palëve për dëmet eventuale të pësuar në procedurë.

Bibliografia

Libra dhe Artikuj

- Enver Hasani, Ivan Čukalović "Komentar-Kushtetuta e Republikës së Kosovës", 2013 GIZ, Prishtinë
- Prof.Dr.Sc. Vesna Rakic-Vodinelic, "Ogranicena Odgovornost Sudije za Stetu – Neophodna Privilegija koja Obezbedjuje Nezavisnost ili Ucvrscivanje Sudijske Neodgovornosti?", Zbornik Pravnog fakulteta u Zagrebu, Vol.63, br. 3-4 (2013), fq.717-742, <https://hrcak.srce.hr/109727>;

- Timothy M. Stengel, "Absolute Judicial Immunity Makes Absolute No Sense: An Argument for an Exception to Judicial Immunity", *Temple Law Review*, Volume 84, No.4, Summer 2012
www.templelawreview.org/lawreview/assets/uploads/2012/09/84.4_Stengel.pdf
- Frank J. Walz, *The Civil Rights Act of 1871: Continuing Validity*, Volume 40, Issue I, *Notre Dame Law Review* 70,
<https://scholarship.law.nd.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=3223&content=ndlrlr>;
- J.Randolph Block, *Stump v. Sparkman and the History of Judicial Immunity*, 1980 *Duke Law Journal* 879-925 (1980),
<https://scholarship.law.duke.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=2753&content=dlj>;
- Douglas K. Barth, *Immunity of Federal and State Judges from Civil Suit - Time for a Qualified Immunity*, 27 *Case Western Reserve Law Review* 727 (1997): <http://scholarlycommons.law.case.edu/caselrev/vol27/iss3/7>
- Cees Van Dam, *European Tort Law*, Second Edition, Oxford University Press (2013);
- Antonio Cilento, *The Civil Responsibility of the Italian Judiciary: A Double Speed System*, *The Italian Law Journal*, Volume 3, No. 1 (2017),
<http://theitalianlawjournal.it/data/uploads/3-italj-1-2017/pdf/cilento.pdf>
- Prof.Dr.Ismet Salihu, Mr.Sc.Hilmi Zhitija, Dr.Sc. Fejzullah Hasani, "Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës", Botimi 1, Mars 2014, GIZ
- Jörg Philipp Terhechte, *Judicial Accountability and Public Liability—The German "Judges Privilege" Under the Influence of European and International Law*, *German Law Journal*, Vol 13, Nr.03

Akte juridike dhe Dokumente

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Ligji Nr.03/ L-199 për Gjykatat, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës: Viti V/ Nr.79/ 24 Gusht 2010).
- "Mount Scopus Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë Gjyqësore", të Shoqatës Ndërkombëtare të Pavarësisë Gjyqësore dhe Paqes Botërore,
<https://www.icj.org/wp-content/uploads/2016/02/Mt-Scopus-Standards.pdf>;
- Standardet Minimale të Nju Delhit të Asociacionit për Pavarësinë Gjyqësore të miratuar në vitin 1982
- Deklarata Universale e Montrealit mbi Pavarësinë e Drejtësisë e vitit 1983;

- Parimet themelore të Pavarësisë Gjyqësore të OKB-së të vitit 1985 (UN Basic Principles on the Independence of the Judiciary endorsed by the General Assembly resolutions 40/32 of 29 November 1985 and 40/146 of 13 December 1985) e qasshme në <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/IndependenceJudiciary.aspx>;
- Rekomandimi Nr.94(12) i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare - pavarësia, efikasiteti dhe roli i gjyqtarëve, <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1707137>;
- Karta Evropiane mbi Statutin e Gjyqtarëve e Këshillit të Evropës, e qasshme në: http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/evaluations/round4/European-Charter-on-Statute-of-Judges_EN.pdf;
- Parimet e Bangalorit mbi Etikën Gjyqësore të vitit 2002: http://www.unodc.org/pdf/crime/corruption/judicial_group/Bangalore_principles.pdf
- Report of the European Network of Councils for Judiciary (ENCJ), Working Group on Liability 2007-2008: <https://www.encj.eu/images/stories/pdf/workinggroups/reportenliability20072008.pdf>
- An Act to enforce the Provisions of the Fourteenth Amendment to the Constitution of the United States and for other Purposes <https://legal-dictionary.thefreedictionary.com/Ku+Klux+Klan+Act>.
- Rekomandimi CM/Rec (2010)12 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës (17 Nëntor 2010) dhe memorandumit sqarues për pavarësinë e gjyqtarëve, efikasitetin dhe përgjegjësitë <https://rm.coe.int/16807096c1>
- Raporti i Rrjetit Evropian të Këshillave Gjyqësor (EJTN): Grupi Punues mbi përgjegjësinë
- Kodi Nr.04/L-123 i Procedurës Penale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr.37 / 28 Dhjetor 2012, Prishtinë, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>.
- Udhëzimi Administrativ i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (04/2015) për zbatimin e procedurës për kompenzimin e dëmit për personat e dënuar ose të arrestuar pa arsye: <http://www.gjyqesori-rks.org/sq/legislation/list?id=0&type=3&year=2015>
- Zakon o Sudijama, https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_sudijama.html
- Zakon o Sudovima Hrvatske https://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2013_03_28_473.html
- Aktgjykimi në Rastin KI41/12 Parashtrues Gëzim dhe Makfire Kastrati kunder Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës

MA.Sc. Dardan Kadolli ¹

Aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve

Abstrakt

Prindërit në ushtrimin e të drejtës prindërore mbi fëmijën kanë të drejta dhe obligime, të cilat burojnë nga ligji. Në mesin e këtyre të drejtave, prindërit mund të ndërmarrin veprime që fëmijën e tyre të përbashkët, ta largojnë nga shteti i vendbanimit të përhershëm të fëmijës në drejtim të shteteve të huaja, për qëllime jetese, por jo pa pëlqimin e prindërit tjetër dhe duke e thyer të drejtën e kujdestarisë, së këndejmi nëse fëmija mbahet pa të drejtë nga njëri prind dhe pa pëlqimin e prindit tjetër nga vendbanimi i përhershëm i fëmijës - në një shtet të botës së jashtme, vije deri të rrëmbimi ndërkombëtar i fëmijës – aspekti civil.

Fjalë kyçe: fëmijë; civile; rrëmbim; konventa; ligji; Konferenca e Hagës; gjykata; shtet i huaj; autoriteti qendror.

Hyrje

Është përgjithësisht e pranuar që fenomeni i aspektit civil të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve nga prindërit ka shënuar rritje të madhe viteve të fundit. Nëse tentohet të bëhet një analizë gjithëpërfshirëse se pse është duke ndodhur një gjë e tillë, para nesh shtrohen shumë elemente që duhet studiuar, e rrjedhimisht, duhet analizuar këtë dukuri nga prizma të ndryshëm, siç mund të jenë, aspekte politike, sociale, ekonomike etj. Në tërë problematikën e aspektit civil të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës, subjekt kryesor është fëmija. Largimi i fëmijës nga shteti i vendbanimit të përhershëm të tij nga prindi në kundërshtim me të drejtën e kujdestarisë, dhe pasojat negative që mund të ketë në fëmijën mbajtja pa të drejtë në shtetin e huaj, ka nxitur organizatën më të madhe të së drejtës private ndërkombëtare në botë – Konferencën e Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private, që të nxjerrë një konventë e cila ekskluzivisht do të trajtonte këtë problematikë. Qysh në preambulën e sajë Konventa mbi aspektet civile të rrëmbimit

¹ Autori i këtij punimi është gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë

ndërkombëtar të fëmijës², ka përcaktuar se interesat e fëmijëve janë të një rëndësie të veçantë në çështjet që lidhen me kujdestarinë e tyre, dhe të nxitur në mbrojtjen ndërkombëtare të fëmijëve nga pasojat e dëmshme të largimit ose mbajtjes së tyre të padrejtë dhe për të krijuar procedura që sigurojnë kthimin e tyre të menjëhershëm në shtetin e vendbanimit të tyre të përhershëm, si dhe për të siguruar mbrojtje për të drejtat e kontaktit, kanë nxjerrë këtë konventë.

Ekuilibrimi mes dy rrafshve siç janë kthimi i shpejtë i fëmijës së rrëmbyer jashtë shtetit të vendbanimit, dhe mbrojtja e fëmijëve, gjithmonë kanë paraqitur një sfidë të vërtetë, ngase fëmijët të gjendur si subjekti kryesor në këtë proces, shpesh herë duhet t'i nënshtrohen proceseve gjyqësore dhe procedurave administrative të mundimshme për ta, dhe që mund të kenë pasojë tek fëmijët³. Vend mjaft të rëndësishëm çështja e rrëmbimit ndërkombëtarë të fëmijëve ka gjetur edhe në disa akte ndërkombëtare. Në tërësinë e sajë Konventa mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës (*më tutje Konventa*), si dhe ligji nacional i për Aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës Ligji Nr. 03/L-238 (*më tutje Ligji i rrëmbimit*), përmbajnë norma në referim të interesit më të mirë të fëmijës. Në kornizën ligjore ndërkombëtare, përta i përket instrumenteve që për objekt trajtimi kanë të drejtat e fëmijëve, mjaft lartë paraqitet të jetë Konventa mbi të drejtat e fëmijës⁴, e po ashtu Konventa e Hagës mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve⁵.

1. Përcaktimi i natyrës së rrëmbimit nga perspektiva e Ligjit për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës.

² E miratuar më 25 tetor 1980, traktat shumëpalësh; instrument i Konferencës së Hagës për të drejtën ndërkombëtare private. Deri më tani shtete palë në këtë konventë janë 98 shtete, pjesa më e madhe e shteteve janë anëtare të Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private.

³ *Netherlands International Law Review, International Law, Conflict of Laws*, Springer International Publishing, dhjetor 2015, Volumi 62, fq. 365–405.

⁴ Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989. Ky instrument ndërkombëtar, sipas nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, zbatohet drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe ka prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

⁵ E miratuar më 19 tetor 1996. Kjo Konventë njihet edhe si Konventa e Hagës për të drejtat e fëmijëve e 1996.

Duke u nisur nga vetë emërtimi i ligjit, e po ashtu nga përmbajtja e dispozitave të tij, rezulton se objekt trajtimi është aspekti juridiko-civil i kësaj materie. Në Kosovë fillimisht kjo fushë është rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/29 për Mbrojtjen kundër Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve, që për nga përmbajtja ka qenë mjaft e shkurtër, me vetëm 9 nene, dhe nuk e ka rregulluar në tërësi këtë materie. Më pas Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/29, është pasuar nga Ligji për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës Ligji Nr. 03/L-238, i nxjerrur nga Kuvendi i Kosovës me 28 tetor 2008. Për nga struktura e tij Ligji i rrëmbimit, ka ngjashmëri tejet të madhe me Konventën e Hagës mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës (*më tutje Konventa e Hagës*), madje disa dispozita janë të huazuara në tërësi nga ky instrument ndërkombëtar. Ligji i rrëmbimit është i strukturuar në atë formë që përcakton autoritetin qendror, veprimet që duhet të ndërmarrin organet gjyqësore, forma e caktuar përmes së cilës palët duhet të iniciojnë procedurën për kthimin e fëmijës, forma e urdhrimit për kthim etj.

Shprehjet e përdorura në Ligjin e rrëmbimit dhe në Konventën e Hagës si rrëmbim nuk është menduar të përdorën në kuptim penal, porse ky term i referohet marrjes dhe largimit të fëmijës pa pëlqimin e prindit tjetër dhe duke e thyer të drejtën e kujdestarisë, si dhe mbajtjes së fëmijës në shtetin e huaj jashtë vendbanimit të përhershëm të fëmijës, në të gjithë këtë proces paraqitet një rezultat, fëmija hiqet nga mjedisi familjar dhe social në të cilën jeta e tij/sajë është zhvilluar.

Në disa shtete kjo fushë është e rregulluar me vete aktin e Konventës, të cilës edhe i kanë dhënë fuqinë e ligjit, kurse në disa shtete tjera, ku është shprehur nevoja që të nxirret legjislacioni i posaçëm, dispozitat e konventës vetëm janë traspozuar me ndryshime të vogla në dispozita të ligjit nacional⁶, në këtë mes bënë pjesë edhe Kosova, për sa i përket ligjit aktual në fuqi. Kurse Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/29 për Mbrojtjen kundër Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve, parashilte që pothuajse në tërësi të aplikohet Konventa e Hagës, gjë që në një farë mënyre le të kuptohet nga vetë përmbajtja e sajë me vetëm nëntë nene në tërësinë e sajë.

⁶ Schuz, Rhona, *The Hague Child Abduction Convention: A Critical Analysis*, Hart Publishing, 2014, fq. 174.

Siç është thënë edhe më lartë, subjekt kryesor në procedurën e rrëmbimit është fëmija, së këndejmi është përcaktuar se fëmijë në Ligjin e rrëmbimit do të konsiderohet personi nën moshën 16 vjeçare. Ky ligj paraqitet të jetë në të njëjtën linjë me Konventën e Hagës, ngase në nenin 4 të sajë është rregulluar se Konventa do të pushojë së zbatuari kur fëmija të arrijë moshën 16 vjeçare. Kurse nëse vihet në planin krahasues me Ligjin për familjen i Kosovës, i njëjti në nenin 3 par. 2 ka përcaktuar se në kontekst të Mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe përgjegjësisë së të dy prindërve për rritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre do të nënkuptohet personi nën moshën 18 vjeçare, kurse në nenin 15 par. 2 është rregulluar se mosha madhore fitohet me të mbushur 18 vite. Nga dhënia e përkufizimeve të mësipërme lë të nënkuptohet se Ligji për Familjen i Kosovës përdorë të njëjtin standard me Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës e 1989⁷, për sa i përket nivelit të moshës ky hynë kategoria e fëmijëve.

Meqë deri më tani u përmend Konventa për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve e 1980, si akti kryesor në botë që rregullon këtë fushë i nxjerrë nga Konferenca e Hagës, sjellim në mendje se Republika e Kosovës ende nuk është anëtare në këtë Konventë, gjithashtu nuk është anëtare e Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private. Mirëpo nuk është pengesë që Kosova të bëhet anëtare e kësaj konvente edhe pse nuk është anëtare e Konferencës së Hagës. Të gjitha shtetet që kanë nënshkruar dhe ratifikuar ose që kanë aderuar në Konventë konsiderohen shtetet kontraktuese të Konventës⁸.

1.2. Definimi i rrëmbimit nga Ligji për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës

Autoritetet qendrore dhe gjyqësore janë të obliguara që veprimet e njërit prind që konsiderohet se pa të drejtë e ka rrëmbyer fëmijën, veprimet e tilla

⁷ Në nenin 1 të sajë: Në këtë Konventë, me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet.

⁸ GUIDE TO GOOD PRACTICE under the Hague Convention of 25 October 1980 on the Civil Aspects of International Child Abduction PART II –IMPLEMENTING MEASURES, publikim i Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private, 2003, fq. 13, 14, 15. Paraqet dokument kuptimplotë lidhur me procedurën që duhet të ndiqet për t'u anëtarësuar në këtë instrument ndërkombëtar.

t'i cilësojnë në përputhje me Ligjin e rrëmbimit. Ky ligj, në nenin 3 ka përcaktuar se cilat raste kur largimi apo mbajtja e një fëmije konsiderohet i padrejtë, dhe si veprime të tilla paraqiten: kur marrja e fëmijës konsiston në shkeljen e të drejtave të kujdestarisë dhënë një personi, një institucioni apo organi tjetër, qoftë bashkërisht apo individualisht, sipas ligjit të shtetit në të cilin fëmija ka qenë banor i përhershëm para largimit apo mbajtjes; dhe në kohën e largimit apo mbajtjes këto të drejta janë ushtruar, qoftë bashkërisht apo individualisht, ose që mund të kenë qenë ushtruar me përjashtim të largimit apo mbajtjes. Ky definim nga ligji jonë i brendshëm nëse vëhet në planin krahasues me Konventën, rezulton se është i njëjtë, pra ligjvënësi në Kosovë ka transpozuar në tërësi nenet për sa i përket cilësimit të veprimeve të prindit rrëmbyes, duke i bërë pjesë e sistemit të brendshëm ligjor⁹.

Ekziston një shumëllojshmëri e rrethanave të cilat do të mund të kombinoheshin në një rast, të cilat do të bënin të pamundur dhënien e një definicioni të saktë ligjor të aspektit civil të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës. Siç edhe rezultoi nga përkufizimi që ka bërë Ligji i rrëmbimit, duhet të kemi parasysh se shkurtimisht janë paraparë situatat që mund të paraqiten në praktikë. Në doktrinën juridike që përpunon këtë materie, në mënyrë mjaft sintetizuese jepet shpjegimi se kemi të bëjmë me përdorimin e forcës nga njëri prind për dërgimin e fëmijës në një shtet të huaj me qëllim të marrjes së kujdestarisë për fëmijën¹⁰.

Në Kosovë për sa i përket analizimit të rrethanave lidhur me gjetjen e shkaqeve se pse prindërit janë të përfshirë në rrëmbimin e fëmijëve, nga shteti i vendbanimit të tyre të përhershme në shtete tjera, nuk rezulton të jetë bërë ndonjë analizë, mirëpo nga analizat krahasuese të bëra nga doktrina juridike, fitimi i të drejtës së kujdestarisë paraqitet të jetë më i shpeshtë. Nëse tentohet të bëhet një listim i shkaqeve për të gjetur motivet tjera që shtynë një prind të rrëmbejë fëmijën, mund të mbështetemi në studime komperative. Lista e shkaqeve do të përfshinte: nëse ka pasur një martesë mes dy personave të shteteve të ndryshme, mund të ndodhë që njëri prind bashkë me fëmijën martesorë të kthehet në shtetin e origjinës, duke mos

⁹ Neni 3 i Konventës mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës.

¹⁰ *Raport shpjegues lidhur me Konventën e Hagës mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës* 1980, nga Elisa Pérez-Vera (1982) paragrafi 16 dhe 17, publikim i Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private. Shpjegimet e dhëna në këtë publikim shkojnë përtej përkufizimeve të dhëna nga Ligji për rrëmbimin, dhe Konventa e Hagës, të paraqitura në një gjuhë koncize dhe profesionale.

marrë pëlqimin e bashkëshortit tjetër; njëri bashkëshort i nënshtrohet dhunës nga bashkëshorti tjetër, merr fëmijën dhe largohet në ndonjë shtet tjetër; dëshira për të pasur më shumë kohë me fëmijën e tije; dëshirat e njërit prind për të jetuar në një shtet tjetër; me qëllim të sigurimit të një mirëqenie më të mirë për fëmijën, ose të konsiderohet se jetesa në shtetin e vendbanimit të fëmijës është e pasigurtë dhe e rrezikshme; ç' rregullimet mendore të prindit etj.¹¹.

Deri më tani nuk del të jetë bërë ndonjë analizë në Kosovë lidhur me përcaktimin e aspekteve gjinore, për të pasqaruar se cilët prindër – nëna apo babai janë të përfshirë në rastet e rrëmbimit të fëmijëve. Mirëpo analiza të tilla janë bërë në kuadër të Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private¹². Mes shteteve anëtare të kësaj organizate, që janë palë të Konventës së Hagës, rezulton se 69 % e personave rrëmbyes ishin nënat, shifër që ka qëndruar pothuajse konstante përgjatë anketimeve që janë bërë në vitet 2003 dhe 1999. Kurse në një analizë të vitit 2008, statistikat tregojnë se 28% e personave rrëmbyes ishte babai. Kurse mjaft interesante paraqitet të jetë se si rrëmbyes në pjesëmarrje prej 3% janë përfshirë gjyshërit dhe të afërmit tjerë¹³.

1.3 Inicimi i procedurës së kthimit kur rrëmbimi i fëmijës ka ndodhur nga Kosova në shtetet tjera

Qëllimet e Ligjit për rrëmbimin dhe Konventës së Hagës, janë të njëjta, të sigurojnë kthimin e shpejtë dhe të sigurt të fëmijës në shtetin e vendbanimit të tij; për t'i siguruar fëmijës mbrojtje ligjore; për t'i siguruar mjete efektive juridike prindit fëmija i të cilit është rrëmbyer dhe të kërkojë kthimin e fëmijës¹⁴. Ligji për rrëmbimin dhe Konventa e Hagës, janë instrumente

¹¹ Schuz, Rhona, *The Hague Child Abduction Convention: A Critical Analysis*, Hart Publishing, 2014.

¹² Kjo organizatë ka 83 anëtarë (82 shtete dhe Bashkimi Evropian) që përfaqësojnë të gjitha kontinentet, Konferenca e Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private është një organizatë ndërkombëtare ndërqeveritare

¹³ Takimi i 6-të i Komisionit të Posaçëm, Konferenca e Hagës (Pjesa I, Qershor 2011, Pjesa II, Janar 2012).

¹⁴ Lindhorst, Taryn; Edleson, Jeffrey L., *Battered Women, Their Children, and International Law: The Unintended Consequences of the Hague Child Abduction Convention*, Northeastern University Press, Boston, 2012, fq. 2.

ligjore normat e të cilave fillojnë të jetësohen tek një raport juridik me element të huaj, pra në rastet kur prindi rrëmbyes bashkë me fëmijën ndodhen në një juridiksion të huaj.

Pretendimet e tija një prind që mendon se fëmija i tijë është rrëmbyer pa të drejtë duhet t'i paraqes përmes *kërkesës për kthim*¹⁵ të cilën duhet të paraqes tek Autoriteti Qendror – Ministria e Drejtësisë, ose Gjykata Themelore në Prishtinë.

2. Përcaktimi i Autoritetit Qendror dhe kompetencat

Autoriteti qendror paraqet institucionin nacional, i cili do të jetë kompetent për qëllimin e operimit sa më të mirë të Konventës së Hagë dhe Ligjit të rrëmbimit, në rastet e bashkëpunimit mes shteteve, në trajtimin e rasteve të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve.

Neni 4 i Ligjit për rrëmbimin, përcakton se Ministria e Drejtësisë është Autoriteti Qendror në Republikën e Kosovës, për qëllime të këtij ligji. Detyrimin e shteteve për të përcaktuar një Autoritet qendror parasheh edhe Konventa e Hagës 1980, në nenin 6 të sajë parashikon se “shtetet kontraktuese do të autorizojë një autoritet qendror të përmbushë detyrat që Konventa u ka dhënë këtyre autoriteteve”¹⁶. Siç është thënë edhe pse Kosova nuk është anëtare në Konventën e Hagës, ajo ka aplikuar një standard të sajë duke e caktuar një Autoritet qendror.

Për të përcaktuar se cili organ do të shërbej si autoritet qendror për qëllime të operimit të Konventës së Hagës, është në diskrecion të shteteve të vendosin për një gjë të tillë. Mirëpo praktika nga Konferenca e Hagës tregon se shumica e shteteve anëtare, si autoritet të ngarkuar kanë lënë Ministrinë e Drejtësisë. Sido që të jetë, nuk është e thënë që shtet nuk kanë vepruar ndryshe, psh. në Kroaci si Autoritet qendror shërben Ministria për

¹⁵ Shih nenin 6 të Ligji për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës

¹⁶ Një obligim të tillë përmban edhe Konventa e Hagës mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve e 1996. Në nenin 29 parashikon Një shtet kontraktues do të caktojë një autoritet qendror për të kryer detyrat, të cilat janë vënë nga kjo Konventë për këto autoritete.

Demografi, Familje, Rini dhe Politikë Sociale, në Danimarkë, Ministria për Fëmijët dhe Çështjet Sociale etj.¹⁷

Rëndësia e Autoritetit qendror tek trajtimi i rasteve të aspektit civil të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve, është tejet e madhe, ngase është bartësi dhe mbikëqyrësi kryesor i në mes komunikimit mes: *së pari* prindërve dhe fëmijëve, dhe *së dyti* mes autoriteteve qendrore të shteteve të huaja. Përgjatë takimeve të janarit 1993 të Komisionit të Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private, për rishikimin e funksionimit të Konventës Hagës për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve, në mesin e konkluzioneve të nxjerra është kolauduar se Autoritetet Qendrore të përcaktuara nga Shtetet Palë luajnë një rol kyç në funksionimin e Konventës. Ata duhet të veprojnë në mënyrë dinamike dhe duhet të sigurohet stafi dhe burime të tjera të nevojshme për të kryer funksionet e tyre në mënyrë efektive, dhe Fëmijët që janë rrëmbyer ose mbahen jashtë shtetit gabimisht duhet të kthehen menjëherë, dhe për këtë Autoritet Qendror duhet të luajnë rol crucial¹⁸. Po ashtu në Deklaratën e Maltës¹⁹ ritheksohet rëndësia që kanë Autoritetet qendrore mes tjerash në bashkëpunimin me autoritetet e shteteve tjera, në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkufitare në rastet kur përfshihen fëmijët.

Në Kosovë, kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij institucioni janë të përcaktuara me Ligjin për rrëmbimin në nenin 4 par. 2, të cilat janë:

- a) të zbulojë vendndodhjen e fëmijës, i cili është larguar apo mbajtur pa të drejtë;
- b) për të parandaluar dhe mbrojtur fëmijën nga veprimet e dëmshme duke marrë ose bërë që të merren masa të përkohshme;

¹⁷ Për të parë në tërësi listën e autoriteteve qendrore të përcaktuara nga shtetet shiko <https://www.hcch.net>, seksioni "Central Authorities".

¹⁸ Shih *GUIDE TO GOOD PRACTICE* under the Hague Convention of 25 October 1980 on the Civil Aspects of International Child Abduction PART I - CENTRAL AUTHORITY PRACTICE, publikim i Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private, 2003, fq. 85-86.

¹⁹ Konferenca e Detyrë Gjyqësore e Maltës lidhur me Çështjet Ndërkufitare të së Drejtës Familjare, të organizuar nga Qeveria e Maltës në bashkëpunim me Konferencën e Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private, 19-22 mars 2006, pika e dytë e Deklaratës.

- c) të siguroj kthimin vullnetar të fëmijës ose për të arritur një marrëveshje për çështjen;
- d) për të filluar apo lehtësuar institucionit procedimin gjyqësor ose administrativ, me qëllim të kthimit të fëmijës dhe në rastin e duhur, të bëjnë përgatitje për organizimin ose sigurimin e ushtrimit efektiv të të drejtave të kontaktit;
- e) siç e kërkojnë rrethanat, të sigurojnë ose lehtësojnë sigurimin e konsulencës dhe asistencës ligjore, duke përfshirë pjesëmarrjen e konsulentëve ligjorë;
- f) të marrin masat e nevojshme administrative, për të siguruar kthimin e sigurt të fëmijës;
- g) të shkëmbejë informata me autoritetet qendrore të shteteve tjera për eliminim e pengesave për zbatimin e këtij ligji.

2.1 Parashtrimi i kërkesës në Ministri të Drejtësisë

Kërkesa paraqet aktin me të cilën iniciohet procedura për kthimin në Kosovë të fëmijës së rrëmbyer, për të cilën në legjislacione të ndryshme dhe doktrinë juridike mund të haset termi aplikacion, mirëpo bëhet fjalë për të njëjtin akt. Neni 6 i Ligjit të rrëmbimit ka rregulluar këtë aspekt, në të cilin thuhet se: *Çdo person, institucion apo organ tjetër që pretendon se një fëmijë është larguar nga apo në Kosovë apo është mbajtur në kundërshtim me të drejtat e kujdestarisë, mund t'i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë ose Autoritetit Qendror të ndonjë shteti tjetër për asistencë në sigurimin e kthimit të fëmijës.* Kjo normë është transpozuar në tërësi nga Konventa e Hagës neni 8²⁰. Aplikuesit janë të autorizuar që kërkesën për kthimin e fëmijës ta

²⁰ Megjithatë ekziston një ndryshim tek pjesa e Ligjit të rrëmbimit, që autorizon palët që kërkesën mund ta parashtojnë tek Autoritet Qendrorë tek shtetet tjera. Aplikuesit që zgjedhin këtë mundësi mund të hasin në vështirësi, ngase meqë Kosova nuk është anëtare në Konventën e Hagës dhe as në Konferencën e Hagës, shtetet e huaja mund të refuzojë bashkëpunimin, duke u thirrur në këtë pikë. Konventa përcakton se aplikuesit mund t'i drejtohen autoritetit qendror të çdo shteti kontraktues, pra përdorë termin shtet kontraktues.

dorëzojnë edhe në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e cila pastaj të njëjtin e transmeton në Ministri të Drejtësisë.

Përmbajtjen e aplikacionit e ka rregulluar neni 3 i Ligjit të rrëmbimit, i cili duhet të përmbajë: informacion në lidhje me identitetin e kërkuarit, të fëmijës dhe të personit që supozohet se ka larguar apo mbajtur fëmijën pa të drejtë; data e lindjes së fëmijës; shkaqet mbi të cilat bazohet pretendimi i kërkuarit për kthimin e fëmijës; të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me vendndodhjen e fëmijës dhe identitetin e personit me të cilin supozohet të jetë fëmija. Në Kosovë ekziston një aplikacion i veçantë, i përpiluar enkas për këtë qëllim dhe i cili mund të merret në Ministri të Drejtësisë, këtij aplikacioni duhet bashkëngjitur dokumente si kopje e vërtetuar e ndonjë vendimi apo marrëveshjeje përkatëse; dokumente që ndriçojnë çështje të së drejtës së kujdestarisë së fëmijës; ekstrakte të dispozitave ligjore etj.²¹

Nëse i referohemi praktikave²² më të mira të ndërtuara nga shtet palë në Konventën e Hagës, vërejmë se ekzistojnë formularë të gatshëm të cilët përdoren nga aplikuesit për iniciimin e procedurës së rrëmbimit. Deri tek unifikimi që shtetet anëtare të Konventës së Hagës të përdorin një aplikacion të veçantë, kanë ndikuar edhe qëndrimet e marra në Sesionin e katërmëdhjetë të Konferencës së Hagës, ku është marrë qëndrim që të rekomandohet përdorimi i një forme të veçantë i cili do të përdoret nga të gjitha shtetet²³.

Me rastin e pranimit të aplikacionit për kthim të fëmijës, Ministria e Drejtësisë duhet të kujdeset se është i qartë dhe përmban të gjitha informacionet e duhura të fëmijës dhe prindërve. Në këtë fazë të procedurës, bashkëpunimi mes parashtruesit të aplikacionit dhe Ministrisë së Drejtësisë

²¹ Neni 6 par. 4 I Ligjit të Rrëmbimit.

²² Praktikata më të mira të ndërtuara nga Konferenca e Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private, janë të një rëndësie të veçantë, prandaj edhe Ligji i rrëmbimit në nenin 20 parashikon se "Ky ligj do të interpretohet dhe zbatohet në pajtim me Konventën e Hagës si dhe me praktikata më të mira të siguruara nga Konferenca e Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private."

²³ Shih *GUIDE TO GOOD PRACTICE* under the Hague Convention of 25 October 1980 on the Civil Aspects of International Child Abduction PART I - CENTRAL AUTHORITY PRACTICE.

Në web faqen: <https://www.hcch.net>, seksioni "Child Abduction", mund të gjendet aplikacioni.

është crucial, për të eliminuar pengesat që mund të paraqiten gjatë shtjellimit të tij nga ana e autoriteteve qendrore të shtetit të huaj.²⁴

3. Zbulimi i vendndodhjes (lokalizimi) së fëmijës

Lokalizimi i fëmijës së rrëmbyer është faza pasuese pas pranimit të aplikacionit për kthim, pasi Ministria e Drejtësisë të konstatojë se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara nga Ligji i rrëmbimit. Kjo mund të paraqitet të jetë një nga fazat më problematike të procedurës, në rastet kur prindi rrëmbyes me qëllim eliminimin e kontakteve me prindin tjetër, ndërmer veprime që bënë të pamundur gjetjen e tij. Në Kosovë, me rastin e parashtrimit të aplikacionit në Ministri të Drejtësisë, nga aplikuesi (prindi), kërkohet që të japë informacione se në drejtim të cilit vend dyshohet se fëmija i tije/sajë është larguar, dhe mbi bazën e këtyre informacioneve, Ministria e Drejtësisë/Autoriteti qendror, bënë operimet e duhura me qëllim vënies së kontakteve me autoritetin qendror homolog. Lokalizimi dhe dërgimi i aplikacionit për kthim tek shteti i caktuar, paraqet një fazë vendimtare të procedurës, ngase bëhet vendosja e raporteve mes dy shteteve, ku më pastaj do të vazhdonte bashkëpunimi i ngushte deri në marrjen e një vendimi për kthimin ose refuzimin e kthimit të fëmijës në Kosovë.

Në Ligjin e rrëmbimit, për sa i përket zbulimit të vendndodhjes së fëmijës flet neni 4 par. 2 pika 2, në të cilin thuhet se Autoriteti qendror është i ngarkuar *për të zbuluar vendndodhjen e fëmijës, i cili është larguar apo mbajtur pa të drejtë*, pa qartësuar me tutje se cilat mjete mund të përdoren. Nëse i referohemi praktikave më të mira të Konferencës së Hagës dhe shteteve të ndërhuara në këtë aspekt, mund të konsiderohet shfrytëzimi i rrjeteve ndërkombëtare të bashkëpunimit i cili mund të paraqesë ndihmesë të konsiderueshme, për shkak të shtrirjes së tyre që kanë, dhe numrit të shteteve që tërheqin pas vete. Në këtë mes INTERPOL mund të luajë një rol konstruktiv dhe të dobishëm në lokalizimin e fëmijës së rrëmbyer. Nuk është e nevojshme të fillohet procedura penale në mënyrë që të kërkohet ndihmë të tillë, por mund të shërbejë si bazë për kërkim të personave të zhdukur,

²⁴ Për më shumë shih: *GUIDE TO GOOD PRACTICE* under the Hague Convention of 25 October 1980 on the Civil Aspects of International Child Abduction PART I - *CENTRAL AUTHORITY PRACTICE*, fq. 33. Ky publikim paraqet njërin nga udhëzuesit të nxjerrë nga ekspertët të Konferencës së Hagës, me qëllim lehtësimin dhe unifikimin e procedurave në mes shteteve anëtare, për të trajtuar rastet e rrëmbimit.

dhe në të vërtetë procedura penale mund të jetë kundër-produktive në raste të veçanta. Është në diskrecion të çdo vendi të përcaktojë se si mund të bëhet komunikimi me rrjetin INTERPOL²⁵, në lidhje me rrëmbimet e fëmijëve²⁶.

Neni 9 Konventës së Hagës, ka përcaktuar se pasi të pranohet një aplikacion nga ana e një autoriteti qendrorë i caktuar dhe fëmija nuk gjendet në atë shtet, por ka informacion se një fëmijë gjendet në një shtet tjetër, ka për obligim që aplikacionin për kthim ta transmetojë tek ai shtet, dhe për ndërmarrjen e këtyre veprimeve të informoj shtetin kërkues. Kjo normë është e ndërtuar mbi parimin se procedura e për kthimin e fëmijëve është urgjente, dhe ndikon në shkurtimin e kohës së procedimit të rasteve. Të njëjtën normë e përmban dhe Ligji i Kosovës për rrëmbimin, në formulimin e njëjtë me atë të Konventës së Hagës.

Në qoftëse pas pranimit të aplikacionit sigurohet informacion se një fëmijë është lokalizuar në një shtet të caktuar, përgatitet dosja në gjuhën zyrtare në përdorim në atë shtet, dhe dërgohet përmes rrugëve diplomatike të komunikimit. Një gjë e tillë, nuk është normuar në Ligjin e rrëmbimit, mirëpo kjo është gjendja faktike që në realitet e ndjekë Ministria e Drejtësisë, kurse nëse bëjmë krahasim me Rregulloren e UNMIK nr. 2004/29 mbi mbrojtjen nga rrëmbimi ndërkombëtar i fëmijëve, parashihej se të gjitha aplikacionet, vendimet, urdhrat dhe komunikimet tjera nga Kosova do t'u transmetohen autoriteteve të huaja nëpërmjet kanaleve diplomatike²⁷.

4. Inicimi i procedurës së kthimit kur fëmija është rrëmbyer në Kosovë

Ligji i rrëmbimit por edhe Konventa e Hagës bënë ndarjen e rasteve me origjinë nga Kosova – rastet kur fëmija rrëmbehet në Kosovë, dhe rasteve me origjinë nga shtete e huaja – rastet kur njëri prind së bashku me fëmijë

²⁵ Republika e Kosovës nuk është e anëtarësuar në INTERPOL, mirëpo ka bashkëpunim me të. Kosovën në këtë organizatë e përfaqëson UNMIK.

Lidhur me mundësitë që mund të përdoren në Mbretërinë e Bashkuar për lokalizimin e fëmijës, shih: Standley, Kate, *Family Law*, Palgrave, London, 1993, fq. 200.

²⁶Raporti i takimit të dytë të komisionit të Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private, për rishikimin e funksionimit të Konventës Hagës (18-21 janar 1993), konkluzioni i gjashtë, <https://www.hcch.net>, seksioni "Special Commission meetings".

²⁷ Seksioni 3 par. 3.1.

ka hyrë në Kosovë, duke e lënë në shtetin tjetër njërin prind. Edhe në këto raste, aplikacionin për kthim nga shteti i huaj e pranon Ministria e Drejtësisë përmes rrugëve diplomatike, apo në ndonjë formë tjetër të komunikimit, duke përfshirë me email apo faks që shërben mjaft mirë në kursimin e kohës²⁸.

Menaxhimi i rastit bëhet në përputhje me procedurën e përcaktuar me Ligjin e rrëmbimit. Duke u referuar standardeve të praktikave më të mira të ndërhuara në këtë fushë, Autoriteti qendror duhet që tërë procedurën ta trajtojë me urgjencë dhe kujdes. Së pari është e preferueshme që të shteti që pranon aplikacionin të konfirmojë autoritetit qendror kërkesën se ka pranuar aplikacionin, me qëllim të realizimit me shpejtësi të kësaj preferohet që një gjë e tillë të bëhet përmes mjeteve elektronike të komunikimit (email)²⁹. Pas pranimit të aplikacionit Autoriteti qendror e regjistron aplikacionin në regjistrat e sajë përkatës, dhe analizohet aplikacioni nëse i plotëson kushtet e duhura për të vepruar më tej sipas tij (shqyrtimi paraprak i aplikacionit dhe dokumenteve mbështetëse)³⁰.

4.1. Procedura për kthim vullnetar

Pas pranimit të aplikacionit dhe sigurimit se është e mundur të veprojë sipas tij, Ministria e Drejtësisë ka për obligim që të zbulojë vendndodhjen e fëmijës dhe personit që e ka rrëmbyer, se në cilin vend në Kosovë qëndron fëmija. Kjo e dhënë mund të sigurohet në bazë të informacioneve të ndryshme, një ndër to përfshinë të dhënat e ofruara në aplikacionin për kthim. Po qesë në të nuk ofrohet një e dhënë e tillë, atëherë, Ministria e Drejtësisë shfrytëzon ndihmën e Policisë së Kosovës për të lokalizuar

²⁸ GUIDE TO GOOD PRACTICE under the Hague Convention of 25 October 1980 on the Civil Aspects of International Child Abduction PART I - CENTRAL AUTHORITY PRACTICE, Hague Conference on Private International Law 2003, fq. 44.

²⁹ Po aty faqe 45.

³⁰ Në Kosovë mendohet se brenda një viti pranohen 2-3 aplikacione. Kurse nëse analizojmë statistikat e 2008 të shteteve tjera si: Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë pranuar 283 aplikacione për kthim, ndërsa Anglia dhe Uells mori 200, Meksikë 168 dhe Gjermania 115. Shih: Analiza statistikore e aplikimeve të bëra në vitin 2008 nga shtetet anëtare të Konventës së Hagës për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve, Raport global, pjesa e parë, faqe 9. Publikim i Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private.

fëmijën. Në shkresën që i drejtohet policisë, Ministria mund të ofrojë ndonjë të dhënë lidhur me vendet që dyshon lidhur me vendndodhjen e fëmijës.

Sigurimi i vendndodhjes së fëmijës dhe personit rrëmbyes, paraqet hap vendimtar, ngase më pas në përputhje më nenin 7 par. 1 të Ligjit të Rrëmbimit, Ministria e Drejtësisë ka për detyrë të informojë kujdestarin e përkohshëm të fëmijës se larguar apo mbajtur padrejtësisht në lidhje me kërkesën për kthim dhe do të bëjë propozimin për të siguruar kthimin vullnetar të fëmijës ose për të arritur marrëveshje³¹. Në Kosovë deri më tani ka funksionuar rregulli se Ministri i Drejtësisë në emër të tij i është drejtuar personit që mbanë pa të drejtë fëmijën në Kosovë, që të ndërmer veprime të kthejë në mënyrë vullnetare fëmijën në vendin nga është rrëmbyer, si dhe duke e njoftuar personin rrëmbyes lidhur me konsekuencat që mund të pasojnë, nëqoftëse nuk e kthen fëmijën vullnetarisht, e që mund të pasojnë me procedurë gjyqësore.³²

Vënia e kontakteve me prindin rrëmbyes, duhet të bëhet me kujdes dhe në mënyrë të përshtatshme, ngase ai me qëllim të shmangies së kthimit të fëmijës, mund të ndodhë që fëmijën ta ri-rrëmbejë në shtete tjera, ose të bëjë të vështirë komunikimin e mëtejme me të. Nëse konsiderohet mjaftueshëm e rrezikshme se prindi rrëmbyes do ta rrëmbejë, ose keqtrajtojë fëmijën, duhet të konsiderohet që në këtë fazë të procedurës të kërkohen urdhra për masa të përkohshme nga gjykata që të ndalojë prindit rrëmbyes që të lëvizë fëmijën nga vendqëndrimi i tij³³. Po ashtu në këtë stad, praktikat më të mira udhëzojnë që kur të pranohet një aplikacion për kthim, Autoriteti Qendror duhet të luaj rol lehtësues në dhënien e informacionit mbi shërbimet e ndërmjetësimit të përshtatshme për rastet ndërkufitare të rrëmbimit të fëmijëve. Së këndejmi arritja e një marrëveshje jashtëgjyqësore në procedurë të ndërmjetësimit, në shtetet perëndimore zë vend gjithnjë e më shpesh³⁴.

³¹ Procedurën për kthim vullnetar e parasheh edhe Konventa e Hagës në nenin 10.

³² Lidhur me këtë është rasti "Nikolla" ashtu që në vitin 2014, ishte arritur kthimi në mënyrë vullnetare i fëmijëve nga Kosova në Zvicër.

³³ Neni 15 i Ligjit të rrëmbimit.

³⁴ Shih: *MEDIATION Guide to Good Practice under the Hague Convention of 25 October 1980 on the Civil Aspects of International Child Abduction*, HccH, 2012, fq. 42.

Ndërmjetësimi në rastet ndërkufitare të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve, paraqet procedurë të komplikuar, ngase shpesh herë kërkohet që të vëhen kontakte me të dy prindërit që me vendndodhje janë në shtete të ndryshme, përveç kostos së madhe, vijnë në shprehje edhe vështirësi organizative etj., mirëpo paraqet mundësi efektive për arritjen e një marrëveshje jashtëgjyqësore që do të ishte e arritur nga vetë palët dhe rrjedhimisht më lehtë

Kthimi i fëmijës në mënyrë vullnetare, e kështu duke i shmangur procedurat gjyqësore janë më të përshtatshme për fëmijën, ngase ai do t'i shmanget proceseve gjyqësore të mundimshme që do të pasonin në të kundërtën. Po ashtu nëse mundësohet pajtimi për kthim vullnetar, edhe procedura do të zgjasë më pak, kurse nëse iniciohet procedurë gjyqësore, kjo mund të marrë më shumë kohë, ngase secila palë e pakënaqur me një vendim gjyqësor do të mund të përdorte të drejtën në ankesë dhe lënda të përfundoje në instanca më të larta gjyqësore, që me konsekuencë kanë kosto kohore. Në Republikën Federale të Gjermanisë, është llogaritur se procedura për kthim vullnetar ka zgjatur mesatarisht brenda 64 ditësh, kurse nëse është inicuar procedurë gjyqësore dhe është vendosur për kthimin e fëmijës në shtetin e mëhershëm, procedura ka zgjatur mesatarisht 122 ditë, kurse kur është refuzuar kërkesa për kthim, procedura ka zgjatur 164 ditë³⁵.

Në nenin 7 par. 2 të Ligjit të Rrëmbimit është përcaktuar se nëse kujdestari i përkohshëm nuk ndërmerr veprime brenda shtatë ditëve prej datës kur e ka pranuar shkresën për kthim vullnetar, Ministria e Drejtësisë do të iniciojë procedurat gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe është e autorizuar të veprojë në interes të kërkuarit për kthimin e fëmijës nga Kosova. Së këndejmi roli i Ministrisë së Drejtësisë paraqitet të jetë mjaft aktiv në këtë fazë të procedurës.

4.2. Inicimi i procedurës gjyqësore

Inicimi i procedurës gjyqësore do të paraqitet në rastin kur mbajtësi i fëmijës, refuzon të kthejë fëmijën në mënyrë vullnetare. Trajtimi në aspekt të procedurës gjyqësore të rasteve të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve, bëhet në pajtim me rregullat Ligjit të Procedurës Jokontestimore³⁶. Nëse analizohet në aspektin krahasues, shtetet anëtare të Konventës së Hagës kanë ndërtuar rregulla të veçanta mbi të cilat udhëhiqet procedura në rastet

e implementueshme. Në Kosovë tashmë ekzistojnë rreth 10 ndërmjetësues që janë të certifikuar për trajtimin e rasteve të ndërmjetësimit në çështjet familjare ndërkufitare. Trajnimin e tyre e kanë bërë ekspertë gjerman.

³⁵ Shih: Raporti kombëtar i Gjermanisë, i përpiluar në 2001 nga Konferenca e Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private, Analiza statistikore pjesa dytë, faqe 14 dhe 15 i këtij raporti.

³⁶ Neni 8 par. 2 i Ligjit të rrëmbimit.

e rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve, me qëllim të shpejtimit të procedurës. Ka raste kur gjykatat kanë krijuar edhe protokolle të veçanta për trajtimin e këtyre rasteve³⁷, kryesisht duke u udhëhequr nga natyra specifike që kërkon trajtimi i këtyre rasteve. Sido që të jetë, brenda kornizës ligjore të tanishme mund të gjenden zgjidhje në kuptim trajtimin sa më të mirëfilltë të këtyre rasteve. Në këtë kuptim mund të përmenden masat e përkohshme të cilat gjykata është e autorizuar t'i caktojë. Në praktikën gjyqësore ka raste kur masat e tilla janë caktuar me qëllim të mos ndryshimit të gjendjes ekzistuese. Kështu psh. Gjykata Themelore në Prishtinë, kishte marrë vendim duke e urdhëruar prindin rrëmbyes që të mos i ndaloj prindit tjetër kontaktet me të, deri në fazën e zgjidhjes së rastit përfundimisht³⁸

Është rregull i përgjithshëm se procedura jokontestimore inicohet me propozim të personit fizik apo juridik, kurse me propozim të organit shtetëror në raste më të limituara. Tek inicimi i procedurës së kthimit të fëmijës ndodh pikërisht kjo, Ministria e Drejtësisë është ajo që inicohet procedurën gjyqësore për kthim, mirëpo, akti me të cilin inicohet procedura jokontestimore nuk është propozimi në kuptimin formalo-juridik, mirëpo aplikacioni për kthim dhe shkresa përcjellëse e përpiluar nga Ministria e Drejtësisë³⁹.

Në aspektin e kompetencës, Ligji i rrëmbimit në nenin 8 par. 1 ka përcaktuar se Gjykata Themelore në Prishtinë do të ketë juridiksionin ekskluziv të instancës së parë për tërë territorin e Kosovës, përderisa me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/29 për Mbrojtjen kundër Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve, në seksionin 4 par. 4.1 parashihej se Gjykata e Qarkut në territorin ku është gjendur fëmija është kompetente për të trajtuar atë rast. Praktikën e koncentrimin të juridiksionit gjyqësor të trajtimin të këtyre rasteve, e kanë ndjekur një pjesë e madhe e shteteve, duke e limituar kompetencën në numër të vogël të gjykatave të tyre⁴⁰. E gjithë kjo duke pasur parasysh avantazhet e pritshme që mund të arrihen, si: përvojë më e madhe e gjyqtarëve të kësaj lëmine; rritja e nivelit të kuptimit të procedurave të

³⁷ Schuz, Rhona, *The Hague Child Abduction Convention: A Critical Analysis*, Hart Publishing, 2014.

³⁸ Vendimi C.nr.2955/2013, i Gjykatës Themelore në Prishtinë datë 08.01.2014.

³⁹ Shih neni par. 1 i Ligjit Nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore.

⁴⁰ Gjermania ka përcaktuar se vetëm 24 gjykata të instancës së parë do të jenë kompetente për trajtimin e këtyre rasteve, dhe një numër i caktuar i gjyqtarëve. Në Holandë ka vetëm një gjykatë kompetente.

caktuara; zvogëlim i vonesave etj.⁴¹ Së këndejmi, duke qenë se në Kosovë paraqiten një numër jo edhe aq i madh rasteve të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve, është mëse e arsyeshme që vetëm një gjykatë të jetë me kompetencë ekskluzive, me qëllim të rritjes së profesionalizmit dhe eksperiencës së gjyqtarëve të ngarkuar me këto raste.

Më nenin 9 të ligjit të rrëmbimit është përcaktuar se kur Gjykata Themelore në Prishtinë e pranon një kërkesë sipas këtij ligji, procedurat në çfarëdo gjykatë tjetër në Kosovë në lidhje me çështjen e kujdestarisë së fëmijës do të ndërpriten derisa procedura për kthimin e fëmijës ka përfunduar.

Ligjvënësi i Kosovës është rreshtuar në mesin e shteteve, që ka përfaqëson atë që është edhe vet qëllimi i Konventës së Hagës - trajtimi me urgjencë i procedurave që duhet të zhvillohen sa i përket vendosjes lidhur me kthimin e fëmijës. Këtë e gjejmë në nenin 1 të Ligjit të rrëmbimit, ku thuhet: *Qëllimi i këtij ligji është, sigurimi i kthimit të shpejtë të fëmijës që largohen apo mbahen pa të drejtë në shtetin e vendqëndrimit...*, po ashtu në nenin 8 par. 7 parashihet se *gjykatat duhet t'i japin përparësi procedurave të kërkesës për kthimin e fëmijës*, në këtë aspekt edhe procedura që zhvillohet pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë duhet të ndjekë këtë logjikë. Në Angli janë të përcaktuara edhe afatet kohore për trajtimin e rastit⁴². Zhvillimi i shpejtë i procedurës paraqitet të jetë vënë ndër çështjet kryesore si nga ligji i rrëmbimit, ashtu edhe nga Konventa e Hagës. Neni 8 par. i Ligjit të Rrëmbimit ka përcaktuar se procedura gjyqësore duhet të përfundoj brenda afatit prej 42 ditëve, por me mendësi të vazhdimin. Mirëpo në praktikë vendosja brenda këtyre afateve mund të rezultojë të jetë mjaft e vështirë, sepse shpesh herë brenda procedurës gjyqësore mund të paraqitet nevoja që të kërkohet ndihma nga shteti i huaj. Rast i tillë mund të jetë dërgimi i thirrjes për seancë gjyqësore personit që parashtron kërkesë për kthim të fëmijës, që vendbanimin e ka në shtetin e huaj, dhe kjo mund të merr kohë të konsiderueshme. Në praktikë gjyqësore ka pasur raste kur procedura për kthim është zhvilluar edhe pa i dërguar letërthirrjen për seancë gjyqësore personit që ka kërkuar kthim e fëmijës⁴³. Mirëpo zhvillimi i procedurës në

⁴¹ Konkluzione dhe Rekomandime të takimin e katërt të Komisionit Special të shqyrtimit dhe funksionimit të Konventës së Hagës (22-28 mars 2001) paragrafi 3.1 i përmbledhjes, përgatitur nga Zyra permanente e Konferencës së Hagës.

⁴² Shih: Lowe, Nigel & Armstrong, Sarah, GOOD PRACTICE IN HANDLING HAGUE ABDUCTION CONVENTION RETURN APPLICATIONS, 2002, fq. 51.

⁴³ Shih Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren A.gj. nr. 2/2009-16.

mungesë të parashtruesit të kërkesës, nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës është konsideruar si shkelje e nenit 6 "E drejta për një Proces të Rregull të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut"⁴⁴.

Në procedurën që zhvillohet pranë gjykate, duhet që të merren provat që ofrohen nga palët, mirëpo gjykata ka për detyrë që aplikoj edhe parimin e hetimit, duke u kujdesur që të merr edhe ato prova që i konsideron relevante për vërtetimin e fakteve, që mund të kenë rëndësi në marrjen e vendimit përfundimtar. Gjatë procedurën mund të lindë nevoja që të merren të dhëna nga shteti i vendbanimit të përhershëm të fëmijës, për këtë qëllim gjykata duhet t'i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë-Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, i cili është i obliguar që të veprojë me urgjencë në drejtim të sigurimit të të dhënave gjegjëse.

Ndihma juridike ndërkombëtare domosdoshmërisht është e nevojshme tek këto raste, ngase kemi të bëjmë me trajtim të rastit me element të huaj, ku janë të përfshirë së paku dy shtete. Me qëllim të arritjes së objektivave sa më të mira, brenda shteteve anëtare të Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare private ekziston Rrjeti ndërkombëtar i Hagës për gjyqtarë, i cili përbëhet nga gjyqtar të zgjedhur nga ç' do shtet, të cilët kanë rol që nëse gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore nevojitet që të merret një e dhënë (dëshmi, apo vërtetimi i ndonjë fakti), apo të merr informacione lidhur me kornizën ligjore të shtetit nga është pranuar aplikacioni për kthim, të komunikojnë direkt në arritjen e qëllimeve. Kjo mënyrë e komunikimit është tejet efikase, ngase mundëson që brenda një kohe të shkurtër të arrihet deri tek informacioni i kërkuar, pra duke eliminuar procedurat burokratike të komunikimit, e që rrjedhimisht procedura gjyqësore për vendosjen e një rasti të jetë më e shpejtë⁴⁵.

4.3. Marrja e vendimit nga gjykata

Gjykata vendimin përfundimtar me të cilin e vendos rastin e merr në formë të aktvendimit. Në Ligjin për rrëmbim përdoret fjala urdhër për kthim,

⁴⁴ Aktgjykimi Nr.ref. AGJ 455/13 i datës 05.07.2013.

⁴⁵ Shish: *Direct Judicial Communications*, HccH 2013, fq. 7.

Kosova ende nuk është anëtare e këtij rrejt, mirëpo me t'u anëtarësuar në Konferencën e Hagës, do të hapet mundësia për një gjë të tillë. Kjo do të paraqiste avantazh të madh, ngase përveç në rastet e rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve, do të mund të shfrytëzohej edhe në raste tjera që kanë të bëjnë me fëmijët.

mirëpo aktvendimi ka karakterin detyrues të urdhrit, i cili i obligon palët në zbatimin e tij.

Është në diskrecionin e gjykatës që bazuar në procedurën provuese gjyqësore, të merr dy lloje urdhrash, të urdhëroj kthimin e fëmijës, ose të refuzoj kthimin. Deri tek njëra apo tjetra mënyrë e vendosjes, arrihet pasi gjykata konstaton se janë plotësuar kushtet nga neni 11 respektivisht 12 i Ligjit të rrëmbimit.

Vendimin për kthim gjykata e merr pasi të konstatoj se janë plotësuar kushtet në nenin 3 të Ligjit të rrëmbimit⁴⁶ dhe kur konstaton se fëmija është larguar apo mbajtur pa të drejtë në Kosovë, një vendim i tillë mund të merret po ashtu kur nga data kur është pranuar kërkesa në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ka kaluar një periudhe me pak se një (1) vit nga data e largimit apo mbajtjes së padrejtë të fëmijës në Kosovë. Gjykata do të mundet të nxjerrë vendim për kthimin e fëmijës, nëse konstaton se ai përkundër kohës që ka kaluar në Kosovë nuk është provuar se fëmija tashmë është vendosur në një mjedis të ri të tij⁴⁷. Vendimin e sajë me të cilin është urdhëruar kthimi, Gjykata Themelore në Prishtinë duhet ta zbatojë sipas detyrës zyrtare, dhe do të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme. Shtet e ndryshme kanë ndërtuar praktika të ndryshme në drejtim të mbikëqyrjes së ekzekutimit të urdhrit, psh., në Belgjikë mbikëqyrjen e bënë Prokuroria Publike, në Kanada Autoriteti qendror është ai i cili bënë mbikëqyrjen e ekzekutimit të urdhrit, në Zvicër ka gjykata të specializuara për ekzekutimin e urdhrit⁴⁸. Në praktikë është treguar se marrja e urdhrit për kthim dhe ekzekutimi i tij, mund të ndryshojnë mes tyre. Kështu psh., është i njohur rasti *Gashi*, ashtu që fëmijët ishin rrëmbyer nga Gjermania në Kosovë, për kthimin e tyre në Gjermani kishte vendosur Gjykata Supreme e Kosovës në vitin 2012, kurse ekzekutimi i vendimit nuk ka qenë i mundur të bëhet për 7 vite, derisa sa përfundimisht në muajin nëntor 2019 është ekzekutuar vendimi dhe fëmijët janë kthyer në Gjermani⁴⁹.

Tashmë disa herë është vënë theksi tek rëndësia që ka trajtimi me urgjencë i rasteve, deri sa janë në procedurë gjyqësore, mirëpo edhe deri sa ekzekutohet urdhri për kthim, prandaj shtetet kanë vënë organe të

⁴⁶ Shih faqe 4 e këtij punimi.

⁴⁷ Në këtë pikë, Ligji i rrëmbimit është i ngjashëm me Konventën e Hagës, shih nenin 12.

⁴⁸ *ENFORCEMENT GUIDE TO GOOD PRACTICE* under the Hague Convention of 25 October 1980 on the Civil Aspects of International Child Abduction, HccH, 2010, fq. 30.

⁴⁹ Shih Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Mlc.nr.21/2012 datë 12.11.2012.

specializuara për trajtimin e rasteve. Një problematikë e tillë është trajtuar edhe nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Rasti *Bianchi kundër Zvicrës* është një prej tyre, i cili kishte të bënte me rrëmbimin e një fëmije nga nëna e tij zvicerane. Babai u ankua për kohëzgjatjen e procedurave para Kantonit të Lucernit dhe dështimin autoritetet zvicerane për të zbatuar vendimet gjyqësore që e urdhëronin kthimin e djalit në Itali. Gjykata Evropiane kishte gjetur se ka shkelje të nenit 8 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, dhe zgjatja e procedurave që kishin shkaktuar ndarje të babait nga fëmija i tij për dy vjet, nuk ishin në frymën e Konventës së Hagës së 1980⁵⁰.

Vendimin tjetër që mund të merr gjykata është refuzimi i kthimit të fëmijës. Një vendim të tillë gjykata e merr në këto raste:

- konstatohet që personi, institucioni apo organi tjetër që është kujdesur për fëmijën nuk po ushtronin të drejtat e kujdestarisë në kohën e largimit apo mbajtjes ose kanë rënë dakord, ose si rrjedhojë të kenë pranuar në heshtje largimin apo mbajtjen e padrejtë të fëmijës.
- Në rrethana përjashtuese gjykata nuk është e detyruar të urdhërojë kthimin e fëmijës, nëse ekziston rrezik serioz që kthimi do ta ekspozojë fëmijën ndaj dëmit fizik ose psikologjik ose vënien e fëmijës para një situatë të pa tolerueshme.
- nëse gjen se fëmija kundërshton të kthehet dhe ka arritur një moshë dhe një shkallë pjekurie, sipas së cilës është në gjendje të vendosë vetë për jetën e vet⁵¹.

Kjo pjesë e Ligjit të rrëmbimit që rregullon refuzimin e kthimit, është tërësisht e kopjuar nga Konventa e Hagës, mirëpo, me një ndryshim, që mund të ketë ndodhur gjatë përkthimit të dispozitës, së nenit 13 pika a) të Konventës. Neni 12 par. 1 i Ligjit të rrëmbimit përcakton se: "...personi, institucioni apo organi tjetër që është kujdesur për fëmijën nuk po ushtronin të drejtat e kujdestarisë në kohën e largimit apo mbajtjes ose kanë rënë dakord, ose si rrjedhojë të kenë pranuar në heshtje largimin apo mbajtjen e

⁵⁰ *Bianchi kundër Zvicrës*, Aplikacioni nr. 7548/04. Ka pasur raste në të cilat edhe Republika e Shqipërisë ka përfunduar para Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. I tillë është rasti *Bajrami kundër Shqipërisë*. Shih: *Bajrami kundër Shqipërisë* Aplikacioni nr. 35853/04.

⁵¹ Neni 12 i Ligjit të rrëmbimit.

padrejtë të fëmijës”, kurse Konventa e Hagës fjalën *e padrejtë* nuk e përdorë. Mendojmë se cilësimin mbajtje *e padrejtë* duhet të fshihet nga Ligji i rrëmbimit, ngase këtë e konstaton gjykata. Mirëqenia e fëmijës paraqitet të jetë një ndër fokuset e Konventës së Hagës. Në frymës e këtij akti, në rastet kur dyshohet se kthimi i fëmijës mund t’i nënshtrohet dhunës në shtetin ku do të kthehet, duhet të refuzohet kërkesa për kthim⁵².

Përfundim

Rregullimit të materies së aspektit civil të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve, shtetet bashkëkohore i kushtojnë interes të çmueshëm, ngase çështjet familjare zënë vend të rëndësishëm në legjislacionet e tyre, duke pasur parasysh ndërlikueshmërinë dhe ndjeshmërinë e tyre. Duke qenë se subjekt kryesor në këtë rrafsh paraqitet të jetë fëmija, kjo ndjeshmëri në vazhdimësi shënon rritje.

Të drejtat e shteteve bashkëkohore kanë tendencë që trajtimin e kësaj fushe ta bëjnë në mënyrë sa më uniforme, rol tejet të madh në këtë pikë ka zënë Konferenca e Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private, e cila në periudha afatshkurtra kohore mbledhë shtetet anëtare për diskutime në sesione, nga dalin me qëndrime dhe udhëzues të praktikave më të mira në zbatim të Konventës së Hagës mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës. Së këndejmi, diskutimet për këtë janë të ngritura e të kundruara në nivele mjaft të larta.

Duke marrë shkas nga pozita jo e favorshme që mund të gjendet fëmija i rrëmbyer dhe i dërguar në një shtet të huaj, kjo çështje ngre pas vetes edhe një kolorit social dhe emocional, prandaj mbrojtja e fëmijëve është objekt i akteve të ndryshme ndërkombëtare si Konventa e Hagës mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve, pastaj Konventa mbi të drejtat e fëmijës e OKB-së. Gjithashtu edhe organizatave ndërkombëtare.

⁵² Lindhorst, Taryn & Edleson, Jeffrey L., *Battered Women, Their Children, and International Law: The Unintended Consequences of the Hague Child Abduction Convention*, Northeastern University Press, Boston, 2012, fq. 13.

Siç edhe është elaburuar më lartë, Republika e Kosovës ende nuk është anëtare në Konventën së Hagës mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës, e po ashtu nuk është anëtare në Konferencën e Hagës, mirëpo autoritetet kompetente do të duhej të trajtonin mundësinë e anëtarësimit në Konventën e Hagës, i cili do të ngriste në një nivel më të avancuar pozitën e trajtimit të fëmijëve të rrëmbyer dhe mbajtur pa të drejtë. Nga analiza e bërë Ligjit për Aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës Ligji Nr. 03/L-238, mund të nxjerrim këto përfundime:

Së pari: Në Ligjin e rrëmbimit konsiderojmë se duhet të rishikohen masat e përkohshme që janë paraparë nga ligjdhënësi, të cilat mund t'i urdhëroj gjykata. Lista e masave të përkohshme do të duhej të përfshinte gamë të gjerë të tyre, që do të ndikonin në pengimin e dëmtimit të fëmijës, e po ashtu në ri-rrëmbimin e fëmijës gjatë procedurës.

Së dyti: Ligji i rrëmbimit në pjesën më të madhe të sajë ka bërë transpozimin (kopjimin) e dispozitave të Konventës së Hagës, gjë që ka avantazhet e sajë ngase e ofron ligjin nga standardi i Konventës, mirëpo duhet pasur parasysh se kemi të bëjmë me ligj nacional. Prandaj do të duhej të konsiderohet si mundësi që ligji të përfshijë edhe dispozita procedurale karshi atyre materiale, ngase do të përmirësonte operimin e sajë në praktikë. Nga disa ekspert të BE-së është sugjeruar që të aplikohen rregullat e Ligjit të Procedurës Kontestimore, pra ndryshe nga versioni i tanishëm, që parasheh zbatimin e dispozitave të Ligjit të Procedurës Jokontestimore.

Së treti: Siç edhe i jemi referuar praktikave më të mira të Konferencës së Hagës lidhur me ndërmjetësimin, që paraqet zgjidhje të rastit në mënyrë jashtëgjyqësore, në Ligjin e rrëmbimit mund të konsiderohet që të përfshihen dispozita të veçanta që në ç'do fazë të procedurës, gjykata të referonte rastin në ndërmjetësim⁵³.

Bibliografia

I. Literatura:

- Lindhorst, Taryn, Edleson, L. Jeffrey, *Battered Women, Their Children, and International Law: The Unintended Consequences of The Hague Child Abduction Convention*, Northeastern University Press, Boston, 2012;

⁵³ Shih: MEDIATION Guide to Good Practice under the Hague Convention of 25 October 1980 on the Civil Aspects of International Child Abduction, HccH, 2012.

- Schuz, Rhona, *The Hague Child Abduction Convention: A Critical Analysis*, Hart Publishing, 2014;
- Standley, Kate, *Family Law*, Palgrave, London, 1993;
- *Netherlands International Law Review, International Law, Conflict of Laws*, Springer International Publishing, dhjetor 2015;
- Murphy, John *International Dimensions in Family Law*, Manchester University Press, 2005;
- ENFORCEMENT GUIDE TO GOOD PRACTICE under The Hague Convention of 25 October 1980 on the Civil Aspects of International Child Abduction, HccH, 2010;
- Lowe, Nigel & Armstron, Sarah, GOOD PRACTICE IN HANDLING HAGUE ABDUCTION CONVENTION RETURN APPLICATIONS, 2002;
- *MEDIATION* Guide to Good Practice under The Hague Convention of 25 October 1980 on the Civil Aspects of International Child Abduction, HccH, 2012;
- GUIDE TO GOOD PRACTICE under The Hague Convention of 25 October 1980 on the Civil Aspects of International Child Abduction PART I - CENTRAL AUTHORITY PRACTICE, Hague Conference on Private International Law 2003;
- *GUIDE TO GOOD PRACTICE* under the Hague Convention of 25 October 1980 on the Civil Aspects of International Child Abduction PART II – IMPLEMENTING MEASURES, Hague Conference on Private International Law 2003;
- GENERAL PRINCIPLES AND A GUIDE TO GOOD PRACTICE transfrontier contact concerning children, Hague Conference on Private International Law 2008;
- *Raport shpjegues lidhur me Konventën e Hagës mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës 1980*, nga Elisa Pérez-Vera (1982).

II. Akte Juridike

- Ligji për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës Ligji Nr. 03/L-238;
- Ligji Nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore;
- Rregullore e UNMIK-ut Nr. 2004/29 për Mbrojtjen kundër Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve;
- Konventën e Hagës mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës, E miratuar më 25 tetor 1980;

- Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës e 1989;
- Konventa e Hagës mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve, 19 tetor 1996.

III. Burime tjera

- <https://www.hcch.net> – Konferenca e Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private.
- <https://hudoc.echr.coe.int>

Msc. Filloreta Lekiqi¹

Liria e shprehjes – deri ku shtrihet

Abstrakt

Liria e shprehjes është e drejtë e rëndësishme e individit që garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, por jo vetëm – liria e shprehjet njihet dhe garantohet edhe me aktet e tjera ndërkombëtare juridike që trajtojnë të drejtat e njeriut, përfshirë por jo duke u kufizuar në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Nuk ka vend të lirë, nuk ka demokraci pa njohje dhe garantim të së drejtës për lirinë e shprehjes, të garantuar nga gjykatat e pavarura dhe të paanshme.

Por edhe pse si një e drejtë themelore, manifestimi i saj nga një person nuk shkon deri në pakufi në raport me personin tjetër dhe në raport me shoqërinë në përgjithësi. Së këndejmi, dispozitat ligjore, por më shumë praktika gjyqësore, veçmas ajo e GJEDNJ, ka vendosur kufizime sa i përket realizimit të saj, duke bërë kështu që kësaj të drejte të individit t'i caktohen kufij të shtrirjes.

Ky punim mëton të trajtojë në pika të përgjithshme aspektet e rregullimit juridik të lirisë së shprehjes, bazuar në dispozitat ligjore por edhe vendimet e GJEDNJ-së, mënyrat se si shprehet, kufizimet e saj, ndërhyrjet në realizimin e saj etj.

Fjalët kyçe: liri e shprehjes, dispozita ligjore, akte ndërkombëtare, vendime gjyqësore, kufizime etj.

Hyrje

E drejta e lirisë së shprehjes, përbën një nga themelet bazë të një shoqërie demokratike, një nga kushtet themelore për përparimin dhe zhvillimin e saj.²

¹ Filloreta Lekiqi, Master në shkencat juridiko-civile, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë

² Shih rastin *Handyside V. The United Kingdom*, Ap. Nr. 5493/72, vendim i 7 dhjetorit 1976, paragrafi 49, shih <http://hudoc.echr.coe.int/app/conversion/pdf/?library=ECHR&id=001-57499&filename=001-> (shikuar më 09.09.2018).

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, si një nga të drejtat më të rëndësishme të njeriut, thekson të drejtën e lirisë së shprehjes. si e drejtë e përgjithshme që i takon çdo njeriu (neni 10. Paragrafi 1.). Kjo e drejtë e përfshin lirinë e pasjes së mendimit personal, marrjes dhe dhënies së informatave dhe të ideve pa ndërhyrje të pushtetit publik dhe pa marrë parasysh kufijtë. Natyrisht, shfrytëzimi i këtyre të drejtave tërheq pas vetes edhe disa obligime dhe përgjegjësi të caktuara, prandaj kjo mund t'u nënshtrohet formaliteteve të caktuara, kushteve dhe kufizimeve, madje edhe dënimeve, të parashikuara me ligj dhe të domosdoshme në shoqërinë demokratike.³ Teksti i Konventës nuk duhet të interpretohet jashtë jurisprudencës të saj.

Ajo që mund të konsiderohet emërues i përbashkët i të gjitha akteve që trajtojnë liritë dhe të drejtat e njeriut, e ndër to edhe të drejtën e lirisë së shprehjes, është se kësaj të drejte i jepet një vend tejet i rëndësishëm, duke u konsideruar njëkohësisht edhe si e drejtë personale, gjegjësisht liri personale, që në mënyrën më të domosdoshme janë të lidhura me dinjitetin e njeriut, integritetin trupor dhe moral të personalitetit dhe me privatësinë e tij.

Konventa funksionon mbi sistemin e vendimeve e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) që shpjegojnë dhe interpretojnë tekstet, andaj edhe në trajtimin e kësaj të drejte, vendimet përkatëse të GJEDNJ kanë zënë vend për trajtim meqë përbëjnë precedentë të detyrueshëm.

Ky punim paraqet një analizë të të drejtës në lirinë e shprehjes, analizë kjo e bërë nën prizmin e vendimeve të GJEDNJ. Struktura e punimit përmban shpjegimet me referenca të qarta për kualifikimin ligjor të kësaj të drejte dhe fushën e veprimit të së njëjtës, pastaj në detaje janë shtjelluar kufizimet që aplikohen në lidhje jetësimin e kësaj të drejte nga titullarët e saj, si dhe rëndësi i është kushtuar edhe diskurseve që nuk gëzojnë mbrojtje nga e drejta e lirisë së shprehjes. Arsyeja se përse kemi trajtuar pikërisht këtë temë është fakti se, të drejtat e njeriut, sado që konsiderohen "të njohura", ato prapë se prapë shumicë e herave paraqesin një enigmë në vete, veçmas nisur nga fakti se interpretimet e ndryshme të dispozitave ligjore, i japin edhe kahje të ndryshme zbatimin praktik të atyre dispozitave. Ndaj ky punim mëton të paraqes një

³ Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Botimi I, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit, Prishtinë, 2013 fq. 140.

përmbledhje të aspekteve më të rëndësishme të së drejtës së lirisë së shprehjes, natyrisht duke mos pretenduar që janë thënë të gjitha lidhur me të.

1. Kualifikimi ligjor i të drejtës së lirisë së shprehjes dhe fusha e veprimit

Sa herë që flasim për kualifikimin ligjor të një të drejte të njeriut, nisemi nga Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore⁴, e cila është shprehja më konkrete e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës për ruajtjen e vlerave të demokracisë, paqes dhe drejtësisë, dhe përmes tyre, edhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Kështu, në lidhje me lirinë e shprehjes, Neni 10(1) i **Konventës Evropiane për Liritë dhe të Drejtat Themelore të Njeriut**, të njëjtën e përkufizon si:

Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë [...].

Edhe Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut⁵ me nenin 19 rregullon të drejtën e lirisë së shprehjes duke përcaktuar me sa vijon:

Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe njoftimit të informacionit dhe ideve me çfarëdo mjeti qoftë, pa marrë parasysh kufijtë.

Edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës⁶ me nenin 40(1) njeh dhe garanton të drejtën e lirisë së shprehjes, duke përkufizuar me sa vijon:

Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë

⁴ Hartuar në vitin 1950 nga Këshilli i Evropës, Konventa hyri në fuqi më 3 shtator 1953.

⁵ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut është miratuar më 10 dhjetor 1948 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. Është përkthyer në më shumë se 350 gjuhë të botës, ndërsa teksti origjinal i Deklaratës përmban 30 nene.

⁶ E miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008.

informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush.

Me këtë Kushtetutë garantohen të drejtat e njeriut dhe të pakicave të parashikuara me rregullat botërisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare, të konfirmuara me marrëveshje ndërkombëtare dhe ligje. Të drejtat dhe liritë e njeriut të cilat janë vërtetuar me marrëveshje dhe instrumentet përkatëse ndërkombëtare janë të garantuar me këtë Kushtetutë dhe zbatohen drejtpërdrejt në territorin e Republikës së Kosovës,⁷ sipas përcaktimit të nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Liria e shprehjes është një e drejtë në vetvete si dhe një komponent i të drejtave të tjera të garantuara nga Konventa, si për shembull liria e mbledhjes. Në të njëjtën kohë, liria e shprehjes mund të konfliktuohet me të tjera të drejta të garantuara nga Konventa si e drejta për një gjykim të drejtë, për respektimin e jetës private, të ndërgjegjes dhe besimit fetar.⁸

Por në çka konsiston e drejta e lirisë së shprehjes? Si duhet kuptuar ajo? Thelbi i të drejtës së lirisë së shprehjes, përkatësisht nenit 10 të Konventës, ka lidhmëni të ngushtë me realizimin e të gjitha të drejtave të njeriut në përgjithësi. Kjo sepse pa ekzistimin e lirisë së shprehjes, shkeljet e të drejtave të njeriut mund të neglizhohen, të mos dihen dhe kështu abuzimet me to të kalonin pa u kontrolluar dhe pa u vërejtur. Një situatë e tillë do të na qonte në një mungesë llogaridhënieje. E drejta e lirisë së shprehjes, po ashtu, shërben edhe si mjet lehtësues komunikimi në shkëmbimin e informacionit kulturor, politik e social. Liria e shprehjes promovon dije, mirëkuptim dhe tolerancë në shoqëritë kulturalisht të ndryshme si ato të Evropës.⁹

Me të drejtën në lirinë e shprehjes, mbrohet, por nuk kufizohet vetëm në mbrojtjen e deklaratave të vërteta të fakteve, por kjo përfshin edhe shprehjen

⁷ Shih Komentari i Kushtetutës, fq. 83. Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, rregullon zbatimin e drejtpërdrejt të instrumenteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës.

⁸ *Liria e Shprehjes: një Udhëzues për implementimin e nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*, Këshilli i Evropës, Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut, Strazburg, 2001, fq. 7.

⁹ *Liria e Shprehjes dhe marrëdhënia e saj me të Drejtën për Respektimin e Jetës Private dhe të Drejtën për një Proces të Rregullt: Guidë mbi jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*, AIRE Centre, UK, 2017, fq. 10.

e mendimeve të tilla si kritikën dhe gjykimet mbi vlerat. Ky nen nuk kufizohet as në përmbajtje, që janë trajtuar si të favorshme, të padëmshme apo si çështje indiferente. Gjithashtu, përfshin informacione dhe ide që fyejnë, trondisin ose shqetësojnë. Këto informacione dhe ide mbrohen, mbi baze të parimit se një shoqëri demokratike nuk mund të ekzistojë pa një pluralizëm, tolerancë dhe largpamësi të caktuar.¹⁰

Gjithashtu, kjo e drejtë siguron mbrojtje në lidhje me një gamë shumë të gjerë të mjeteve të shpërndarjes së informacionit dhe ideve. Kjo mbrojtje shtrihet edhe në mediat kryesore, të tilla si televizioni, gazetën, si dhe shumë mjete të tjera të shprehjes të tilla si veshje, muzikë, ose mbishkrime.¹¹ Madje, GJEDNJ mbrojtje i ka ofruar edhe informacioneve dhe ideve të postuara në faqet e internetit. Liria e shprehjes përfshin lirinë negative për të mos folur, siç ishte vendosur në rastin *K kunder Austrisë*¹², duke mbrojtur kërkuesin kundër vetë-inkriminimit në lidhje me procedimet penale.

Fusha e zbatimit e të drejtës së lirisë së shprehjes është tejte e gjerë. Nga Neni 10 i Konventës, kuptohet se kjo e drejtë iu garantohet "të gjithëve", ku përfshihen personat fizik dhe kompanitë¹³. Gjithashtu, ky nen garanton lirinë e shprehjes për një shumëllojshmëri të gjerë informacionesh ose idesh, për shembull, në fushën politike, tregtare, madje edhe në atë të argëtimit.¹⁴ Liria e shprehjes mbrohet më fort në disa kontekste se të tjerat. Në veçanti, një shkallë e gjerë e tolerancës u jepet fjalimeve politike dhe debatit gjatë fushatave zgjedhore.¹⁵

2. Kufizimet e të drejtës së lirisë së shprehjes

E drejta e lirisë së shprehjes kualifikohet si e drejtë themelore, por jo absolute, që do të thotë që është objekt i përjashtimeve të përcaktuara me ligj, dhe të

¹⁰ Po aty, fq. 11.

¹¹ Po aty, fq. 11

¹² Shih rastin *K. v. Austria*, case no. 47/1992/392/470, 26 Maj 1993.

¹³ Shih rastin *Ahmet Yildirim V. Turkey* (Application no. 3111/10), vendim i 18 dhjetorit 2012, paragrafi 50,

¹⁴ *Liria e Shprehjes: një Udhëzues për implementimin e nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*, Këshilli i Evropës, Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut, Strazburg, 2001, fq. 11.

¹⁵ *Freedom of expression: Guidance – Legal framework*, Equality and Human Rights Commission, March 2015, fq. 4 (po ashtu, shih www.equalityhumanrights.com)

cilat përjashtime duhet të interpretohen në mënyrë tejte të ngushtë dhe se e drejta e individit duhet të balancohet me interesin e shoqërisë. "Të shfrytëzosh lirinë është një gjë shumë e vështirë", citohet të ketë thënë shkrimtari Ismail Kadare¹⁶, dhe natyrisht, shikuar në aspektin juridik, por edhe atë social, del të jetë një e vërtetë e madhe.

Nuk është gjithmonë e lehtë të vendoset kufiri midis shprehjes së pikëpamjeve intolente ose ofenduese (të cilave u sigurohet mbrojtja sipas nenit 10) dhe gjuhës së urrejtjes ose komunikimit tjetër shumë fyes që është aq serioz sa që nuk është aq i mbrojtur. Faktorët që mund të jenë relevantë në bërjen e dallimit do të përfshijnë qëllimin e personit që bën deklaratën, kontekstin në të cilin ata bëjnë, audiencën e synuar, dhe fjalët dhe formën e veçantë të komunikimit. Liria e shprehjes mbrohet më fort në disa kontekste se të tjerat. Në veçanti, një shkallë e gjerë e tolerancës u jepet fjalëve politike dhe debatit gjatë fushatave zgjedhore.¹⁷

Përderisa paragrafi 1 i Nenit 10 të Konventës Evropiane parasheh bazat e kësaj të drejte themelore, paragrafi 2 i po këtij neni parasheh kufizimet që mund të bëhen në raport me këtë të drejtë, duke theksuar me sa vijon:

Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

Ndërsa Kushtetuta kufizimet e kësaj të drejte individuale i parasheh si vijon:

Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe

¹⁶ Kajtazi, M. Besim: "Ndikimi i Shtypit në Kriminalitet", Albanika, Lublanë, 2007, f. 22.

¹⁷ *Freedom of expression: Guidance – Legal framework*, Equality and Human Rights Commission, March 2015, fq. 3 (po ashtu, shih www.equalityhumanrights.com).

provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka vendosur që kufizimi i të drejtës së lirisë së shprehjes, përfaqëson një standard të lartë, të cilin duhet ta kalojë çdo ndërhyrje:

Liria e shprehjes, siç mishërohet në nenin 10, i nënshtrohet një sërë përjashtimesh, të cilat, megjithatë, duhet të interpretohen qartë dhe nevoja për çdo kufizim duhet të përcaktohet në mënyrë bindëse.¹⁸

Çdo kufizim i së drejtës së lirisë të shprehjes duhet të kalojë një test të rreptë të përbërë prej tri pjesësh, ku kërkohet që çdo kufizim duhet (1) të jetë i parashikuar në ligj, (2) të ketë për qëllim mbrojtjen e interesit të ligjshëm (duke përfshirë mbrojtjen e reputacionit të të tjerëve) dhe (3) të jetë i nevojshëm për të siguruar këtë interes.

"I parashikuar me ligj" – ndërhyrja në lirinë e shprehjes nuk mund të jetë e justifikuar, po që se ndërhyrja e tillë nuk është "e parashikuar me ligj". Dhe anasjelltas – në qoftë se ndërhyrja nuk është e parashikuar në ligj, atëherë automatikisht kemi shkelje të nenit 10 të Konventës dhe neneve përkatëse të akteve të tjera.

Shkaqet që mund të jenë bazë e kufizimit të lirisë së shprehjes, i përcakton kushtetuta në mënyrë taksative. Do të thotë, ky kufizim është i mundshëm, vetëm nëse kjo është e domosdoshme për pengimin e nxitjes dhe të provokimit të dhunës dhe të armiqësisë në bazë të urrejtjes racore, nacionale, etnike apo fetare.¹⁹

"Qëllime legjitime" – Qëllimet legjitime si parakusht për të legjitimuar në kufizim të lirisë së shprehjes sipas nenit 10 të Konventës, por edhe bazuar në kushtetutshmërinë krahasuese, janë:

¹⁸ Shih rastin Thorgeir Thorgeirson V. Iceland (Application no. 13778/88), vendimi i datës 25 qershor 1992, shënimi 18, paragrafi 63

(http://www.humanrights.is/static/files/Itarefni/torgeir_torgeirson_gegen_islandi.pdf).

¹⁹ Komentari, fq. 141-142.

- Interesi i sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike;
- Mbrojtja e rendit dhe parandalimi i krimit;
- Mbrojtja e shëndetit ose e moralit;
- Mbrojtja e dinjitetit ose e të drejtave të tjerëve;
- Ndalimi i përhapjes së të dhënave konfidenciale;
- ruajtja e autoritetit dhe e paanësisë së gjyqit.

"E nevojshme në një shoqëri demokratike" – dhe kushti i tretë që duhet të përmbushet për të justifikuar një ndërhyrje në lirinë e shprehjes, është proporcionaliteti në mes të qëllimit legjitim dhe të drejtës individuale. Kjo do të thotë se çdo kufizim në lirinë e shprehjes së një personi duhet të reflektojë një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesave konkurruese individuale dhe të përgjithshme.²⁰ Në rastet kur Gjykata zbulon se të tre kushtet përmbushën, ndërhyrja e shtetit konsiderohet si e ligjshme. Barra për të provuar që të gjitha këto tre kushte janë përmbushur, i takon shtetit.²¹

Në veçanti, që një kufizim të gjykohet i nevojshëm, ai duhet ta kufizojë lirinë e shprehjes sa më pak që të jetë e mundur, duhet të përpilohet me kujdes për të arritur objektivin në fjalë dhe nuk duhet të jetë arbitrar, i padrejtë apo i mbështetur në konsiderata të paarsyeshme. Kufizimet e paqarta apo të përgjithshme, edhe nëse përmbushin kriterin "e parashikuar në ligj", janë të papranueshme, sepse ato e tejkalojnë atë që kërkohet rreptësisht për mbrojtjen e interesave të ligjshme.

Nga arsyet e lartpërmendura, kufizimit i nënshtrohet vetëm liria e shprehjes, por jo edhe liria fetare, e bindjes dhe e ndërgjegjes, e cila në vete përfshin lirinë e mendimit.²² Kjo sepse liria e mendimit është një push para lirive të tjera të garantuara dhe gëzon mbrojtje absolute në sensin e kufizimeve të mundshme. Në anën tjetër, organet shtetërore nuk duhet të përpiqen të indoktrinojnë qytetarët dhe nuk lejohet të bëhen dallime ndërmjet individëve që kanë një mendim dhe atyre që kanë një mendim tjetër. "Ndërhyrja e shtetit" mund të shihet si çdo formë e ndërhyrjes që vjen nga çdo lloj autoriteti që

²⁰ *Liria e Shprehjes: një Udhëzues për implementimin e nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*, Këshilli i Evropës, Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut, Strazburg, 2001, fq. 14.

²¹ Po aty, fq. 24.

²² Komentari, fq. 141.

ushtron pushtet publik dhe detyrime, ose që është në shërbimin publik, si për shembull, gjykata, prokuroria policia, çdo organ zbatues të ligjit, shërbimet sekrete, resore qeveritare etj.

Pavarësisht "përmbushjes" së një apo më shumë kushteve që lejojnë ndërhyrjen, autoriteteve shtetërore nuk iu kërkohet me domosdo të ndërhyjnë në ushtrimin e lirisë së shprehjes, ngase kjo do të qonte në kufizimin e përmbajtjes së kësaj të drejte. Thënë ndryshe, dispozitat kanë paraparë vetëm mundësinë për autoritetet shtetërore, por jo edhe detyrimin për të urdhëruar ose për të vënë në zbatim një masë kufizuese ose dënuese mbi ushtrimin e të drejtës së lirisë së shprehjes. Sidoqoftë, çdo ndërhyrje e ndërmarrë, duhet të jetë proporcionale me "rrezikun" e shkaktuar, ndërsa kjo hapësirë e ndërhyrjes vlerësohet nga rasti në rast, porse nuk mund të jetë e pakufizuar.

Lista e ndërhyrjeve të mundshme (formalitetet, kushtet, kufizimet, sanksionet) në ushtrimin e të drejtës së lirisë së shprehjes është mjaftë e gjerë dhe nuk ka kufizime të paracaktuara.²³ Midis formave të ndryshme të ndërhyrjes, censurimi përpara botimit konsiderohet nga GJEDNJ si më e rrezikshmja pasi ndalon transmetimin e informacionit dhe ideve atyre dëshirojnë ta marrin atë.²⁴

Në parim, pra, individët kanë të drejtë të thonë çfarëdo, me kusht që ajo që e shprehin të mos e ndaluar me ligj dhe me kusht që deklarata e tillë të mos përbëjë shpifje a fyerje për tjetrin apo të mos përbëjë vepër penale. Sidoqoftë, në jetën reale shpesh ndodhin kufizime të lirisë së shprehjes, dhe kjo ndodh nga konteksti i ngjarjes konkrete. Kufizime të tilla janë, për shembull: kufizimet në vendin e punës; kufizimet në mjediset shkollore etj. Liria e shprehjes nuk i "amnistion" të punësuarit nga përgjegjësia disiplinore në rastet kur mund të ketë shkelje të rregullave. Pra, këto kufizime rrjedhin nga vet natyra e situatës ku gjendet një person, pa pasur nevojë për ndërhyrje të organeve shtetërore aty-për-aty, porse nuk konsiderohen si kufizime të lirisë së shprehjes, në përputhje me nenin 10 të Konventës.

²³ Udhëzues për nenin 10, fq. 20.

²⁴ Po aty, fq. 20.

3. Diskurset që nuk gëzojnë mbrojtje

Edhe pse liria e shprehjes konsiderohet një e drejtë fundamentale, që mbron çdo "shprehje", prapë se prapë nuk është e atillë absolute²⁵, siç është, për shembull, e drejta në jetë, që garantohet në tërësinë e saj, pa ekuivoqe. Kësisoj, pavarësisht garantimit të saj me akte ndërkombëtare, kushtetutë të shtetit dhe/apo akte të tjera juridike, e drejta e lirisë së shprehjes mund të mos gëzojë mbrojtje në momente të caktuara. Kjo madje edhe pavarësisht faktit që neni 10 i Konventës, si fushë të mbrojtjes mbulon edhe ato informacione ose ide të cilat mund të tronditin apo ofendojnë disa njerëz.²⁶ Së këndejmi,

Gjuha e urrejtjes – liria e shprehjes nuk mund të përdoret për të justifikuar gjuhën e urrejtjes. Diskurset, të cilat mund të jenë ofenduese duhet të dallohen nga gjuha e urrejtjes. Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës e ka përshkruar "gjuhën e urrejtjes" si "forma të shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose forma të tjera të urrejtjes në bazë të intolerancës."²⁷ Një qëndrim luftues i gjuhës së urrejtjes ka dalë edhe nga vendimi i GJEDNJ, në rastin *Erbakan kundër Turqisë*, ky Gjykata ka vërejtur se:

*Toleranca dhe respekti për dinjitetin e barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike pluraliste. Duke qenë kështu, parimisht, mund të konsiderohet e nevojshme në disa shoqëri demokratike për të dënuar apo parandaluar të gjitha format e shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen në bazë të intolerancës.*²⁸

²⁵ Përtjashto këtu ato vende që ende nga sistemim i tyre juridik nuk e kanë hequr dënimin me vdekje.

²⁶ Shih rastin *Handyside k Mbretërisë së Bashkuar*, Ap.Nr. 5493/72, vendim i 7 dhjetorit 1976, paragrafi 49.

²⁷ Shih Rekomandimin Nr. R(97)20 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në lidhje me "gjuhën e urrejtjes", i datës 30 tetor 1997, i qasshëm në uebfaqen:

<https://rm.coe.int/1680505d5b>.

²⁸ Shih rastin *Erbakan v. Turkey*, Application Nr. 59405/00, 6 korrik 2006, paragrafi 56, <https://hudoc.echr.coe.int/app/conversion/pdf/?library=ECHR&id=003-1728198-1812055&filename=003-1728198-1812055.pdf>

Për shkak të natyrës së saj, gjuha e urrejtjes bie tërësisht jashtë fushës së mbrojtjes nga neni 10 i konventës, dhe rrjedhimisht një çështje e ngritur me pretendimin e shkeljes së lirisë së shprehjes, kualifikohet si e papranueshme *ratione materiae*.

4. Shpifja dhe fyerja - legjislacioni dhe praktika gjyqësore

Me qëllim respektimi të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut si dhe të lirisë së shprehjes dhe për parandalimin e gjuhës së shpifjes dhe fyerjes, Kuvendi i Kosovës, me datë 15.06.2006, ka miratuar Ligjin Nr. 02/L-065, Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes²⁹ (tash e tutje referuar si LCKShF).

Ndërkohë që risia më e madhe që kishte sjellë miratimi i këtij ligji, ishte dekriminalizimi i veprës penale të shpifjes dhe fyerjes - deri në miratimin e këtij ligji, shpifja dhe fyerja konsideroheshin vepra penale, ndërkohë që, nën këtë frymë, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, me Qëndrimin Parimor të datës 20.02.2012³⁰, konfirmoi dekriminalizimin e këtyre veprave penale. Dekriminalizimi i veprave penale të shpifjes dhe fyerje u pasua edhe me hyrje në fuqi të Kodit Nr. 04/L-82 Kodi Penal i Republikës së Kosovës³¹, e me të cilin u shfuqizua Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (UNMIK REG 2003/05), që shpifjen³² dhe fyerjen³³ i parashihte si vepra penale kundër nderit dhe autoritetit.

Qëllimi i LCKShF është të rregullojë përgjegjësinë civile për shpifje dhe fyerje, duke siguruar të drejtën e lirisë së shprehjes, duke u siguruar që rregullat që kanë të bëjnë me shpifjen dhe fyerjen, të mos vënë kufij të paarsyeshëm mbi lirinë e shprehjes duke përfshirë edhe publikimin dhe diskutimin e çështjeve me interes të rëndësishëm për publikun; kompensime efektive dhe të përshtatshme për personat të cilëve u është dëmtuar reputacioni nga shpifja dhe fyerja; që mjetet e informimit publik të kenë rol të rëndësishëm

²⁹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Viti III, Nr. 24, 01.05.2008.

³⁰ Qëndrimi parimor I Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Agj.Nr.K.94/2012, dates 20.02.2012.

³¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 19, 12.07.2012.

³² Neni 187.

³³ Neni 188.

në procesin demokratik si vëzhgues publik dhe transmetues i informatave të publiku.³⁴

Me dispozitat e këtij ligji, është definuar nocioni i shpifjes, duke përcaktuar se *shpifja* nënkupton publikimin e një fakti ose deklarate të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër, ndërsa *fyerja* nënkupton deklarimin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese.³⁵ Pra, që të kemi "shpifje", duhet të plotësohen elementet si: a) publikimi i një fakti ose deklarate; b) që fakti ose deklarata të jenë të pavërtetë; c) që publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti ose deklarata është e pavërtetë; d) kuptimi i këtij fakti ose kësaj deklarate, ta dëmtojë reputacionin e personit tjetër. Ndërsa, që të kemi "fyerje", duhet të plotësohen elementet si në vijim: a) publikim, sjellje ose deklaratë; b) që drejtohet ndaj një personi tjetër; c) që të jetë nënçmuese.

Por cka është "reputacioni"? Koncepti i "reputacionit" nuk është i qartë nuk ekziston definicion universal për atë se çka është reputacion, kurse kjo mund të jetë edhe rrezik për shkak të faktit se ai mund të shfrytëzohet si bazë për kufizim të të drejtave të njeriut. Derisa flasim për reputacioni, një pyetje që shtrohet është se a ekziston edhe "reputacioni negativ" dhe, po që se ekziston, a gëzon mbrojtje edhe ky lloj reputacioni? "Reputacioni" përkufizohet si mendimi që njerëzit në përgjithësi kanë për dikë ose diçka, ose sa respekt ose admirim merr dikush ose diçka, bazuar në sjelljen ose karakterin e kaluar.³⁶ Ligji jonë kundër shpifjes dhe fyerjes, që nga miratimi i tij, nuk ka pësuar asnjëherë ndonjë ndryshim apo amendim, dhe ndoshta në të ardhmen, do të shqyrtohet mundësia që fjala "reputacion" të zëvendësohet me fjalën "dinjitet". "Dinjiteti" përkufizohet si tërësia e vlerave morale të njeriut a të një grupi njerëzish (nderi, krenaria etj.); vetëdija që ka njeriu a një grup njerëzish për këto vlera e për të drejtat e veta në shoqëri dhe nderimi i tij për vetveten.³⁷ Deri më tani, nuk dihet për ndonjë rast ku është kërkuar mbrojtje gjyqësore për shkak të cenimit të "reputacionit negative", por edhe po të kishte, një padi e tillë nuk do të duhej të gëzonte mbrojtje ngase do të krijonte dëme tepër të

³⁴ Neni 1 i Ligjit Nr. 02/L-065.

³⁵ Neni 3 I Ligjit Nr. 02/L-065.

³⁶ <https://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/reputation>

³⁷ <http://www.fjalori.shkenca.org/>

mëdha dhe, mbi të gjitha, keqpërdorim të dispozitave ligjore për shpifje dhe fyerje.

Në cilëndo rrethanë, fakti ose deklarata duhet të jenë të pavërtetë. Me fjalë të tjera, publikimi i një të vërtete, sado i dëmshëm që të jetë ai publikim, nuk mund të konsiderohet shpifje e as të akordohet kompensim dëmi në lidhje me të.

Ky ligj njih të drejtën e kompensimit për personat që e gjejnë veten si subjekt të një shpifjeje dhe/apo fyerje. Personi i tillë ka të dejtë që përmes rrugëve gjyqësore të ndalë shpifjen dhe fyerjen dhe premtimin se shpifja nuk do të përsëritet në të ardhmen, tërheqjen e informacionit shpifës apo fyes ndaj personalitetit të tij/saj dhe kompensimin për dëmin moral dhe material të shkaktuar nga shpifja dhe fyerja.

Megjithatë, ligji në fjalë njih edhe përjashtime në rastin kur kemi të bëjmë me interesin publik, me publikimet e arsyeshme, me opinionet dhe në raste subjekti për deklaratat e dhëna gëzon imunitet. Në aspektin subjektiv, autoriteteve publike u është ndaluar paraqitja e një kërkesë për kompensimin e dëmit nga shpifja dhe fyerja, ndërsa sa i përket zyrtarëve publikë, të njëjtit mund të paraqesin kërkesë për kompensim e dëmit nga shpifja apo fyerja privatisht dhe ekskluzivisht në kapacitetin e tyre personal.³⁸

Procedura gjyqësore në një kontest sipas një padie për kompensim të dëmit të shkaktuar nga një shpifje dhe/ose fyerje, është procedurë tipike kontestimore. Megjithatë, sa i përket barrës së provës, LCKShF parasheh se barra e provës i takon palës së paditur. Pra, i duhet palës së paditur që të provojë me fakte para gjykatës se deklarata e tij nuk përbënte shpifje dhe/ose fyerje.

Sa i përket lartësisë së kompensimin, kompensimi do të jetë proporcional me dëmin e shkaktuar dhe do të caktohet vetëm me qëllim të korigjimit të dëmit të shkaktuar ndaj reputacionit të personit në fjalë, ose për të kompensuar çfarëdo humbje të provueshme aktuale financiare apo dëmi material. Kompensimi për humbjet reale financiare, ose dëme materiale, të shkaktuara

³⁸ Neni 5 I LCKShF.

nga një shpifje do të caktohet nga gjykata vetëm kur humbja është konstatuar në mënyrë të veçantë.³⁹

Pra, në çdo rast, qëllimi i akordimit të një kompensimi të dëmit për shkak të një shpifjeje dhe/ose fyerje, nuk është pasurimi i subjektit paditës, siç ndodh në të shumtën e rasteve, por korrigjimi i dëmit të shkaktuar në reputacionin e personit të tillë.

Janë jo të pakta rastet kur, derisa lexojmë një artikull, konsiderojmë se përmbajta e këtij artikulli përmban shpifje dhe/ose fyerje. Por, janë të pakta rastet kur këto çështje përfundojnë në gjyq me ngritjen e një padie nga personi ndaj të cilit është shpifur ose është fyer. Ndërsa, edhe më të pakta se këto në numër, janë vendimet meritore me të cilat gjykatat kompetente kanë vendosur lidhur me këto padi. Dhe kjo nuk është për faktin se "bëhet fjalë për një lëmi të re", ngase liria e shprehjes, megjithë kufizimet e saja, ka ekzistuar shumë kohë para nxjerrjes së LCKSHF, kodeve përkatëse penale vendore apo edhe Kushtetutës së Republikës. Kjo, në fakt, mund t'i atribuohet edukimit të nivelit jo të kënaqshëm që ekziston për të drejtat e njeriut.

Megjithatë, një pjesë të "fajit" mund ta ketë vet procedura gjyqësore, pothuajse në secilën gjykatë të vendit, që zgjat me vite të tëra. Kjo stërzgjatje, në fund të fundit, mund ta humb paksa edhe efektin që do të kishte ofrimi i mbrojtjes juridike në një kohë të arsyeshme për palët që e gjejnë veten subjekt të një shpifjeje dhe/ose fyerje.

Përfundim

Nga e gjithë kjo materie del se e drejta e lirisë së shprehjes është ndër të drejtat themelore më të rëndësishme të njeriut, ndaj është postulat i vendeve demokratike që e njëjta të respektohet në gamë sa më të gjerë dhe me sa më pak kufizime apo ndërhyrje. E drejta e lirisë së shprehjes vazhdon të jetë burim diskutimi publik, ndërkohë që shpifja dhe fyerja, veçmas interpretimi dhe

³⁹ Neni 14 I LCKSHF.

zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë këtë fushë, vazhdojnë të jenë burim i diskutimit juridik.

Në kuptimin sa më të saktë të saj dhe rrjedhimisht edhe në zbatimin praktik të së njëjtës, vendimet e GJEDNJ duhet të shërbejnë si pikënisje në kuptimin e të drejtave individuale.

Marrë parasysh faktin që kjo e drejtë, por edhe shumica e të drejtave të tjera individuale ju përkasin "të gjithëve", vetëdijesimi më i madh shoqëror do të luante rol tejet të madh. Ndërkohë që publikimet profesionale dhe programet e trajnimeve të ndryshme për profesionistë ligjor, duhet të mbulojnë më shumë edhe sferën e të drejtës së lirisë së shprehjes dhe kufizimeve të saja, në mënyrë që të implementojnë në nivel më të madh dispozitat ligjore të kësaj fushe.

Brenda gazetarisë ka një mungesë të madhe të njohurive se çka janë të drejtat e njeriut. Andaj, deri më tani, del se tejkalimi i të drejtës së lirisë së shprehjes, ashtu që e njëjta të konsiderohet si shpifje dhe/ose fyerje, bëhet më së shpeshti nga gazetarët, përfshirë këtu edhe mediat elektronike. Rrjedhimisht, del se gazetat dhe gazetarët do të jenë palë të paditur

Në rastet gjyqësore që janë proceduar në gjykatat tona, dominojnë rastet kur palë paditëse janë personat publik, e në ta, figurat politike, padi këto të ushtruara ndaj personave të po të njëjtit nivel, apo edhe ndaj gazetave e portaleve informative. Praktika gjyqësore, veçmas ajo e ndërtuar nga GJEDNJ⁴⁰, sugjeron se kritika e lejuar në lidhje me figurat politike është më e gjerë në krahasim me personat privat. Së këndejmi, figurat politike duhet të jenë më të hapur për kritike më të madhe nga ana e gazetarëve dhe e opinionit.

⁴⁰ Rasti Lombardo v. Malta, 2007, Gjykata konstatoi se „...demokracia e shëndoshë kërkon që Qeveria të jetë e eksponuar në mbikëqyrje të vazhdueshme jo vetëm nga pushteti ligjdhënës dhe gjyqësor, por edhe nga opinionimi më i gjerë dhe nga mediet”.

Bibliografia

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e miratuar më 15.06.2008 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;
- Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, nënshkruar më 04.11.1950 në Romë, nga Këshilli i Evropës
- (https://www.echr.coe.int/documents/convention_eng.pdf);
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e Kombeve të Bashkuara, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 10.12.1948
- (<https://www.un.org/en/universal-declaration-human-rights/>);
- Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Botimi I, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit, Prishtinë, 2013;
- Rekomandimin Nr. R(97)20 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në lidhje me "gjuhën e urrejtjes", i datës 30 tetor 1997;
- Qëndrimi parimor i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Agj.Nr.K.94/2012, I dates 20.02.2012;
- Kuvendi i Kosovës, me datë 15.06.2006, ka miratuar Ligjin Nr. 02/L-065, Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, Viti III, Nr. 24, 01.05.2008;
- Kodit Nr. 04/L-82 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 19, 12.07.2012;
- Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (UNMIK REG 2003/05);
- *Freedom of expression: Guidance – Legal framework*, Equality and Human Rights Commission, March 2015
- *Liria e Shprehjes: një Udhëzues për implementimin e nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*, Këshilli i Evropës, Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut, Strazburg, 2001;
- *Liria e Shprehjes dhe marrëdhënia e saj me të Drejtën për Respektimin e Jetës Private dhe të Drejtën për një Proces të Rregullt: Guidë mbi jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*, AIRE Centre, UK, 2017;
- Kajtazi, M. Besim: "Ndikimi i Shtypit në Kriminalitet", Albanika, Lublan, 2007.
- *Ahmet Yildirim V. Turkey* (Application no. 3111/10), vendim i 18 dhjetorit 2012
- *Thorgeir Thorgeirson V. Iceland* (Application no. 13778/88), vendimi I dates 25 qershor 1992
- *Handyside k Mbretërisë së Bashkuar*, Ap. Nr. 5493/72, vendim i 7 dhjetorit 1976
- *Erbakan v. Turkey*, Application Nr. 59405/00, 6 korrik 2006;
- *K. v. Austria*, case no. 47/1992/392/470, 26 Maj 1993;
- *Lombardo v. Malta*, case No. (no. 7333/06), 2007.

Hysni Ismaili¹

Fitimi i pronës së paluajtshme në Kosovë, nga qytetarët e shteteve anëtare të Bashkimit European

Abstrakt

Përmes këtij punimi synohet që të paraqitet korniza ligjore e Kosovës për mënyrën e fitimit të pronësisë së paluajtshme nga peronat fizik e juridik, në bazë të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit midis Kosovës dhe BE-se, e cila duhet të përafrohet, me *acquis* te BE-së, në mënyrë që të mundësohet trajtimi i barabarte për qytetarët e Unionit European. Në këtë punim do të paraqiten edhe disa raste të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.

Fjalët kyçe: Bashkimi European, Traktati i Bashkimit European, Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, Konventës Europiane për të Drejtat e Liritë Fundamentale, Fitimi i pronës së paluajtshme, përafrimi përkatësisht harmonizimi i legjislacionit.

Hyrje

Qëllimi i këtij punimi është që të trajtoj çështjet e fitimit të pronës së paluajtshme në Kosovë nga qytetarët e Bashkimit European (BE), në kontekst të përafrimit të legjislacionit të Kosovës sipas kërkesave që dalin nga ato të integritimit në Unionin European dhe në kontekst të Protokollit 1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Liritë Fundamentale, në kuadër të Këshillit të Europës.

Synim kryesor i Kosovës është anëtarësimi në Unionin European, në këtë drejtim janë bërë hapa të rëndësishëm, pasi që Kosova ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim – Asociimit (MSA), me Bashkimi European, e cila ka hyrë në fuqi nga prilli 2016, kjo Marrëveshje ka ndikuar esencialisht që të intensifikohet procesi i përafrimit të legjislacionit. MSA siç dihet është marrëveshja e parë kontraktuale mes Kosovës dhe BE-së dhe si e tille, MSA,

¹ Autori është Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë

paraqet një fazë të re të marrëdhënieve politike ndërmjet Kosovës dhe BE-së². Si marrëveshje ndërkombëtare, ajo përcakton mekanizmat dhe afatet zyrtare për zbatimin e të gjitha reformave që do ta përafrojnë Kosovën në mënyrë progresive me BE-në në të gjitha fushat e politikave, deri në përmbushjen e të gjitha standardeve të BE-së. Për më tepër, MSA vendosë kornizën e marrëdhënieve të Kosovës me shtetet anëtare dhe institucionet e BE-së për jetësimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit (PSA) deri në anëtarësimin e plotë në BE. Sa i përket fushëveprimit, përveç çështjeve politike e detyrimeve juridike (përfshirë ato që prekin rendin e brendshëm juridik), MSA mbulon të gjitha sferat e qeverisjes.

1. Legjislacioni primar i Bashkimit Evropian në çështjet e pronës së paluajtshme

Unioni European akoma nuk i ka të rregulluar në mënyrë të unifikuar çështjet pronësore, kjo çështje adresohet me nenin 345 të Traktatit Mbi Funkcionimin e Unionit European³ (ish neni 295 i Traktatit të Bashkimit Evropian) i cili përcakton që *“Traktati në asnjë mënyrë nuk do t’i paragjykoj apo cenoj rregullat e Shteteve Anëtare që e përcaktojnë sistemin e të drejtës së pronësisë”*, në shikim të parë kjo dispozitë lenë të kuptohet që Unioni European nuk ka kompetencë në fushën e pronës.

Hulumtimet kanë treguar që kjo dispozitë e bënë të qartë që vendimet për nacionalizimin apo privatizimin e ndërmarrjeve janë një çështje sipas të cilës vetëm Shtetet Anëtare kanë kompetencë. Neni 345 deklaron një kompetencë negative për Bashkimin European, e kufizuar në aspektin specifik (ndërmarrjet në pronësi private apo publike) të ekonomisë së Shteteve Anëtare.

Të gjitha sferat tjera të pronësisë, sigurojnë që kompetenca pozitive ekziston, pra nuk janë të përjashtuar prej ligj bërjes së BE-së. Në këtë kontekst nëse shikojmë Direktivën nr. 94/47⁴, për përdorimin për një kohë të caktuar të pronësisë çështja e nenit 345 i Traktatit të BE-së vjen në shprehje në mënyrë

² Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, 2016.

³ Traktati Mbi Funkcionimin e Bashkimit European, dt. 30.03.2010, OJ 2010 C83/01.

⁴ Direktiva 94/47/EC e dt. 26.10.1994 për mbrojtjen e blerësve sa i përket aspekteve të sigurta të kontratave që kanë të bëjnë me blerjen e të drejtës për të përdorur pronësinë e paluajtshme në mënyrë të afatizuar, OJ 1994 L 280/83-87.

eksplicite pasiqë në çështjet pronësore kjo Direktivë e lë në kompetencë të Shteteve Anëtare, Megjithatë, në asnjë mënyrë, e drejta pronësore nuk përjashtohet nga e drejta primare Europiane, veçanarisht në aspektin e respektimit të lirive e të drejtave të njeriut apo duke pasur parasysh parimin e mos-diskriminimit. Kjo ka pasoja të rëndësishme, duke pasur parasysh faktin që kufizimet në fitimin e pronës së paluajtshme nga të huajt shpeshherë paraqesin shkelje të lirisë së konstituimit të pronës dhe lirisë së lëvizjes së kapitalit. Gjykata Europiane e Drejtësisë (GjED) është marr tanimë me situata të tilla, në një numër të rasteve⁵.

1.2 Legjislacioni sekondar i BE-së

Sa i përket legjislacionit sekondar BE-ja nuk i ka të rregulluar me anë të akteve të veçanta vetëm për pronën, megjithatë, disa Direktiva Europiane kanë ndikim indirekt në çështjet e paluajtshmërive.

Direktiva Nr. 93/13 mbi kushtet e padrejta në kontratat e konsumatorit⁶ në përmbajtjen e saj në disa raste nuk i përjashton kontratat që lidhen për tokën nga fushëveprimi i saj i zbatimit.

Megjithatë, kjo Direktivë zbatohet për *"kushtet kontraktuese të cilat nuk janë individualisht të negociueshme"*, Direktiva për Kushtet e Padrejta ka potencialin e ndikimit në shitjen e paluajtshmërive.

Disa Direktiva qartë nuk zbatohen për shitjen e paluajtshmërive, siç është rasti me Direktivën nr. 85/577, për mbrojtjen e konsumatorit sa i përket kontratave të negociuara larg prej vendit të ushtrimit të biznesit⁷, e cila sipas nenit 1 (1) zbatohet *"për kontratat sipas të cilave një tregtar furnizon me mallra apo shërbime"*, ndërsa neni 3 (2) përcakton në mënyrë eksplicite që direktiva nuk do të zbatohet tek *"kontratat për ndërtim, shitja dhe qira marrja e pronës së paluajtshme ose kontratave që ndërlidhen me të drejtat në pronën e paluajtshme"*.

⁵ ECJ 22.8.1997 – case C-302/97 (Konle ./, Republik Österreich), Rep. 1999 I-3099; 13.7.2000 – case C-423/98 (Albore), Rep. 2000 I-5965; 5.3.2002.

⁶ Direktiva e Këshillit 93/13/EEC e 05.04.1993 mbi kushtet e padrejta në kontratat e konsumatorit, OJ 1993 L 95/29-34.

⁷ Direktiva e Këshillit 85/577/EEC e 20.12.1985 për mbrojtjen e konsumatorëve në aspekt të të kontratave të negociuara larg prej vendit të ushtrimit të biznesit, OJ 1985 L 372/31-33.

1.3 Legjislacioni vendor në çështjet e fitimit të pronës së paluajtshme

Ligji aktual mbi pronësinë dhe të drejtat e përafërta⁸ konsiderohet që përmban dispozita të cilat paraqesin një spastrim të tekstit të krahasuar me ligjin e mëparshëm⁹ (jugosllav) i cili siç dihet ka qenë i bazuar në ideologjinë e sistemit socialist, ky Ligj është në proces të Plotësim/ndryshimit. Ligji aktual ka një qasje me të detajuar ndaj instituteve kryesore të pronës, i cili përveç kësaj rregullon edhe disa institute të reja e poashtu përcakton zgjidhje të reja në kuadër të instituteve ekzistuese. Nga përmbajtja e këtij ligji mund të konkludohet që ky ligj për secilin institut përcakton rregulla mjaft të detajuara, megjithatë dispozitat e këtij ligji nuk përmban rregulla sa i përket fitimit të pronësisë së paluajtshmërive nga shtetasit e shteteve anëtare të BE-së. Poashtu kjo çështje nuk është e përcaktuar as në Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve¹⁰

Andaj, sa i përket fitimit të pronësisë së paluajtshmërive nga shtetasit e shteteve anëtare të BE-së, kjo çështje aktualisht është e pa rregulluar dhe si e tillë duhet të bëhet përafrimi i kësaj pjese të legjislacionit, duke u hartuar dispozita të veçanta ligjore.

2. Kufizimet ndaj të huajve për t'u bërë pronarë të tokës dhe të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Kosovë

Përderisa një numër i vogël i vendeve Europiane akoma praktikojnë kufizime mbi fitimin e pronësisë së tokës nga shtetasit e vendeve të treta, por sa i përket shtetasve të BE-së, kufizimet janë hequr kudo, përveç Hungarisë dhe Polonisë, ku këto vende vazhdojnë me këtë regjim vetëm për tokë bujqësore dhe shtëpi apo vendbanim të dytë për një periudhë të caktuar tranzitore.

Ka pasiguri nëse dhe në çfarë mase të huajt mund të posedojnë pronë të paluajtshme në Kosovë. Dispozitat relevante në Kushtetutë kanë dykuptimësi dhe lejojnë interpretime të ndryshme që shpjen në aplikim jo të qëndrueshëm të ligjit në praktikë.

⁸ Ligji Nr. 03/L-154, për Pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 57, i datës 04.08.2009.

⁹ Ligji mbi marrëdhëniet themelore juridike-pronësore, aprovuar nga Kuvendi i RSFJ, në seancën e Dhomës Federative datë 30.01.1980 (LMTHJP).

¹⁰ Ligji nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 16, i datës 13.07.2012.

Neni 121.2 i Kushtetutës përcakton se personat fizikë të huaj dhe organizatat e huaja mund të fitojnë të drejta të pronësisë mbi pronën e paluajtshme në pajtim me kushtet e arsyeshme të përcaktuara me ligj ose me marrëveshje ndërkombëtare. Një interpretim pretendon se, sipas kësaj dispozite, personat e huaj mund të fitojnë të drejtën e pronësisë mbi pronën e paluajtshme, vetëm nëse kjo është paraparë si mundësi me ligj apo me marrëveshje ndërkombëtare. Në mungesë të ligjit apo marrëveshjes ndërkombëtare, të huajt nuk do të duhej të lejoheshin të fitojnë të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme.

Mirëpo, mund të argumentohet se kjo dispozitë në të vërtetë afirmon të drejtat pronësore të të huajve për atë sa kushtet për të drejtën e pronësisë të jenë në pajtim me Kushtetutën dhe autoritetin kushtetues. Neni 119.2 e mbështet këtë argument duke theksuar se të gjithë investitorët e huaj dhe ndërmarrjet duhet të kenë të gjitha të drejtat ligjore të barabarta sikurse i kanë investitorët dhe ndërmarrjet vendore për të pasur pronë të paluajtshme.

Ky argument mbështetet edhe më shumë nga dispozitat e Ligjit nr. 05/L-079 për investime strategjike në Republikën e Kosovës¹¹. Ky ligj kërkon që shtetasit e huaj dhe ndërmarrjet të trajtohen në mënyrë të barabartë. Duket se kjo kërkesë përfshinë edhe të drejtën e fitimit të pronës.

Megjithatë, shtetasit e huaj gjatë përpjekjeve të tyre për t'i regjistruar të drejtat pronësore në kadastrë, në praktikë kanë hasur në rezistencë të zyrave komunale kadastrale (ZKK). Pengimi i regjistrimit të drejtave pronësore të shtetasve të huaj, janë krijuar për shkak se legjislacioni¹², përkatësisht Ligji për Themelimin e Regjistrave për drejtën Pronës së Paluajtshme (*i plotësuar me Ligjin nr. 2003/13 për ndryshim plotësimin e Ligjit 2002/5 Themelimin e Regjistrave për drejtën Pronës së Paluajtshme*), Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2003/25 për Kadastrin¹³, nuk është definuar qartë regjistrimi i të drejtave pronësore të shtetaseve të huaj, se kush ka të drejtë t'i

¹¹ Ligji nr. 05/L-079 për investime strategjike në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare nr. 6/2017.

¹² Ligji nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrave për drejtën Pronës së Paluajtshme, i plotësuar me Ligjin nr. 2003/13 për ndryshim plotësimin e Ligjit 2002/5 Themelimin e Regjistrave për drejtën Pronës së Paluajtshme, të botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 34, të datës 01.08.2008. Ligji nr. 04/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, Gazeta Zyrtare nr. 7, e dt. 10.08.2011.

¹³ Ligji nr. 02/L-96 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2003/25 për Kadastrin, Gazeta Zyrtare nr. 37, e dt. 10.09.2008

regjistrojë këto të drejta, dhe se cili është dokumentacioni i nevojshëm apo kushtet tjera për regjistrim. Në mungesë të udhëzimeve të qarta, legjislacioni interpretohet në mënyrë të ndryshme dhe jo konsistente.

Është vërejtur gjithashtu se praktikrat e tilla nuk janë në pajtim me Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociim, e nënshkruar në mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Neni 65.3 i kësaj marrëveshje¹⁴ kërkon që Kosova t'u ofrojë shtetasve të BE-së tretman si vendasve në sigurimin e të drejtave pronësore mbi pronën e paluajtshme në territorin e vet, në një periudhë brenda pesë viteve nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje. Neni 51.4 i marrëveshjes ngjashëm thekson se degët dhe përfaqësitë e kompanive të BE-së, prej hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje do të kenë të drejtat të njëjta të fitimit të pronës mbi pronat e paluajtshme, njësojë sikurse të drejtat që kanë kompanitë e Kosovës, edhe sa i përket të mirave publike/interesit publik të njëjtat të drejta që i gëzojnë kompanitë kosovare. Këto të drejta janë kyçe për aktivitetet dhe zhvillimin ekonomik.

Për më shumë në këtë marrëveshje përcaktohet se *“Pa cenuar paragrafin 1, Palët nuk do të paraqesin kufizime të reja në lëvizjen e kapitalit dhe pagesave rrjedhëse ndërmjet rezidentëve të BE-së dhe Kosovës dhe nuk do t'i bëjnë marrëveshjet ekzistuese më tepër kufizuese”*.

Në këtë proces e kanë kaluar edhe shtetet tjera të rajonit, të cilat e kanë rregulluar në mënyra të ndryshme, varësisht prej rrethanave, specifikave dhe interesave nacionale që i kanë pasur, kjo përfshinë sidomos vendet që kanë hapësira bregdetare apo resurse tjera të rëndësishme natyrore, andaj Kosova është prej vendeve të fundit të Ballkanit Perëndimor që e ka përfshirë këtë çështje në kuadër të dispozitave të MSA-së e që do të rezultoj edhe me ndryshimet ligjore, të cilat janë në proces, e sidomos duhet të theksohet hartimi i Kodit Civil të Republikës së Kosovës në të cilin është duke u punuar aktualisht. Konsideroj që kjo çështje të rregullohet shprehimisht në kuadër të këtij dokumenti përmbledhës.

¹⁴ Shih Neni 65.3 i MSA.

2.1 E drejta e pronës në kontekst të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore

Sipas dispozitave të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, respektivisht në nenin 22 (2) institucionet e Kosovës¹⁵ janë të obliguara që të sigurojnë që të gjitha aktet legjislative duhet të jenë në pajtim me të drejtat e përcaktuara në Konventën për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Fundamentale¹⁶. E drejta që lidhet me pronën është ndër sferat e të drejtës më së shumti e ndikuar nga diskursi i të drejtave të njeriut. Kjo është pjesërisht pasiqë, në përgjithësi Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNj) ka kompetenca të kufizuara krahasuar me gjykatat vendore dhe poashtu pasiqë nuk mundet që plotësisht të vlerësoj çështjet e brendshme.

Formulimi i miratuar në kuadër të Protokollit të Parë siguron një të drejtë të kualifikuar, i cili garanton të drejtën e pronës, instrumentet tjera ndërkombëtare të drejtave të njeriut, të tilla si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, gjithashtu njohin të drejtën e pronës.

Neni 1 i Protokollit nr. 1 mbron individët apo personat juridik prej ndërhyrjes arbitrare nga Shteti në posedimin e tyre. Megjithatë, këto dispozita njohin të drejtën e shtetit që të kontrollojnë përdorimin apo madje të privimin nga prona ndaj individëve apo personave juridik sipas kushteve të përcaktuara në këto dispozita. Në veçanti, autoritetet publike mund të kontrollojnë përdorimin e pronës për të siguruar pagesën e taksave, kontributeve apo gjobave, me këtë rast ndërhyrja duhet të jetë e zhvilluar në atë mënyrë që nuk është arbitrare dhe të jetë në pajtim me ligjin.

Kështuqë, rregullat gjyqësore që kërkojnë një individ të dorëzoj pronën tek një tjetër individ, për shembull sipas të drejtës së aplikueshme të përgjithshme, siç janë dispozitat e ligjit të detyrimeve, rregullat e kompenzimit të dëmit, e drejta familjare (ndarja e pronës në bazë të trashëgimisë), përgjithësisht janë jashtë fushëveprimit të nenit 1 të Protokollit 1. Megjithatë, në përcaktimin e efekteve të marrëdhënieve juridike midis individëve mbi pronën, organet e Konventës marrin në konsideratë (kontrollojnë) nëse një ligj i caktuar nuk ka

¹⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22 (2), Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2008.

¹⁶ Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale, e dt. 04.11.1950, Romë, e miratuar nga Këshilli i Evropës, Strasburg; poashtu Protokollin nr. 1 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale, Paris, 20.03. 1952.

krijuar një pabarazi të tillë që një person të mund të jetë arbitrarisht apo padrejtësisht i privuar nga prona në favor të një tjetri.

Qytetarët e Republikës së Kosovës në kuptim të mbrojtjes së përcaktuar nga dispozitat e kësaj Konvente ende nuk e kanë këtë të drejtë në krahasim me vendet e tjera Europiane që t'iu drejtohen organeve të kësaj Konvente pasiqë siç dihet kjo është e kufizuar për arsye se Kosova nuk është anëtare e plotë e kësaj Konvente, pasiqë ende nuk e ka ratifikuar këtë Konventë, me çka poashtu do të duhej të zotohej për një respektim dhe mbrojtje më të madhe, qenia anëtare e të cilit do të ishte shumë e rëndësishme, pasiqë ndaj qytetarëve krahas autoriteteve shtetërore do të ofroheshin së paku disa standarde minimale të garantuara më normat e kësaj Konvente. Por marrë në përgjithësi për gjendjen në të cilin jemi si shoqëri dhe si shtet edhe po të bëheshin anëtarë i plotë, ne nuk do të mund t'i përmbushnim të drejtat dhe detyrimet që dalin për zbatimin e kësaj Konvente, ndonëse, institucionet e Kosovës njëanshmërisht kanë hartuar dhe reformuar kornizën ligjore dhe institucionale në funksion të mbrojtjes së pronës.

Përfundim

Duke pasur parasysh obligimet që dalin nga agjenda europiane, duhet të hartohen ligjet e reja ndërsa ato ekzistuese duhet të avancohen konform kriterëve e koncepteve bashkëkohore dhe praktikave më të mira të vendeve anëtare të Unionit Europian. Kriteri kyç dhe primar i aderimit në Unionin Europian është pa dyshim fuqizimi i sundimit të ligjit, përkatësisht shtetit të së drejtës, në këtë aspekt është duke u ndihmuar Kosova shumë sidomos nga asistenca që jepet në vazhdimësi në kuadër të Instrumentit të Para Anëtarësimit II (që njihet shkurt IPA) që ofrohet nga mjetet e Unionit Europian.

Rregullativa ligjore duhet të përafrohet apo harmonizohet konform Tabelës së Pajtueshmërisë, e cila është një dokument pune krahasues i BE-së që pasqyron shkallën e pajtueshmërisë së një drafti ligjor të brendshëm me një akt të *Acquis* së BE-së, veçanarisht është e pashmangshme, sidomos pas hyrjes në fuqi të MSA-së, dhe ndërlidhet kryesisht me Kapitullin 23 që ka të bëjë me gjyqësorin dhe Kapitullin 24 që kanë të bëjnë me Drejtësi, Liri dhe Siguri.

Duke i marrë parasysh përvojat europiane, në të cilat kemi një integrim të unifikuar dhe kredibil të të dhënave, me qëllim të krijimit të parakushteve për

investitorët e jashtëm dhe në përmbushjen e kriterëve duhet të kemi regjistra adekuat të cilët duhet të paraqesin gjendjen reale, dhe që dokumentacioni që lëshohet dhe që administrohet nga organet përkatëse të gëzoj kredibilitet të plotë, pasi që çfarëdo manipulimi apo dështimi në këtë aspekt, mund të ndikoj drejtpërdrejt paaftësinë e shtetit në njërin anë dhe në anën tjetër, në të drejtat e njeriut, siç është e drejta e pronës.

Bibliografia

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, 2008, Prishtinë.
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale, e dt. 04.11.1950, Romë, e miratuar nga Këshilli i Evropës, Strasburg; poashtu Protokolli nr. 1 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale, Paris, 20.03. 1952.
- Ligji Nr. 03/L-154, për Pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 57, i datës 04.08.2009.
- Ligji nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 16, i datës 13.07.2012.
- Ligji mbi marrëdhëniet themelore juridike-pronësore, aprovuar nga Kuvendi i RSFJ, në seancën e Dhomës Federative datë 30.01.1980 (LMTHJP).
- Ligji nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrave për drejtën Pronës së Paluajtshme, i plotësuar me Ligjin nr. 2003/13 për ndryshim plotësimin e Ligjit 2002/5 Themelimin e Regjistrave për drejtën Pronës së Paluajtshme, të botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 34, të datës 01.08.2008. Ligji nr. 04/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2002/ 5 për Themelimin e Regjistrat të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, Gazeta Zyrtare nr. 7, e dt. 10.08.2011.
- Ligji nr. 02/L-96 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2003/25 për Kadastrin, Gazeta Zyrtare nr. 37, e dt. 10.09.2008.
- Ligjit nr. 05/L-079 për investime strategjike në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare nr. 6/2017.

- Traktatin Mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian, 30.03.2010 (OJ 2010 C83/01).
- Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, 2016.
- Direktiva Nr. 94/47/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e dt. 26.10.1994 për mbrojtjen e blerësve sa i përket aspekteve të sigurta të kontratave që kanë të bëjnë me blerjen e të drejtës për të përdorur pronësinë e paluajtshme në bazë të afatizuar, OJ 1994 L 280/83-87.
- Direktiva e Këshillit 93/13/EEC e 05.04.1993 mbi kushtet e padrejta në kontratat e konsumatorit, OJ 1993 L 95/29-34.
- Direktiva e Këshillit 85/577/EEC e 20.12.1985 për mbrojtjen e konsumatorëve në aspekt të të kontratave të negociuara larg prej vendit të ushtrimit të biznesit, OJ 1985 L 372/31-33.
- Rastet e Gjykatës Europiane të Drejtësisë: ECJ 22.8.1997 – case C-302/97 (Konle./Republik Österreich), Rep. 1999 I-3099; 13.7.2000 – case C-423/98 (Albore), Rep. 2000 I-5965; 5.3.2002.

Paulin Pashku¹

Provat në Procedurën Penale: Parimet, Kategorizimi dhe Shqyrtimi i Provave

Abstrakt

Në këtë punim janë elaboruar parimet kryesore të shqyrtimit të provave në procedurën penale duke gjetur, patur parasysh nocionin e provave. Përndryshe, provat përkufizohen si mjete procedurale nëpërmjet të cilave vlerësohet pranueshmëria, rëndësia (relevanca), besueshmëria, në formën e objekteve apo pretendimeve të palëve, me qëllim të zbatimit të të drejtave të tyre në procedurë dhe të cilat i paraprijnë marrjes së vendimit gjyqësor.

Përndryshe, parimet që e karakterizojnë punën përkritazi me provat janë, parimi i pranueshmërisë së provave, parimi i besueshmërisë së provave, parimi i rëndësisë së provave.

Gjatë punës duhet të kihet parasysh që të zbatohen dispozitat përkatëse ligjore të parapara me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, ngase poqese nuk e kanë mbështetjen e duhur ligjore, atëherë të njëjtat nuk paraqesin relevance për punë të mëtejme.

Fjalët kyçe: prova, parimet në procedurë, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës.

1. Hyrje

Në literaturën penalo - juridike ka përkufizime të ndryshme për nocionin e provës. Sipas disa autorëve, prova është konstatim i faktit nga dëshmia². Një qëndrim tjetër është se provë është çdo bazë e dëshmisë apo arsye që e përmban mjete i caktuar dëshmues i cili flet për saktësinë e fakteve të rëndësishme³. Sipas **Encyklopedia Britannica**, *provat në kuptimin ligjor janë çfarëdo objekti material apo pretendime të cilat i paraqiten gjykatës kompetente, si mjete për përcaktimin e së vërtetës lidhur me çështjen e cila është nën hetim (gjykim).*

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë në nenin 149, kuptimin e provës e përkufizon si në vijim: *“Provë konsiderohen njoftimet mbi faktet dhe rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara*

¹ Prokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj

² Parimet e provave, Jon Smibert faqe 238

³ Sijerçiq – Çeliq, Hajrija, Halilović, Haris, asistent i lartë “E drejta e procedurës penale me vështrim të posaçëm në Procedurën Penale të Kosovës faqe 99

në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij". Ky përkufizim ka ngjashmëri edhe me dispozitat e KPPRK-së, ku përcaktohen standardet për dyshimin e arsyeshëm, dyshimin e bazuar mirë, shkakun e bazuar, artikuleshmërinë e provës dhe mbështetjen e pohimit.

Në këtë drejtim, KPPRK-ja, edhe pse nuk përmban përkufizim të veçantë për nocionin e provave, ky nocion lidhet me ekzistimin e dyshimin e arsyeshëm dhe të bazuar, duke udhëzuar në zbatimin e dispozitave ligjore, si (psh. Neni 155, 257 par 4 dhe neni 152 i KPPRK), çështja e relevancës (neni 258 i KPPRK) dhe çështja e besueshmërisë (neni 332 dhe 263 të KPPRK), nëpërmjet të cilave rregullohet çështja e pranueshmërisë së provave. Meqenëse dispozitat ligjore udhëzojnë fuqishëm në detyrimin për vlerësimin sa më objektiv të provave, vijmë te konkludimi se nocioni i "**vëzhguesit objektiv**", i paraparë në nenin 19, par.1, nënpar.1.8 të KPPRK, mund të zërthehet në **Bazën e të provuarit dhe Motivin e të provuarit**. Baza për të qenë "Vëzhgues", është njohuria - kuptimi për ngjarjen, - ndërsa **Objektiviteti** lidhet me motivin se si një person e sheh rolin e tij për një ngjarje. Ndryshe me objektivitet kuptohet kushti i provave ku paragjykimi është minimal ose joekzistent⁴. Me vështrim në këtë shumëllojshmëri të përkufizimeve mbi nocionin e provave, ky punim vëren se në literaturë ka qëndrime se "*E vërteta e cila konstatohet me procedurën penale është e vërtetë subjektive dhe relative sepse konstatimi i saj gjithmonë varet nga personaliteti i gjyqtarit, nga bindjet e tij, njohuritë dhe përvojat e tij por edhe vet mjetet argumentuese me ndihmën e të cilave më së shpeshti konstatohet e vërteta në procedurën penale (dëshmitarët, ekspertët, i pandehuri) - janë subjektive.*"⁵. Një qëndrim i tillë në literaturë reflektohet edhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut, ku mbrohet qëndrimi se çështja e përdorimit të provave të papranueshme është çështje e brendshme e gjykatës nacionale⁶, ndërsa për GJEDNJ është e rëndësishme mënyra e zhvillimit të procedurës-përkatësisht se a u është dhënë palëve mundësia e mjaftueshme për të sfiduar, kundërshtuar dhe propozuar provat (parimi kontradiktor dhe akuzator).

Qëndrimet e lartëcekura i referohen parimit të çmuarjes së lirë të provave që i mundëson gjykatës diskrecion që të nxjerrë konkludim nëse një fakt është

⁴ Parimet e provave, Jon Smibert faqe 235

⁵ Sijerçiq – Çeliq, Hajrija, Halilović, Haris., asistent i lartë "E drejta e procedurës penale me vështrim të posaçëm në Procedurën Penale të Kosovës, faqe 22

⁶ Aktgjykimi i datës 13.07.1998 në rastin Schenk v Zveirës "**while Article 6 of the Convention guarantees the right to a fair trial, it does not lay down any rules on the admissibility of evidence as such, which is therefore primarily a matter for regulation under national law**" (§ 46

vërtetuar ose jo. Gjithashtu edhe në nenin 361, par.2 të KPPRK, parimi i çmuarjes së lirë të provave shprehet kështu: "Gjykata detyrohet **që me ndërgjegje të vlerësojë çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë, të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar**".

Shembull konkret paraqet fakti se KPPRK në nenin 141, par.2 parasheh të drejtën e të pandehurit për të anagazhuar ekspertë, duke përcaktuar se "I pandehuri mund të merr dhe të paguajë vetë për ekspertizë". Pasi që dispozita e tillë flet për "ekspertin e mbrojtjes" i cili angazhohet me pagesë nga i pandehuri - kjo e drejtë ligjore e të pandehurit e vë në pikëpyetje nocionin e "vëzhguesit objektiv", me parakushtin që paragjykimi të jetë minimal ose joekzistent. Pra baza dhe motivi për të provuar si test i objektivitetit, shprehet përmes parimit akuzator, kontradiktor dhe barazisë së armëve, sepse palët duhet të vendosin për arsyeshmërinë e mbrojtjes së interesit juridik të tyre, të paraqesin argumente dhe të deklarohen për provat e palës tjetër.

Në mbështetje të këtij qëndrimi flet edhe kategorizimi i provave në praktikën gjyqësore, ku ndarja kryesore është ajo mes provave të akuzës dhe të mbrojtjes; provave materiale dhe personale, të drejtëpërdrejta dhe të tërthorta; kontradiktore; burimore dhe të prejardhura etj. Të gjitha këto lloje të provave në procedurën penale janë produkt i zbatimit të parimit "Barazia e armëve", ku e formojnë atë që në literaturën juridike shpesh quhet edhe "trup i provave"⁷, ku paraqet tërësinë e vlerësimeve për çdo provë të shqyrtuar në procedurë dhe duhet të integrohet në arsyetimin e aktgjykimit, siç e parasheh edhe dispozita e nenit 370 par.7 të KPPRK ku theksohet: "Gjykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyes i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Gjykata gjithashtu në mënyrë të veçantë vlerëson saktësinë e provave kundërtënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij".

Andaj në bazë të nenit 9 të KPPRK, mbi barazinë e palëve - provat përkufizohen si: **Mjete procedurale nëpërmjet të cilave vlerësohet pranueshmëria, rëndësia, besueshmëria, në formën e objekteve apo pretendimeve të palëve, me qëllim të zbatimit të të drejtave të tyre në procedurë dhe të cilat i paraprijnë marrjes së vendimit gjyqësor.**

⁷ Parimet e provave, Jon Smibert faqe 242

1. Parimet e provave

Duke ju përmbajtur qëndrimit se prova është mjet procedural, ky punim konsideron se ky atribut i provës konsiston në faktin se një objekt apo pretendim për tu konsideruar si provë në procedurën penale, duhet të plotësojë kushtin ligjor, e që është **pranueshmëria** e provës nga gjykata. Atribut tjetër i provës si mjet procedural është **rëndësia - relevanca**. Për të qenë objekt i shqyrtimit dhe i vendosjes meritorë, prova duhet ta ketë peshën e saj për faktin që ka për qëllim ta vërtetojë, ose ta kundërshtojë. **Besueshmëria** e provës është atribut që konsiston në fuqinë provuese të provës dhe i referohet përputhshmërisë dhe konsistencës së provës lidhur me rrethanat dhe pretendimet faktike, apo qëndrimet e paraqitura në procedurën penale. Ky parim shprehet në nenin 19, par.1, nënpar.1.30 të KPPRK, ku ligjdhënësi kërkon që pala e cila paraqet informacionin apo proven, duhet të specifikojë në detaje informatën apo provën në të cilën mbështetet. Në pikëpamje të nocionit të dyshimit të bazuar mirë, ky parim pasqyrohet edhe në dispozitën e nenit 19 par.1 nënpar.1.2 të KPPRK, ku përcaktohet se dyshimi i bazuar mirë, nënkupton ngritjen e aktakuzës në bazë të provave të pranueshme, që do të bindte një vëzhgues objektiv **që një vepër penale ka ndodhur dhe që është kryer nga i pandehuri**.

Duhet theksuar se parimet e cekura më lartë, janë të ndërlidhura me njëra tjetrën dhe në kuadër të dispozitave të KPPRK, ato shpesh herë janë të integruara në një fjali, apo dispozitë ligjore. Për shembull në nenin 150. par.2 të KPPRK theksohet se: "*Këqyrjen ose rikonstruksionin e tillë të vendit të ngjarjes e kryen prokurori i shtetit ose policia. Prokurori i shtetit dhe policia mund të kryejnë këqyrjen ose rikonstruksionin e tillë për t'u njoftuar personalisht me gjendjen, e cila do t'u ndihmonte në përcaktimin e besueshmërisë ose gjetjen e fakteve, por në rastin e tillë, rezultatet për gjykatën janë të papranueshme, përveç nëse është në pajtim me paragrafin 3. ose 4. të këtij neni. Prokurori i shtetit mund ta përsërisë këqyrjen ose rikonstruksionin e tillë me njoftim, siç parashihet me këtë nen, me ç'rast rezultatet e tilla janë të pranueshme*".

Pra dispozita në fjalë udhëzon në zbatimin e parimit të besueshmërisë dhe pranueshmërisë.

2. Pranueshmëria

Çështja e pranueshmërisë së provave e paraqet kushtin thelbësor që një objekt fizik apo pretendim të konsiderohet si provë në procedurën penale. Si e tillë,

pranueshmëria e provave është drejtëpërdrejtë e kushtëzuar me: detyrimet kushtetuese⁸ dhe ligjore që i referohen Mbrojtjes së të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe fakteve të cilat nuk mund të vërtetohen sipas fuqisë së ligjit. Kështu, vlerësimi i pranueshmërisë së provave përfshin siguruarat provat e me rastin e këqyrjes së vendit të ngjarjes, kontrollit dhe sekuestrimit të përkohshëm⁹; provat e siguruarat me zbatimin e masave të fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit¹⁰, provave që merren gjatë marrjes në pyetje dhe dhënies së deklaratave të pandehurve, dëshmitarëve dhe ekspertëve¹¹¹² dhe provave të nevojshme për konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me veprë penale.

Duke marrë për bazë praktikën gjyqësore të GJEDNJ dhe rastet Khan c/a UK (2000.; § 34), Allan c/a UK (2002.,§42) dhe Jalloh c/a Gjermanisë (2006., § 94 – 95)¹³, mund të konkludojmë se parimi i pranueshmërisë së provave nga pikëpamja e GJEDNJ, udhëzon në qëndrimin se mbrojtja e interesit publik, që ka për qëllim dënimin e kryesit të veprës penale, nuk e arsyeton ndërhyrjen e rëndë dhe me pasoja për integritetin trupor dhe mendor të të pandehurit.

Në rastin Jalloh kundër Gjermanisë, zyrtarët policor gjermanë me të vërejtur se i pandehuri ka shitur në rrugë qese të vogla me narkotikë, të cila i kishte nxjerrur nga goja, e arrestojnë dhe pas urdhërit të prokurorit për kontroll trupor të pandehurit, të njëjtin e dërgojnë në spital, ku pas refuzimit të pandehurit që të

⁸ Neni 21, par 2 i i Kushtetutës së Republikës së Kosovës - Të Drejtat dhe Liritë Themelore

Neni 22 [Zbatimi i drejtëpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]

Neni 23 [Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut]

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

Neni 26 [E Drejta e Integritetit Personal]

Neni 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimin Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruës]

Neni 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë]

Neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit]

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]

Neni 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale].

⁹ Neni 111 i KPPRK - Pranueshmëria e provave të marra gjatë kontrollit

¹⁰ Neni 97 I KPPRK - Pranueshmëria e provave të siguruarat me anë të urdhrit për masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit

¹¹ Neni 128 Rrethanat kur deklarata është e papranueshme

¹² Neni 257 Rregullat e përgjithshme për prova

¹³ "The Court reiterates that its duty, according to Art. 19 of the Convention, is to ensure the observance of the engagements undertaken by the Contracting state to the Convention. In particular, it is not its function to deal with errors of fact or of law allegedly committed by a national court unless and in so far as they may have infringed rights and freedoms protected by the Convention. While Art. 6 guarantees the right to a fair hearing, it does not lay down any rules on the admissibility of evidence as such, which is primary a matter for regulation under national law. It is therefore not the role of the Court to determine, as a matter of principle, whether particular types of evidence – for example, evidence obtained unlawfully in terms of domestic law – may be admissible, or indeed, whether the applicant was guilty or not. The question which must be answered is whether the proceedings as a whole, including the way in which evidence was obtained, were fair. This involves an examination of the 'unlawfulness' in question and, where violation of another Convention rights is concerned, the nature of the violation found." (NEZAKONITI DOKAZI U KAZNENOM POSTUPKU PREMA PRAKSI EUROPSKOG SUDA ZA LJUDSKA PRAVA Prof. dr. sc. Davor Krupa c)

pranojë ilaqin për të vjellur, e detyrojnë me dhunë që të pranojë infuzionin, me ç'rast nëpërmjet të vjellurave, të pandehurit ia nxjerrin qesen me narkotikë dhe në bazë kësaj prove, ndaj të njëjtit ngritet aktakuzë për tregtinë e palejuar me narkotikë, e ku në bazë të GJEDNJ, ka gjetur se i pandehuri i është nënshtruar trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës, në kundërshtim me nenin 3 të Konventës dhe nenit 6 të kësaj konvente, me arsyetim se prova kryesore, qesja me narkotikë është marrë me shkelje të të drejtave të garantuara me Konventë, e ku bën pjesë edhe drejta e heshtjes dhe e refuzimit për të inkriminuar veten, në të cilën është thirrur edhe i pandehuri¹⁴.

KPPRK në fuqi, për situatë të tillë, e parashehë në nenin 76 par.5, ku theksohet se *"Policia mund të kërkojë nga i dyshuari t'i shtrohet alkotestit përmes mostrave të urinës ose të frymëmarrjes, ndërsa refuzimi i të dyshuarit për dhënien e këtyre mostrave përbën provë të pranueshme*. I dyshuari duhet të njoftohet paraprakisht në lidhje me këtë. Asnjë mostër nuk duhet të merret me detyrim pa urdhrin e gjykatës". Një tjetër zgjidhje të cilën e adapton KPPRK për situata të tilla është ajo e paraparë me nenin 71 të KPPRK, që parasheh se *"për provat që merren nga trupi i një individi të cilat mund t'i nënshtrohen testimi mjeko-ligjor, policia duhet të ketë pëlqimin me shkrim të individit, që provat e tilla të merren ose me urdhrin e gjykatës"*, sipas nenit 143, 144 apo 145 të këtij Kodi që autorizon marrjen e provave".

Në këtë kuptim, konsideroj se Parimi i Pranueshmërisë së provave në procedurën penale paraqet materializim të mbikqyrjes gjyqësore që sipas KPPRK realizohet nëpërmjet funksionit të gjyqtarit të procedurës paraprake, gjatë fazës së hetimeve, e deri në ngritjen e aktakuzës (neni 23, par.2 dhe neni 24, par.2 i KPPRK)¹⁵. Pas ngritjes së aktakuzës në funksion të kësaj mbikqyrje, është shqyrtimi fillestar ku sipas nenit 26 par 2 të KPPK, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues mban shqyrtimin fillestar dhe të dytë, në kuadër të marrjes

¹⁴ Jalloh, § 82: "Having regard to all the circumstances of the case, the Court finds that the impugned measure attained the minimum level of severity required to bring it within the scope of Article 3. The authorities subjected the applicant to a grave interference with his physical and mental integrity against his will. They forced him to regurgitate, not for therapeutic reasons, but in order to retrieve evidence they could equally have obtained by less intrusive methods. The manner in which the impugned measure was carried out was liable to arouse in the applicant feelings of fear, anguish and inferiority that were capable of humiliating and debasing him. Furthermore, the procedure entailed risks to the applicant's health, not least because of the failure to obtain a proper anamnesis beforehand. Although this was not the intention, the measure was implemented in a way which caused the applicant both physical pain and mental suffering. He has therefore been subjected to inhuman and degrading treatment contrary to Article 3."

¹⁵ 1. Gjyqtari i procedurës paraprake mbikëqyr procedurën penale gjatë fazës së hetimit. Me paraqitjen e aktakuzës, gjyqtari i procedurës paraprake nuk ka më kompetencë mbi të pandehurit e përmendur në aktakuzë.

2. Urdhrat e gjyqtarit të procedurës paraprake në Departamentin e Përgjithshëm apo në Departamentin e Krimeve të Rënda mund të shqyrtohen nga kolegji shqyrtues i të njëjtit departament të asaj gjykate pas paraqitjes së kundërshtimit nga palët. Nëse nuk ka numër të mjaftueshëm të gjyqtarëve, kryetari i gjykatës mund të caktojë gjyqtarët nga ndonjë departament tjetër për të shërbyer në kolegjin shqyrtues.

së vendimeve në këtë fazë të procedurë merr edhe vendim për pranueshmërinë e provave¹⁶.

3. Rëndësia (Relevanca)

Gjithnjë duke pasur për bazë faktin i cili duhet të dëshmohet dhe provat me të cilat duhet të dëshmohet një fakt apo pretendim, rëndësia e provës shprehet në peshën - rëndësinë e saj, për faktin që ka për qëllim ta vërtetojë, ose ta kundërshtojë¹⁷. Në shërbim të këtij funksioni, rezulton se parimi i relevancës paraqet udhëzues për konkretizimin të kërkesave dhe propozimeve të palëve, me qëllim të efikasitetit të procedurës penale.

Sa i përket rëndësisë së provës, ligjdhënësi në nenin 258 të KPPRK¹⁸, përcakton kriteret në pikëpamje të vlerësimit të rëndësisë së të provuarit, duke vënë theksin në rastet kur marrja e provave është e panevojshme për shkak të vëllimit të mjaftueshëm të materialit provues; kur fakti që duhet të provohet është i parëndësishëm apo i provuar; kur prova është e papërshtatshme, e pamundshme ose e paarritshme dhe ku kërkesa bëhet për të zvarritur procedurën.

Edhe në nenin 329 të KPPRK parashihen rregulla të përgjithshme të paraqitjes së provave ku në par.1 të këtij neni reflektohet parimi i rëndësisë-relevancës, ku theksohet se: "*Prezentimi i provave përfshin të gjitha faktet që gjykata i konsideron të rëndësishme për një gjykim të saktë dhe të drejtë*". Në kuadër të këtij përkufizimi rezulton edhe detyrimi i prokurorit të shtetit nga neni 48 i KPPRK për të analizuar provat fajësuese dhe shfajësuese¹⁹.

4. Besueshmëria

Siç e kemi cekur më lartë, Besueshmëria e provës është atribut që konsiston në fuqinë provuese të provës dhe i referohet përputhshmërisë dhe konsistencës së proves, lidhur me rrethanat dhe pretendimet faktike apo qëndrimet e paraqitura

¹⁶ Neni 26 i KPPRK " Pas ngritjes së aktakuzës nga prokurori i shtetit në gjykatën themelore, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues mban shqyrtimin fillestar dhe shqyrtimin e dytë, merr vendim mbi kërkesat për hudhje të aktakuzës, **merr vendim mbi kërkesat për të përjashtuar dëshmitë**, dhe merr vendim mbi kërkesën për caktim të paraburgimit apo masat tjera për të siguruar praninë e të pandehurit".

¹⁷ Neni 131 pika 1-5 i KPPRK.

¹⁸ Neni 258 dhe neni 132 i KPPRK

¹⁹ Neni 258 Provat dhe rendi në gjykatë:

2. Gjykata mund të ndalojë marrjen e provave nëse:

- 2.1. marrja e provave të tilla për të plotësuar provat tjera është e panevojshme dhe e tepërt sepse çështja në fjalë është e njohur në vija të përgjithshme;
- 2.2. fakti që do të provohet është i parëndësishëm për vendimin apo është provuar;
- 2.3. prova është tërësisht e papërshtatshme, e pamundshme ose e paarritshme; ose
- 2.4. kërkesa bëhet për të zvarritur procedurën.

3. Gjykata mund të ndalojë marrjen e provës apo të përjashtojë provën.

në procedurën penale. Ky parim zbatohet njëkohshëm me parimin in dubio pro reo, sepse atëherë kur mungon ndërlidhshmëria dhe përputhshmëria e provës me provat tjera dhe rethanat faktike - provat e tilla interpretohen në favor të pandehurit. Kjo do të thotë se parimi i besueshmërisë është në funksion të përcaktimit të vërtetës materiale, nëpërmjet sfidimit të saktësisë dhe vërtetësisë së provave.

Në shërbim të këtij funksioni, KPPRK parasheh disa dispozita ligjore nëpërmjet të cilave mundësohet vlerësimi i besueshmërisë së provave si: Mbështetja e pohimit (neni 263 i KPPRK)²⁰, marrja në pyetje në procedurë paraprake²¹, marrja e deklaratës në procedurë paraprake, ekspertimi, këqyrja dhe rikonstruksioni, marrja në pyetje e të pandehurit në procedurën paraprake, paraqitja e materialeve nga mbrojtja²², përdorimi i deklaratave të mëparshme në shqyrtimin gjyqësor²³, marrja e drejtpërdrejtë në pyetje, marrja e tërthortë në pyetje, rimarrja në pyetje e dëshmitarit (neni 332 i KPPRK), provat materiale që mbështesin dëshminë e dëshmitarit, betimi (neni 340), deklarimi i ekspertit dhe marrja në pyetje të akuzuarit pas paraqitjes së provave. Nga përmbajtja e dispozitave të cekura, mund të vërehet se procesi i vlerësimit të besueshmërisë së provave është i natyrës verbale dhe zhvillohet nëpërmjet marrjes së tërthortë dhe të drejtpërdrejtë në pyetje të dëshmitarit lidhur me deklaratat për ndonjë prove. Si i tillë ky proces ka për qëllim kundërshtimin e besueshmërisë së dëshmitarit apo rehabilitimin e të njëjtit. Në nenin 332 par.2 dhe 3 të KPPRK, shprehimisht theksohet se palëve u jepet mundësia për marrjen e tërthortë në pyetje të dëshmitarit ose kundërshtimin e besueshmërisë së dëshmitarit, përkatësisht palës e cila ka paraqitur provën i jepet mundësia në fund që të sqarojë përgjigjet me dëshmitarin ose të rehabilitojë besueshmërinë e dëshmitarit.

Parimi i Besueshmërisë së provave, në fakt e paraqet bazën për vlerësimin meritator nga ana e gjykatës, e cila sipas nenit 361, par.2 të KPPRK, detyrohet që të vlerësojë çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar.

²⁰ Neni 19, par.1, nënpar.30 Mbështetje e pohimit - dokument i paraqitur nga pala në mbështetje të dëshmisë apo provës që nuk është drejtpërdrejtë e arritshme në shqyrtim gjyqësor. Mbështetja e pohimit cakton prova tjera të pranishme që mbështesin provën në fjalë. Mbështetja e pohimit ka për qëllim të tregojë se prova në fjalë nuk do të ishte prova e vetme apo vendimtare në mbështetje të aktgjykimit me të cilin i pandehuri shpallet fajtor.

²¹ Neni 131 Marrja në pyetje në procedure paraprake

²² Paraqitja e materialeve nga mbrojtja

²³ Përdorimi i deklaratave të mëparshme në shqyrtimin gjyqësor

5. Kategorizimi i provave

Rëndësia e kategorizimit të provave në procedurën penale, qëndron në faktin se ndërtimi i argumentit juridik, është shpesh herë në varësi të llojit të provave me të cilat synohet të provohet një fakt. Meqenëse qëllimi kryesor i provës është që të vërtetohet ekzistimin ose mosëksistimin e një fakti të rëndësishëm për procedurën penale, ky punim konsideron se kategorizimi i provave është në shërbim të caktimit të prioriteteve në administrimin e provave dhe vlerësimit të të njëjtave nga mbrojtja, prokuroria dhe gjykata. Prandaj nga kjo, konsideroj se në kuptim të caktimit të prioriteteve, provat mund të ndahen në: **Primare dhe Sekondare**.

Si **prova primare** mund të konsiderohen provat materiale, të siguruar nga vendi i ngjarjes dhe me rëndësi të drejtëpërdrejtë për çështjen në shqyrtim. Të tilla mund të jenë lloji i provave materiale, të parapara me nenin 336 par 2 të KPPRK ku theksohet se, "*Provë materiale mund të jetë dokumenti, tabela, përmbledhja, videokaseta, audiokaseta apo prova tjetër materiale*".

Prova sekondare janë provat të prejardhura, të cilat e interpretojnë një provë ose informacion në formë të mendimit, analizës apo të një studimi. Nga përmbajtja e nenit 341, par.2 të KPPRK, theksohet se "*Eksperti përshkruan konstatimet dhe shpjegon analizat e tij. Ai mund të përdorë provat materiale në mbështetje të dëshmisë së tij*", - vijmë në përfundim se deklarimi i ekspertit është provë sekondare, pasi që si i tillë është vlerësim për provën dhe jo provë në vete. Sipas rëndësisë për vërtetimin e një fakti në mbështetje të fajësisë ose pafajësisë së të pandehurit, provat ndahen në të drejtëpërdrejta dhe të tërthorta. Të drejtëpërdrejta janë provat të cilat nuk ka nevojë të provohen me prova tjera, ndërsa të tërthorta janë provat të cilat e ndërlidhin një provë me një konkluzion²⁴.

Sidoqoftë në dispozitat e KPPRK, konkretisht në nenin 261, par.1, nocionin e provës së drejtëpërdrejtë e ndërlidhë edhe me mundësinë e kundërshtimit të deklaratës së të pandehurit në gjyq - lidhur me deklaratën e të pandehurit të dhënë në polici ose në Prokurori.

Në këtë drejtim duhet shtuar se ka dallime të konsiderueshme mes definicioneve të ofruara në literaturë lidhur me provat e drejtëpërdrejta dhe definicionit ligjor në KPPRK.

Për shembull në librin "**Parimet e Provave**" të Jon Smibert, provat e drejtëpërdrejta përkufizohen si: "*Prova e cila provon objektivin final, si një*

²⁴ Jon Smibert, Parimet e Provave, faqe 238.

element të veprës penale, pa ndonjë hap intervenues". Së këndejmi pavarësisht faktit që neni 261, e konsideron si provë të drejtëpërdrejtë deklarimin e të pandehurit në polici dhe prokurori - neni 262, par.2 i KPPRK thekson se: "Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare deklarimit të dhënë nga i pandehuri në polici ose para prokurorit të shtetit". Bazuar në zgjidhjen e mësipërme të KPPRK, rezulton se prova e drejtëpërdrejtë, megjithatë nuk ka ndikim në përcaktimin e fajësisë së të pandehurit.

Më tutje, një ndarje tjetër sipas cilësisë provuese është ndarja në prova konkluduese, zëvendësuese dhe kontradiktore. Provat kontradiktore janë provat me të cilat kontestohet vërtetësia e një prove tjetër dhe për të njëjtën çështje. Prova konkluduese janë ai lloj provave nëpërmjet të cilave mbështetet një fakt. Me prova zëvendësuese i kuptojmë provat të cilat për shkak të pamundësisë së paraqitjes të provave kryesore - burimore, i zëvendësojnë provat e tilla në formë të kopjeve, fotografive ose skicave, me kushtin e paraqitjes së përmbajtjes së vërtetë të provave të cilat i zëvendësojnë. Lloji tjetër i provave është ai i provave dëshmuese të cilat mund të jenë deklarata me gojë ose me shkrim të cilat jepen nga një person në ndonjë dokument, adresë elektroklike ose letër. Në këtë kuptim dispozita e nenit 336 të KPPRK e mbulon edhe nocionin e provës materiale, provës dëshmuese, provës burimore dhe zëvendësuese²⁵.

6. Shqyrtimi i provave

Si një ndër çështjet më sfiduese në raport me shqyrtimin e provave dhe me vështrim në dispozitat e KPPRK, paraqet **nocioni i provës së drejtëpërdrejtë**. Ky nocion nuk është i përfshirë në përkufizimet e KPPRK, ndërsa nga përmbajtja

²⁵ 1. Pala mund t'i paraqesë dëshmitarit provën materiale dhe t'i parashtrijë pyetje dëshmitarit lidhur me atë provë materiale gjatë marrjes në pyetje, marrjes së tërthortë në pyetje ose rimarrjes në pyetje.

2. Provë materiale mund të jetë dokumenti, tabela, përmbledhja, videokaseta, audiodaseta apo prova tjetër materiale.

3. Çdo provë materiale që përmbledh ose tregon provë të pranueshme që është e shumtë, e madhe apo që është asgjësuar së pari i paraqitet dëshmitarit i cili mund të identifikojë këtë provën të pranueshme, të shpjegojë si është krijuar prova dhe të vërtetojë se prova është e vërtetë, e bazuar dhe paraqet saktësisht provën e pranueshme origjinale.

4. Cilado provë nga paragrafët 2. apo 3. të këtij neni është e pranueshme nëse është e vërtetë, e bazuar dhe paraqet saktësisht provën e pranueshme origjinale. Prova materiale shënohet në procesverbal nëse nuk është shënuar më parë.

e dispozitave ligjore, psh: Në nenin 119, par. 5 të KPPRK²⁶, në interpretim të lirë, rezulton se *“Provë e drejtpërdrejtë mund të konsiderohet një provë që do ta provonte dëmin e shkaktuar (cenimin e së mirës juridike të mbrojtur me ligj), mënyrën e kryerjes dhe pasojat për të dëmtuarin (përkufizim i autorit)”*. Sidoqoftë përmbajtja e dispozitës së nenit 123, par.3 të KPPRK²⁷, lidhur me atë se çka konsiderohet provë e drejtpërdrejtë, sugjeron se deklarata e dëshmitarit e dhënë gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake, mund të përdoret si provë e drejtpërdrejtë gjatë shqyrtimit kryesor, nëse dëshmitari për shkak të rrethanave të cekura në këtë dispozitë, nuk është në dispozicion. Gjithashtu në këtë dispozitë theksohet se një provë e tillë nuk mund të përdoret si provë e vetme apo vendimtare fajësuese për të pandehurin. Duke marrë parasysh edhe dispozitën e nenit 262, par.2 të KPPRK, nga e cila rezulton se deklaratat e të pandehurit në polici dhe në prokurori nuk mund të ketë rëndësi vendimtare për shpalljen fajtor të pandehurit - arrijmë në përfundim se dispozitat e sipërpërmendura provën e drejtpërdrejtë e trajtojnë si mbështetje të pohimit nga neni 19, par.1, nënpar. 1.31 të KPPRK²⁸, sepse nuk i japin rëndësi vendimtare për shpalljen fajtor të të pandehurit. Në anën tjetër dispozita e nenit 7 par.1 të KPPRK thekson se: *“Gjykata, prokurori i shtetit dhe policia të cilët marrin pjesë në procedurën penale detyrohen që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm”*. Detyrimi i paraparë me nenin 7, par.1 të KPPRK, nuk ka si të mos i adresohet nocionit të provës së drejtpërdrejtë, si shprehje e parimit të së vërtetës material.

Përfundim

²⁶Gjatë hetimit, i dëmtuari mund të kërkojë nga prokurori i shtetit që të merr ose të ruajë provat të cilat mund të tregonin apo ka arsye të pritit që provat e tilla do të tregonin dëmin e shkaktuar me vepër penale, dhembjen apo vuajtjen e pësuar nga viktimi, apo shpenzimet tjera të ndërlidhura me vepër penale.

²⁷ Deklarata në procedurë paraprake zbatohet nga prokurori i shtetit në pajtim me nenet 132-133 të këtij Kodi. Deklarata në procedurë paraprake audio incizohet, audio dhe video incizohet ose transkribohet fjalë për fjalë. Provat e siguruar gjatë deklaratës në procedurë paraprake mund të përdoren si bazë për të forcuar urdhrat hetues në procedurë paraprake, urdhrat për paraburgim dhe aktakuzën. Deklarata në procedurë paraprake pranohet gjatë shqyrtimit kryesor për marrjen e tërthortë në pyetje të dëshmitarit të njëjtë dhe mund të përdoret si provë e drejtpërdrejtë gjatë shqyrtimit kryesor nëse dëshmitari nuk është në dispozicion për shkak të vdekjes, sëmundjes, privilegjeve apo mungesës së pranishë së tij në Kosovë, **por nuk mund të përdoret si provë e vetme apo vendimtare fajësuese për dënimin e të pandehurit.**

²⁸ Mbështetje e pohimit - dokument i paraqitur nga pala në mbështetje të dëshmisë apo provës që nuk është drejtpërdrejtë e arritshme në shqyrtim gjyqësor. Mbështetja e pohimit cakton prova tjera të pranishme që mbështesin dëshminë apo provën në fjalë. **Mbështetja e pohimit ka për qëllim të tregojë se prova në fjalë nuk do të ishte prova e vetme apo vendimtare në mbështetje të aktgjykimit me të cilin i pandehuri shpallet fajtor.**

Pas materialit të shqyrtuar në kuadër të dispozitave të KPPRK dhe literaturës juridike, ky punim vjen në përfundim se:

1. *Provat mund të përkufizohen si mjete procedurale nëpërmjet të cilave vlerësohet pranueshmëria, rëndësia (relevanca), besueshmëria, në formën e objekteve apo pretendimeve të palëve, me qëllim të zbatimit të të drejtave të tyre në procedurë dhe të cilat i paraprijnë marrjes së vendimit gjyqësor;*
2. *Parimi i pranueshmërisë së provave nga pikëpamja e GJEDNJ, mund të përkufizohet si parim i cili udhëzon se mbrojtja e interesit publik nuk e arsyeton cenimin e të drejtave themelore të njeriut dhe thelbi i këtij parimi qëndron në mbikqyrjen gjyqësore të mbledhjes dhe sigurimit të provave;*
3. *Parimi i Besueshmërisë së provave është i ndërlidhur me parimin in dubio pro reo ,dhe si ti tillë , e paraqet bazën për vlerësimin meritor nga ana e gjykatës;*
4. *Parimi i Rëndësisë (relevancës) paraqet udhëzues për konkretizimin të kërkesave dhe propozimeve të palëve, me qëllim të efikasitetit të procedurës penale;*
5. *Kategorizimi i provave është në shërbim të caktimit të prioriteteve në administrimin e provave dhe vlerësimit të të njëjtave nga mbrojtja, prokuroria dhe gjykata;*
6. *Bazuar në dispozitat ligjore të KPPRK lidhur me shqyrtimin e provave , ky punim gjen se ligdhënësi e ka relativizuar nocionin e provës së drejtëpërdrejtë dhe pasojat juridike të një prove të tillë për të pandehurin, sepse sipas fuqisë së ligjit me referencë në nenin 123 par 3 të KPPRK dhe nenin 262 të KPPRK , një provë e tillë nuk mund të ketë rëndësi vendimtare për shpalljen fajtor të të pandehurit.Për më tepër dispozita e cekura nocionin e provës së drejtëpërdrejtë e lidhin me kuptimin e mbështetjes së pohimit nga neni 19 par 1 nënpar 1.31 të KPPRK.*

Nisur nga ky fakt, ky punim gjen se dispozitat e sipërpërmendura nuk korrespondojnë në tërësi me parimin e së vërtetës materiale, të paraparë me nenin 7 të KPPRK, sepse si të tilla, e anashkalojnë faktin botërisht të njohur - se interesi

dhe pozita juridike e të pandehurit në procedurë penale, janë të drejtuara kah marrja e një vendimi sa më të favorshëm nga gjykata dhe jo kah sqarimi meritor i rrethanave të një rasti penal.

Bibliografia

- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës;
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë;
- "Analysis of Evidence" Terence Anderson, David Schum and William Twining Cambridge;
- "Parimet e Provave" Jon Smibert;
- E drejta e procedurës penale me vështrim të posaçëm në Procedurën Penale të Kosovës, Prof. dr. sc. Hajrija Sijerçiq – Çoliq, Mr. sc. Haris Halilović, asistent i lartë;
- "Nezakoniti Dokazi u Kaznenom Postupku Prema Praksi Europskog Suda za Ljudska Prava", Pr.Dr.Sc. Davor Krapac;
- -<https://legal-dictionary.thefreedictionary.com/direct+evidenc>;
- <http://www.businessdictionary.com/definition/direct-evidence.html>;
- <https://study.com/academy/lesson/direct-evidence-definition-law-examples.html>.

Rexhep Gashi¹

Roli i të dëmtuarit në procedurën penale sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës

Abstrakt

I dëmtuari në procedurë penale paraqet personin të cilit ndonjë e drejtë personale ose pasurore i është shkelur, i është dëmtuar ose i është rrezikuar me veprën penale të kryer apo e cila është tentuar që të kryhet. Si palë të dëmtuar në procedurë penale mund të jenë personat fizik, personat juridike, organet shtetërore apo subjektet tjera ndaj të cilave është i orientuar apo ndërmerret veprimi i kryerjes së veprës penale. I dëmtuari, së bashku me prokurorin e shtetit dhe të pandehurin përbëjnë palët në procedurë, të cilët bëjnë të mundur realizimin e procedurës penale në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Në praktikë shpeshherë mund të haset në përdorim edhe termi viktimë duke ju referuar të dëmtuarit në procedurë penale mirëpo koncepti i termit viktimë jo gjithëherë asocion me termin i dëmtuar, i cili duhet thënë ka kuptim më të gjerë dhe gjithëpërfshirës dhe nënkupton jo vetëm subjektin ndaj të cilit është shkaktuar ose ka mundur të shkaktohet dëmi por edhe personat tjerë të cilët në një mënyrë ose tjetër janë prekur apo dëmtuar nga vepra penale e kryer. I dëmtuari në procedurë penale luan rol esencial drejt ndriçimit dhe zbardhjes të së vërtetës në një çështje penale, qoftë në cilësi të dëshmitarit apo të palës në procedurë. Roli i tij aktiv fillon që nga procedura hetimore, procedura e mbledhjes së provave, procedura e ndërmjetësimit, pastaj shqyrtim gjyqësor, si dhe në ushtrimin e mjetit juridik për një kategori të vepra penale të përcaktuara me ligj. Një rol të veçantë i dëmtuari e ka tek veprat penale të cilat ndiqen me propozimin e tij. I dëmtuari në procedurë penale gëzon një varg të drejtash të cilat duhet të respektohen nga policia, prokurori dhe gjykata. Për tu konsideruar nga gjykata si palë në procedurë penale i dëmtuari duhet të paraqes deklaratë të dëmit e cila në fakt përbën të drejtën elementare të dëmtuarin për të kërkuar kompensimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale.

Fjalët kyçe: I dëmtuar, viktimë, procedurë penale, gjykatë, dëshmitar, ndërmjetësim.

¹ Autori është Master i Shkencave Juridiko-Penale dhe Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë

Hyrje

Veprat penale të cilat kryhet nga ana e kryerësve shkaktojnë pasoja apo dëme të cilat i godasin personat fizik dhe juridik por edhe personat tjerë të cilët në një mënyrë ose tjetër i lidh afërsia dhe interesi i përbashkët. Dëmi i shkaktuar mund të jetë i natyrës materiale, shëndetësore dhe morale. I dëmtuari ose viktima është personi të cilit çfarëdo e drejte personale ose pasurore i është shkelur ose rrezikuar me veprën penale.² Edhe pse i dëmtuari nuk përbën subjektin qendror të procedurës penale sikurse janë prokurori i shtetit dhe i akuzuari, i dëmtuari prapë së prapë paraqet subjektin apo pjesëmarrësin i cili luan një rol aktiv dhe tejet me rëndësi në procedurë duke filluar nga iniciimi, pastaj në zhvillimin dhe përfundimin e procedurës penale.

Të drejtat dhe pozita procedurale si subjekt në procedurë e të dëmtuarit janë të rregulluara në kapitullin e VI të Kodit të Procedurës Penale por duke mos përjashtuar edhe të drejtat tjera të tij të cilat parashihen në kapitujt tjerë të Kodit të Procedurës Penale.

Ligjet penale të mëparshme të cilat janë zbatuar në Kosovë³, të dëmtuarit ndër tjera i kishin siguruar të drejtën e padisë private apo të padisë subsidiare si mjet të drejtpërdrejt në ndjekjen penale të kryerësve të veprave penale, mirëpo Kodi i aplikueshëm i Procedurës Penale duke i parë edhe praktikën e kaluar jo shumë të suksesshme në këtë drejtim të cilat ishin zbatuar në Kosovë si dhe duke i pasur parasysh praktikën më të mira ndërkombëtare e largoj këtë të drejtë duke e fuqizuar rolin e të dëmtuarit në të drejta tjera siç janë e drejta për t'u trajtuar me respekt, për t'u njoftuar, për të marrë pjesë në procedurë dhe për tu kompensuar.⁴ Ndonëse pozita e të dëmtuarit me Kodin e Procedurës Penale ka avancuar dukshëm në të drejtat dhe fuqizimin e tij si palë në procedurë mirëpo nuk është e tepërt të thuhet se roli pro aktiv i palës së dëmtuar në njërin anë dhe respektimi rigoroz i atyre të drejtave në procedurë nga prokuroria dhe gjykata në anë tjetër përbëjnë garanci në përmbushjen e rolit të rëndësishëm të palës së dëmtuar në procedurë penale.

I dëmtuari krahas të drejtave të përcaktuara me ligj ka edhe obligime ligjore të cilat duhet të respektohet nga ana e tij gjatë procedurës penale e të cilat janë që nga pranimi i ftesave nga prokuroria dhe gjykata, pastaj prezantimi në thirrjen e prokurorisë dhe gjykatave gjatë shqyrtimeve gjyqësore, dhënia e dëshmisë së

² Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi me 1 janar 2013 dhe i publikuar në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës nr.37, 28 dhjetor 2012, Prishtinë, neni 19 përkufizimet, paragrafi 1 nën paragrafi 1.7.

³ Ligji Penal i Kosovës i vitit 1974, dhe Kodi i Procedurës Penal i Kosovës i vitit 2004.

⁴ Udhëzuesi për Kodin e Procedurës Penale dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Prishtinë 2013, fq 24.

vërtet mbi ngjarjen e cila përbën objekt të procedurës penale si dhe realizimi i atyre të drejtave të përcaktuara me ligj në fazat e procedurës penale.

1. Roli dhe pozita e të dëmtuarit në procedurë penale

I dëmtuari në procedurë penale nuk ka vetëm një rol të caktuar por ai mund të realizoj role të ndryshme e të cilat janë sikurse: ⁵ 1) të paraqesë propozim për ndjekje penale për kategori të posaçme të veprave penale, të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare, por që ndjekjes së tyre u paraprin propozimi i të dëmtuarit; 2) të paraqitet në cilësi të personit i cili e paraqet kërkesën pasurore juridike; 3) të paraqitet si dëshmitar; të propozojë prova për ndriçimin e çështjes penale dhe 5) të paraqesë ankesë kundër aktgjykimit. Pra, i dëmtuari në procedurë penale luan një rol të shumëfishtë dhe se pozita e tij në procedurë penale është e varur kryekëput nga deklarimi i dëmit nga ana e tij i cili në fakt përbën parakushtin esencial për t'iu njohur më pastaj të njëjtit e drejta si palë në procedurë penale nga gjykata. Kjo përcaktohet me dispozitën e nenit 218 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës ⁶ sipas të cilës deklarimi i dëmit nga ana e të dëmtuarit në procedurë penale mund të bëhet gjatë fazës së hetimi ose brenda gjashtë dhjetë (60) ditëve prej ngritjes së aktakuzës.

I dëmtuari mund të paraqesë një deklaratë të thjeshtë të dëmit të shkaktuar nga vepra penale. Deklarimi i dëmit nga ana e të dëmtuarit sipas kodit të procedurës penale duhet ti përmbajë disa elemente e ku përfshihen emri i personit i cili e ka shkaktuar dëmin, pastaj mënyra se si ka ardhur deri te dëmi, si është shkaktuar dëmi nga vepra penale apo si ka qenë dëmi rezultat i parashikuar i veprës penale; dhe nëse ka pasur shpenzime të shkaktuara si rezultat i dëmit apo humbjeve të shkaktuara nga vepra penale, në deklaratë caktohet vlerësimi i arsyeshëm i shpenzimeve apo humbjeve.⁷ Sikurse është përmendur edhe në abstrakt të këtij punimi termi i dëmtuar në praktikë shpeshherë ngatërrohet me termin viktimë e veprës penale mirëpo këto dy terme jo gjithë herë përputhen në mes tyre, për faktin se tek disa vepra penale si p.sh. te vepra penale e vrasjes viktimë mund të jetë subjekti pasiv tek i cili është orientuar vepra penale kurse të dëmtuar mund të jenë familjarët e tij, andaj mbi këtë bazë pastaj rrjedh edhe e drejta e kompensimit të dëmit nga pala e dëmtuar dhe jo nga vet viktimja e veprës penale

⁵ Prof.dr.Ejup Sahiti, Prof.dr.Rexhep Murati, Mr.Xhevdet Elshani, *Komentari i Kodit të Procedurës Penale*, Prishtinë 2014, fq 222.

⁶ *Kodi i Procedurës Penale të Kosovës*, i cili ka hyrë në fuqi me 1 janar 2013 dhe i publikuar në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës nr.37, 28 dhjetor 2012, Prishtinë, neni 218. Paragrafi 1.

⁷ Po aty, neni 212, paragrafi 3.

në mënyrë të drejtpërdrejtë sikurse është fjala me një kategori të veprave penale të sanksionuara me Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim disa kode të procedurës penale në Evropë i kanë rregulluar ndaras të drejtat e të dëmtuarit nga të drejtat e viktimës në procedurë penale, mirëpo Kodi i Procedurës Penale i aplikueshëm aktualisht nuk e bënë një gjë të tillë por të drejtat e subjektiv pasiv të veprës penale i njih si të drejtat e të dëmtuarit.

I dëmtuari në procedurë penal përveç të drejtës elementare të cilën e ka dhe e cila në fakt ja njih të drejtën e palës në procedurë, ai i gëzon edhe disa të drejta tjera bazike të cilat duhet të zbatohen nga subjektet tjera gjatë procedurës penale e aty përfshihen edhe e drejta që i dëmtuari nga vepra penale duhet të trajtohet me respekt nga policia, prokuroria, gjyqtarët ose organi tjetër që e zbaton procedurën penale, dhe po ashtu nëse i dëmtuari nga vepra penale mund të identifikohet, policia dhe prokurori ose organi tjetër i cili e zbaton procedurën penale duhet ta kontaktojë të dëmtuarin dhe ta informojnë atë që është palë e dëmtuar.⁸ Këto siç u tha përbëjnë në fakt të drejtat bazike të cilat i gëzon i dëmtuari në procedurë penale kurse të drejtat tjera të përcaktuara me kodin e procedurës penale do të trajtohen më tej në këtë punim përkatësisht në fazat respektive të procedurës penale atë të hetimit, shqyrtimit gjyqësore, dhe të ushtrimit të mjetit juridik.

2. Roli i të dëmtuarit në fazën e hetimit

Sikurse dihet procedura penale sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës përbëhet nga katër faza të ndryshme; fazën e hetimit, fazën e ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit, fazën e shqyrtimit gjyqësor dhe fazën e mjetit juridik.⁹ Në vazhdim do të trajtohet roli dhe pozita e të dëmtuarit në fazën e hetimit si faza fillestare e procedurës penale. Varësisht prej asaj që pala e dëmtuar është prezantuar thjesht si palë e dëmtuar ose si dëshmitar, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës i siguron disa të drejta respektive. Disa të drejta derivojnë nga pasojat të cilat i janë shkaktuar atij nga veprimi i veprës penale konkrete nga e cila ka pësuar ndonjë dëm material apo moral.¹⁰

⁸ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi me 1 janar 2013 neni 62.

⁹ Po aty neni 25.

¹⁰ Dr .Azem Hajdari, *Position of The Injured Party in Kosovo Criminal Procedure*, publikuar në revistën „*European Journal of Business and Social Sciences*”, Vol. 5, No. 10, January 2017, fq 14.

3. Kallëzimi Penal nga ana e të dëmtuarit

I dëmtuari i cili është objekt i veprës penale dhe ka pësuar nga vepra penale qoftë direkt ai apo ndonjë anëtarë i familjes së tij në bazë të kodit të procedurës penale ka të drejtë të kallëzoj veprën penale tek organet kompetente siç janë policia dhe prokuroria. Kjo e drejtë hynë në kuadër të kallëzimit penale nga personat. Me rastin e mbledhjes së të dhënave nga i dëmtuari, policia informon të dëmtuarin për të drejtat e tij nga neni 62 i Kodit dhe me kërkesën e të dëmtuarit apo kur i dëmtuari i përket njëres prej kategorive nga neni 62, njofton Njësinë për Mbrojtje të Viktimave.¹¹ Pra, mbi këtë bazë policia e cila në fakt merr deklaratën e parë nga i dëmtuari pas kryerjes së veprës penale duhet ti respektoj të drejtat e të dëmtuarit dhe ta trajtoj atë me respekt maksimal pasi që në të kundërtën ai ka të drejtë ankese tek prokurori kompetent i shtetit.

4. Përfaqësimi i të dëmtuarit

I dëmtuari në procedurë penale pavarësisht asaj se në cilën fazë të procedurës penale gjendet dhe duke pasur parasysh aftësinë procedurale të cilën e ka, ai gëzon të drejtën të përfaqësohet në procedurë nga përfaqësuesi i cili është anëtarë i Odës së Avokatëve të Kosovës. Çështja e përfaqësimit në mënyrë të rregullt duhet të vërtetohet në fillim të procedurës, në mënyrë që për shkak të mangësive në përfaqësim, të mos ndodhë përfaqësimi i paautorizuar ose dhënia e deklaratave që janë me rëndësi për rrjedhjen e procedurës.¹²

Përveç mundësisë së parë atë të përfaqësimit në procedurë nga një avokat i angazhuar i dëmtuari e ka mundësinë që të përfaqësohet edhe nga mbrojtësi i viktimave e sidomos tek disa kategori të caktuara të veprave penale siç janë veprat penale të trafikimit dhe veprat penale të dhunës në familje ku mbrojtësit e viktimave luajnë rol më aktiv në procedurë duke i ndihmuar të viktimat- të dëmtuarit gjatë gjithë procedurës penale e cila zhvillohet tek organet kompetente. Si mundësi tjetër të përfaqësimit në procedurë penale në bazë të Kodit të Procedurës Penale është edhe ajo që i dëmtuari mund ta përfaqësoj vetën e tij në procedurë dhe ti ushtroj të gjitha të drejtat të cilat atij i garantohet me ligj, çka në praktikë ndodh në jo pak raste për arsye nga më të ndryshme duke filluar nga ajo

¹¹ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 77.

¹² Prof.dr.Ejup Sahiti, Prof.dr.Rexhep Murati, Mr.Xhevdet Elshani, *Komentari i Kodit të Procedurës Penale*, Prishtinë 2014, fq 227.

që i dëmtuari shpeshherë nuk ka mundësi financiare të paguaj një përfaqësues të autorizuar avokat çka e detyron që përfaqësimin ta bëjë vet e i cili përfaqësim mund të mos jetë adekuat pasi që i dëmtuari nuk është jurist i cili do ti kishte përgatitjet e nevojshme dhe ti realizonte të drejtat ashtu siç ja garanton ligji mirëpo në këto raste duhet të kujdeset prokuroria dhe gjykata duke ja kujtuar të dëmtuarit gjithherë të drejtat të cilat ai i ka në procedurë penale dhe të cilat mund ti ushtroj për të kontribuar kështu në zgjidhjen sa më të drejtë të një çështje penale. Një lloj tjetër i përfaqësimit për të dëmtuarin në procedurë penale mund të jetë edhe përfaqësimi ligjor i cili zbatohet kur të dëmtuarit në procedurë penale i mungon zotësia për të vepruar, qoftë për shkak të moshës jo madhore, qoftë për shkak të gjendjes së tij psikofizike.¹³ Në këtë rast përfaqësuesi ligjor vepron në emër dhe dobi të personit të përfaqësuar me të drejtën që të deklaroj dhe të paraqes edhe kërkesën pasurore juridike për kompensim dëmi. Si përfaqësues ligjor mund të paraqitet prindi i fëmijës së mitur-të dëmtuar ose kujdestari i personit pa zotësi të veprimit.

5. Prezantimi i provave

I dëmtuari në procedurë penale luan një rol të rëndësishëm sa i përket ndriçimit të kryerësit të veprës penale, të rrethanave të kryerjes së veprës penale, motive të kryerësit si dhe fakteve tjera me rëndësi për procesin penal. Këtë mundësi për të paraqitur prova dhe fakte për veprën penale i dëmtuari e ka që nga kryerja e veprës penale, pastaj kallëzimi i veprës penale, deklarata e dhënë në polici dhe prokurori, bërja e pyetjeve dëshmitarëve në procedurën paraprake, deklarimi rreth ekspertizës të caktuar nga prokurori i shtetit, pastaj e drejta për të kërkuar për tu siguruar-marr prova nga jashtë. I dëmtuari gjatë fazës hetimore duhet ta dëshmoj me dëshmi bindëse se ndaj tij është kryer një vepër penale dhe duhet të sqaroj raportin e tij me kryerësin e veprës penale. Paraqitja e provave nga ana e të dëmtuarit dhe vet deklarata e tij për veprën penale të kryer ose e cila është tentuar që të kryhet ndaj tij padyshim paraqesin veprime tejet me rëndësi në procedurë penale por rëndësia e deklaratës së dëmtuarit në procedurës penale sa vjen e rritet kur ajo në fakt përbën provën e vetme e cila do të zbardhte veprën penale dhe kryerësin. I dëmtuari ka të drejtë dhe i lejohet të bëjë deklaratë për të gjitha faktet dhe provat që ndikojnë në të drejtat e tij dhe ka të drejtë për të bërë deklaratë mbi të gjitha faktet dhe provat. Ai ka të drejtë të marrë në pyetje dëshmitarët, t'u

¹³ Po aty fq, 228.

parashtrijë pyetje të tërthorta dëshmitarëve të palës tjetër dhe të kërkojë nga prokurori i shtetit që të thirren dëshmitarët.¹⁴

Në praktikë nga rastet e trajtuara nuk janë rastet të rrallë kur të dëmtuarit ndryshojnë deklaratat e tyre të dhëna në procedurë paraprake me ato të dhëna në shqyrtim gjyqësor dhe kjo në fakt përbën problemin shqetësues me të cilin shpeshherë ballafaqohet gjykata.

6. Qasja e të dëmtuarit në shkresat e lëndës

I dëmtuari në procedurë penale ndër tjera gëzon edhe një të drejtë tjetër shumë të rëndësishme në procedurë penale e cila në fakt edhe i mundëson që të realizoj të drejtën e palës në procedurë e ajo është e drejta e të dëmtuarit qoftë personalisht apo përmes përfaqësuesit të tij ligjor, përfaqësuesit të autorizuar, mbrojtësit të viktimave, që ti shikojnë, kopjojnë ose fotografojnë shkresat e lëndës dhe provat tjera materiale që i disponon gjykata ose prokurori i shtetit nëse ka interes legjitim për ta bërë një gjë të tillë.¹⁵ Gjykata apo prokurori i shtetit mund ta refuzojnë lejen e shikimit, kopjimit ose të fotografimit të shkresave dhe provave materiale nëse interesi legjitim i të pandehurit dhe i personave tjerë e kalon interesin e të dëmtuarit, dhe nëse ka gjasa që shikimi, kopjimi ose të fotografimi i shkresave mund të rrezikojë qëllimin e hetimit ose jetën dhe shëndetin e njerëzve, ose një kërkesë e tillë mund ta zvarriste procedurën penale. Në rastet kur prokurori i shtetit e refuzon një kërkesë të tillë të palës së dëmtuar për t'iu ofruar qasje në shkresat e lëndës atëherë ai ka të drejtë që të paraqesë ankesë tek gjyqtari i procedurës paraprake dhe vendimi i tij është përfundimtar, kurse kur kjo kërkesë i refuzohet nga gjyqtari i procedurës paraprake atëherë ai ka të drejtë të ankohet tek kolegji shqyrtues i cili vendos për ankesën e të dëmtuarit. Pra, qasja efektive e të dëmtuarit në shkresat e lëndës ia mundëson atij që ti realizoj të drejtat në mënyrë efikase dhe të suksesshme gjatë procedurës penale pasi që e ka më të lehtë ti ushtroj të drejtat në këtë mënyrë, e kundërta e kësaj do t'ia pamundësonte të dëmtuarit që të jetë aktiv në procedurë penale sikurse në fakt kërkohet me dispozitat e kodit të procedurës penale.

¹⁴ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi me 1 janar 2013, neni 9.

¹⁵ Po aty, neni 214.

7. Roli i të dëmtuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, prokurori, i dëmtuari dhe i pandehuri kanë të drejta të barabarta lidhur me fjalën hyrëse, thirrjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve, paraqitjen e provave dhe fjalën përfundimtare.¹⁶ Këto të drejta bëjnë që i dëmtuari të jetë palë e barabartë në pjesën kryesore të procedurës penale atë të shqyrtimit gjyqësor. Në praktikë jo rrallë herë mund të ndodh që i dëmtuari të mos merr pjesë në shqyrtimin fillestar dhe shqyrtimin e dytë, pasi që prania e tij nuk është paraparë si e obligueshme sipas dispozitave aktuale të kodit të procedurës penale mirëpo kjo çështje qëndron ndryshe kur ndodh fjala me rastin e pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit atëherë në këtë situatë është e domosdoshme që i dëmtuari gjithsesi të thirret në shqyrtimin fillestar sidomos duke marrë parasysh faktin se nëse i pandehuri pranon fajësinë duhet ti jepet mundësia që i dëmtuari të deklarohet përkitazi me llojin dhe lartësinë e kërkesës pasurore-juridike.¹⁷

8. E drejta e të dëmtuarit në fjalën hyrëse

Me njëherë pas fillimit të shqyrtimit gjyqësor me leximin e aktakuzës në rastin kur i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar shqyrtimi gjyqësor vazhdon me fjalën hyrëse e cila në fakt paraqet një përmbledhje të provave për rastin dhe kërkesën e palëve në procedurë penale.¹⁸ Tri qëllime të përgjithshme të fjalës hyrëse janë; tërheqja e vëmendjes së gjykatës, të ndihmojë gjykatën të kuptojë ngjarjet që pritet të ndodhin në gjykatë dhe të përkrah pozicionin e klientit tuaj.¹⁹ Rendi i paraqitjes së fjalës hyrëse sipas kodit të procedurës penale është i tillë që fillon me prokurorinë shtetit, vazhdon me të dëmtuarin, dhe mbrojtësin e të akuzuarit në fund. I dëmtuari në paraqitjen e fjalës hyrëse mund ti referohet provave dhe dëshmimeve të cilat janë propozuar për tu administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, ligjeve në fuqi, si dhe të dhënave tjera të cilat janë me rëndësi për procesin penal dhe vet të dëmtuarin. Parimisht fjala hyrëse duhet të jetë e shkurtër dhe duhet të pasqyroj në pika të shkurta atë çfarë do të prezantojnë palët gjatë shqyrtimit gjyqësor. Kur i dëmtuari ka përfaqësues të tij rëndom ata përgatisin fjalën hyrëse dhe e paraqesin para gjykatës, ndërsa kur i dëmtuari e përfaqëson veten e tij ai fjalën hyrëse mund ta paraqet vet ose të

¹⁶ Udhëzuesi për Kodin e Procedurës Penale dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Prishtinë 2013, fq 15.

¹⁷ Agim Maliqi, *Një Komentim i Shkurtër i Shqyrtimit Fillestar dhe Shqyrtimit të Dytë Sipas Dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës*, publikuar në revistën shkencore „Opinio Juris”, nr.1/2015, fq 21.

¹⁸ Neni 328 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

¹⁹ Lavdim Krasniqi : *Fjala hyrëse si shkathtësi e përfaqësimit gjatë gjyqimit*, Revista “E drejta”, nr.2/2011, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Prishtinë, 2011, faqe 119.

mbetet pranë fjalës hyrëse të prokurorit të shtetit, dhe të deklarohet përkitazi me kërkesën pasurore juridike.

9. E drejta për të marr në pyetje dëshmitarët nga ana e të dëmtuarit

I dëmtuari përveç asaj që mund të thirret si dëshmitarë në procedurë penale, ai po ashtu ka të drejtë edhe të propozoj dëshmitarë, dhe të merr në pyetje dëshmitarët e propozuar nga prokurori dhe mbrojtësi apo i akuzuari. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton radhën e marrjes në pyetje të dëshmitarëve, duke filluar me dëshmitarët e propozuar nga prokurori i shtetit, dëshmitarët e propozuar nga i dëmtuari apo mbrojtësi i viktimave, dhe në fund me dëshmitarët e propozuar nga i pandehuri apo mbrojtësi i tij.²⁰ Dëshmitarët e propozuar nga i dëmtuari ai ka të drejtë ti merr dhe ri merr në pyetje sipas dispozitave të kodit të procedurës penale në mënyrë të drejtpërdrejtë, kurse dëshmitarët e mbrojtjes ai mund ti merr në mënyrë të tërthortë në pyetje sikurse e përcakton kodi i procedurës penale.

Përveç kësaj që i dëmtuari ka të drejtë ti merr në pyetje dëshmitarët e propozuar në shqyrtim gjyqësor, i dëmtuari mund tu parashtrij pyetje edhe ekspertëve të cilët paraqiten në gjykatë për të dhënë mendimin dhe sqarimet e nevojshme lidhur me ekspertizat profesionale të cilat i kanë punuar për procedurë penale.

10. I dëmtuari si dëshmitar në procedurën penale

Në fillim të këtij punimi është theksuar fakti se i dëmtuari në procedurë penale mund të ketë disa role varësisht nga pozita e tij procedurale po njëri ndër rolet kryesore dhe më të rëndësishme të tij pa dyshim është roli i dëshmitarit në procesin penal i cili zhvillohet ndaj kryerësit të veprës penale në një rast konkret. Sipas kodit të procedurës penale si dëshmitar thirret personi për të cilin besohet se mund të jep informata për veprën penale, për kryerësin dhe për rrethanat e rëndësishme për procedurën penale,²¹ dhe këtu padyshim bënë pjesë edhe i dëmtuari pasi që ai supozohet se ka njohuri mbi veprën penale konkrete. I dëmtuari është i obliguar ligjërisht që thirrjes në cilësi të dëshmitarit ti përgjigjet qoftë kur ftohet të dëgjohet nga prokuroria ashtu edhe nga gjykata dhe se i njëjti duhet ti përgjigjet thirrjes. Varësisht prej asaj se në cilën fazë të procedurës penale

²⁰ Neni 331 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

²¹ Po aty, neni 124.

dëgjohet dhe merret deklarata e të dëmtuarit në procedurë paraprake, ose gjatë shqyrtimit gjyqësor i dëmtuari njoftohet për të drejtat dhe obligimet e tija si dëshmitar e ku përfshihen detyrimi për të thënë të vërtetën, e drejta që në deklaratimet e tij të mos e inkriminoj vetën ose të afërmit e tij familjar pra ta refuzoj të përgjigjet në këto pyetje, apo kur me deklarin e tij i ekspozohet ndonjë dëmi të konsiderueshëm material ose ndjekje penale, e drejta për këshillim me një avokat, e drejta për pushim të shkurtër në seancë gjatë marrjes në pyetje, e drejta në kompensim.²² Deklarata e të dëmtuarit në procedurë penale është kruciale sidomos ku ajo paraqitet si një fakt ose provë e vetme e cila e determinon edhe procesin penal. Gjykata në praktikë ballafaqohet shpesh me ndryshim të deklaratave nga i dëmtuari gjatë shqyrtimit gjyqësor në krahasim me deklarin të cilin e ka bërë në procedurë paraprake, gjë që e vështirëson edhe vendimmarrjen e drejtë të gjykatës pasi që nuk janë të përjashtuar mundësitë kur i dëmtuari e ndryshon deklarin e tij lidhur me veprën penale konkrete dhe kryerësin si pasojë e ndikimit nga i pandehuri ose persona tjerë dhe me këtë rast jepet edhe dëshmi e rrejshme dhe për deklarim të tillë të dëshmitarit do të duhej të vihej në veprim prokurori i shtetit.

11. Fjala përfundimtare e të dëmtuarit

Pas përfundimit të procedurës së provave, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues u jep fjalën palëve, të dëmtuarit dhe mbrojtësit për t'i përmbledhur argumentet e tyre. Së pari, fjalën e merr prokurori i shtetit, pastaj i dëmtuari, mbrojtësi dhe në fund i akuzuari.²³ I dëmtuari në fjalën e tij përfundimtare të paraqitur nga vet ai ose përfaqësuesi i tij mund ti referohet provave të administruara gjatë procedurës e ku hyjnë edhe provat e propozuar nga vet ai, pastaj ai mund ti referohet edhe dispozitave ligjore në fuqi të cilat ndërlidhen me rastin konkret dhe të cilat i ofrojnë mbrojtje atij karshi veprës penale dhe dëmit të shkaktuar, qoftë ai material apo moral, pastaj mund ti referohet tabelave, diagrameve, gjetjeve në ekspertiza, raporteve mjekësore, dhe dokumenteve tjera me të cilat provohet se i dëmtuari është dëmtuar realisht me kryerjen e veprës penale dhe mbi këtë bazë gëzon edhe të drejtën e kompensimit material-realizimit të kërkesës pasurore juridike për dëmin e pësuar nga vepra penale objekt i të cilit ka qenë. I dëmtuari në fjalën përfundimtare sidomos duhet të përqendrohet në

²² Neni 125 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

²³ Neni 352 i Kodit të Procedurës Penale.

dokumentimit e dëmit dhe vlerës së dëmit në mënyrë që gjykatës t'ia bëjë më të lehtë vendosjen për kërkesën pasurore juridike dhe aprovimin e saj, gjë që praktikë jo rrallë herë gjykata në vendimet e saja e ka të vështirë aprovimin e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale dhe detyrimin e kryerësit të veprës penale për ta kompensuar atë për shkak se nuk është në gjendje që me siguri të vendos lidhur me dëmin të cilin e ka pësuar pala e dëmtuar.

12. Roli i të dëmtuarit në fazën e mjetit juridik

I dëmtuari në procedurë penale përveç rolit aktiv në fazën e hetimit, atë të shqyrtimit gjyqësorë, ai luan një rol me rëndësi edhe në fazën tjetër në procedurën penale e cila ka të bëjë me ushtrimin e mjetit juridik sipas dispozitave të kodit të procedurës penale. E drejta e të dëmtuarit për të atakuar vendimin e gjykatës - aktgjykimit të shkallës së parë sipas kodit të procedurës penale shtrihet vetëm sa i përket aktgjykimit lidhur me sanksionet penale për veprat penale në kapitullin kundër jetës dhe trupit, kundër integriteti seksual, kundër sigurisë së trafikut publik dhe për shpenzimet e procedurës penale.²⁴ Pra, sikurse shihet kjo e drejtë është kufizuar në raport me të drejtat për ankesë të cilat i ka pasur pala e dëmtuar në kodin e mëparshëm të procedurës penale kur procedura penale është iniciuar nga ai si paditës subsidiar pasi që në ato raste ai ka pasur të drejtë të ankimoj vendimin e gjykatës për të gjitha bazat ligjore për të cilat ka pasur edhe prokurori i shteti, gjë që nuk ndodhë tani më kodin aktual të procedurës penal.

Si duket qëllim i ligdhënësit këtu ka qenë i dëmtuari ta ushtroj mjetin juridik të ankesës vetëm atëherë kur goditet direkt nga kryerja e veprës penale dhe vetëm sa i përket vendimit mbi dënimin kurse për bazat tjera ligjore të ankesës ju është lënë palëve tjera në procedurë prokurorit të shtetit dhe mbrojtjes.

Një tjetër fakt me rëndësi i cili duhet të theksohet në këtë punim është ai se i dëmtuari në procedurë penale në rastet kur ndaj kryerësit të veprës penale shqiptohet aktgjykim me urdhër ndëshkimor pa u zhvilluar shqyrtim gjyqësor, sikurse përcaktohet me kodin e procedurës penale tek pjesa e katërt-procedurat e veçanta i dëmtuari nuk e ka të drejtën e kundërshtimit, për grupin e veprave

²⁴ Neni 381 i Kodit të Procedurës Penale.

penale për të cilat në procedurë të rregullt mund të ushtroj ankesë për shkak të vendimit për sanksionin penal dhe shpenzimeve të procedurës penale.²⁵

Përfundim

Nga trajtimet të cilat i janë bërë palës së dëmtuar në këtë punim e veçanërisht rolit dhe pozitës së tij në procedurën penale në Kosovë arrihet në disa konkluzione modeste përkitazi me rolin e tij si pjesëmarrës dhe palë në procedurën penale.

1. I dëmtuari në procedurë penale paraqet personin të cilit ndonjë e drejte personale ose pasurore i është shkelur, i është dëmtuar ose i është rrezikuar me veprën penale të kryer apo e cila është tentuar që të kryhet.
2. Kodi i Procedurës Penale i Kosovës nuk e bën dallimin në mes të dëmtuarit dhe viktimës, çka në praktikë nuk janë të rralla rastet kur një gjë e tillë ngatërrohet nga palët pjesëmarrëse në procedurë andaj do të ishte e udhës që të bëhej ky diferencim edhe sa i përket pozitës së tyre në procedurën penale.
3. I dëmtuari si palë në procedurë penale mund të jetë personi fizik i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë është dëmtuar me veprën penale ose në mënyrë të tërthortë kur paraqitet si anëtar i familjes tek një kategori e veprave penale, si dhe mund të jetë personi juridik i cili ka pësuar dëm nga vepra penale e kryer ose e cila ka tentuar të kryhet.
4. Pozita dhe roli i të dëmtuarit në legjislacion procedural penal ka ndryshuar dhe evoluar herë duke e forcuar e herë duke e zvogëluar rolin e tij në procedurë mirëpo prapë së prapë roli i tij është jetik dhe i domosdoshëm për tu zbardhur çështja penale konkrete e cila përbën objektin e procedurës penale.
5. Garantimi ligjor i të drejtave për të dëmtuarin në procedurë penale në praktikë mund të mos jetë i mjaftueshëm në realizimin e tyre dhe në mbarëvajtjen e procedurës penale nëse ato nuk respektohet në radhë të parë nga organet kompetente në procedurë penale duke filluar nga policia, pastaj prokurori dhe gjykata, dhe në radhë të dytë nëse ato nuk ushtrohen si duhet nga ana e të dëmtuarit. Për tu realizuar një gjë e tillë do ishte e nevojshme që i dëmtuari në çdo rast të përfaqësohet në procedurë penale nga përfaqësues të autorizuar të cilët do të ishin në gjendje t'ia mbronin interesin juridik më së mirë palës së dëmtuar.

²⁵ Ky qëndrim i tillë është dhënë në *Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës* GJA-SU.nr.390/2014 të datës 02.10.2014.

6. Deklarimi i të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit përbën provën dhe dëshminë shumë të rëndësishme në procedurë penale e cila duhet të analizohet me kujdes të shtuar si nga prokuroria dhe gjykata për faktin se ajo në fakt paraqet „zërin e veprës penale” përmes të cilës zbardhet apo ndihmohet ndriçimi i veprës penale kur ajo është e vërtet dhe e saktë ndërsa kur ajo pra dëshmia e të dëmtuarit është e pa vërtet, ajo në fakt paraqet deklaram të rrejshëm e për të cilën duhet kujdeset sipas detyrës zyrtare prokurori i shtetit.

Bibliografia

- Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, 1 janar 2013.
- Ligji Penal i Kosovës i vitit 1974.
- Kodi i Procedurës Penal i Kosovës i vitit 2004.
- Udhëzuesi për Kodin e Procedurës Penale dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Prishtinë 2013.
- Prof.dr.Ejup Sahiti, Prof.dr.Rexhep Murati, Mr.Xhevdet Elshani, Komentari i Kodit të Procedurës Penale, Prishtinë 2014.
- Dr.Azem Hajdari, Position of The Injured Party in Kosovo Criminal Procedure, publikuar në revistën „European Journal of Business and Social Sciences”, Vol. 5, No. 10, January 2017.
- Agim Maliqi, Një Komentim i Shkurtër i Shqyrtimit Fillestar dhe Shqyrtimit të Dytë Sipas Dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, publikuar në revistën shkencore „Opinio Juris”, nr.1/2015.
- Lavdim Krasniqi: Fjala hyrëse si shkathtësi e përfaqësimit gjatë gjykimit, Revista “E drejta”, nr.2/2011, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Prishtinë, 2011.
- Bashkim Hyseni, Afrim Shala, Doracaku i gjyqtarëve për procedurën penale, Prishtinë.
- Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës GJA-SU.nr.390/2014 i datës 02.10.2014.

Rilind Sermahaj¹

Ankesa kundër aktgjykimit sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës

Abstrakt

Ankesa si nocion i përgjithshëm nënkupton shprehjen e pakënaqësisë ndaj një ndodhie apo ndaj ndonjë vendimi të ndonjë organi, qoftë gjyqësor apo administrativ ndërsa në kuptim e ngusht nënkupton shprehjen e pakënaqësisë ndaj vendimeve të organeve shtetërore e në veçanti atyre gjyqësore për shkak të arsyeve të parapara në ligj.

E drejta e ankesës në legjislacionin tonë penal rregullohet në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, i hyrë në fuqi më 1 janar 2013, më saktësisht në nenet 380-387, ku ndër të tjera rregullohet përmbajtja e ankesës, personat e autorizuar për ta paraqitur atë dhe arsyet e ushtrimit të saj po ashtu kjo e drejtë parashihet edhe në Kushtetusën e Republikës së Kosovës më saktësisht në nenin 32 të saj sipas të cilës: "*Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj*".

Fjalët kyçe: Ankesa, aktgjykimi, gjykata e shkallës së parë, gjykata e shkallës së dytë, i pandehuri.

Hyrje

Në kuadër të këtij punimi ndër të tjera do të trajtohen këto tematika: Nocioni i ankesës, përmbajtja e ankesës, personat e autorizuar për të ushtruar ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë, arsyet për ushtrimin e ankesës, procedura për paraqitjen e ankesës, kufijtë e shqyrtimit të ankesës nga Gjykata e Apelit, Reformatio in Peus, Beneficium Cohesionis, vendimet e Gjykatës së Apelit lidhur me ankesën dhe rastet kur sipas KPP-ës lejohet ankesa ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së dytë.

Punimi ka për qëllim të paraqes një studim të pavarur lidhur me rëndësinë, mënyrën e paraqitjes së ankesës, personat e autorizuar për paraqitjen e

¹ Autori i këtij punimi është gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm.

ankesës, kompetencën e gjykatës për shqyrtimin e ankesës, mënyrat e vendosjes lidhur me ankesën si dhe faktit se me ushtrimin e ankesës synohet korigjimi i gabimeve procedurale të ndodhura në gjykatën e shkallës së parë si dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut në raport me të pandehurin si dhe pjesmarrësit e tjerë në procedurë.

1. Krahasimet lidhur me ankesën në mes të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës dhe Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës numër 04/L-123

Ankesa si mjet i rregullt juridik ishte paraparë edhe në Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejme KPPPK) në nenet 398-437 mirëpo me një vështrim të thjesht nuk vërehet ndonjë ndryshim i madh sidomos sa i përket personave të autorizuar për të paraqitur ankesë, përmbajtjes së ankesës dhe arsyeve për paraqitjen e ankesës. I vetmi ndryshim qëndron në faktin se me hyrjen në fuqi të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme KPPK) me 1 janar 2013 është bërë një rregullim i ri i sistemit gjyqësor me çrast edhe procedura e ushtrimit të së drejtës së ankesës ka ndryshuar.

Kjo procedurë ka ndryshur për shkak se siç thamë më lartë rregullimit të ri gjyqësor, ku sipas KPPPK-ës, ankesa ndaj aktgjykimit të shkallës së parë i është paraqitur Gjykatës së Qarkut (si gjykatë e shkallës së dytë), të cilin funksion tanimë e ka Gjykata e Apelit të Kosovës ndërsa sa i përket përmbajtjes së ankesës, personave të autorizuar për ta paraqitur atë, afatit kohor dhe arsyeve për ushtrimin e saj ato identike dhe nuk kanë asnjë dallim me dispozitat e KPP-ës andaj edhe lirisht mund të arrijmë në përfundim se dallimi mes këtyre kodeve sa i përket ankesës qëndron vetëm në procedurën për shqyrtimin e saj dhe asgjë më tepër.

1.1 Nocioni i ankesës

Ankesa si mjet i rregullt juridik ka si qëllim evitimin e gabimeve të natyrës juridike ose faktike që kanë shoqëruar procedurën penale gjatë rrjedhës së saj. E drejta e ankesës kundër vendimeve gjyqësore është e drejtë e garantuar si me legjislacionin vendor ashtu edhe me instrumentet ndërkombëtare, të cilat garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Si instrumenti ndërkombëtar kryesor në të cilin është paraparë e drejta e ankesës është

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut², ndërsa në legjislacionin tonë kjo e drejtë është paraparë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës³ dhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, me të cilat garantohet e drejta e ankesës për çdo person ndaj të cilit zhvillohet procedura penale apo përfundohet procedura penale me vendim gjyqësor.

Duhet theksuar faktin se edhe pse kjo e drejtë parashihet në legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar përsëri kjo e drejtë është në diskrecion të palës lidhur me atë se është në vullnetin e palës se a dëshiron apo jo ta ushtrojë atë mirëpo mos ushtrimi i saj mund të prodhojë efekte të tjera juridike si për palën ashtu edhe për procedurën penale në përgjithësi ngase vendimi i cili nuk atakohet nga ana e palëve brenda afatit të caktuar e merr formën e prerë me çrast procedura penale konsiderohet e përfunduar dhe aktgjykimi bëhet i formës së prerë.

1.2 Personat e autorizuar për të paraqitur ankesë kundër aktgjykimit

Sipas nenit 381 të KPP-së, ku parashihet se cilët janë personat e autorizuar për të paraqitur ankesën dhe si të tillë janë prokurori i shtetit, i akuzuari, mbrojtësi i tij, përfaqësuesi ligjor i të akuzuarit dhe i dëmtuari⁴.

Prokurori i shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij si subjekte të procedurës penale kanë të drejtë që çdo herë kur konsiderojnë se ekziston njëra nga bazat e paraqitjes së ankesës, të ushtrojnë këtë të drejtë pa marrë parasysh llojin e aktgjykimit qoftë ai aktgjykim dënues, lirues apo refuzues ndërsa i dëmtuari në procedurën penale ka një rol pasiv ngase interesin e tij gjithmonë konsiderohet se e mbron prokurori i shtetit, si organ i pavarur me kompetencë ekskluzive për ndjekjen e kryesve të veprave penale dhe mbrojtjen e shoqërisë nga kriminalitet mirëpo duhet theksuar faktin se KPP parasheh mundësinë që i dëmtuari mund të ushtrojë ankesën kundër aktgjykimit sa i përket saknsionit penal kundër veprave penale të caktuara dhe atë kundër veprave penale kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual dhe kundër sigurisë së trafikut

² Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 13, në:

http://www.echr.coe.int/Documents/Convention_SQL.pdf <qasur për herë të fundit 25 Shkurt 2020>

³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 32

<https://gzk.rksgov.net/BroëseInstByCat.aspx?Index=1&CatID=1> <qasur për herë të fundit 25 Shkurt 2020>

⁴ Kodi i Procedurës Penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 37 / 28 dhjetor 2012, Prishtinë, neni 381.

publik po ashtu i dëmtuari mund të ushtrojë ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë edhe lidhur me shpenzime e procedurës penale.

1.3 Përmbajtja e ankesës

Pjesët kryesore dhe të domosdoshme të cilat duhet ti përmbaj çdo ankesë në mënyrë që e njehta të konsiderohet në përputhje me nenin 382 të KPP-së janë: Të dhënat mbi aktgjykimin i cili ankimohet, arsyet për kundërshtimin e aktgjykimit, propozimi për anulimin e tërësishtëm apo pjesërisht të aktgjykimit ose për ndyshimin e tij dhe nënshkrimin e ankuesit⁵.

- a. Në të dhënat mbi aktgjykimin i cili ankimohet, përfshihen numri i aktgjykimit i cili atakohet, gjykata e cila e ka shqiptuar aktgjykimin, data e shpalljes së aktgjykimit, etj., mirëpo duhet theksuar faktin se nëse në ankesë nuk janë të përfshira këto të dhëna, kjo nuk është bazë për refuzimin apo hu dhjen e ankesës si të parregullt nga ana e gjykatës së shkallës së dytë ngase këto të dhëna mund të mësohen nga burime të tjera mirëpo rëndësia e të lartcekurave, qëndron në faktin se nga to gjykata e shkallës së dytë mëson vëllimin e shqyrtimit të aktgjykimit të atakuar.
- b. Arsyet për kundërshtimin e aktgjykimit janë shumë të rëndësishme për faktin se në bazë të tyre gjykata e shkallës së dytë mëson edhe pretendimin e paraqitësit të ankesës, se sa të rëndësishme janë ato tregon fakti se gjykata e shkallës së dytë nuk ka bazë të mjaftueshme për të vendosur lidhur me ankesën nëse pretendimet se për çfarë lloje shkeljesh bëhet fjalë nuk theksohen dhe nëse për ato pretendime nuk kujdeset sipas detyrës zyrtare gjykata e shkallës së dytë.
- c. Arsyetimi i ankesës është elementi kryesor i ankesës, ngase përmes saj gjykata e shkallës dytë ka një pasqyrim më të qartë lidhur me pjesët e atakuara të aktgjykimit, kjo nisur nga fakti se parashtruesi i ankesës në arsyetim vë në dukje shkaqet e ankimit duke i përshkruar shkeljet dhe mangësitë e tjera në aktgjykim dhe në procedurën penale të zhvilluar ndaj të pandehurit.

⁵ Kodi i Procedurës Penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 37 / 28 dhjetor 2012, Prishtinë, neni 382.

- d. Propozimi se çfarë vendimi kërkon parashtruesi i ankesës është i një rëndësie të veçantë ngase i njejti mund të propozojë që gjykata e shkallës së dytë të marrë një vendim në dëm apo në favor të tij, të bëjë propozimin për kualifikimin juridik të veprës penale, të propozojë që të ndryshohet vendimi mbi sanksionin penal dhe të propozojë që gjykata e shkallës së dytë ta bëjë anulimin e plotë apo të pjesshëm apo edhe ndryshimin e aktgjykimit.
- e. Nënshkrimi i ankuesit është element i domosdoshëm i ankesës, ngase përmes saj përcaktohet edhe identiteti i parashtruesit të ankesës edhe pse e njejta nuk kërkohet që të jetë e lexueshme por vetëm që ankesa të jetë e nënshkruar në mënyrat e zakonshme ashtu që të konsiderohet se është përmbushur edhe elementi i fundit i domosdoshëm i ankesës, po ashtu edhe pse me ligj nuk kërkohet, në praktikën gjyqësore të Republikës së Kosovës ankuesi përveç nënshkrimit duhet të shënoj edhe emrin dhe mbiemrin e tij, në mënyrë që të dihet saktë identiteti i tij, për të përcaktuar nëse ai është apo jo person i autorizuar për ushtrimin e ankesës⁶.

1.4 Arsyet për ushtrimin e ankesës

Arsyet për ushtrimin e ankesës janë të parapara në nenin 383 të KPP-ës⁷ dhe si të tilla janë:

- a) Për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale;
- b) Për shkak të ligjit penal;
- c) Për shkak të vërtetimit të gabur dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe
- d) Për shkak vendimit lidhur me sanksionet penale, konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, shpenzimeve të procedurës penale, kërkesave pasurore juridike si dhe për shkak të vendimit mbi publikimin e aktgjykimit.

1.1.4 Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale

Bazë për ushtrimin e ankesës mund të jenë vetëm shkeljet esenciale të ligjit formal dhe material dhe sipas rëndësisë së tyre ato ndahen në shkelje absolute

⁶ Ejup Sahiti, Rexhep Murati & Xhevdet Elashani, Komentari i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2014, fq. 882-884.

⁷ Kodi i Procedurës Penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 37 / 28 dhjetor 2012, Prishtinë, neni 383.

dhe relative. Shkeljet absolute konsiderohen se janë më të rëndësishme ngase kur gjykata e e shkallës së dytë konsaton se kemi të bëjmë me shkelje absolute atëherë ajo aktykimin e gjykatës së shkallës së parë duhet ta ndryshojë apo duhet ta anulojë tërësisht pa u lëshuar fare në të provuarit e ndikimit të kësaj shkelje në aktgjykimin e atakuar ndërsa shkeljet esenciale sipas nenit 384 të KPP-ës janë⁸:

Përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin, ose kur në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, ose kur me vendim të formës së prerë është përjashtuar nga gjykimi⁹.

Kjo shkelje në praktikën gjyqësore ndodh kur në vend të trupit gjykues gjykon gjyqtari i vetëm gjykues apo në rastet kur prokurori i shtetit në shqyrtim gjyqësor e ndryshon aktakuzën (neni 350), duke ia ngarkuar të pandehurit një vepër më të rëndë për të cilën kompetente është gjykata në përbërje kolegjiale apo edhe e kundërta, po ashtu në praktikën tonë gjyqësore kjo shkelje ndodh edhe në rastet kur gjykimin e ka mbajtur gjyqtari të cilit i ka skaduar mandati për të cilën është emëruar si gjyqtar, kur gjyqtari nuk është emëruar në mënyrë të rregullt, kur gjykimin e ka mbajtur gjyqtari i shkarkuar, kur aktykimin e merr praktikanti, kur aktgjykimin e ka marrë gjyqtari i cili nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor etj.

Në shqyrtimin gjyqësor ka marrë pjesë gjyqtari i cili është dashur të përjashtohet.

Kjo shkelje ekziston vetëm në rastet kur janë plotësuar kushtet për përjashtimin e detyrueshëm të gjyqtarit nga neni 39, paragrafi 1 dhe 2 të KPPK-së, ndërsa gjyqtari ka vazhduar shqyrtimin gjyqësor dhe ka marrë aktgjykim për rastin e caktuar edhe pse e ka ditur se ekzistojnë arsyet për përjashtimin e tij të paraparë në nenin e lartcekur mirpo kjo shkelje mund të vie në shprehje edhe në rastet kur kryetari i gjykatës si person kompetent për të vendosur lidhur me kërkesat për përjashtimin e gjyqtarëve pa ndonjë arsye,

⁸ Kodi i Procedurës Penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 37 / 28 dhjetor 2012, Prishtinë, neni 384.

⁹ Ejup Sahiti, Rexhep Murati & Xhevdet Elashani, Komentari i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2014, fq.890.

refuzon kërkesën e palës edhe pse në rastin konkret kanë ekzistuar kushtet për përjashtimin e gjyqtarit të çështjes¹⁰.

Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur pa personat, prania e të cilëve në shqyrtim gjyqësor kërkohet me ligj ose kur të akuzuarit apo mbrojtësit të tij i është mohuar përdorimi i gjuhës së vet, apo përcjellja e zbatimit të shqyrtimit gjyqësor në gjuhën e tij.

Kusht për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor është prania e subjekteve të procedurës penale si prokurori i shtetit, i pandehuri, mbrojtësi i tij kur mbrojtja është e detyrueshme dhe i dëmtuari, për të ekzistuar kjo shkelje duhet që shqyrtimi gjyqësor të jetë mbajtur pa praninë e njërit prej këtyre subjekteve pa marrë parasysh faktin se janë thirrur apo jo në mënyrë të rregullt¹¹.

Publiku është përjashtuar nga shqyrtimit gjyqësor në kundërshtim me ligjin.

Parimi i publicitetit të gjykimeve është parim ndërkombëtar i cili është i inkorporuar edhe në nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës sipas të cilës është përcaktuar se të gjitha gjykimet janë publike përveç rasteve kur gjykata çmon se përjashtimi i publikut është në interes të rendit publik apo sigurisë kombëtare, në interes të të miturit si dhe rasteve të tjera të parapara me ligj, andaj duke marrë parasysh publicitetin e gjykimit, çdo përjashtim i publikut nga gjykimi, përveç rasteve të parapara me ligj, paraqet shkelje esenciale të dispozitave të KPPK-së¹².

Gjykata ka shkelur dispozitat e procedurës penale lidhur me çështjen, nëse ekziston akuzë e prokurorit të shtetit, propozimi i të dëmtuarit ose leja e organit publik kompetent.

Ky lloj i shkeljes përbën shkeljen e parimit akuzator në procedurën penale sipas të cilit procedura penale fillohet vetëm me vendim të prokurorit të shtetit

¹⁰ Ejup Sahiti, Rexhep Murati & Xhevdet Elashani, Komentari i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2014, fq. 891

¹¹ Po aty, fq.892, neni 384 (par.1.3) i KPP.

¹² Kodi i Procedurës Penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 37 / 28 dhjetor 2012, Prishtinë, neni 384 parag.1.4

kur ekziston dyshimi i bazuar se është kryer vepër penale dhe personi i cekur në aktakuzë është kryes i veprës penale. Kjo shkelje vjen në shprehje në tri situata procedurale: a) kur gjykata ka shkelur dispozitat e procedurës penale lidhur me çështjen nëse ekziston akuza e prokurorit të shtetit, b) nëse ekziston propozimi i të dëmtuarit për ndjekje ose c) nëse ekziston leja e organit publik kompetent¹³. Konsiderohet se gjykata ka shkelur dispozitat lidhur me ekzistimin e akuzës të prokurorit të shtetit, kur ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor pa prokurorin e shtetit ose pas tërheqjes së prokurorit të shtetit nga ndjekja penale, po ashtu për një numër relativisht të vogël të veprave penale për tu filluar ndjekja penale nga ana e prokurorit duhet edhe pëlqimi i të dëmtuarit, si në rastin e veprës penale të kanosjes nga neni 185 paragrafi 5 të KPRK-ës, ku pa pëlqimin e të dëmtuarit nuk mund të fillohet procedura penale për veprat penale nga paragrafi 1 dhe 2 i nenit të lartcekur andaj nëse fillohet procedura penale pa pëlqimin e të dëmtuarit në këto raste kemi të bëjmë me shkelje të kësaj dispozite ndërsa prokurori i shtetit nuk mund të ndërmarr ndjekjen penale ndaj të pandehurit në rastet kur me ligj është parashikuar së për ndjekjen e personave të caktuar është e nevojshme leja e organit publik kompetent.

Aktgjykimin e ka marrë gjykata e cila nuk ka pasur kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes.

Gjykata detyrohet të kontrollojë kompetencën e vet lëndore dhe territoriale dhe posa të konstatojë se nuk ka kompetencë, shpallet jo kompetente dhe pasi aktvendimi merr formën e prerë ia dërgon lëndën gjykatës kompetente për vendosje. Pasi aktakuza të marrë formë të prerë gjykata nuk mund të shpallet jo kompetente në pikëpamje territoriale dhe palët nuk mund të paraqesin kundërshtim për shkak të mos kompetencës territoriale. Kjo shkelje vjen në shprehje kur aktgjykimin e ka marrë gjykata e cila nuk ka pasur kompetencë, në këtë rast bëhet fjalë vetëm për shkelje të dispozitave lidhur me kompetencën lëndore, por jo edhe për kompetencën territoriale e cila nuk mund të shqyrtohet pasi që aktakuza të marrë formën e prerë. Kodi i Procedurës Penale nuk ka paraparë ndonjë zgjidhje në rastet kur gjykata gjatë marrjes së aktgjykimit konstaton se nuk ka kompetencë lëndore për të vendosur, ngase mos

¹³ Ejup Sahiti, Rexhep Murati & Xhevdet Elashani, Komentari i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2014, fq. 895.

kompetencën lëndore nuk e ka paraparë as si shkak të refuzimit të akuzës me aktgjykim e as si shkak për hedhje të aktakuzës me aktvendim të trupit gjykues¹⁴.

Gjykata me aktgjykim nuk e ka gjykuar plotësisht lëndën e akuzës.

Me rastin e zgjidhjes së çështjes penale gjykata duhet që lëndën ta zgjidh në tërësi, duke mos lënë asnjë element të aktakuzës pa zgjidhur çka do të thotë se gjykata në aktgjykim duhet të zgjidhë çështjen penale në tërësi dhe të përshijë të gjitha veprat penale dhe të pandehurit për të cilët është ngritur aktakuza, andaj nga të lartcekurat mund të konsiderojmë se kjo shkelje ekziston kur gjykata nuk vendos në tërësi për njëri nga veprat penale të përfshira në aktakuzë, apo për ndonjërin nga të pandehurit ndaj të cilëve është ngritur aktakuzë e përbashkët¹⁵.

Aktgjykimi bazohet në provë të papranueshme.

Kur gjykata merr aktgjykim të cilin e bazon në prova të marra në kundërshtim me dispozitat e KPPK-së (neni 257, par. 2), atëherë kemi të bëjmë me shkelje absolute të dispozitave të KPPK-së, pasi prova e pa pranueshme ka pasur rol vendimtar apo jo në marrjen e aktgjykimit, nuk është i rëndësishme për gjykatën e shkallës së dytë, pasi që mjafton vetëm që aktgjykimi të jetë bazuar në prova të papranueshme, pa marrë parasysh rolin e tyre në zgjidhjen çështjes penale¹⁶.

I akuzuari i thirrur të deklarohet mbi fajësinë, nuk e ka pranuar fajësinë për tërë akuzën ose ndonjë pikë të saj dhe është marrë në pyetje para prezantimit të provave.

Deklarimi mbi fajësinë nga ana e të akuzuarit është shumë e rëndësishme për rrjedhën e procedurës penale, pasi kur i pandehuri pranon fajësinë, pason

¹⁴ Kodi i Procedurës Penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 37 / 28 dhjetor 2012, Prishtinë, neni 384 parag.1.6.

¹⁵ Ejup Sahiti, Rexhep Murati & Xhevdet Elashani, Komentari i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2014, fq. 896.

¹⁶ Kodi i Procedurës Penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 37 / 28 dhjetor 2012, Prishtinë, neni 384 parag.1.8

marrja e aktgjykimit dhe shqiptimi i dënimit, por nëse i pandehuri nuk e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës së prokurorisë dhe përkundër kësaj merret në pyetje para prezantimit të provave, do të konsiderohet se gjykata ka bërë shkelje absolute të dispozitave të KPP-ës¹⁷.

Aktgjykimi ka tejkalluar akuzën.

Identiteti objektiv dhe subjektiv ndërmjet aktgjykimit dhe aktakuzës, duhet të ekzistojë në të gjitha rastet në të kundërtën kemi tejkallim të akuzës në kuptimin objektiv dhe subjektiv. Tejkallimi i akuzës në kuptim objektiv nënkupton rastet kur në aktgjykim përfshihet edhe ndonjë vepër tjetër penale e cila nuk ka qenë objekt i aktakuzës ndërkaq. Ndërsa në kuptim subjektiv nënkupton kur me aktgjykim është përfshirë edhe ndonjë person i cili nuk ka qenë i përfshirë me aktakuzë ose i cili fare nuk ka qenë i akuzuar andaj aktgjykimi duhet t'i referohet vetëm personit të akuzuar dhe vetëm veprës që është objekt i akuzës, në të kundërtën kemi shkelje absolute të dispozitave të KPPK-së, për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare¹⁸.

Me aktgjykim është shkelur dispozita e nenit 395 të KPP-së.

Instituti *reformatio in peius* nënkupton ndalimin e keqësimit të pozitës së të pandehurit në procedurë penale, në rastet kur është paraqitur ankesë vetëm në dobi të akuzuarit, po ashtu, aktgjykimi për sa i përket vlerësimit juridik të veprës penale dhe sanksionit penal nuk mund të ndryshohet në dëm të akuzuarit andaj në të gjitha rastet kur kemi të bëjmë me shkelje të këtij instituti nga ana e gjykatës, kemi të bëjmë me shkelje të dispozitave të KPP-së më saktësisht nenin 395 të KPP-ës. Vlen të theksohet se edhe kjo shkelje është shkelje për të cilën gjykata e shkallës së dytë kujdeset detyrës zyrtare¹⁹.

¹⁷ Kodi i Procedurës Penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 37 / 28 dhjetor 2012, Prishtinë, neni 384 parag.1.9

¹⁸ Kodi i Procedurës Penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 37 / 28 dhjetor 2012, Prishtinë, neni 384 parag. 1.10

¹⁹ Ejup Sahiti, Rexhep Murati & Xhevdet Elashani, Komentari i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2014, fq. 901

Aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370.

Aktgjykimi si rregull duhet të përmbajë hyrjen, dispozitivin dhe arsyetimin dhe në të gjitha rastet kur dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij, ose me arsyet e dhënies së aktgjykimit, kur aktgjykimi nuk përfshinë arsyetimin, ose në të nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare, kur arsyet janë plotësisht të paqarta ose kundërthënëse në masë të konsiderueshme, kur për faktet vendimtare ka kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit, lidhur me përmbajtjen e shkresave ose të procesverbaleve për deklaratimet e dhëna në procedurë, vetë këtyre shkresave dhe procesverbaleve konsiderohet se ekziston kjo shkelje. Po ashtu kjo shkelje ekziston edhe në rastet kur aktgjykimi nuk është përpiluar në përputhje me përmbajtjen dhe formën e përcaktuar në nenin 370 KPP-së²⁰.

Shkeljet e ligjit penal

Shkeljet e ligjit penal kanë të bëjnë me moszbatimin ose zbatimin e gabuar të ndonjë dispozite të KPK-ës, kjo shkelje referon në çështje që kanë të bëjnë me ekzistimin apo mosekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe sanksionin penal²¹.

Shkeljet e ligjit penal konform dispozitave të KPP ekzistojnë në këto raste:

1. Vepra penale për të cilën i akuzuari ndiqet nuk përbën vepër penale,
2. Ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale të kryesit, (shkaqet për përjashtimin e përgjegjësisë penale janë: mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme, dhuna dhe kanosja, veprat e rëndësisë së vogël dhe urdhërat nga lart).
3. Ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë ndekjen penale sidomos nëse vepra penale është përfshirë në amnisti apo falje ose për çështjen e tillë është gjykuar me aktgjykimit të formës së prerë (ne bis in idem),

²⁰ Kodi i Procedurës Penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 37 / 28 dhjetor 2012, Prishtinë, neni 384 parag. 1.12.

²¹ Kodi i Procedurës Penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 37 / 28 dhjetor 2012, Prishtinë, Neni 385 parag. 1

lidhur me veprën e gjykuar është zbatuar ligji i cili nuk mund të zbatohet (p.sh në vend të Kodit Penal është zbatuar Kodi i Përkohshëm Penal etj).

4. Në marrjen e vendimit për dënimin, dënimin alternativ, vërejtjen gjyqësore, në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm apo për konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me veprë penale gjykata ka tejkaluar kompetencën ligjore kjo ndodh në rastet kur p.sh gjykata shqipton ndonjë sanksion penal i cili nuk është parapar në KPK, kur gjykata shqipton sanksion penal që nuk mund të shqiptohet për veprën penale konkrete etj²².

Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike

Si bazë për paraqitjen e ankesës si dhe shkelje e dispozitave të KPP-ës paraqitet edhe vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike që ekziston në rastet kur gjykata ka vërtetuar gabimisht ndonjë fakt të rëndësishëm, apo kur përmbajtja e dokumentit, procesverbalit mbi provat e shqyrtuara apo të incizimit teknik, vënë në pikëpyetje saktësisht ose bazueshmërinë e vërtetimit të fakteve të rëndësishme, të cilat fakte do të mund të ndikonin në llojin dhe lartësinë e dënimit të shqiptuar ndaj kryesit të veprës penale. Po ashtu është e kuptueshme që mos vërtetimi i plotë i gjendjes faktike paraqet shkelje të dispozitave të KPPK-ës, saktësisht nenit 7, që është detyrim i gjykatës që të bëjë vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve të paraqitura në shqyrtim gjyqësor²³.

Vendimi lidhur me sanksionet penale, konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, shpenzimeve të procedurës penale, kërkesave pasurore juridike si dhe për shkak të vendimit mbi publikimin e aktgjykimit.

Aktgjykimi mund të atakohet edhe për shkak të vendimit mbi shqiptimin e dënimit ose vërejtjes gjyqësore, kur gjykata duke marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese nuk ka caktuar drejtë dënimin, ose vërejtjen gjyqësore apo edhe kur gjykata nuk ka zbatuar drejtë apo nuk ka zbatuar fare dispozitat për ashpërsimin apo zbutjen e dënimit. Ndaj vendimit të shqiptimit të masës së trajtimit të detyrueshëm rehabilitues të personave të varur nga

²² Fejzulla Hasani dhe të tjerë, Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Prishtinë 2015, fq. 310.

²³ Fejzulla Hasani dhe të tjerë, Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Prishtinë 2015, fq. 311.

droga apo alkooli, ose për konfiskimin e sendeve të fituar me vepër penale, palët mund të ushtrojnë ankesë kur konsiderojnë se gjykata ka vendosur jo drejtë, ose nuk ka shqiptuar masën e trajtimit edhe pse kanë ekzistuar kushtet ligjore. Po ashtu palët mund të ushtrojnë ankesë edhe kundër vendimit mbi shpenzimet procedurale kur konsiderojnë se gjykata ka vendosur jo drejtë apo në kundërshtim me dispozitat e KPPK-së për shpenzimet e tilla, ndërsa ndaj vendimit për kërkesën pasurore juridike dhe publikimin e aktgjykimit palët mund të ushtrojnë ankesë vetëm kur konsiderojnë se gjykata për to ka vendosur në kundërshtim me dispozitat ligjore²⁴.

2. Procedura lidhur me ankesën në gjykatën e shkallës së parë

Ankesa kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë paraqitet nga subjekti i autorizuar për paraqitjen e ankesës, për të cilët kemi folur më lartë në këtë punim. Ankesa si rregull paraqitet brenda afatit ligjor prej 15 ditëve, përjashtimisht tek procedura e të miturve ku afati ligjor për paraqitjen e ankesës është 8 ditë dhe paraqitet në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët²⁵.

Në gjykatën e shkallës së parë ankesën e pranon gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues, i cili e ka dhënë aktgjykimin dhe nëse ankesa nuk i ka përmbushur kushtet e caktuar me nenin 400 të KPP-së, ai merr aktvendim me të cilin e hedh ankesën si të palejueshme (kundër këtij aktvendimi palës i lejohet ankesë në gjykatën e shkallës së dytë), ndërsa kur ankesa i plotëson kushtet e parapara ligjore atëherë ajo në afat prej 8 ditësh i dërgohet palës kundërshtare, në mënyrë që e njejta të paraqet përgjigje në ankesë. Pas kalimit të këtij afati gjykata ankesën së bashku me shkresat e tjera të lëndës ia dërgon gjykatës së shkallës së dytë për vendosje²⁶.

2.1 Procedura lidhur me ankesën në gjykatën e shkallës së dytë

Kur ankesa së bashku me shkresat e tjera të lëndës arrinë në gjykatën e shkallës së dytë, ato i dorëzohen kryetarit të kolegjit, i cili shikon nëse ankesa është e

²⁴ Ejup Sahiti, Rexhep Murati & Xhevdet Elashani, Komentari i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2014, fq. 393.

²⁵ Azem Hajdari, Komentari i Kodit të procedurës penale, Prishtinë 2016, fq. 943.

²⁶ Kodi i Procedurës Penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 37 / 28 dhjetor 2012, Prishtinë, neni 389.

afatshme dhe e lejuar dhe me pas vepron në pajtim me nenin 399 dhe 400 të KPP-së. Kur ankesa është e pranueshme kryetari i kolegjit cakton seancën. Më pas para se të procedojë me çështjen në kuptim e vendimmarrjes, shkresat e lëndës ia dërgon prokurorit të shtetit në mënyrë të mund të paraqes propozimet e tij lidhur me ankesën, Pas ndërmarrjes së këtyre veprimeve procedurale caktohet seanca e kolegjit dhe shqyrtohet ankesa, mirëpo duke u kufizuar vetëm në pjesën e atakuar të aktgjykimit, si dhe duke u kujdesur për shkeljet për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare²⁷.

2.2 Vendimet e gjykatës së shkallës së dytë lidhur me ankesën e paraqitur

Duke u bazuar në dispozitat e KPPK-së gjykata e shkallës së dytë lidhur me ankesën mund të marr këto vendime²⁸:

1. e hedh ankesën si të paafatshme ose të palejuar;
2. e refuzon ankesën si të pabazë dhe e vërteton aktgjykimin e gjykatës themelore;
3. e anulon aktgjykimin dhe çështjen ia kthen gjykatës themelore për rigjykim dhe vendim; ose
4. e ndryshon aktgjykimin e gjykatës themelore.

Hedhja e ankesës si e paafatshme vjen në shprehje kur gjykata e shkallës së dytë vërteton se ankesa është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor ndërsa hedhja e ankesës si e palejuar në rastet kur kjo gjykatë konstaton se ankesa është paraqitur nga personi pa të drejtë ankese, nga personi i cili ka hequr dorë nga ankesa, kur ankesa është tërhequr, apo ankesa nuk është e lejuar me ligj. Lidhur me refuzimin e ankesës si të pabazë dhe vërtetimin e gjykatës së shkallës së parë, gjykata e shkallës së dytë vendos kështu, kur vërteton se nuk ekzistojnë shkaqet për të cilat është ushtruar ankesa ndaj aktgjykimit dhe nuk ka shkelje të ligjit sipas nenit 394 i KPPK-ës.

Gjykata e shkallës së dytë në të gjitha rastet kur vërteton se ekzistojnë shkelje të dispozitave të KPPK-ës dhe gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike, apo nuk ka vërtetuar në mënyrë të plotë, me aktvendim e

²⁷ Azem Hajdari, Komentari i Kodit të procedurës penale, Prishtinë 2016, fq. 945-947.

²⁸ Kodi i Procedurës Penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 37 / 28 dhjetor 2012, Prishtinë, neni 398.

anulon aktgjykimin e atakuar dhe e kthen në rigjykim. Ndryshimi i aktgjykimit të atakuar nga ana e gjykatës së shkallës së dytë ndodhë në dy mënyra: a) duke zbatuar shqyrtimin për të marrë prova të reja, apo për të përsëritur shqyrtimin e provave në mënyrë që të vlerësojë drejtë dhe të çmojë provat materiale, dhe b) në seancë të kolegjit kur mund të vërtetojë dhe të çmojë provat materiale pa mbajtur shqyrtim, nëse nuk ka nevojë për të marrë prova të reja apo për të përsëritur shqyrtimin e provave.

Lidhur me mënyrën e vendosjes duhet theksuar se gjykata e shkallës së dytë vendos me aktgjykim dhe aktvendim. Me aktgjykim vendos kur e refuzon ankesën si të pabazë dhe vërteton aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, me ç rast konstaton se nuk qëndrojnë pretendimet e paraqitura në ankesë dhe nuk ekzistojnë të meta sipas të cilave gjykata e shkallës së dytë vepron ex officio ²⁹. Ndërsa me aktvendim vendos në rastet kur ankesa është a paafatshme, kur ankesa është paraqitur nga personi i paautorizuar, kur ankesa është paraqitur nga personi i cili njëherë ka hequr dorë nga ankesa dhe kur ankesa nuk është e lejuar me ligj. Po ashtu gjykata vendos me aktvendim edhe në rastet kur e aprovon ankesën dhe e prish aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe lëndën e kthen në rigjykim.

2.3 Beneficium cohaesionis dhe reformatio in peus

Këto dy institute janë shumë të rëndësishme sa i përket të akuzuarit sepse që të dy këto institute shkojnë vetëm në dobi të të akuzuarit.

Beneficium cohaesionis është institut sipas të cilit gjykata është e obliguar që përshtatshmëritë të cilat i ka konstatuar se ekzistojnë për të pandehurin i cili ka paraqitur ankesë, ti zbatojë edhe ndaj të pandehurve të tjerë, të cilët nuk kanë paraqitur ankesë, p.sh Nëse katër persona janë të akuzuar se kanë kryer veprën penale të vjedhjes së rëndë në bashkëkryerje, mirëpo pas shpalljes së aktgjykimit vetëm njëri prej tyre paraqet ankesë ndaj aktgjykimit dhe gjatë shqyrtimit të ankesës gjykata e shkallës së dytë gjen shkelje në aktgjykim të cilat shkojnë në favor të të pandehurit i cili ka paraqit ankesë, atëherë këto

²⁹ Ejup Sahiti & Rexhep Murati. E drejta e procedurës penale, Prishtinë 2013, fq.399.

gjetje të cilat janë konstatuar nga ana e gjykatës shkojnë në favor edhe të të pandehurve të tjerë të cilët nuk kanë paraqitur ankesë.

Ndërsa reformatio in peus është institut sipas të cilit nuk lejohet keqësimi i pozitës së të pandehurit në procedurë, çka do të thotë se gjykata e shkallës së dytë nuk mund ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar në dëm të të pandehurit, pra kjo ndalesë vie në shprehje vetëm në rastet kur ankesa është paraqitur vetëm në dobi të të pandehurit po ashtu vlen të thekson se ndryshimi i aktgjykimit nuk mund të ndodhë sa i përket cilësimit juridik të veprës penale dhe sanksionit penal të shqiptuar.

3. Ankesa kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë

Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës lejon trishkallshmërinë dhe kjo vihet më së miri në shprehje në rastet kur lejohet ankesa ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së dytë. Kemi të bëjmë me vetëm dy raste kur lejohet ushtrimi i ankesës edhe ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së dytë dhe ato janë:

1. Kur gjykata e shkallës së dytë ndryshon aktgjykimin lirues të gjykatës së shkallës së parë dhe atë e zëvendëson me aktgjykim dënues, dhe;
2. Kur me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë apo shkallës së dytë të akuzuarit i është shqiptuar dënim me burgim të përjetshëm.

Lidhur me ankesën e paraqitur ndaj aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë vendos Gjykata Supreme e Kosovës, e cila ka kompetencë që të shqyrtojë atë dhe të vendos për të me ç'rast vie në shprehje edhe trishkallshmëria.

Përfundim

Pas shtjellimit dhe analizimit të të lartcekurave sa i përket ankesës mund të vihet në përfundim se me këtë punim kemi arritur deri tek këto përfundime:

1. Ankesa është mjet juridik, sipas të cilit çdo palë e cila konsideron se me anë të ndonjë vendimi i është shkelur ndonjë e drejtë të paraparë me KPPK-ës, Kushtetutë apo akte të tjera ndërkombëtare.
2. Ankesa ka për qëllim eliminimin e të gjitha të metave të ndonjë vendimi të dhënë nga gjykata e shkallës së parë, për të cilat kujdeset gjykata e shkallës së dytë, qoftë sipas detyrës zyrtare apo sipas pretendimeve të palëve.
3. Ankesa është mjet juridik i cili garantohej edhe me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe konventa tjera ndërkombëtare, të cilat sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës janë të zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë dhe se të njejtat kanë një përparësi ndaj legjislacionit vendor.
4. Sipas KEDNj ankesa duhet të lejohet ndaj çdo vendimi përfundimtar, në mënyrë që të minimizohet shkelja e të drejtave të njeriut në masë sa më të madhe.
5. Për ushtrimin e të drejtës së ankesës në sistemin tonë gjyqësor, ajo duhet të përmbajë elementet formale të parapara në KPPK, në mënyrë që e njejtja të jetë e pranuar nga Gjykata e Apelit.

Bibliografia

- Afrim Shala, Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës, në Gjilan, 2010;
- Azem Hajdari, Komentari i Kodit të Procedurës Penale, në Prishtinë, 2016;
- Ejup Sahiti & Rexhep Murati. E drejta e procedurës penale, në Prishtinë, 2013;
- Ejup Sahiti, Rexhep Murati & Xhevdet Elshani, Komentari i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, në Prishtinë, 2014;
- Fejzulla Hasani, Doracaku mbi përgatitjen e provimit të jurispruencës, Prishtinë 2015;
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, i hyrë në fuqi me 1 janar 2013;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Ma.sc. Rrahman Beqiri¹

Veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës

Abstrakt

Veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës janë parashikuar në një kapitull të veçantë të pjesës së posaçme të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Nga vetë titulli nënkuptohet se shkelja e këtyre të drejtave paraqesin cenim të drejtave individuale e të cilat rrjedhin nga marrëdhënia e punës në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit. Këto të drejta i takojnë grupit të drejtave sociale dhe ekonomike të njeriut, të cilat mbrohen qoftë me drejtën ndërkombëtare e po ashtu edhe me drejtën vendore.

Këtij grupi të veprave penale, në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, i është kushtuar rëndësi më e madhe, marr parasysh se për dallim nga Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, është rritur numri i veprave penale nga ky kapitull dhe me këtë është zgjeruar numri i drejtave nga marrëdhënia e punës të cilat mbrohen me drejtën penale. Kjo tregon se legjislacioni jonë penal i kushton rëndësi të veçantë të drejtave nga marrëdhënia e punës, marr parasysh edhe faktin se janë të shumta shkeljet që bëhen në çështje që drejtpërdrejtë apo tërthorazi lidhen me marrëdhënien e punës.

Është e pakontestueshme se shumica e drejtave të kësaj natyre realizohen përmes drejtës civile, ngase janë marrëdhënie kontraktuese mes palëve, mirëpo me drejtën penale mbrohen vetëm ato të drejta esenciale nga marrëdhënia e punës, e të cilat nuk mund të mbrohen me norma tjera. Për shkak të natyrës së tyre, veprat penale nga ky kapitull, kryhen nga motivet ekonomike dhe në të shumtën e rasteve të lidhura me procesin e punësimit si dhe sigurimit social.

Fjalët kyçe: marrëdhënia e punës, punëmarrës, punëdhënësi, cenim, sigurim social,

¹ Autori i këtij punimi është gjyqtar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm.

Hyrje

Të drejtat nga marrëdhënia e punës janë të shumta dhe të llojllojshme dhe si të tilla, ato rregullohen me një numër të madh të dispozitave ligjore dhe akte tjera nënligjore, në mënyrë të hollësishme.

Përveç që rregullohen me norma ndërkombëtare, të drejtat nga marrëdhënia e punës rregullohen edhe legjislacionin intern. Kështu, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e garanton të drejtën e punës.² Si ligje kryesore ku rregullohen të drejtat nga marrëdhënia e punës në vendi tonë janë: Ligji i Punës³ dhe Ligji për Shërbimin Civil të Kosovës⁴. Mirëpo, këto nuk janë ligjet e vetme që e rregullojnë këtë fushë sepse ekzistojnë edhe ligje tjera që rregullojnë marrëdhënien e punës në fusha specifike, si p.sh Ligji për policinë, i cili rregullon aspekte specifike të marrëdhënies së punës në polici, por edhe akte tjera nënligjore.

Meqenëse numri i këtyre të drejtave nga marrëdhënia e punës janë shumta, është pamundshme, por edhe e panevojshme, që secilës nga këto të drejta t'i sigurohet mbrojtje penalo-juridike. Kështu që, me dispozitat e këtij kapitulli mbrohen vetëm ato të drejta që konsiderohen shumë të rëndësishme, e pa mbrojtje penale nuk mund të realizohen si të tilla.

Veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës janë parashikuar në Kapitullin e XIX-të të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK)⁵. Në këtë kapitull janë parashikuar gjithsej shtatë vepra penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës. Shikuar nga aspekti historik, edhe në Kodin e Përkohshëm Penal (tutje: KPP)⁶, ka ekzistuar një Kapitull i veçantë i këtyre veprave penale. Megjithatë, dallimi ekziston se në KPRK, janë paraparë edhe disa vepra të reja penale të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në legjislacionin e mëparshëm penal.

Me veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës inkriminohen një tërësi veprimesh apo mosveprimesh nëpërmjet të cilave, në radhë të parë,

² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi 15.06.2008, neni 49.

³ Ligji Nr. 03/L-212 i Punës, Gazeta Zyrtare, Vitit V, Nr. 90 datë 01.12.2010.

⁴ Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, Gazeta Zyrtare, Nr. 72/2010, datë 25.06.2010.

⁵ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr.04/L-82, i datës 20.04.2012, ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

⁶ Kodi Përkohshëm Penal i Kosovës, Rregullorja e UNMIK-ut nr.2003/25, i datës 06.07.2003.

cenohet ligjshmëria e procesit të punësimit por edhe realizimi i plotë i të drejtave nga marrëdhënia e punës, përfshirë edhe të drejtat nga sigurimin social. Këto vepra penale janë në funksion të mbrojtjes së drejtave të punëtorëve nga marrëdhënia e punës, të drejta këto esenciale të individit përmes të cilave individ e siguron ekzistencën e tij.

Është për tu cekur fakti se përmes këtij grupi të veprave penale, përveç që mbrohen të drejtat nga marrëdhënia e punës, në disa raste të caktuara mbrohet edhe keqpërdorimi i këtyre të drejtave si. p.sh: me nenin 222 mbrohet keqpërdorimi i drejtës në grevë, ndërsa me nenin 224 mbrohet keqpërdorimi i drejtave nga sigurimi social. Përmes këtyre veprave, ligjdhënësi ka dashur që garancionet që ofrohen për drejtën në grevë dhe të drejtën në sigurimin social, të mos shfrytëzohen deri në atë masë sa të keqpërdoren.

Karakteristikë e përbashkët e veprave penale të këtij Kapitulli është se shumica e tyre kanë karakter blanket, sepse për të ekzistuar këto vepra penale duhet që veprimet e kryerjes të jenë në kundërshtim me ligjin, kontratën kolektive apo aktin e brendshëm të punëdhënësit. Gjithashtu, këto dispozita nuk bëjnë ndonjë dallim sa i përket të punësuarve në sektorin publik apo sektorin privat, e që rrjedhimisht këto vepra mund të kryen si sektorin publik ashtu edhe në atë privat.

Për veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës, sipas nenit 21 paragrafi 3 të Kodit të Procedurës Penale (tutje: KPPRK)⁷, kompetent për gjykimin e tyre në shkallë të parë është Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore.

Edhe pse në dispozitat e këtij Kapitulli thuhet se këto vepra penale mund t'i kryejë çdo person, ngase përdoret shprehja "kushdo", nga figura e këtyre veprave rezulton se shumicën e këtyre veprave mund t'i kryejnë vetëm ata persona të cilëve u është besuar ushtrimi i atyre llojeve të detyrave, që u mundëson të vendosin për ndonjë të drejtë të punëtorit nga marrëdhënia e punës⁸. Veprat penale të këtij kapitulli kryhen vetëm me dashje dhe atë eventuale, ndërsa sa i përket motivit ai mund të dallojë nga njëra vepër tek tjetra.

⁷ Kodi i Procedurës Penale, Nr.04/L-123, i datës 13.12.2012, ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

⁸ Salihu Ismet, E drejta penale – Pjesa e posaçme, Botimi i II, Prishtinë, 2014, fq. 262.

Pasojë e këtyre veprave nga ky Kapitull është mohimi apo kufizimi i të drejtave të punëtorëve, ndërsa që për tu konsideruar se është kryer vepra duhet të shkaktohet edhe pasoja e jo vetëm të cenohet ndonjë dispozitë ligjore.⁹ Gjithsesi, gjithnjë duhet pasur parasysh që këto drejta mbrohen edhe në rrugë administrative dhe duhet të kihet parasysh se dallimi ndërmjet shkeljes administrative dhe asaj penale është shumë i ngushtë dhe se në çdo rast duhet të analizohen në detaj të gjitha të dhënat, dhe vetëm atëherë kur shkelja është me dashje dhe është shkaktuar pasoja, atëherë ka vend për vepër penale.

1. Cenimi i të drejtave në marrëdhëniet e punës¹⁰

Puna është një veprimtari jetike e individëve të aftë për punë. Ajo është burim i të ardhurave që ata sigurojnë mjetet e jetesës. Gjithashtu, puna është edhe veprimtari sociale për individët në moshë për të punuar. Secili që ka një punë kërkon të jetë i mbrojtur gjatë kohës që shpenzon për kryerjen e saj, si dhe për energjitë e harxhuara në disa drejtime kryesore.¹¹ Meqenëse puna është veprimtari e domosdoshme jetësore, shtrohet nevoja që secili shtet, çështjen e marrëdhënies së punës ta rregulloj me dispozita ligjore konkrete.

Siç u tha më lartë, në vendin tonë, e drejta e punës është e garantuar me nenin 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ndërsa me dispozitat e Ligjit të punës janë rregulluar hollësisht të gjitha çështje që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës në Kosovë, përfshirë themelimin e marrëdhënies së punës, ndërprerjen, pagat dhe shpërblimin, pushimin, mungesën nga puna dhe çështje e tjera të kësaj natyre. Ndërsa, përmes Ligjit për Shërbimin Civil janë rregulluar këto çështje në sektorin publik, respektivisht në Shërbimin Civil të Kosovës. Prandaj, duke u bazuar në këto dispozita ligjore, realizimin i disa nga këto të drejta nga marrëdhënia e punës është i garantuar edhe me dispozitat e legjislationit penal.

Sa i përket kuptimit, marrëdhënia e punës nënkupton një marrëveshje ose rregullim kontraktual ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit për kryerjen e

⁹ Salihu Ismet, Zhitija Hilmi & Hasani Fejzullah, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Komentar, Botimi I, Prishtinë, 2014, fq. 591

¹⁰ Neni 218 i KPRK-së.

¹¹ Ledio Milkani, Manual për të punësuarit dhe sindikatat, Tiranë, 2016, fq. 11.

detyrave të caktuara, nga ana e të punësuarit, nën mbikëqyrjen e punëdhënësit, kundrejt një pagese të dakorduar, zakonisht në formë të parave.¹²

Përmes kryerjes së veprës penale, Cenimi i të drejtave në marrëdhëniet e punës, cenohen të drejtat e punëtorit. Qëllimi kryesor i kësaj norme penale është që të mbrohen të drejta e punëtorit nga marrëdhënia e punës në formën dhe vëllimin e përcaktuar me ligjin përkatës. Se cilat janë këto të drejta nga marrëdhënia e punës që mbrohen përmes kësaj norme, kryekëput varet nga dispozita e ligjit përkatës, por edhe dispozitat e akteve tjera juridike nënligjore. Sipas nenit 218 të KPRK, këtë vepër penale e kryen kushdo që me vetëdije nuk e zbaton ligjin apo kontratën kolektive për punësimin apo ndërprerjen e marrëdhënies së punës; pagat apo të ardhurat e tjera; kohëzgjatjen e orarit të punës; punën jashtë orarit apo punën me ndërtime; pushimin apo mungesën nga puna; ose mbrojtjen e grave, fëmijëve apo personave me aftësi të kufizuara dhe kësisoj punëtorit ia mohon apo ia kufizon të drejtat që i takojnë, në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës nga marrëdhënia e punës.

Nga ky përkufizim shihet qartë se kjo normë penale është e karakterit blanket, për faktin se, që fillim të dispozitës udhëzon në dispozitë të një ligji të caktuar, akti nënligjor apo edhe kontratë kolektive, të cilat janë të rregulluar me dispozita konkrete ligjore, qoftë me ligjin e punës, kontratën kolektive, apo edhe akte tjera nënligjore siç janë urdhëresat administrative apo rregulloret e brendshme të punëdhënësve.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston kur kryesi ndërmerr veprime të atilla të kundërligjshme, apo nuk ndërmerr fare veprimet që ka qenë i obliguar t'i ndërmarr, duke ia mohuar apo kufizuar punëtorit ndonjë të drejtë apo edhe disa të drejta të cilat iu kanë garantuar me ligj apo akt tjetër juridik.¹³ Si veprim i kryerjes do të ishte shkelja e ndonjë dispozite ligjore me të cilën përcaktohet ndonjë e drejtë e punëtorit, p.sh. marrja e vendimit për kufizimin e pushimit vjetor, apo edhe marrja e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës gruas-punëtores derisa ajo është shtatzënë. Ndërsa situata kur kryesi këtë vepër e kryen me mosveprim është rasti kur kryesi nuk i ndërmerr veprimet që ka qenë i obliguar t'i ndërmarr e që për pasojë punëtorit i është kufizuar ose mohuar ndonjë e drejtë, p.sh. kryesi nuk e merr vendimin për njohjen dhe pagesën e përvojës së punës.

¹² Neni 3, Ligji i Punës, Nr. 03/L-212, Gazeta Zyrtare, Vitit V, Nr. 90, datë 01.12.2010.

¹³ Salihu Ismet, Zhitija Hilmi & Hasani Fejzullah, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Komentar, Botimi I, Prishtinë, 2014, fq. 592

Objekt mbrojtës i kësaj vepre penale janë të drejtat e punëtorit nga marrëdhënia e punës, që janë: të drejtat lidhur me themelimin dhe kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës; të drejtat lidhur me pagën dhe përfitimet; orarin e punës; pushimin dhe mungesën nga puna; dhe, të drejtat që i referohen mbrojtjes së grave, fëmijëve apo personave me aftësi të kufizuar.¹⁴

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje, në të kundërtën nëse mungon dashja e kryerësit atëherë kemi shkelje administrative dhe për to kryesi mund të përgjigjet në procedurë disiplinore.

Sa i përket kryerësit, pavarësisht formulimit që është dhënë "kushdo", këtë vepër penale nuk mund ta kryejë çdo person, por vetëm ata persona të cilët sipas ligjit kanë përgjegjësi dhe detyrë që të kujdesen për të drejtat e punëtorëve dhe të cilët ligjërisht janë përgjegjës për të udhëhequr me punëtorët, e për rrjedhojë edhe për të vendosur lidhur me të drejtat e punëtorëve nga marrëdhënia e punës.

Është për tu theksuar fakti se kjo normë penale nuk e bënë ndonjë dallim në mes të të punësuarve në sektorin publik dhe atyre privat, çka nënkupton se kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë qoftë nga sektori privat apo nga ai publik, pa asnjë dallim.

Megjithëse, kjo normë nuk përcakton nëse kjo vepër penale mund të kryhet vetëm ndaj personave që ligjërisht kanë themeluar marrëdhënie pune, konsideroj që kjo vepër mund të kryhet edhe ndaj çdo personi i cili është i angazhuar që të kryej punë kundrejt një shpërblimi, edhe nëse nuk ka kontratë formale të punës.

Pasojë e kësaj vepre penale është mohimi apo kufizimi i ndonjë të drejte nga marrëdhënia e punës së të punësuarit, të cilat të drejta ia siguron ligji apo akti tjetër juridik përkatës, e që për rrjedhojë ka dëmtimin material apo shpirtëror të të punësuarit.

Për këtë vepër penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në një vit.

2. Cenimi i të drejtave të punësimit dhe papunësisë¹⁵

Një nga parimet kryesore në çdo shtet demokratik, është edhe parimi i barazisë para ligjit. Këtë parim e mbron edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ku

¹⁴ Salihu Ismet, E drejta penale – pjesa e posaçme, Botimi i II, Prishtinë, 2014, fq. 263.

¹⁵ Neni 219 i KPRK-së.

ceket se të gjithë janë të barabartë para ligjit.¹⁶ Në frymën e kësaj edhe me rastin e punësimit secili duhet të trajtohet në mënyrë të barabartë dhe pa asnjë lloj diskriminimi. Në funksion të mbrojtjes së këtij parimi kushtetues, është ofruar edhe mbrojtje penale juridike, duke e sanksionuar si vepër penale mohimin apo kufizimin e drejtës për punësim në kushte të njëjta për secilin person.

Vepra penale, cenimi i të drejtave të punësimit apo papunësisë, është një vepër penale që është parashikuar në KPRK, ku përmes kryerjes së kësaj vepre penale cenohen të drejtat në punësim të punëkërkuesve apo edhe personave të papunësuar.

Sipas paragrafi 1 të nenit 219 të KPRK, këtë vepër penale e kryen kushdo që ia mohon apo kufizon personave tjerë të drejtën në punësim në kushte të njëjta, siç është përcaktuar me ligj.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale mund të jetë në dy forma, në mohimin e drejtës në punësim në kushte të njëjta dhe kufizimin e drejtës në punësim në kushte të njëjta. Shprehja mohim nënkupton pamundësinë e plotë në realizimin e drejtës për punësim në kushte të njëjta, ndërsa shprehja kufizim nënkupton pamundësim të kufizuar në realizimin e drejtës në punësim në kushte të njëjta, të përcaktuara me ligj ose akt tjetër juridik.¹⁷ Si mohim i drejtës në punësim mund të jetë situata kur kryesi fare nuk e publikon konkursin, e përjashton nga lista e ngushtë edhe pse i plotëson kriteret, apo edhe situata kur kryesi nuk e fton në mënyrë të rregullt për testim. Ndërsa si kufizim i drejtës në punësim mund të jetë situata kur kryesi i ndihmon kundër kandidatit me rastin e testimit apo edhe kur nuk jep informatat e duhur me rastin e shpalljes së konkursit, apo edhe kriteret në konkurs janë diskriminuese.

Kjo norme penale është e karakterit blanket për faktin se mohimi apo kufizimi i të drejtës në punësim duhet të jetë në kundërshtim me dispozitat e një ligji apo akti juridik që e rregullon fushën e punësimit, konkretisht duhet të jetë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të punës apo edhe të Ligjit për shërbimin civil.

Sa i përket kryerësit, pavarësisht formulimit që është dhënë "kushdo", këtë vepër penale nuk mund ta kryejë çdo person, por vetëm ata persona të cilët sipas ligjit kanë përgjegjësi dhe detyrë për zhvillimin e procedurave të

¹⁶ Neni 24 i Kushtetutës.

¹⁷ Salihu Ismet, Zhitija Hilmi & Hasani Fejzullah, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Komentar, Botimi I, Prishtinë, 2014, fq. 593.

punësimi dhe të cilët ligjërisht janë përgjegjës për udhëheqjen, mbikëqyrjen dhe miratimin e procedurave të punësimit.

Vepra konsiderohet se është kryer, atëherë kur në kundërshtim me kushtet e parapara me ligj apo akt tjetër, respektivisht kriteret e konkursit është punësuar personi i cili nuk i ka plotësuar kriteret ndërsa është refuzuar kandidati i cili i ka plotësuar këto kritere.

Sipas paragrafit 2 të këtij neni, formën e dytë e kësaj vepre e kryen kushdo që nuk vepron në pajtim me legjislacionin mbi të drejtat e personave të papunësuar dhe me këtë ia mohon apo ia kufizon të drejtat që iu takojnë atyre. Lidhur me këtë vepër, vlen të ceket se shumë shtete të zhvilluara, personat të cilët pa fajin e tyre nuk mund të punësohen, iu njihen disa të drejta si: ndihma financiare, sigurim shëndetësor. Por për shkak të gjendjes ekonomike në të cilën gjendet vendi ynë, shumë pak të drejta ka paraparë për personat e papunësuar.¹⁸ Pasi shumë pak të drejta iu njihen personave të papunësuar, atëherë edhe gjasat që të kryhet kjo vepër penale janë shumë të vogla.

Sidoqoftë, nga përmbajtja e kësaj dispozite del se veprimi i kryerjes së kësaj vepre është mosrespektimi i ndonjë dispozite ligjore, e që për pasojë ka mohimin apo kufizimin e ndonjë të drejte të personave të papunësuar. Si mënyra të kryerjes mund të jenë: fshehja e kërkesës, moszgjidhja e kërkesës, shlyerja nga evidenca e të papunësuarve.¹⁹

Edhe te kjo formë, kryes mund të jetë vetëm personi i cili ligjërisht ka përgjegjësi për të vendosur në lidhje me të drejtat e personave të papunësuar. Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje, nëse mungon dashja e kryerësit atëherë kemi shkelje administrative dhe për to kryesi mund të përgjigjet në procedurë disiplinore.

Për këtë vepër penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në dy vite.

3. Cenimi i të drejtës në menaxhim²⁰

¹⁸ Salihu Ismet, E drejta penale –Pjesa e posaçme, Botimi i II, Prishtinë, 2014, fq. 265.

¹⁹ Salihu Ismet, Zhitija Hilmi & Hasani Fejzullah, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Komentar, Botimi I, Prishtinë, 2014, fq. 595.

²⁰ Neni 220 i KPRK

Në kuptimin e përgjithshëm menaxhimi nënkupton planifikimin, organizimin, udhëheqjen, koordinimin dhe kontrollin e një institucioni, respektivisht organizate apo kompanie, për të arritur një qëllim të caktuar.

E drejta e menaxhimit buron nga ligji dhe aktet tjera të cilat janë aprovuar me rastin e themelimit, konstituimit dhe regjistrimit në bazë të punës ose mjeteve të deponuara.²¹ Nuk mund të mendohet në asnjë mënyrë që një organizatë të drejtohet dhe funksionojë pa e rregulluar mënyrën dhe formën e menaxhimit të saj. Kështu që, secili institucion, organizatë apo kompani e rregullon çështjen e menaxhimit të saj, qoftë përmes ligjit, akti nënligjor apo edhe aktit të brendshëm të organizatës.

Menaxhimi mund të jetë individual, kur një person e menaxhon një organizatë, por mund të jetë edhe kolektiv, në rastet kur një organizatë menaxhohet apo udhëhiqet nga një trup drejtues, respektivisht organi kolektiv. Në të dy rastet është e domosdoshme që përmes një aktit juridik të rregullohet mënyra dhe forma e menaxhimit.

Për shkak të rëndësisë së madhe që ka menaxhimi i një organizate dhe në funksion të ushtrimit të kësaj përgjegjësie në mënyrë të papenguar, të suksesshme por edhe efikase, të drejtës në menaxhim i ofron mbrojtje penalo-juridike edhe KPRK.

Sipas paragrafit 1 të nenit 223 të KPRK, formën themelore të kësaj vepre penale e kryen kushdo që në mënyrë të kundërligjshme e pengon apo ndalon trupin drejtues në vendimmarrje ose anëtarit të trupit drejtues ia bën të pamundshëm ushtrimin e të drejtës së tij për të marrë pjesë në vendimmarrje në atë trup.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale mund të jetë në dy forma:

1. Veprimi i kryerjes mund të jetë duke e penguar apo ndaluar trupin drejtues në vendimmarrje. Shprehja pengim nënkupton vënien e pengesave me qëllim që trupit drejtues ti pamundësohet vendosja për një çështje të caktuar në drejtimin e organizatës, ndërsa shprehja ndalim, nënkupton marrjen e atyre veprimeve të cilat e ndalojnë trupin drejtues të vendos për çështje të caktuara. Pengimi mund të bëhet duke mos krijuar kushte adekuate për të vendosur, duke mos i dorëzuar me kohë materialet apo duke i dorëzuar ato gabimisht, ndërsa ndalimi mund të bëhet duke i vënë në lajthitje lidhur me ndonjë çështje

²¹ Salihu Ismet, Zhitija Hilmi & Hasani Fejzullah, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Komentar, Botimi I, Prishtinë, 2014, fq. 595.

për të cilën duhet të jap mendimin e tij, por edhe forma tjera që varen prej secilës situatë konkrete.

2. Veprimi i kryerjes konsiston në ndërmarrjen e atyre veprime përmes të cilave një anëtar i caktuar të trupit drejtues i pamundësohet ushtrimi i së drejtës së tij në marrjen e vendimit dhe ushtrimin e përgjegjësisive sipas aktit juridik. Si formë e pamundësisimit duhet të kuptohet situata kur një anëtar i caktuar të trupit drejtues në mënyra të ndryshme i shkaktohen pengesa që ai fare të mos ketë mundësi të jetë i pranishëm në mbledhjen e organit ku merren vendime për qeverisjen e organizatës.²² Se në çfarë forme mund të bëhet ky pamundësim i ushtrimit të drejtës në vendimmarrje është një çështje faktike e cila varet prej secilit rast, mirëpo një prej tyre mund të jetë mos njoftimi fare për takim, njoftimi me vonës apo edhe njoftimi gabimisht me qëllim për orarin e takimit dhe forma tjera.

Kjo norme penale është e karakterit blanket për faktin se, për tu përmbushur elementet e veprës penale, pengimi apo ndalimi duhet të bëhet me ndonjë veprim apo mosveprim të kundërligjshëm, respektivisht veprimi apo mosveprimi të bëhet duke e shkelur ndonjë dispozitë ligjore apo dispozitë të ndonjë akti tjetër juridik.

Objekt mbrojtës i kësaj vepre penale është mbrojtja e drejtës për ushtrimin e papenguar të drejtave në menaxhimin e një organizate në mënyrë efikase.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje, në të kundërtën nëse mungon dashja e kryerësit mund të ketë vetëm shkelje administrative. Ndërsa, si kryerës mund të jetë çdo person qoftë nga brenda organizatës apo jashtë saj. Për të ekzistuar kjo vepër penale nga paragrafi 1 është e nevojshme që pengimi apo ndalimi të bëhet me ndonjë veprim apo mosveprim të kundërligjshëm, të pa drejtë, qëllimisht duke shkelur ndonjë dispozitë ligjore apo të ndonjë akti tjetër juridik.

Formë e kualifikuar e kësaj vepre penale është paraparë në paragrafi 2 dhe konsiderohet se kryhet nëse kjo vepër kryhet nga personi zyrtar ose personi përgjegjës në keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij. Sipas këtij formulimi, formë më të rëndë dhe rrjedhimisht edhe dënim më të ashpër është paraparë kur kjo vepër kryhet nga personi i cili posedon cilësi të caktuar apo pozitë të caktuar dhe se për shkak të kësaj cilësi i njëjti mund gjendet në situatën që ta kryej këtë vepër penale. Pra, rrjedhimisht këtë formë nuk mund

²² Salihu Ismet, E drejta penale – Pjesa e posaçme, Botimi i II, Prishtinë, 2014, fq. 266.

ta kryej kushdo, por vetëm një rreth i caktuar i personave, të cilët ushtrojnë detyra të caktuara dhe atë duke i keqpërdorë pozitat e tyre.

Ndërsa paragrafi 3 ka paraparë formë më të rëndë dhe atë kur kjo vepër kryhet me përdorim të forcës apo kanosjes serioze, për të realizuar qëllimet e caktuara. Pra, formë të kualifikuar e bënë fakti se veprimet apo mosveprimet e kryesit të kësaj vepre janë manifestuar përmes përdorimit të forcës apo kanosjes serioze.

Për formën themelore të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në një vit, ndërsa për formën e kualifikuar është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Te forma e tretë, dënimi është nga 6 muaj deri në 5 vjet.

4. Cenimi i të drejtës në grevë²³

E drejta në organizim sindikal është e drejtë që rrënjët e veta i ka në histori. Për shkak të rëndësisë që ka, greva është e rregulluar me norma ndërkombëtare por edhe me legjislacionin e brendshëm. Në këtë drejtim punëtorët dhe punëdhënësi kanë të drejtë të themelojnë dhe varësisht nga rregullat e organizatës së caktuar, t'iu bashkohen organizatave të cilat ata i zgjedhin vetë pa kurrfarë leje paraprake.

Përveç me drejtën ndërkombëtare, të drejtën për organizim sindikal e njeh edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ku përcaktohet qartë se: "Liria për të themeluar sindikata dhe për t'u organizuar, me qëllim që të mbrohen interesat, është e garantuar. Kufizimi i kësaj të drejte mund të bëhet me ligj për kategori të veçanta të punonjësve".²⁴

Qëllimet kryesore të sindikatave janë mbrojtja e drejtave të punëtorëve. Një nga format më të rëndësishme të presionit sindikal kundër punëdhënësit për mbrojtjen dhe avancimin e drejtave të punëtorëve është greva. Greva është formë e organizuar e ndërprerjes së punës, kurse qëllimi i organizimit të grevës nga ana e sindikalisteve qëndron në realizimin e të drejtave dhe interesave ekonomike dhe sociale për punëtorët, në rastet kur këto të drejta nuk mund të realizohen me mjete paqësore.

²³ Neni 221 i KPRK-së.

²⁴ Neni 44 paragrafi 2 i Kushtetutës.

Në shumicën e legjislacioneve e drejta në grevë është e përcaktuar me ligj. Në Kosovë, kjo çështje është e rregulluar me Ligjin për grevat, sipas të cilit: "Greva është ndërprerje e organizuar e punës nga ana e të punësuarve me qëllim të realizimit të të drejtave dhe interesave ekonomike, sociale dhe profesionale nga marrëdhënia e punës".²⁵

Përveç rregullimit me ligj të veçantë që i është bërë drejtës në grevë, edhe KPRK në nenin 224 i ka ofruar mbrojtje penalo juridike kësaj të drejte, duke e paraparë si vepër penale cenimin e të drejtës në grevë. Kjo është vepër penale e re, e cila për herë të parë është paraparë në KPRK dhe se qëllimi kryesor i saj është që të mbrohet e drejta e punëtorëve për organizim dhe pjesëmarrje në grevën e organizuar në përputhje me dispozitat ligjore.

Sipas nenit 221 paragrafi 1 të KPRK, këtë vepër penale e kryen kushdo që me përdorim të forcës apo kanosjes serioze ose në ndonjë mënyrë tjetër të kundërligjshme, parandalon ose pengon punëtorin nga organizimi, pjesëmarrja apo ushtrimi në ndonjë mënyrë tjetër i çfarëdo të drejte ligjore për grevë në pajtim me ligjin dhe për të marrë pjesë në grevë, apo në ndonjë mënyrë tjetër për të ushtruar të drejtën në grevë.

Veprimet e tilla si parandalim ose pengim i punëtorit në ushtrimin e të drejtës në grevë, lidhur me organizimin, pjesëmarrjen apo ushtrimin e ndonjë mënyre tjetër të çfarëdo të drejte ligjore për grevë në pajtim me ligjin dhe për të marrë pjesë në grevë apo në ndonjë mënyrë tjetër për të ushtruar të drejtën në grevë. Kështu, ligdhënësi mbron të drejtën në grevë edhe në "ndonjë mënyrë tjetër" të kundërligjshme. Shprehja, edhe në ndonjë mënyrë tjetër, të cilën e përdorë KPRK mund të jenë edhe veprimet të cilat kanë lidhje me grevën, por ende nuk kuptohen si organizim, si pjesëmarrje, apo ushtrim të çfarëdo të drejte ligjore për grevën në pajtim me ligjin, si veprime të tilla janë p.sh., bisedimet për grevë, biseda lidhur me vendimin se a do të organizohet greva apo jo, a do t'i bashkëngjiten grevës apo jo, formulimi i kërkesave për mos t'i qasen grevës dhe veprime të ngjashme.²⁶

Edhe kjo vepër penale është e karakterit blanket sepse për tu përmbushur elementet e veprës penale, parandalimi apo pengimi i punëtorit duhet të bëhet me ndonjë veprim apo mosveprim të kundërligjshëm, pra duke e shkelur

²⁵ Neni 4, paragrafi 1.1 i Ligjit Nr. 03/L-200 për Greva, Gazeta Zyrtare, Vitit V, Nr.79, datë 24.08.2010.

²⁶ Salihu Ismet, Zhitija Hilmi & Hasani Fejzullah, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Komentar, Botimi I, Prishtinë, 2014, fq. 597.

ndonjë dispozitë ligjore apo dispozitë të ndonjë akti tjetër juridik, me të cilën rregullohet çështja e grevës.

Për të ekzistuar kjo vepër penale është e nevojshme që parandalimi dhe pengimi të realizohet me përdorimin e forcës apo kanosjes serioze ose në ndonjë mënyrë tjetër të kundërligjshme. Ndonjë mënyrë tjetër të kundërligjshme është çdo mënyrë përveç forcës dhe kanosjes serioze, e cila është drejtuar për parandalimin apo pengimin e punëtorit nga organizimi, pjesëmarrja apo ushtrimi në ndonjë mënyrë tjetër çfarëdo të drejte ligjore për grevë, si për shembull, mashtrimi, shantazhi, krijimi i vështirësive për pjesëmarrje apo ushtrimin e çfarëdo të drejte ligjore lidhur me grevën, vendosja e pengesave për të hyrë apo për të dalë nga organizata.²⁷

Forma tjetër e kryerjes së kësaj vepre penale është paraparë në paragrafin 2, e cila qëllimin kryesor e ka mbrojtjen e punëtorit në rastet kur ai merr pjesë në grevën e organizuar në përputhje me ligjin.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person, përjashtim nga paragrafi 2 ku kryes mund të jetë vetëm personi i cili ka autorizime ligjore për të menaxhuar me punëtorët.

Për këtë vepër penale është parashikuar dënimi me gjobë ose burgim deri në dy vjet.

5. Keqpërdorimi i të drejtës në grevë²⁸

Siç e cekëm më lartë, e drejta në grevë është e garantuar si me Kushtetut ashtu edhe me ligj. Mirëpo, duhet ditur se greva duhet të organizohet dhe mbahet vetëm nën kushtet dhe rrethanat e përcaktuara me ligj. Prandaj, me qëllim që kjo e drejtë të mos keqpërdoret, atëherë KPRK e ka inkriminuar si vepër penale edhe keqpërdorimin e drejtës në grevë. Pra, pavarësisht se legjislacioni ynë e garanton të drejtën në grevë, kjo nuk nënkupton që greva mund të organizohet dhe udhëhiqet edhe në kundërshtim me ligjin. Përkundrazi, secila grevë duhet të organizohet dhe në mënyrë të rreptë tu përmbahet dispozitave të ligjit mbi organizimin e grevës. Kështu që, mos respektimi i kushteve dhe kritereve të përcaktuar me ligjin në fuqi për grevat, apo edhe me aktet tjera juridike, madje edhe ato të brendshme të punëdhënësit, konsiderohet vepër penale sipas nenit 222 të KPRK dhe emërtohet "Keqpërdorimi i të drejtës në grevë". Sipas kësaj

²⁷ Po aty, fq 598.

²⁸ Neni 222 i KPRK-së.

dispozite ligjore, këtë vepër penale e kryen kushdo që në shkelje të ligjit, organizon ose udhëheq grevën dhe nëse nuk ka elemente të ndonjë vepre penale tjetër, pra konsiston në organizimin e grevës apo në udhëheqjen e grevës.

Me organizim duhet kuptuar të gjitha veprimet të cilat i paraprijnë ndërprerjes së punës nga të punësuarit, e të cilat kanë për qëllim që ndërprerja e punës të arrihet, si p.sh. bindja e punëtorëve t'i bashkëngjiten grevës, organizimi i mbledhjeve të punëtorëve, ndikimi për ta marrë vendimin për grevë, formimin e këshillit për grevë e të ngjashme.²⁹ Udhëheqësi i grevës është personi që e drejton grevën.

Për tu konsideruar se është kryer kjo vepër, veprimet e ndërmarra në drejtim të organizimit dhe udhëheqjes së grevës duhet të jenë në kundërshtim me ligjin. Gjithashtu, kusht tjetër është edhe që me këto veprime të mos jetë realizuar figura e ndonjë vepre penale. Përndryshe nëse me këto veprime është realizuar figura e ndonjë vepre tjetër, atëherë nuk kemi këtë vepër por kemi vepër tjetër, që do të thotë çfarëdo vepre tjetër e konsumon këtë vepër penale. Është karakteristikë se nga formulimi i dhënë kjo vepër konsiderohet se është kryer me vetë faktin se greva organizohet dhe udhëhiqet në kundërshtim me ligjin edhe nëse nuk është shkaktuar kurrfarë pasoje nga kjo vepër penale.³⁰

Forma e kualifikuar e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 e cila konsiderohet se kryhet nëse greva e organizuar ose e udhëhequr në shkelje të ligjit shkakton dëm në shkallë të madhe, humbje në shkallë të madhe ose rrezikon jetën apo shëndetin e personave me kusht që nuk ekzistojnë elementet e ndonjë vepre tjetër penale. Pra, forma e rëndë është e lidhur kryekëput me pasojat e grevës, përfshirë dëmet materiale dhe rrezikimin e jetës apo shëndetit të personave, me kusht që mos të jenë realizuar elementet e ndonjë vepre tjetër penale. Sepse, nëse janë realizuar elementet e ndonjë vepre tjetër penale, atëherë kemi vepër tjetër.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person, i cili ka ndërmarrë veprime organizative apo udhëheqëse të grevës, në kundërshtim me ligjin. Ndërsa, vetëm pjesëmarrja në grevë nuk konsiderohet kryerje e kësaj vepre penale.

²⁹ Salihu Ismet, Zhitija Hilmi & Hasani Fejzullah, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Komentar, Botimi I, Prishtinë, 2014, fq. 600.

³⁰ Salihu Ismet, E drejta penale – Pjesa e posaçme, Botimi i II, Prishtinë, 2014, fq. 268.

Për formën themelore të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në një vit, ndërsa dënimi i paraparë është gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

6. Cenimi i të drejtave nga sigurimi social³¹

Të drejtat nga sigurimi social bëjnë pjesë në grupin e drejtave socio-ekonomike dhe si të tilla kanë një rëndësi jetike për individin dhe, rrjedhimisht, edhe parakusht që njeriu të mund t'i gëzojë shumë të drejta të tjera. Për shkak të rëndësisë që kanë, këto drejta janë të rregulluara si me norma ndërkombëtare ashtu me ato brenda vendit.

Sipas Deklaratës Universale për Drejtat e Njeriut, secili si anëtar i shoqërisë, ka të drejtë sigurimi social dhe të drejta të domosdoshme ekonomike, sociale e kulturore për dinjitetin e tij dhe për zhvillimin e lirë të personalitetit të tij, me ndihmën e shtetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në përputhje me organizimin dhe burimet e çdo shteti.³²

Edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka paraparë se kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social rregullohen me ligj.³³ Ndërsa si ligje kryesore me të cilat janë rregulluar të drejtat nga sigurimi social janë: Ligji për sigurimin shëndetësor³⁴ dhe Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti.³⁵

Përveç rregullimit me ligje të veçantë, edhe KPRK në nenin 223 i ka ofruar mbrojtje penalo-juridike kësaj të drejte, duke e paraparë si vepër penale cenimin e të drejtave nga sigurimi social, ku si objekti mbrojtës i saj është mbrojtja e të drejtës në sigurimin shëndetësor, pensional dhe invalidor dhe formave tjera të sigurimit social në përputhje me ligjin.

Pra, këtë vepër penale e kryen kushdo që me vetëdije nuk zbaton ligjin apo kontratën kolektive nga lëmi i sigurimit shëndetësor, pensional apo invalidor, apo nga ndonjë formë tjetër e sigurimit social dhe me këtë ia mohon apo ia kufizon të drejtat që i takojnë punëtorit.

³¹ Neni 223 i KPRK-së.

³² Neni 22, Deklarata Universale për Drejtat e Njeriut

³³ Neni 51 i Kushtetutës.

³⁴ Ligji Nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor, Gazeta Zyrtare, Nr. 29, datë 30.04.2014.

³⁵ Ligji Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shtetit, Gazeta Zyrtare, Nr. 35, datë 05.06.2014.

Sigurimet shëndetësore janë kategori e sigurimeve shoqërore apo sociale, që përfshijnë mbulesën e shpenzimeve lidhur me kujdesin shëndetësorë me rastin e sëmundjes, si: kontrollimin mjekësor, shërimin e të sëmurit dhe dhënia e ndihmave tjera mjekësore dhe rehabilituese, rimbursimin e shpenzimeve për barëra etj. Ndërsa me sigurimin pensional dhe invalidor, nënkuptojmë të drejtat për shkak të moshës, papunësisë, humbja apo kufizimi i aftësisë për punë si dhe sigurime të caktuara për anëtarët e familjes së të siguarit, psh: e drejta në pension për shkak të moshës, pension familjar me rastin e vdekjes së të siguarit, pension invalidor për shkak të zvogëlimit të aftësive për punë, të drejtën në rehabilitimin profesional etj.³⁶

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në moszbatimin me qëllim të ndonjë dispozite të ligjit apo kontratës kolektive dhe si pasojë e këtij veprimi punëtorit i mohohet apo i kufizohet ndonjë e drejtë nga sigurimi social. Mohimi i të drejtave do të thotë bërja tërësisht e pamundshme që ndonjë person t'i shfrytëzojë ndonjë të drejtë nga sigurimi social, kufizim do të thotë që personit tjetër i bëhet e mundshme që këto të drejta t'i shfrytëzojë pjesërisht, e jo në tërësi ashtu siç i takojnë.³⁷

Edhe kjo vepër penale është e karakterit blanket, sepse për të gëzuar mbrojtje penalo-juridike, të gjitha këto të drejta duhet të jenë të parapara me ligje të veçanta apo edhe me kontratë kolektive. Vlen të ceket se pavarësisht që Ligji për sigurime shëndetësore ka hyrë në fuqi nga mesi i vitit 2014, akoma nuk ka filluar së funksionari sigurimi shëndetësor.

Pavarësisht formulimit se kryes mund të jetë çdo person, konsiderojë se duke pasur parasysh përmbajtjen e kësaj vepre, kryes i kësaj vepre penale nuk mund të jetë çdo person, por vetëm ai i cili, sipas pozitës që mban, ka autorizime ligjore që të vendos për ndonjë të drejtë nga sigurimi social për punëtorin. Kjo vepër mund të kryhet vetëm me dashje, që nënkupton edhe qëllimin e kryesit për t'ia mohuar punëtorit një të drejtë të caktuar nga sigurimi social.

Për këtë vepër penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në një vit.

7. Keqpërdorimi i të drejtave nga sigurimi social³⁸

³⁶ Salihu Ismet, Zhitija Hilmi & Hasani Fejzullah, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Komentar, Botimi I, Prishtinë, 2014, fq. 602.

³⁷ Salihu Ismet, E drejta penale – Pjesa e posaçme, Botimi i II, Prishtinë, 2014, fq. 270.

³⁸ Neni 224 i KPRK-së.

Ashtu siç u tha, e drejta në sigurim social është e garantuar si me Kushtetutë ashtu edhe me ligje. Mirëpo, këto të drejta duhet të realizohen vetëm në formën dhe mënyrën e përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi. Prandaj, me qëllim që këto të drejta të mos keqpërdoren, KPRK e ka inkriminuar si vepër penale edhe keqpërdorimin e të drejtave nga sigurimi social.

Sipas nenit 224 këtë vepër penale e kryen personi i cili duke u shtirur ose duke i shkaktuar vetes sëmundje apo paaftësi për punë ose mënyrë tjetër të kundërligjshme arrin që të sigurojë ndonjë të drejtë nga sigurimi social ose pensioni shtetëror që nuk i takon sipas ligjit.

Veprimi i kryerjes të kjo vepër penale është i përcaktuar në mënyrë alternative, duke u shtirur se është i sëmurë, duke i shkaktuar vetes sëmundje, duke i shkaktuar vetes paaftësi për punë, ose duke ndërmarrë ndonjë veprim tjetër që është i kundërligjshëm.³⁹ Në kuptim të kësaj dispozite, të shtirurit apo simulimi nënkupton rastin kur një person, edhe pse gëzon shëndet të plotë, simulon apo prezantohet rrejshëm si i sëmurë duke i imituar simptomat e caktuara të sëmundjes. Simulimi mund të bëhet në forma dhe mënyra të ndryshme qoftë përmes prezantimit të dokumenteve të rrejshme mjekësore, deklaratave të rrejshme etj.

Të shkaktuarit vetes sëmundje, ose paaftësi për punë do të thotë, se kryesi me vetëdije vetes i shkakton sëmundje ose paaftësi për punë, me qëllim që të krijon të tjetri bindjen se është i sëmurë, respektivisht se nuk është i aftë për punë, me çka organi kompetent vihet në lajthim.⁴⁰ Ndërsa nga shprehja "në ndonjë mënyrë tjetër të kundërligjshme", ligjdhënësi ka mundësuar që të mbrohet keqpërdorimi i drejtave nga sigurimi social në çfarëdo forme dhe mënyre nga e cila, ndonjë person, ka përfituar ndonjë të drejtë nga sigurimi social, në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Objekti mbrojtës i kësaj vepre penale është mbrojta e drejtave nga sigurimi social nga keqpërdorimi si dhe ndalimi i përfitimit të kundërligjshëm nga këto të drejta.

Kryes i kësaj vepre mund të jetë çdo person. Ndërsa për nga forma e fajit, kjo vepër mund të kryhet vetëm me dashje, që ngërthen në vete edhe qëllimin e qartë të kryerësit që përmes ndërmarrjes së këtyre veprimeve dëshiron të

³⁹ Salihu Ismet, E drejta penale – pjesa e posaçme, Botimi i II, Prishtinë, 2014, fq. 271.

⁴⁰ Salihu Ismet, Zhitija Hilmi & Hasani Fejzullah, *Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Komentar*, Botimi I, Prishtinë, 2014, fq. 603-604.

realizojë ndonjë të drejtë nga sigurimi social, respektivisht të përfitojë kundërligjshëm qoftë sigurim shëndetësor, pensional apo invalidor.

Për këtë veprë penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Përfundim

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës e garanton të drejtën në punë dhe të drejtat nga sigurimi social. Përveç Kushtetutës, të drejtat nga marrëdhënia e punës dhe sigurimit social janë të rregulluar me ligj dhe akte tjera nënligjore, duke filluar me Kodin Penal të Kosovës.
2. Kështu, Kapitulli XIX i KPRK, konsiderohet njëri ndër kapitujt me rëndësi të madhe në fushën e mbrojtjes së drejtave të punëtorëve dhe disa nga këto vepra konsiderohen si vepra të reja, ngase nuk kanë qenë të parashikuara si të tilla në legjislacionin e mëparshëm penal.
3. Duke qenë se numri i këtyre të drejtave nga marrëdhënia e punës dhe nga sigurimi social janë shumta, është pamundshme, por edhe e panevojshme, që secilës nga këto të drejta t'i sigurohet mbrojtje penalo-juridike. Kështu që, me dispozitat e këtij kapitulli mbrohen vetëm ato të drejta që konsiderohen kyçe dhe shumë të rëndësishme, e që pa mbrojtje penale nuk mund të mbrohen në formën e tyre.
4. Zakonisht këto vepra kryhen nga motivet ekonomike, ngase janë të lidhura me aspektin e marrëdhënieve kontraktuale ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit.
5. Sa i përket fajësisë, të gjitha këto vepra mund të kryhen vetëm me dashje, e kur mungon dashja atëherë nuk mund të bëhet fjalë për veprë penale, por përgjegjësi disiplinore. Kryerës të këtyre veprave penale parimisht mund të jetë çdo person, mirëpo disa forma të këtyre vepra penale mund t'i kryejnë vetëm personat që ushtrojnë autorizime ligjore dhe kanë përgjegjësi për të vendosur lidhur me të drejtat e punëtorëve.
6. Në parandalimin e veprave penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës rëndësi të veçantë ka funksionimi i mirëfilltë i institucioneve

përgjegjëse për mbrojtjen e drejtave të punëtorëve. Në radhë të parë, këtu nënkuptohet funksionimi i Inspektoratit të punës, si një mekanizëm i veçantë dhe me përgjegjësi të qarta ligjore për mbrojtjen e drejtave të punëtorëve, e po ashtu edhe institucionet e tjera, si Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, si organ i pavarur i cili i mbikëqyrë të drejtat e të punësuarve në shërbimin civil, sindikatat të cilat luajnë rol aktiv në mbrojtjen e drejtave të punëtorëve.

7. Në luftimin dhe parandalimin e këtyre veprave penale rol të rëndësishëm ka edhe kompletimi i legjislacionit, dhe këto të drejta janë rregulluar qartë me dispozita ligjore, por edhe me akte tjera juridike. E gjithë çka nevojitet është një përkushtim më i madh i organeve për mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre të drejtave. Gjithsesi, vlen të ceket se disa nga këto të drejta, si p.sh e drejta në sigurim shëndetësor, edhe pse e rregulluar me ligj, akoma nuk ka filluar të zbatohet dhe si pasojë e kësaj, në vendin tonë mungojnë sigurimet shëndetësore, çka bënë që individët e sëmurë, për çdo sëmundje serioze duhet të paguajnë shuma të mëdha për shërim.
8. Sa i përket politikës ndëshkimore, për shumicën e këtyre veprave është paraparë dënimi me gjobë dhe burgim prej 1 deri në 3 vjet. Kjo politikë ndëshkimore është e ultë, marr parasysh rëndësinë e të drejtave nga marrëdhënia e punës, si të drejta ekzistenciale të njeriut, të cilat i mundësojnë sigurimin e mjeteve për jetesë dhe shërbejnë si parakusht për realizimin e drejtave dhe lirive tjera ekonomike e sociale. Andaj politika ndëshkimore duhet të orientohet në shqiptimin e dënimeve me gjobë, ku këto dënime do të ndihmonin në vetëdijesimin e kryerësve për respektimin e plotë të këtyre drejtave dhe evitimin e shkeljes së dispozitave ligjore apo akteve tjera juridike.

Bibliografia

Librat

- Elezi, Ismet, Kaçupi, Skender; Haxhia, Maksim, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2001.
- Elezi, Ismet, E drejta penale, Pjesa e posaçme, Tiranë, 2013.
- Hajdari, Azem, Procedura penale, Komentari, Prishtinë, 2009.

- Salihu, Ismet, E drejta penale, Pjesa e posaçme, Prishtinë, 2014.
- Salihu, Ismet, E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2014.
- Salihu, Ismet, Zhitija, Hilmi, Hasani, Fejzullah, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Komentar, Botimi I, Prishtinë, 2014.
- Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Komentar, Botimi I, Prishtinë, 2014.
- Ledio, Milkani, Manual për të punësuarit dhe sindikatat, Tiranë, 2016.
- Sahiti, Ejup, E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2005.
- Benjamin Levin, *Criminal Labor Law*, 37 Berkeley J. Emp. & Lab. L. 43 (2016).
- Çollaku, Hashim, Hasani, Fejzullah, Klinika Juridike Penal, Udhëzues, Prizren, 2016.
- Çela, Radovan, Garancitë juridike të së drejtës së punës, Tiranë, 2016.
- Shala, Afrim, Hyrje në të drejtën penale, Botimi i dytë, Gjilan, 2013.

Akte juridike

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 09 prill 2008, e cila ka hyrë në fuqi 15.06.2008.
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr.04/L-82, i datës 13.12.2018, ka hyrë në fuqi më 14.01.2019.
- Kodi Përkohshëm Penal i Kosovës, Rregullorja e UNMIK-ut nr.2003/25, i datës 06.07.2003.
- Kodi i Procedurës Penale, Nr.04/L-123, i datës 13.12.2012, ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.
- Ligji Nr. 03/L-212 i Punës, Gazeta Zyrtare, Vitit V, Nr. 90 datë 01.12.2010.
- Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, Gazeta Zyrtare, Nr. 72/2010, datë 25.06.2010.
- Ligjit Nr. 03/L-200 për Greva, Gazeta Zyrtare, Vitit V, Nr.79, datë 24.08.2010.
- Ligji Nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor, Gazeta Zyrtare, Nr. 29, datë 30.04.2014.
- Ligji Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shtetit, Gazeta Zyrtare, Nr. 35, datë 05.06.2014.
- Ligji Nr. 03/L-199 për Gjykatat, Gazeta Zyrtare, Viti V, Nr. 79, datë 24.08.2010.
- Deklarata Universale për Mbrojtjen e të Drejtat e Njeriut,

Ma.Sc. Veton Ademaj -Gjyqtar¹

Masat edukative ndaj personave të mitur të parapara në Kodin e Drejtësisë për të Mitur

Abstrakti

Masat edukative ndaj personave të mitur, të parapara në Kodin e Drejtësisë për të Mitur konsideroj se paraqet interes të veçantë të studimit, në fushën e drejtësisë penale për të mitur si në aspektin e teorisë juridiko-penale, ashtu edhe të zbatimit të tyre në praktikën gjyqësore. Këto masa janë llojet kryesore të sanksioneve penale që mund të shqiptohen ndaj kryerësve të mitur të veprave penale dhe janë masat e vetme që krahas masave të diversitetit, mund të shqiptohen ndaj të miturve të rinj (14-16) vjeç), si dhe preferohet të shqiptohen edhe ndaj të miturve të rritur (16-18) vjeç.

Andaj trajtimi juridiko-shkencor i temës në fjalë mendoj, se do të paraqiste edhe një kontribut shtesë në teorinë juridiko-penale të së drejtës penale për të mitur.

Në aspektin e doktrinës juridiko-penale objekti i studimit është përkufizimi i masave edukative, llojet, kushtet në të cilat shqiptohen, qëllimi i shqiptimit të tyre, procedura dhe kompetenca e shqiptimit të tyre. Në aspektin praktik në këtë punim do të paraqitën, raste nga praktika gjyqësore e shqiptimit të masave edukative ndaj kryerësve të mitur të veprave penale.

Fjalët kyçe: I mitur, masat edukative, riedukimi dhe rehabilitimi.

Hyrja

Në Kodin e Drejtësisë për të Mitur në mesin e të gjitha llojeve të masave dhe dënimeve që mund të shqiptohen ndaj kryerësve të mitur të veprave penale, kryesoret janë masat edukative, që janë parapara në kreun e pestë të këtij kodi. Këto masa janë lloj i posaçëm i sanksioneve penale të karakterit edukues-

¹ Autori i këtij punimi është Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm.

pedagogjik, te cilat shqiptohen ndaj të miturve të cilët kanë kryere vepra penale të lehta, veçanërisht nga pamaturia apo pakujdesia.

Andaj, këto masa mund të shqiptohen për veprat penale që parashihet dënimi deri në pesë vjet burg, të cilat nuk mund të kalojnë afatin maksimal të burgimit të paraparë për veprën penale .

Qëllimi i shqiptimit të këtyre masave është të kontribuojë në rehabilitimin dhe zhvillimin adekuat të kryerësit të mitur, madje në të shumtën e rasteve pa i izoluar nga mjedisi i deriatëhershëm familjar dhe shoqëror, duke ofruar mbrojtje, ndihmë dhe mbikëqyrje, duke siguruar edukim dhe aftësim profesional, duke zhvilluar përgjegjësinë e tij personale dhe kështu duke parandaluar sjelljet recidiviste.

1. Delikuenca e të miturve

1.1 Nocioni i delikuencës së të miturve.

Kriminaliteti si dukuri negative shoqërore, nuk është karakteristikë vetëm e të rriturve, pasi si kryerës të veprave penale paraqiten edhe personat e mitur². Ndërsa në aspektin fenomenologjik, kriminaliteti i të miturve është pjesë integrale e kriminalitetit të përgjithshëm të një vendi.

Por për shkak të karakteristikave të kryerësve të mitur të veprave, sidomos moshës, aspektit sociologjik, psikologjik, juridik dhe papjekurisë që i karakterizon, ndaj tyre mund të ndikohet si në aspektin pozitiv por edhe negativ, duke pasur parasysh karakteristikat e tilla, të miturit në këtë moshë nuk mund të kuptojnë në tërësi rëndësinë e veprës dhe kontrollojnë sjelljet e tyre³.

Numri më i madh i veprave penale të kryera nga të miturit është i drejtuar kundër pasurisë.

Mirëpo shqetësuese është rritja e pjesëmarrjes së të miturve në krimin e organizuar, në trafikim më njerëz, me drogë, me armë dhe forma tjera. Andaj në këtë aspekt gjasat më të mëdha që të miturit të paraqiten si recidivistë janë të ata persona të cilët si të mitur kanë kryer vepra penale⁴.

² Sahiti, Ejup. *E drejta e procedurës penale*, Prishtinë, 2005, fq. 254.

³ Halili, Ragip. *Kriminologjia*, Prishtinë, 2005, fq. 224.

⁴ Salihu, Ismet. *Vepra e cituar*, fq. 12.

Më qëllim që të mos njollosen dhe të mos etiketohen si kriminel, veprimet e tyre antisociale në literaturën juridiko-penale quhen delikuencë e të miturve. Me delikuencë të miturve nënkuptojmë veprimet dhe sjelljet antiligjore që i kryejnë personat mes moshës 14 dhe 18 vjeç, të cilat emërohen si delikte⁵. Këto sjellje shkelje të disa normave pozitive juridike, të natyrës penale, kundërvajtëse, ekonomike dhe disiplinore.

Në teorinë juridiko-penale, ka ardhur më shumë në shprehje aplikim i konceptit të ngushtë dhe të gjerë i delikuencës së të miturve. Sipas konceptit të ngushtë, ky nocion përfshinë vetëm sjelljet që janë përcaktuar si vepra penale, i cili dominon në një pjesë të madhe në legjislacione evropiane. Ky koncept është pranuar edhe në Kodin e Drejtësisë për të Mitur në Kosovë.

1.2. Historiku i masave dhe dënimeve ndaj të miturve në Kosovë dhe kategorizimi

Sipas të drejtës zakonore Shqiptare, kryerës i veprës penale konsiderohet personi që është i zoti të mbajë e të përdorë armën. E drejta zakonore nuk ka arritur të bëjë ndarjen e të miturve në kategori të posaçme dhe të parashikoj masa edukuese për të miturit⁶.

Pas renjës së Perandorisë Otomane, Kodi Penal i Jugosllavisë i vitit 1929 bëri dispozita të veqanta për të miturit dhe i ndau në dy kategori:

- Kategorinë e parë e përbëjnë të miturit të rinj (prej 14 deri 17 vjeç), që kanë mundur të shqiptohen masat e caktuar edukative, përjashtimisht dënimet nëse është fjala për recidivistë.
- Kategorinë e dytë e përbënin të miturit të rritur (prej 17 deri 20 vjeç)⁷, ndaj tyre kanë mundur të shqiptohen dënimet, duke marrë parasysh dispozitat e posaçme për individualizimin e dënimeve.

Pas luftës së Dytë Botërore, dispozitat penale që dedikoheshin delikuinteve të mitur ishin të përcaktuara në Ligjin mbi llojet e dënimeve (1945) dhe në Kodin

⁵ Halili, Ragip. *Kriminologjia*, Prishtinë, 2005, fq, 224.

⁶ Ministria e punës dhe mirëqenies sociale, Instituti i politikës sociale. *Delikuenca e të miturve në Kosovë në periudhën 2003-2004*, Prishtinë, 2005, fq.17.

⁷ Salihu, Ismet. *E drejta penale për të mitur*, Prishtinë, 2005, fq, 17.

Penal (1947), në pjesën e përgjithshme të tij. E tërë materia e së drejtës penale që u dedikohet të miturve u rregullua në tërësi me Kodin penal (1951), ku të miturit ndaheshin në dy kategori, të mitur të rinj (prej 14 deri 16 vjeç) dhe të mitur të rritur (prej 16 deri 18 vjeç). Sipas këtij Kodi ndaj të miturve nuk ka mundur të shqiptohet dënimi me vdekje. Trajtimi penalo-juridik i kryerësve të mitur vazhdimisht është bërë në mënyrë më të favorshme (1959), me ndryshimet që u bënë në Kodin penal (1951). Sipas këtyre ndryshimeve masat edukative u konsideruan si lloje kryesore të sanksioneve penale. Ndaj të miturve të rinj dënimet nuk kanë mundur të shqiptohen, ndaj të miturve të rritur vetëm përjashtimisht ka mundur të shqiptohet burgimi për të mitur⁸.

Në vitin 1977 nxirret Ligji penal i ish-Federatës Jugosllave, që përmbante parimet themelore të trajtimit penalo-juridik të kryerësve të mitur të veprave penale, llojet e masave edukative dhe sanksioneve penale që mund të shqiptoheshin kryerësve të mitur. Në dispozitat e këtij ligji ishte paraparë mundësia e ndryshimit dhe pezullimit të masave edukative dhe burgimit për të mitur. Kurse ligjet penale të republikave dhe krahinave socialiste rregullonin çështjet e kushteve që duhet të përmbusheshin për të mundur gjykata të shqiptonte masat disiplinore, masat edukative dhe burgimin për të mitur⁹. Ky legjislacion u aplikua gjer më 5 prill të vitit 2004¹⁰.

Ligji penal për të mitur i Kosovës u aprovua me 20 prill të vitit 2004 nga PSSP-ja¹¹ dhe në të njëjtën ditë hyri në fuqi¹². Për herë të parë në historinë e Kosovës çështja e trajtimit penalo-juridik të kryerësve të mitur të veprave penale u rregullua me ligj të posaçëm. Personat ndërmjet moshës 14 dhe 18 vjeç quhen të mitur¹³, dhe ndahen në dy kategori:

- Në kategorinë parë hyjnë të miturit e rinj (prej 14 deri 16 vjeç)¹⁴, ndaj tyre mund të shqiptohen vetëm masat e diversitetit dhe masat edukative, dënimet kurrsesi nuk mund të shqiptohen¹⁵.

⁸ Salihu, Ismet. *Vepra e cituar*, fq. 18.

⁹ Salihu, Ismet. *Vepra e cituar*, fq. 19.

¹⁰ Salihu, Ismet. *Vepra e cituar*, fq. 19.

¹¹ PSSP-ja d,m,th Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së.

¹² Salihu, Ismet. *E drejta penale për të mitur*, Prishtinë, 2005, fq. 20.

¹³ Ligji Penal për të Mitur i Kosovës, neni. 2. par, 2.

¹⁴ Salihu, Ismet. *E drejta penale për të mitur*, Prishtinë, 2005, fq. 30.

¹⁵ Ligji Penal për të Mitur i Kosovës, neni, 6, par, 3.

- Në kategorinë e dytë hyjnë të miturit e rritur (prej 16 deri 18 vjeç), ndaj tyre parimisht shqiptohen masat e diversitetit dhe masat edukative, dhe në rastet e caktuara me ligj ndaj të miturve të rritur mund të shqiptohen edhe dënimet¹⁶, ndaj të miturve të rritur është paraparë mundësia e shqiptimit edhe të dënimit me kusht¹⁷.

Ligji Penal për të Mitur njih edhe kategorinë tjetër të personave nga mosha 18 deri 21 vjet të quajtur madhorë të rinj¹⁸. Ndaj tyre gjykata mund të shqiptoj masat dhe dënimet e përcaktuar në Ligjin penal për të mitur, nëse çmon se qëllimi që do të arrihej me shqiptimin e burgimit, gjithashtu do të arrihej me shqiptimin e masës dhe dënimit, duke marrë parasysh rrethanat në të cilat është kryere vepra penale, mendimin e ekspertit lidhur me zhvillimin psikologjik të madhorit të ri dhe interesin e tij më të mirë¹⁹.

Më hyrjen në fuqi të Kodit të Drejtësisë për të Mitur i cili u aprovuar me 8 korrik 2010 nga Kuvendi i Kosovës, ka pushuar së vepruari Ligji penal për të mitur i aprovuar në kohën e UNMIK-ut, (Rregulloren nr. 2004/8 të datë 20.04.2004)²⁰. Personat nën moshën katërmëdhjetë vjet nuk i nënshtrohen përgjegjësisë penale. Sipas këtij kodi, për personat të cilët janë nën moshën 14 vjet në kohën e kryerjes së veprës penale, ndaj tyre nuk fillon procedura gjyqësore, nëse procedura ka filluar ajo pushohet menjëherë dhe organi i kujdestarisë njoftohet për rastin²¹.

Gjithashtu me datë 14 shtator 2018, është aprovuar Kodi i Drejtësisë për të mitur, i cili ka hyrë në fuqi me datë 18 tetor 2018, i cili është në fuqi edhe sot. Sa i përket kategorizimit të të miturve, edhe ky kod e ka të rregulluar këtë çështje, si kodi paraprak.

Sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur personat ndërmjet moshës 14 dhe 18 vjet quhen të mitur²².

Këta ndahen në dy kategori:-

¹⁶ Salihu, Ismet. *E drejta penale për të mitur*, Prishtinë, 2005, fq. 31.

¹⁷ Ligji Penal për të Mitur i Kosovës, neni, 6, par.5.

¹⁸ Ibid, neni 2, par. 3.

¹⁹ Salihu, Ismet. *E drejta penale për të mitur*, Prishtinë, 2005, fq. 32.

²⁰ Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni 161.

²¹ Ibid, neni 41, par.1.

²² Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni 3, par.1, 1.2.

1. Prej moshës 14 deri në 16 vjet quhen të mitur të rinj²³. Ndaj tyre të shqiptohen vetëm masat e diversitetit dhe masat edukative, kurrsesi dënimet nuk shqiptohen.
2. Prej moshës 16 dhe 18 vjet të quajtur të mitur të rritur²⁴. Ndaj tyre shqiptohen masat e diversitetit dhe masat edukative. Në raste të caktuara me ligj të miturve të rritur u shqiptohen edhe dënimet²⁵ dhe dënimi me kusht në pajtim me Kodin Penal të Kosovës²⁶.

KDM e njeh edhe kategorinë e personave të moshës ndërmjet 18 dhe 21 vjet të quajtur madhorë të rinj²⁷. Ndaj tyre gjykata mund të shqiptoj masë ose dënim, nëse e çmon se qëllimi që do të arrihej me shqiptimin e burgimit, do të arrihej edhe me shqiptimin e masës dhe dënimit, duke marrë parasysh rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, dhe interesin e tij më të mirë²⁸.

2. Llojet e masave dhe dënimeve ndaj miturve sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur në Kosovë

Sipas KDM, ndaj kryerësve të mitur të veprave penale masat që mund t'u shqiptohen janë: masat e diversitetit dhe masat edukative²⁹. Dënimet që mund të shqiptohen ndaj të miturve janë:

1. gjoba,
2. urdhri për punë në dobi të përgjithshme,
3. burgimi për të mitur³⁰,
4. dënimi me kusht³¹,
5. disa nga dënimet plotësuese në pajtim me nenet 64-69 të Kodit Penal të Kosovës³² dhe

²³ Ibid, neni 3, par.1, 1.3

²⁴ Ibid, neni 3, par.1, 1.4.

²⁵ Salihu, Ismet. *E drejta penale për të mitur*, Prishtinë, 2005, fq.31.

²⁶ Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni, 7, par.5.

²⁷ Ibid, neni 3, par.1, 1.5.

²⁸ Ibid, neni, 16, par. 1.

²⁹ Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni 12, par. 1.

³⁰ Ibid, neni 12, par.2.

³¹ Ibid, neni 12, par.5.

³² Ibid, neni 39.

6. masat e trajtimit të detyrueshëm neni 38 Kodi i Drejtësisë për të Mitur. Cila nga masat e diversitetit apo masat edukative duhet të shqiptohen ndaj kryerësit të mitur të veprës penale, nuk varet prej llojit dhe peshës së veprës penale, por nga vetitë e kryerësit të mitur dhe nevoja për edukimin, rehabilitimin dhe zhvillimin e tij të drejtë. Kryerësve të mituri të rritur prej gjashtëmbëdhjetë deri tetëmbëdhjetë vjet, në raste të rënda dhe të veçanta ndaj tyre mund të shqiptohet edhe burgimi për të mitur i cili ka shumë tipare të masave edukuese³³.

2.1 Nocioni dhe llojet e masave të diversitetit

Masat e diversitetit janë lloj i masave jo penale të parapara në Kreun IV të KDM, të cilat mund të shqiptohen ndaj kryerësve të mitur të veprave penale. Këto masa mund të aplikohen në rastet e veprave të lehta penale, që është paraparë dënimi me gjobë apo me burgim deri në 3 vite, ose për vepër penale të kryer nga pakujdesia për të cilën është paraparë dënimi deri në pesë vite burgim, me përjashtim të atyre të cilat sjellin si pasojë vdekjen³⁴. Pra synohet parandalimi i zhvillimit të procedurës penale ndaj të miturit çdo herë kur një gjë e tillë është e mundur, rehabilitimi dhe ri integrimi i të miturit në bashkësinë e tij si dhe parandalimi i sjelljeve recidiviste.

Kodi i Drejtësisë për të Mitur (neni 20), ka paraparë llojet e masave të diversitetit që mund të shqiptohen ndaj kryerësve të mitur, e të cilat janë: *pajtimi në mes të kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar, duke përfshirë edhe kërkim faljen nga i mituri ndaj palës së dëmtuar; pajtimi ndërmjet të miturit dhe familjes së tij; kompensimi i dëmit palës së dëmtuar në bazë të marrëveshjes së ndërsjellët ndërmjet të dëmtuarit, të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, në përputhje me situatën financiare të të miturit; vijimi i rregullt në shkollë; pranimi i punësimit apo aftësimit në një profesion adekuat me aftësitë dhe shkathtësitë e tij; kryerja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme në pajtim me aftësitë e kryerësit të mitur për kryerjen e punës së tillë. Kjo masë mund të shqiptohet me pëlqimin e të miturit në kohëzgjatje prej dhjetë (10) deri në gjashtëdhjetë (60) orë; edukimi në rregullat e trafikut; këshillimi psikologjik; angazhimi në aktivitete bamirëse; pagesa e një shume të caktuar të të hollave të destinuara për qëllime bamirëse apo në programin*

³³ Salihu, Ismet. *E drejta penale (pjesa e përgjithshme)*, Prishtinë, 2005, fq. 430.

³⁴ Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni 21, par.1.

për kompensimin e viktimave në përputhje me situatën financiare të miturit; angazhimi në aktivitete sportive dhe rekreative; këshillimi ndërmjet familjeve të të miturve; të përmbahet nga çfarëdo kontakti me individë të caktuar që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri; të mos vizitohet vende ose mjedise të caktuara që mund të kenë ndikim tek i mituri; të përmbahet nga përdorimi i drogës apo alkoolit, dhe vërejtja policore.

2.2 Nocioni i masave edukative

Masat edukative janë lloje i posaçëm i sanksioneve penale të karakterit edukues-pedagogjik, që u dedikohen kryesisht kryerësve të mitur të veprave penale³⁵. Masat edukative u shqiptohen personave të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale gjenden ndërmjet moshës katërmëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjet. Në KDM masat edukative janë të parapara në Kreun V.

Me këto masa edukative mundësohet që ndaj të miturve, pa i izoluar nga mjedisi familjar, shkollor dhe social, të ushtrohet rehabilitimi, mbrojtja, ndihma dhe edukimi dhe të përgatiten për të ardhmen si anëtarë të dobishëm të shoqërisë dhe të veprojnë në harmoni me normat ligjore³⁶.

2.3. Qëllimi i masave edukative

Qëllimi i masave edukative është të kontribuojë në rehabilitimin, riedukimin, risocializimin dhe zhvillimin adekuat të kryerësit të mitur: duke ofruar mbrojtje, ndihmë dhe mbikëqyrje, duke siguruar edukim dhe aftësim profesional, duke zhvilluar përgjegjësinë e tij personale, dhe kështu duke ndaluar sjelljet recidiviste kështu që në të ardhmen kryerësi i mitur të bëhet i dobishëm për vetveten, familjen e tij, për shoqërinë dhe çdo herë të veprojnë në përputhje me normat ligjore³⁷.

2.4 Llojet e masave edukative

Masat edukative që mund tu shqiptohen të miturve, janë: **Qortimi gjyqësor; Masat e mbikëqyrjes së shtuar, dhe Masat institucionale**³⁸.

³⁵ Salihu, Ismet. *E drejta penale (pjesa e përgjithshme)*, Prishtinë, 2005, fq.427.

³⁶ Ibid, fq. 39.

³⁷ Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni 22.

³⁸ Kodi i Drejtësisë për të mitur, neni 23, par.1.

Masat e mbikëqyrjes së shtuar janë: **Mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues ose kujdestarit të të miturit; Mbikëqyrja e shtuar nga familja tjetër; dhe Mbikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë³⁹.**

Në masat institucionale edukative bëjnë pjesë: **Dërgimi i të miturit në institucion edukues-korrektues; dhe Dërgimi i kryerësit të mitur në institucionin e kujdesit të posaçëm⁴⁰.**

2.4.1 Qortimi gjyqësor

Qortimi gjyqësor është masë që shqiptohet për vepra të lehta penale⁴¹, në rastet kur nuk ka nevojë të shqiptohen masa të tjera më të rënda të parapara në Kodin e Drejtësisë për të Mitur. Rrjedhimisht gjykata e shqipton masën e qortimit gjyqësor kur masa e tillë konsiderohet e mjaftueshme dhe në interes të të miturit për të ndikuar pozitivisht në sjelljen e tij⁴².

Më rastin e shqiptimit të kësaj masë gjykata i bën me dije të miturit se ka kryer vepër të dëmshme dhe të rrezikshme e cila përbën vepër penale, dhe në të njëjtë kohë i tërheq vërejtjen se nëse përsëri kryen vepër të tillë, gjykata do të shqiptoi një masë apo dënim me të rëndë⁴³. Qortimi gjyqësor parimisht mund t'i shqiptohet të miturit të ri dhe të miturit të rritur⁴⁴.

³⁹ Ibid, neni 23, par.3.

⁴⁰ Ibid, neni 23, par .4.

⁴¹ Halili, Ragip. *Penologjia*, Prishtinë, 2005, fq, 259.

⁴² Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni 24, par. 1.

⁴³ Ibid, neni 24, par.2.

⁴⁴ Trupi gjykues për të mitur i Gjkata Komunale në Pejë si gjykatë e shkallës së parë në lëndën penale

PM.nr.39/10, ndaj të miturit N.N nga Peja duke vendosur sipas propozimeve për shqiptimin e masës edukative të

PPK në Pejë, PPM, nr. 154/10 të dt 10.12.2010 për shkak të veprës penale të vjedhjes nga neni 252 par.1 të KPK-

së në shqyrtimin gjyqësor jo-publik me dt 19.01.20011, merr Aktvendim: të miturit N N , i lindur në

fsh..., kk. Pejë, i shqiptohet Masa Disiplinore-Qortimi Gjyqësorë në bazë të nenit 21 të Kodit të Drejtësisë për

të Mitur. Me arsyetim se i mituri e ka pranuar fajin për veprën penale të kryer dhe Gjkata krijon bindjen se masa

e tillë është e mjaftueshme dhe në interes të miturit për të ndikuar pozitivisht në sjelljet e tij, me këtë masë

disiplinore do të arrihet qëllimi edukativ i paraparë në nenin 19 të KDM-së e cila masë disiplinore do të ndikoj

2.4.2 Masat edukative të mbikëqyrjes së shtuar

Në sistemin e masave edukative, masat e mbikëqyrjes së shtuar janë masat më të rëndësishme edukative jo -institucionale. Këto masa më së shumti janë shqiptuar në praktikën gjyqësore ndaj kryerësve të mitur të veprave penale, interesat e të cilit nuk kërkojnë izolimin e tyre nga mjedisi i mëparshëm dhe të mbahen më masë afatgjate. Me këto masa të miturit i tërhiqet vërejtja në sjelljen e keqe dhe të dëmshme. Këto masa ekzekutohen në liri dhe kryerësi i veprës penale edhe më tutje qëndron në ambientin familjar ose në një ambient tjetër në kushte dhe në rrethana të lira. Kjo rrethanë ndikon në mënyrë pozitive në riedukimin dhe përmirësimin e këtyre personave⁴⁵.

Kriteret e përgjithshme për shqiptimin e masave edukative të mbikëqyrjes së shtuar janë:

- nevoja e të miturit që t'i tërhiqet vërejtja me anë të masës edukative, metë cilën i bëhet me dije se më sjelljen e tij ka kryer një vepër të dëmshme e cila me ligj është e paraparë si vepër penale;
- nevoja e të miturit për edukim, riedukim dhe zhvillimin e tij të drejtë, qëllim ky i cili mund të realizohet në mjedisin e mëparshëm të të miturit;
- nevoja e të miturit që sjelljet e tij, të cilat e kanë shpënë në kryerjen e veprës penale, të përmirësohen me anë të programit afatshkurtër apo afatgjatë;
- nevoja e të miturit që me këto masa t'i mundësohet arsimimi dhe aftësimi profesional⁴⁶.

Kodi i Drejtësisë për të Mitur njih tri lloje të masave edukuese të mbikëqyrjes së shtuar: mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, nga prindi adoptues ose kujdestarit të të miturit; mbikëqyrja e shtuar nga familja tjetër dhe mbikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë. Kohëzgjatje e kësaj mase nuk mund të jetë më e shkurtër se tre muaj apo më e gjatë se dy vjet⁴⁷.

pozitivisht në të ardhmen në zhvillimin e përgjegjësisë penale dhe ndalimin e sjelljeve recidiviste.

⁴⁵ Halili, Ragnip. *Penologjia*, Prishtinë, 2005, fq. 261.

⁴⁶ Salihu, Ismet. *E drejta penale për të mitur*, Prishtinë, 2005, fq.43.

⁴⁷ Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni 23, par.3.

2.4.3 Mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues ose Kujdestarit

Qëllimi i kësaj mase të mbikëqyrjes së shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues ose kujdestarit është të shtohet mbikëqyrja në jetën dhe sjelljen e të miturit nga ata persona të cilët kanë obligim ligjor të kujdesën për edukimin e tij dhe zhvillimin e drejtë të tij⁴⁸.

Gjykata do ta shqiptojë këtë masë, në rast kur prindi, prindi adoptues ose kujdestari e kanë lënë pas dore të miturin e tyre në edukimin e drejtë, janë treguar të pakujdesshëm në mbikëqyrjen e të miturit, edhe pse kanë pasur mundësi për të ushtruar mbikëqyrje adekuat, e si rezultat i veprimit të prindërve i mituri ka kryer vepër konkrete penale, dhe masa e tillë është në interes më të mire të të miturit⁴⁹.

2.4.4 Mbikëqyrja e shtuar nga familja e tjetër

Mbikëqyrja e shtuar nga familja e tjetër është paraparë në nenin 26 të KDM. Shqiptimi i kësaj mase edukative ndaj personave të mitur vjen në shprehje nëse janë plotësuar kushtet e përgjithshme për ushtrimin e mbikëqyrjes së shtuar, ndërsa prindi, prindi adoptues apo kujdestari janë të paaftë për kryerjen e mbikëqyrjes së shtuar për shkak të paaftësisë fizike, psikike, pranisë së alkoolizmit apo narkomanisë dhe masa e tillë është në interes më të mirë të të miturit⁵⁰. Këtë masë edukative mbikëqyrja e shtuar nga familja e tjetër gjykata e shqipton pas dëgjimit të prindit, prindit adoptues apo kujdestarit të të miturit⁵¹ dhe nëse familja e tjetër është ambient i përshtatshëm për ushtrimin e mbikëqyrjes së shtuar dhe vullnetarisht e pranon këtë detyrë.

⁴⁸ Salihu, Ismet. *E drejta penale për të mitur*, Prishtinë, 2005, fq. 44.

⁴⁹ Trupi gjykues për të mitur i Gjykatës Komunale në Pejë në lëndën PPM. nr.67/08 të dt. 10.06.2008, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par. 1. pika 1. lidhur me neni 23 të KPK-së në shqyrtim gjyqësor jo-publik konform neni 20 të Ligjit Penal për të mitur të Kosovës ndaj të miturit N.N nga Peja merr aktvendim për shqiptimin e masës edukative: Mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues ose kujdestarit. Ku verifikimin e ekzekutimit të kësaj mase edukative e bënë Shërbimi Sprovues i Kosovës, Zyra në Pejë. Shërbimi Sprovues në Pejë me datën . 20.10.2010. dërgon Raport në Gjykatën Komunale në Pejë lidhur me ekzekutimin e masës edukative të shqiptuar ndaj të miturit N.N nga Peja, njofton se është bërë ekzekutimi i masës edukative në periudhën kohore 23.10.08 – 20.10.10, është ndërprerë pasi që tek i mituri është arritur efekti edukues.

⁵⁰ Halili, Ragip. *Penologjia*, Prishtinë, 2005, fq.261.

⁵¹ Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni 26, par . 1.

Gjykata me rastin e caktimit të familjes në të cilën vendoset i mituri ndaj të cilit është shqiptuar kjo masë edukative, merr parasysh propozimin e Shërbimit Sprovues përparësi ka familja me të cilën i mituri ka lidhje farefisnore⁵².

Shërbimi Sprovues dhe familja të cilës i besohet i mituri lidhin një kontratë me shkrim në të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e përbashkëta, familja në të cilën është vendosur i mituri e lejon verifikimin e ekzekutimit të masë edukative nga shërbimi Sprovues, kur një verifikim i tillë urdhërohet nga gjykata⁵³. Kjo masë mund të zgjasë së paku 3 muaj dhe më së tepërmi 2 vjet.

2.4.5 Mbikëqyrja e shtuar nga Organi i Kujdestarisë

Kjo masë edukuese është lloji i tretë i mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturit e cila është e paraparë në nenin 27 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

Gjykata e shqipton këtë masë pas dëgjimit të prindit, prindit adoptues apo kujdestarit, konstaton se ata nuk janë në gjendje të ushtrojnë mbikëqyrjen e shtuar ndaj të miturit, ndërsa shqiptimi i masës është në interes të të miturit⁵⁴. Organi i kujdestarisë që ka kompetencë të ekzekutoj këtë masë edukative, menjëherë pas marrjes së aktvendimit për shqiptimin e kësaj masë edukuese e cakton zyrtarin përgjegjës nga organi i kujdestarisë për ekzekutimin masës dhe lidhur më këtë e informon gjykatën kompetente⁵⁵.

Organi i kujdestarisë duhet të merret më familjen dhe të miturin për t'i trajtuar shkaqet kryesore dhe për të parandaluar përsëritjen e veprës⁵⁶. Në ekzekutimin e kësaj masë me organin e kujdestarisë bashkëpunojnë gjykatat, prokuroria dhe institucione e tjera.

Më rastin e shqiptimit të kësaj mase, Gjykata mund t'i caktojë këto detyra Organit të kujdestarisë: Mbikëqyrjen e edukimit të të miturit, lehtësimin e qasjes në aftësim profesional dhe punësimin, sigurimin e largimit të të miturit nga çfarëdo ndikimi negative, lehtësimin e qasjes në kujdes të nevojshëm mjekësor, ofrimin e zgjidhjeve të mundshme për ndonjë problem që mund të

⁵² Salihu, Ismet. *E drejta penale për të mitur*, Prishtinë, 2005, fq. 44.

⁵³ Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni 80.

⁵⁴ Halili, Ragip. *Penologjia*, Prishtinë, 2005, fq. 262.

⁵⁵ Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni 81, par. 2.

⁵⁶ *Udhëzime për punëtorët social, fq. 6*. Ky publikim është botuar me ndihmën e Unionit Evropian, Prishtinë, 2006.

shfaqet në jetën e të miturit dhe detyra të tjera që gjykata i çmon se do të ishin në interes më të mire të të miturit⁵⁷. Gjykata të miturit mund t'i shqiptoi edhe detyrim të veçantë të paraparë në nenin 28 të KDM. Organi i kujdestarisë ka obligim ligjor t'i raportoj së paku çdo tre (3) muaj gjykatës e cila ka shqiptuar këtë masë edukativ, lidhur me ekzekutimin e saj⁵⁸.

2.4.6 Masat Institucionale edukative

Masat institucionale janë lloji më i rëndë i masave edukative, ku kryerësi i mitur i veprës penale privohet nga liria dhe vendoset në institucione të posaçme më qëllim edukimi dhe rehabilitimi. Këto masa shqiptohen ndaj të miturit interesat e të cilit më së miri përfillen me veçimin e tij nga mjedisi i mëparshëm dhe më masë afatgjate, që të miturit i ofron mundësinë e edukimit, rehabilitimit apo trajtimit.

KDM parasheh 2 lloje të masave edukative institucionale: Dërgimi në institucionin edukues – korrektues dhe dërgimi në institucionin për kujdes të posaçëm⁵⁹. Kur gjykata e cakton masën e dërgimit në institucionin edukativ apo edukativo-korrektues deri në dy vjet, mund të shqiptojë dënim më kusht në pajtim me Kodin Penal të Kosovës⁶⁰.

2.4.7 Dërgimi në institucionin edukativo-korrektues

Dërgimi në institucionin edukativo-korrektues është masa më e rëndë institucionale e cila është paraparë në nenin 29 të KDM. Gjykata i'a shqipton këtë masë të miturit delikuent kur ai ka kryer veprë penale të rëndë të dënueshme me burgim prej më shumë se tre (3) vjet dhe ka nevojë për edukim të specializuar dhe kur masa e tillë është në interesin më të mire të të miturit. Më rastin e shqiptimit të kësaj mase gjykata merr për bazë peshën e veprës penale, natyrën e veprës penale, motivet e kryerjes së veprës penale dhe recidivizmin e kryerësit të mitur⁶¹.

⁵⁷ Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni 27, par.3.

⁵⁸ Ibid, neni 27, par.4.

⁵⁹ Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni 23, par.4.

⁶⁰ Ibid, neni 12, par.5.

⁶¹ Ibid, neni 29.

Kohëzgjatja e kësaj mase nuk mund të jetë më e shkurtër se një (1) vit ose më e gjatë se pesë (5) vjet⁶². Kjo masë edukative ekzekutohet në institucionin i cili është themeluar posaçërisht për këtë qëllim, këto institucione mund të jenë të tipit gjysmë të hapur dhe të hapur. Institucioni edukativo-korrektues personave të mitur u ofron mbrojtje, ndihmë dhe mbikëqyrje me qëllim të edukimit, arsimimit dhe zhvillimit të drejtë të tyre⁶³. Kjo masë zakonisht shqiptohet vetëm ndaj delikuinteve të mitur të cilët janë recidivistë të shumëfishtë apo për vepra me të rënda penale, ku me masa të tjera nuk mund të arrihet riedukimi i të miturit⁶⁴.

2.4.8. Dërgimi në institucionin për kujdes të posaçëm

Dërgimi në institucionin për kujdes të posaçëm është masë institucionale e paraparë në nenin 30 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

Gjykata mund të shqiptojë këtë masë, në vend të masës së dërgimit në institucion edukativo-korrektues me rekomandimin e ekspertit të mjekësisë nëse të miturit i nevojitet një përkujdesje e posaçme për shkak të çrregullimit mendor ose të metave fizike dhe kur kjo është në interes më të mire të të miturit⁶⁵. Kjo masë u shqiptohet atyre të miturve që kanë kryere vepra penale për shkak të çrregullimeve dhe ngecjeve në zhvillimin biopsikikë dhe shpirtërorë siç janë p.sh. personat shurdhmemec, personat e verbër, personat me zhvillim të vonuar psikik dhe personat e mitur me çrregullime të tjera shpirtërore dhe mentale.

Kjo masë ka rëndësi të veçantë për aftësimin dhe rehabilitimin e personave të mitur me aftësi të kufizuar e veçmas për pengimin e aktivitetit të tyre kriminal (recidivizmit). Kohëzgjatja e ekzekutimit të kësaj masë nuk është e caktuar me ligj, gjykata e cila e ka shqiptuar masën, çdo gjashtë muaj e rishikon nevojën për qëndrimin e mëtjeshëm në institucionin e kujdesit të posaçëm si dhe kur arrin moshën tetëmbëdhjetë vjet. Në praktikën gjyqësore kjo masë nuk është

⁶² Ibid, neni 29, par 4.

⁶³ Halili, Ragip. *Penologjia*, Prishtinë, 2005, fq.265.

⁶⁴ Me aktvendimin e Gjykatës Komunale në Pejë, PM.nr.8/2006, ndaj të miturit NN nga fshati..., Komuna e Pejës, i është shqiptuar masa edukative: Dërgimi në institucionin edukativo-korrektues, në Lipjan. ku i mituri do të qëndroj në Institucionin edukativo-korrektues më së paku një (1) vit e më së shumti pesë (5) vjet.

⁶⁵ Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni 30.

shqiptuar në asnjë rast, për shkak se nuk ekzistojnë institucione për ekzekutimin e kësaj masë.

2.4.9 Detyrimet e veçanta lidhur me masat e mbikëqyrjes së shtuar

Sipas nenit 28 të KDM, me rastin e shqiptimit të njëjës nga masat e mbikëqyrjes së shtuar sipas neneve 25, 26 dhe 27 të këtij Kodi, gjykata mund të caktojë edhe më shumë detyrime të veçanta, kur konstaton se është e domosdoshme për ekzekutimin e suksesshëm të masës, e që janë: Personalisht t'i kërkoj falje palës së dëmtuar; Palës së dëmtuar t'ia kompensojë dëmin në pajtim me gjendjen financiare të të miturit; Të vijojë rregullisht shkollimin; Të pranoj punësimin ose të aftësohet për një profesion i cili i përshtatet shkathtësive dhe aftësive të tij; Të përmbahet nga çfarëdo kontakti me individë të caktuar që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri; Të pranojë këshilla psikologjike; Të mos vizitojë vende ose mjedise të caktuara që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri dhe Të përmbahet nga përdorimi i drogës dhe alkoolit⁶⁶. Këto detyrime u ndihmojnë të miturve në edukimin, rehabilitimin, krijimin e shprehive të reja dhe distancimin e plotë nga sjelljet devijonte, pengimin e recidivizmit dhe integrimin e tyre në shoqëri. Gjykata e njofton të miturin se në rast mos përmbushjes së detyrimeve të tilla, masa e shqiptuar e mbikëqyrjes së shtuar do të zëvendësohet me masë tjetër edukative. Mbikëqyrjen se a janë duke u përmbushur obligimet e caktuara e ushtron Shërbimi Sprovues në bashkëpunim me organin e kujdestarisë, policinë dhe prokurorinë dhe kohë pas kohë e informon gjykatën kompetente.

2.4.10 Kriteret themelore me rastin e zgjedhjes së masave edukative

Sipas paragrafit 1 të nenit 12 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, me rastin e zgjedhjes së masës së caktuar të diversitetit apo masës edukative, gjykata duhet të merr parasysh edhe këto kritere dhe rrethana themelore: llojin dhe peshën e veprës penale, moshën e të miturit, nivelin e zhvillimit psikologjik, karakterin dhe prirjet e tij, motivet që e nxitën atë të kryejë veprën penale, edukimin e tij në këtë fazë, mjedisin dhe rrethanat e jetës së tij, nëse është

⁶⁶ Ibid, neni 28. par.2.

shqiptuar masë apo dënim më herët dhe rrethanat e tjera që mund të ndikojnë në shqiptimin e masës apo dënimit.

2.4.11 Rishqyrtimi, zëvendësimi dhe pushimi i ekzekutimit të masave edukative

Gjykata me rastin e shqiptimit të llojit të caktuar të masës edukative e cakton kohëzgjatjen e saj. Me ligj është paraparë mundësia që gjykata çdo 6 muaj ta rishqyrton vendimin e vet dhe varësisht nga sukcesi vendos për ndryshimin apo pushimin e ekzekutimit të masës edukative. Gjykata e përcjell ekzekutimin e masave edukative përmes raporteve të drejtorit të institucionit apo qendrës ku ekzekutohet masa edukative, që i dorëzohen gjykatës çdo 6 muaj dhe vizitave që u bëhen të miturve⁶⁷. Kërkesën për rishqyrtim të ekzekutimit të mëtejme të masës edukative mund të paraqes i mituri, prindi i tij, prindi adoptues apo kujdestari, Shërbimi Sprovues, qendra, institucioni ku ekzekutohet masa edukative. Lidhur më kërkesën e tillë trupi gjykues për të mitur merr vendim brenda tetë ditëve nga pranimi i kërkesës. Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e shkallës së dytë brenda tri ditëve nga pranimi i vendimit.

Gjykata më rastin e rishqyrtimit të masës edukative sipas detyrës zyrtare apo kërkesës së subjekteve të cekura, i merr parasysh raportet e Shërbimit Sprovues dhe ato të drejtorit të qendrës ku ekzekutohet masa edukative institucionale dhe dëgjon të miturin, prindin e tij, prindin adoptues apo kujdestarin, avokatin mbrojtës, prokurorin dhe shërbimin sprovues⁶⁸. Në bazë të rishqyrtimit të vendimit gjykata mund: Të vazhdojë ekzekutimin e mëtejme të masës edukative, Ta pushojë, ta ndalë ekzekutimin e mëtejshëm të masës edukative, Ta zëvendësojë me një masë me të lehtë edukative dhe Të nxjerrë vendim që masa e shqiptuar të mos ekzekutohet.

Përfundimisht nga paragrafi 6 i nenit 93, gjykata masën edukative mund ta zëvendësojë me një masë me të rëndë edukative në rastin kur i mituri nuk i ka përmbushur detyrimet e posaçme të shqiptuara në pajtim me nenin 28 të këtij kodi.

⁶⁷ Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni 93.

⁶⁸ Ibid, neni 93, par.4

Zëvendësimi i masës së shqiptuar edukative mund të bëhet edhe në raste kur ka kaluar një vit nga data prej së cilës vendimi mbi shqiptimin e masës bëhet i formës së prerë, ndërsa ekzekutimi i masës edukative nuk ka filluar⁶⁹.

3. Masat e trajtimit të detyrueshëm

Kodi i Drejtësisë për të Mitur ka paraparë edhe masat e trajtimit të detyrueshëm⁷⁰, që mund t'u shqiptohen kryerësve të mitur të veprave penale, sipas kushteve të përcaktuara në kapitullin 5 të Kodit Penal të Kosovës, të cilat vepra penale i kanë kryer në gjendje të paaftësisë mendore, aftësisë së zvogëluar mendore dhe në varësi të drogave dhe alkoolit. Këto masa janë: Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor; Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri; dhe Trajtimi me anë të rehabilitimit të detyrueshëm të personave të varur nga droga ose alkooli⁷¹.

3.1 Llojet e dënimeve

KDM ka paraparë disa lloje të dënimeve kryesore, dënimeve plotësuese dhe dënimeve alternative që mund të shqiptohen ndaj kryerësve të mitur të veprave penale. Dënimet kryesore të cilat mund të shqiptohen ndaj të miturve janë: Gjoha; Urdhri për punë në dobi të përgjithshme dhe Burgimi për të mitur⁷². Kur gjykata e konsideron të arsyeshme, kryerësit të mitur së bashku me dënimin kryesor mund t'i shqiptojë edhe dënim plotësues në pajtim me nenet 62-71 të Kodit Penal të Kosovës⁷³, të cilat janë: Urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit; Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik; Ndalimi i ushtrimit të profesionit, i veprimtarisë ose detyrës; Ndalimi i drejtimit të automjetit; Marrja e lejes së vozitjes; Konfiskimi⁷⁴.

⁶⁹ Ibid, neni 94, par.2

⁷⁰ Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni 38.

⁷¹ Kodi Penal i Kosovës, neni 88, par.1.

⁷² Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni 12, par.2.

⁷³ Ibid, neni 39, par.1.

⁷⁴ Kodi Penal i Kosovës, neni 54, par.2.

Përfundim

1. Drejtësia penale për të mitur në Kosovë është e rregulluar me KDM që përmban dispozita të natyrës penale materiale, procedurale dhe ekzekutimit të sanksioneve penale.
2. Kodi i Drejtësisë për të Mitur në Kreun IV ka paraparë masat e diversitetit, të cilat janë një lloj i masave jo penale, të cilat mund të shqiptohen ndaj kryerësve të mitur të veprave penale, të cilat në këtë punim janë trajtuar në mënyrë përshkruese.
3. Këto masa mund të aplikohen në rastet e veprave të lehta penale, për të cilat është paraparë dënimi me gjobë apo me burgim deri në tri vite ose për veprat penale të kryera nga pakujdesia për të cilat është paraparë dënimi deri në pesë vite burgim, me përjashtim të atyre të cilat sjellin si pasojë vdekjen.
4. Me shqiptimin e këtyre masave synohet parandalimi i zhvillimit të procedurës penale ndaj të miturit çdo herë kur një gjë e tillë është e mundur, rehabilitimin dhe riintegrimi i të miturit në bashkësinë e tij me qëllim të parandalimit të sjelljeve recidiviste.. Masat e diversitetit janë të ndara në tetë lloje.
5. Kodi i Drejtësisë për të Mitur në Kreun V ka paraparë masat edukative të cilat janë lloji kryesor i sanksioneve penale që mund të shqiptohen ndaj kryerësve të mitur të veprave penale, të cilat kanë një rëndësi të veçantë pasi që me këto masa të miturve u mundësohet edukimi, rehabilitimi në të shumtën e rasteve pa i izoluar nga mjedisi i deriatëhershëm familjar dhe social. Në nenin 20 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur janë paraparë tetë llojet e masave edukative të cilat janë sistemuar në tri grupe: masa disiplinore, masa të mbikëqyrjes së shtuar dhe masa institucionale, të cilat në këtë punim janë trajtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse duke filluar nga përkufizimi i masave edukative, llojet, kushtet në të cilat shqiptohen, qëllimi i shqiptimit të tyre, procedura dhe kompetenca e shqiptimit të tyre. Në aspektin praktik në këtë punim janë paraqitur raste nga praktika gjyqësore e shqiptimit të masave edukative ndaj personave të mitur.

6. Masat disiplinore janë: qortimi gjyqësor dhe dërgimi në qendër disiplinore.
7. Masat e mbikëqyrjes së shtuar janë: mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues, ose kujdestarit të të miturit; mbikëqyrja e shtuar nga familja e tjetër dhe mbikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë. Masat institucionale janë: dërgimi i të miturit në institucionin edukativ; dërgimi i të miturit në institucionin edukativo-korrektues dhe dërgimi i kryerësit të mitur në institucionin e kujdesit të posaçëm. Dy grupet e para të masave edukative, masat disiplinore dhe masat e mbikëqyrjes së shtuar ekzekutohen në liri.
8. Ndërsa masat institucionale ekzekutohen duke e veçuar të miturin nga mjedisi i tij i mëparshëm familjar dhe social, duke vendosur në institucionet e caktuara edukative, me masat institucionale kryerësit të mitur të veprës penale i merret liria e lëvizjes. Masat edukative shqiptohen për veprat penale që është paraparë dënimi deri në pesë vite burgim.
9. Kodi i Drejtësisë për të Mitur gjykatave u ofron mundësi të shqiptojë masën edukative e cila është në interesin më të mirë të të miturit.

Bibliografia

Libra dhe punime:

- Salihu, Ismet. *E drejta penale për të mitur*, Prishtinë 2005.
- Salihu, Ismet. *E drejta penale, Pjesa e përgjithshme*, Prishtinë 2005.
- Salihu, Ismet. *E drejta penale, Pjesa e posaqm*, Prishtinë, 2006.
- Sahiti, Ejup. *E drejta e procedurës penale*, Prishtinë, 2005.
- Sahiti, Ejup. *Psikologjia gjyqësore*, Prishtinë, 2007.
- Halili, Ragip. *Kriminologjia*, Prishtinë, 2005.
- Halili, Ragip. *Penologjia*, Prishtinë 2005.
- Halili, Ragip. *Viktimologjia*, Prishtinë, 2007.
- Latifi, Vesel. *Kriminalistika*, Prishtinë, 2006.

- Ukaj Bajram, Sanksionet penale ndaj të miturve në Ligjin Penal për të Mitur të Kosovë të vitit 2004, *E drejta nr1-2/2008*, Prishtinë 2008.
- Ukaj Bajram, *Kundërvajtjet në lëmin penale./ Leksione të autorizuar*, Prishtinë 2010.
- *Udhëzues për punëtorët social*, Ky publikim u botua me ndihmën e Unionit Evropian, Prishtinë, 2006
- Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, Instituti i Politikës Sociale. *Delikuenca e të miturve në Kosovë në periudhën 2003-2004*, Prishtinë, 2005.
- Hajdari, Azem. *E drejta e procedurës penale e të miturve* (me Ligjin Penal për të Mitur), Prishtinë, 2005.

Ligje, rregullore dhe dokumente ndërkombëtare:

- Kodi i Drejtësisë për të Mitur.
- Ligji Penal për të mitur i Kosovës i aprovuar me 20 prill 2004.
- Kodi Penal i Kosovës i aprovuar me 20 Prill 2012.
- Kodi i Procedurës Penale i aprovuar me 13 Dhjetor 2012
- Kodi Penal i Kosovës, i aprovuar me 6 Korrik 2003.
- Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, i aprovuar me 6 korrik 2003.
- Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, (Rregullorja e UNMIK-u 2004/46, 19 nëntor 2004).
- Konventa për të drejtat e fëmijëve e miratuar nga Asambleja e përgjithshme e OKB-së me 20 nëntor 1989.
- Rregullorja mbi procedurën penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore, 24 Gusht 2004).
- Rregullat standarde minimale të Kombve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të Mitur, (Rregullat e Pekinit), Rezoluta e asamblesë së përgjithshme 40/33, 29 nëntor 1985.
- Rregullat Standarde Minimale për Masat jo-ndëshkimore (Rregullat e Tokios), Rezoluta e Asamblesë së përgjithshme 45/110, 14 dhjetor 1990.

Aktvendime

- Aktvendimi PM. nr. 9/08 i datës 03.04.2008. i Gjykatës Komunale në Pejë.
- Aktvendimi PM. nr. 39/10 i datës 19.01.2011. i Gjykatës Komunale në Pejë.
- Aktvendimi PM. nr. 8/06 i datës 24.10.2008. i Gjykatës Komunale në Pejë.
- Aktvendimi PM. nr. 16/08 i datës 23.10.2008. i Gjykatës Komunale në Pejë.
- Aktvendimi PM. nr. 27/08 i datës 23.10.2008. i Gjykatës Komunale në Pejë.
- Aktvendimi PM. nr. 29/06 i datës 21.02.2007. i Gjykatës Komunale në Pejë.

Akademia e Drejtësisë
<https://ad.rks-gov.net>
infoad@rks-gov.net
Rr. "Muharrem Fejza"-Prishtinë
Tel:+383 38 200 18 660